

# TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE

MANUAL PËR GJYQTARË, PROKURORË  
DHE PROFESIONISTË TË TJERË LIGJORË





# TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE



MANUAL PËR GJYQTARË, PROKURORË  
DHE PROFESIONISTË TË TJERË LIGJORË

## **@ Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 2021**

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Materiali që përmban ky botim mund të citohet ose të rishtypet, me kusht që të njihet autorësia e tij dhe një kopje e botimit që përmban materialin e rishtypur t'i dërgohet Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Çdo përdorim tjetër i këtij materiali, që përfshin, por nuk kufizohet në përdorimin komercial apo në krijimin e punimeve që rrjedhin nga ky botim, kërkon lejen me shkrim të Prezencës së OSBE-së.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Autorët: David Mancini, Prokuror, Prokuroria e Aquilla-s, Itali  
Sander Simoni, Gjyqtar, Gjykata e Lartë e Shqipërisë  
Prof. Dr. Aurela Anastasi  
Prof. Dr. Arta Mandro  
Prof. Dr. Evis Alimehmeti  
Juliana Rexha, Oficere Kombëtare kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore,  
Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

ISBN: 978-9928-294-71-5

Ky botim u realizua nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri në kuadrin e Programit "Transformimi i përgjigjes kombëtare ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në dhe nga Shqipëria", zbatuar nga gjashtë organizata lokale dhe ndërkombëtare: UNICEF-i në Shqipëri, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Terre des Homme, Tjetër Vizion, Vatra dhe Të Ndryshëm dhe të Barabartë.

Ky dokument u financua nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, gjithsesi pikëpamjet e shprehura në të nuk reflektojnë domosdoshmërisht politikat zyrtare të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

# PËRMBAJTJA

Shkurtime.....	7
Hyrje.....	9
<b>KREU I</b>	
<b>Mbi konceptin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore .....</b>	<b>13</b>
1.1 Informacion i përgjithshëm mbi trafikimin e qenieve njerëzore.....	13
1.2 Përkufizimi i trafikimit të qenieve njerëzore dhe kuadri ligjor ndërkombëtar .....	14
1.2.1 Një vështrim i shkurtër historik mbi instrumentet ndërkombëtare në fushën e masave kundër trafikimit.....	15
1.3 Parimet e përgjithshme të zhvilluara nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut .....	20
1.3.1 Interpretimi homogjen i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNJ) .....	20
1.3.2 Jurisprudenca e GjEDNJ-së në lidhje me trafikimin dhe me përkufizimin e tij.....	22
1.3.2 Detyrimet pozitive që rrjedhin nga neni 4 i KEDNJ .....	25
<b>KREU II</b>	
<b>Zbërthimi i veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore.....</b>	<b>29</b>
2. 1 Elementët e veprës penale .....	29
• Shfrytëzimi i prostitucionit të personave të tjerë dhe forma të tjera të shfrytëzimit seksual .....	34
• Puna e detyruar (shfrytëzimi për punë).....	34
• Puna e detyruar e fëmijëve .....	36
• Skllavëria ose praktika të ngjashme me skllavërinë .....	37
2. 2 Dallimet dhe të përbashkëtat e veprave penale të trafikimit të personave dhe veprave të emigracionit të paligjshëm (njohur ndryshe si kontrabandimi i emigrantëve) .....	42
<b>KREU III</b>	
<b>KONCEPTI I TRAFIKIMIT SIPAS LEGJISLACIONIN PENAL SHQIPTAR .....</b>	<b>45</b>
3. 1 Koncepti i trafikimit në legjislacionin penal shqiptar.....	45
3.1.1 Trafikimi i brendshëm sipas Kodit tonë Penal .....	52
3.1.2. Dallimi ndërmjet trafikimit të personave të rritur dhe shfrytëzimit të prostitucionit.....	53
<b>KREU IV</b>	
<b>TRAFIKIMI I FËMIJËVE .....</b>	<b>55</b>
4.1 Legjislacioni mbi trafikimin e fëmijëve.....	55
4.2 Përkufizimi i trafikimit të fëmijëve .....	57
4.2.1 Shfrytëzimi i fëmijëve .....	57
4.2.2 Shfrytëzimi si element i trafikimit .....	58
4.2.3 Lypja e detyruar.....	60
4.2.4. Dallimi ndërmjet trafikimit të të miturit nga keqtrajtimi i të miturit (lypja e detyruar apo shfrytëzimi për punë të detyruar) .....	62
4.3 Trafikimi i fëmijëve si një shkelje e të drejtave të fëmijëve.....	63
4.4 Parimet që udhëheqin mbrojtjen e fëmijëve viktime të trafikimit.....	64
v. Interesi më i lartë i fëmijës .....	64
v. Mosdiskriminimi .....	65
v. Respektimi i mendimit të fëmijës .....	65
4.5 Dëmet që pësojnë fëmijët e trafikuar gjatë dhe pas trafikimit .....	65
4. 6 Mbrojtja e viktimes së mitur gjatë hetimit të veprës penale të trafikimit të fëmijëve .....	66

<b>KREU V</b>	
<b>IDENTIFIKIMI .....</b>	<b>71</b>
5.1 Identifikimi i viktimave si një kusht për hetimin e trafikimit të qenieve njerëzore.....	71
5.1.1 Përkufizimi i termit viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore.....	72
5.2 Identifikimi i viktimës së mundshme ose viktimës së trafikimit në Shqipëri.....	74
5.3 Identifikimi i fëmijës viktimë e trafikimit.....	75
<b>KREU VI</b>	
<b>HETIMI DHE NDJEKJA PENALE .....</b>	<b>79</b>
6.1 Objekti i hetimit dhe ndjekjes penale .....	79
6.1.1 Hetimet proaktive dhe bazuar në të drejtat e viktimës .....	79
• Survejimi elektronik.....	81
• Përdorimi i informatorëve.....	81
• Operacionet e infiltuara.....	82
6.1.2 Hetimi financiar.....	82
6.2 Bashkëpunimi me agjencitë e tjera për hetimin dhe ndjekjen penale.....	84
6.3 Viktima në qendër të veprimeve në luftën kundër trafikimit .....	84
6.3.1 Kuadri ligjor ndërkombëtar për mbrojtjen dhe asistencën ndaj viktimave.....	86
6.3.2 Detyrimet e shteteve për asistencën për viktimat .....	87
6.4 Qasja përmes bashkëpunimit të agjencive.....	90
6.4.1 Mekanizmi Kombëtar i Referimit .....	90
6.4.2 Mekanizmi Kombëtar i Referimit në Shqipëri.....	90
6.5 Koncepti i parimit të përjashtimit nga dënimi .....	91
6.5.1 Përjashtimi nga dënimi në instrumentet kryesore ligjore rajonale dhe ndërkombëtare.....	92
6.5.2 Zbatimi praktik i parimit të përjashtimit nga dënimi.....	93
6.5.3 Dispozita e përjashtimit nga dënimi në legjisllacionin shqiptar .....	94
<b>KREU VII</b>	
<b>POZICIONI PROCEDURAL DHE MBËSHTETJA E VIKTIMAVE GJATË GJYKIMIT TË ÇËSHTJEVE</b>	
<b>TË TRAFIKIMIT .....</b>	<b>97</b>
7.1 Çështje të gjyqimit të veprave penale të trafikimit dhe kompetencës lëndore të tyre. Ndryshimet e reja ligjore në legjisllacionin procedural. ....	97
7.2 Ndryshimet e reja në legjisllacionin tonë penal dhe procedural .....	97
7.3 Gjykimi i veprave penale të trafikimit dhe të drejtat e viktimave gjatë procesit gjyqësor penal .....	99
7.4 Prania e viktimës së trafikimit në seancë gjyqësore dhe pyetja e saj me cilësinë e dëshmitares në seancë gjyqësore. ....	104
7.4.1 Pyetja e të miturit viktimë e trafikimit .....	106
7.5 Roli i Gjyqtarit në lidhje me sistemin e mbrojtjes së viktimës .....	110
<b>KREU VIII</b>	
<b>KOMPENSIMI PËR VIKTIMAT E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE .....</b>	<b>113</b>
8.1 Legjisllacioni ndërkombëtar për kompensimin e viktimave.....	113
8.1.1 Aktet e së drejtës ndërkombëtare globale.....	113
8.2 Aktet e së drejtës ndërkombëtare rajonale .....	115
8.2.1 Aktet e Këshillit të Evropës .....	115
8.2.2 E drejta e Bashkimit Evropian.....	115
8.3 Përvojat e shteteve .....	116
8.3.1 Legjisllacioni shqiptar në lidhje me të drejtat e viktimave për shpërblimin e dëmit.....	116
8.4 Detyrimet shtetërore për një kompensim efektiv të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore. Skema shtetërore e dëmshpërblimit të viktimave të trafikimit.....	120
8.5 Pengesat për kompensimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.....	122
8.6 Mjetet alternative për kompensimin. Roli i shoqërisë civile .....	123
Referenca.....	125

# SHKURTIME

AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
BE	Bashkimi Evropian
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
ICTY	Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë
KDF	Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve
KDPM	Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur i Republikës së Shqipërisë
KIE	Këshilli i Evropës
KEDNJ	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
KP	Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
KPrP	Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
ILO	Organizatës Ndërkombëtare e Punës
INTERPOL	Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
OSBE/OSCE	Organizata për Siguri e Bashkëpunim në Evropë
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OHCHR	Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut
ODIHR	Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara mbi Drogën dhe Krimin
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin
UNTOC	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar
VKM	Vendime të Këshillit të Ministrave
VKM	Vendime të Këshillit të Ministrave





# HYRJE

Trafikimi i qenieve njerëzore përbën shkelje të të drejtave të njeriut, të vlerave themelore të shoqërive demokratike dhe një kërcënim madhor për sigurinë e rendin publik. Me gjithë përpjekjet e shteteve në nivelet kombëtare, rajonale e ndërkombëtare, trafikimi i qenieve njerëzore mbetet një aktivitet kriminal dinamik në përshtatje e sofistikim të vazhdueshëm. Çdo vit, mijëra njerëz, kryesisht gra dhe fëmijë, trafikohen me qëllim shfrytëzimin seksual apo forma të tjera të shfrytëzimit, si brenda dhe jashtë vendit të origjinës. Pothuajse të gjitha vendet në rajon janë vende të origjinës, tranzitit ose destinacionit, ose një kombinim i më sipër. Lufta ndaj trafikimit të qenieve njerëzore<sup>1</sup> duke angazhuar shtetet në reagim të përbashkët e bashkëpunim efikas të mekanizmave kombëtarë të ngritur prej tyre mbetet në prioritetin e shume organizatave ndërkombëtare.

Tashmë thuhet se dy dekada pas hyrjes në fuqi së Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, nëpërmjet së cilës u arrit formalisht për herë të parë në një qëndrim i përbashkët në nivel ndërkombëtar në lidhje me përkufizimin e trafikimit të qenieve njerëzore, ky përkufizim vazhdon të nxisë diskutime, ndonëse është përkrahur dhe mbështetur nga instrumente të tjerë ndërkombëtarë që trajtojnë trafikimin e qenieve njerëzore.<sup>2</sup> Neni 3 (a) i protokollit të Palermos ka bërë përcaktimin e veprës së “trafikimit” përkufizim i cilika një rëndësi të jashtëzakonshme mbarëbotërore veçanërisht për sa i përket harmonizimit të legjislacioneve vendase në këtë fushë dhe rrjedhimisht rritjes së bashkëpunimit ndërkombëtar bazuar në koncepte të njëjta ose të ngjashme të trafikimit. Megjithatë, vetëm gjatë dekadës së fundit është evidentuar se ky përkufizim në vetvete ka disa paqartësi të cilat reflektohen në zbatimin e tij.

Pavarësisht studimeve të shumta të studiuesve dhe organizatave ndërkombëtare për të shtjelluar kompleksitetin e veprës së trafikimit, mbetet ende e madhe nevoja për studimin e praktikës gjyqësore në lidhje me parashikimet ligjore përkatëse. Në përputhje me detyrimin që buron nga Protokollin mbi Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkimin e Trafikut të Personave, Veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve, në Plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Ligjin nr. 8920, datë 11.7.2002, Shqipëria ka përcaktuar si vepër penale trafikimin e personave, duke iu referuar fjalë për fjalë përkufizimit të trafikimit sipas nenit 3 të Protokollit. Nisur nga fakti që ky është një përkufizim ndërkombëtar i cili duhet t'i përshtatet kontekstit të çdo shteti palë të konventës, lind nevoja që zbatimi i tij të lehtësohet jo vetëm nga studimet por dhe nga interpretimi gjyqësor. Formulimi i detajuar, por njëkohësisht dhe fusha e gjerë që mbulon vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore, i japin rëndësi të veçantë praktikës së zhvilluar nga ana e institucioneve gjyqësore shqiptare të cilat kanë vlerë në drejtim të zbrërthimit dhe kuptimit të qëndrueshëm të trafikimit të qenieve njerëzore në fushën e së drejtës.

Sipas standardeve të së drejtës ndërkombëtare trafikimi i qenieve njerëzore duhet njohur e trajtuar jo thjesht në drejtim të rendit e sigurisë publike por edhe si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë e diskriminimit me bazë gjinore dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave. Kështu, Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 19 i Komitetit për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW) identifikon trafikimin, me një formë të dhunës me bazë gjinore në kundërshtim me gëzimin e barabartë të të drejtave dhe dinjitetin e gruas. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjithashtu në jurisprudencën e saj ka përcaktuar qartë se trafikimi i qenieve njerëzore, siç përcaktohet në Protokollin e Kombeve të Bashkuara për Trafikimin dhe

<sup>1</sup> Në manual shprehjet 'trafikim i qenieve njerëzore' dhe 'trafikim i personave' përdoren me të njëjtin kuptim.

<sup>2</sup> Miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin nr. 8920, datë 11.7.2002 "Për Ratifikimin e "Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar" dhe Dy Protokolleve Shtesë të Saj.

Konventën e Këshillit të Evropës mbi Veprimin kundër Trafikimit, është i ndaluar nga Neni 4 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të njeriut (KEDNJ) pa qenë e nevojshme që të kualifikohet në ndonjërin nga format e parashikuar shprehimisht nga ana e nenit 4 pra si skllavëri, ose punë e detyruar:

“Trafikimi i qenieve njerëzore, për natyrën dhe qëllimin e shfrytëzimit të tij, bazohet në ushtrimin e kompetencave që i përkasin të drejtës së pronësisë. Ajo i trajton qeniet njerëzore si mallra për t’u blerë dhe shitur dhe për t’u vënë në punë të detyruar, shpesh për pak ose aspak pagesë, zakonisht në industrinë e seksit por edhe në vende të tjera. Kjo nënkupton mbikëqyrje të ngushtë të aktiviteteve të viktimave, lëvizjet e të cilëve shpesh janë të kufizuara. Ai përfshin përdorimin e dhunës dhe kërcënimeve ndaj viktimave, të cilët jetojnë dhe punojnë në kushte të këqija”.<sup>12</sup>

**Për shkak se vetë përkufizimi përmban koncepte të cilat nuk janë të parashikuara në instrumente të tjera ndërkombëtare dhe/ose në legjislacionin e brendshëm, punonjësit e organeve të drejtësisë ndeshen me sfidën e interpretimit të dispozitave. Një fenomen i tillë vihet re dhe në jurisprudencën e gjykatave shqiptare, ku kompleksiteti e vështirësia në interpretimin e koncepteve të ndryshme të lidhura me veprën penale të trafikimit të qenieve njerëzore përcillet edhe në arsyetimin e vendimeve gjyqësore, duke nxitur zhvillimin e debatit dhe hulumtimeve mbi aspektet teorike dhe zbatimit praktik të dispozitave të trafikimit.**

Lufta kundër krimit të organizuar, përfshirë trajtimin e trafikimit të qenieve njerëzore, është gjithashtu një nga prioritetet e Bashkimit Evropian (BE) në fushën e sigurisë dhe të drejtave të njeriut.<sup>3</sup> Strategjia e BE-së për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore për 2021 - 2025 trajton kompleksitetin e veprimtarisë kriminale të trafikimit, shpesh i lidhur me forma të tjera të krimit të organizuar si kontrabandimi i emigrantëve, trafikimi i substancave narkotike, kontrabanda e mallrave, pastrimi i parave etj, duke theksuar rëndësinë e përgjigjes së përbashkët kundër tij në kuadër të një serë masash në kuadër të politikave të BE-së që përfshijnë sigurinë dhe migracionin, drejtësinë, barazinë e të drejtat themelore, bashkëpunimi, etj. Sipas Strategjisë, gjatë 2017- 2018, brenda BE-së janë regjistruar rreth 14 000 viktima të veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore nga të cilat pothuajse gjysma janë shtetas të BE dhe njëkohësisht shumica e trafikantëve janë qytetarë të BE-së.<sup>4</sup> Sipas raportit, numri real me siguri është më i lartë pasi shumë viktima mbeten të pazbuluara. Një numër i konsiderueshëm i veprave të trafikimit janë realizuar brenda shtetit anëtar të BE-së. Shumica e viktimave në BE janë gra dhe vajza të trafikuar për shfrytëzim seksual dhe pothuajse 1 në 4 viktima të trafikimit në BE është fëmijë.<sup>5</sup> Mbetet një veprimtari kriminale me fitime të larta për kriminelët dhe kosto të mëdha njerëzore, sociale dhe ekonomike. Në BE, kostoja ekonomike vlerësohet të jetë deri në 2.7 miliardë euro në një vit të vetëm.<sup>6</sup>

<sup>3</sup> Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions on the EU Strategy on Combatting Trafficking in Human Beings 2021- 2025, Brussels, 14.4.2021, fq. 1-2 në [https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/default/files/pdf/14042021\\_eu\\_strategy\\_on\\_combatting\\_trafficking\\_in\\_human\\_beings\\_2021-2025\\_com-2021-171-1\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/default/files/pdf/14042021_eu_strategy_on_combatting_trafficking_in_human_beings_2021-2025_com-2021-171-1_en.pdf)

<sup>4</sup> Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions on the EU Strategy on Combatting Trafficking in Human Beings 2021- 2025, Brussels, 14.4.2021, fq. 1-2 në [https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/default/files/pdf/14042021\\_eu\\_strategy\\_on\\_combatting\\_trafficking\\_in\\_human\\_beings\\_2021-2025\\_com-2021-171-1\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/default/files/pdf/14042021_eu_strategy_on_combatting_trafficking_in_human_beings_2021-2025_com-2021-171-1_en.pdf)

<sup>5</sup> Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions on the EU Strategy on Combatting Trafficking in Human Beings 2021- 2025, Brussels, 14.4.2021, fq. 1-2 në [https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/default/files/pdf/14042021\\_eu\\_strategy\\_on\\_combatting\\_trafficking\\_in\\_human\\_beings\\_2021-2025\\_com-2021-171-1\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/default/files/pdf/14042021_eu_strategy_on_combatting_trafficking_in_human_beings_2021-2025_com-2021-171-1_en.pdf)

<sup>6</sup> Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions on the EU Strategy on Combatting Trafficking in Human Beings 2021- 2025, Brussels, 14.4.2021, fq. 1-2 në [https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/default/files/pdf/14042021\\_eu\\_strategy\\_on\\_combatting\\_trafficking\\_in\\_human\\_beings\\_2021-2025\\_com-2021-171-1\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/default/files/pdf/14042021_eu_strategy_on_combatting_trafficking_in_human_beings_2021-2025_com-2021-171-1_en.pdf).

Organizata për Siguri e Bashkëpunim në Evropë (OSBE) përmban gjithashtu angazhime thelbësore në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore si pjesë të mandatit të saj mbi të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës, luftën kundër korrupsionit dhe kontrolli i krimit; diskriminimi dhe pabarazia; dhe politikat ekonomike, të punës dhe migracionit. Në vitin 2003, pranë OSBE është ngritur Zyra e Përfaqësuesit Special dhe Koordinatorit për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore për të ndihmuar shtetet Pjesëmarrëse të zhvillojnë dhe zbatojnë politika efektive për veprim në nivelin kombëtar të njohur si 4 P-të7 që përfshijnë: Parandalimin e veprave penale të trafikimit; Ndjekjen penale që përfshin edhe gjykimin dhe zbatimin e vendimit të gjykatës; Mbrojtjen e të drejtave të viktimave, përfshirë ndihmën dhe kompensimin; Partneritetin, duke nënvizuar nevojën për bashkëpunim midis shteteve dhe organizatave ndërkombëtare në luftën kundër trafikimit, funksionimin e Mekanizmave Kombëtare të Referimit (MKR) dhe punën e përbashkët të institucioneve publike dhe sektorit privat.<sup>8</sup> Në Shqipëri, Prezenca e OSBE-së ofron ndihmë për forcimin e kapaciteteve institucionale të institucioneve ligjzbatuese si dhe institucionet e mbrojtjes sociale organizatave të shoqërisë civile etj, në parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore në zbatim të detyrime ndërkombëtare, përfshirë edhe angazhimet e Shqipërisë si anëtare e OSBE-së. Në kuadër të këtij angazhimi Prezenca asiston institucionet shqiptare në përmirësimin e legjislacionit, politikave dhe procedurave për aspektet e ndjekjes penale dhe gjykimin të veprave penale të trafikimit të personave, zhvillon programe trajnimi për strukturat ligjzbatuese dhe profesionistët e organeve të drejtësisë si dhe kryen studime që ndihmojnë në zhvillimin e politikave në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore. Ky manual vjen si kontribut i radhës së Prezencës në kuadër të mbështetjes së institucioneve shqiptare për përmirësimin e hetimit dhe gjykimin të veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore, bazuar në një qasje ndërsektoriale dhe duke nxitur mbrojtjen e të drejtave të viktimave të trafikimit. Studimi kryhet në kuadrin e projektit **“Transformimi i Përgjigjes Kombëtare ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore në dhe nga Shqipëria”**, i cili zbatohet një sërë organizatash, përfshirë OSBE-në, dhe financohet nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar nëpërmjet UNICEF.

Manuali vjen si nevojë për të reflektuar mbi rregullimet në kuadrin rregullator vendas me objektivin e ofrimit të qëndrimeve mbi standardet e zbatimit të tyre nëpërmjet analizës së rasteve të praktikës dhe sidomos përfaqesjes me rregullimeve në nivelin ndërkombëtar. Ai mëton të ofrojë një kornizë konceptuale mbi veprën penale të trafikimit të qenieve njerëzore, identifikimin dhe hetimin e saj, implikimet ligjore dhe praktike që rrjedhin nga karakterizimi i veprës penale të trafikimit, format e zhvillimit të saj dhe pasojat e trafikimit fizike dhe psikologjike mbi personat e trafikuar, të drejtat e viktimave dhe detyrimet pozitive të shteteve për mbrojtje dhe asistencë të viktimave, etj.

Për këtë qëllim, manuali sjell ekspertizën dhe eksperiencën e kombinuar të pesë profesionistëve nga fusha e praktikës dhe ajo e studimit të të së drejtës penale e të drejtave të njeriut në rregullimin vendas dhe atë ndërkombëtar, konkretisht gjyqtarin e Gjykatës së Lartë z. Sander Simoni, Prof. Dr. Aurela Anastasi. Prof. Dr. Arta Mandro, Prof. Dr. Evis Alimehmeti, prokurorit të prokurorisë së Aquila, Itali, Z. David Mancini, znj. Juliana Rexha, Oficere Kombëtare kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Presenca e OSBE-së në Shqipëri. Hulumentimi për këtë manual bazohet kryesisht në analizën e kuadrit ligjor në fuqi në krahasim me standarte ndërkombëtare e praktikë gjyqësore vendase e të huaj, me ilustrim të rasteve konkrete të trafikimit njerëzor, disa prej të cilave nuk janë trajtuar e analizuar më parë.

Rëndësia e hulumtimeve dhe studimeve përfaqësuese është e madhe sidomos në ndjeshmërinë në rritje të nevojës për zhvillimin e një kuadri rregullator vendas efektiv për të luftuar trafikimin, identifikuar viktimat dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre të njeriut. Kjo përmbledhje synon kështu t'u vijë në ndihmë profesionistëve të

7 PPP përkatësisht e përkthyer në gjuhën angleze: *Prevention, Prosecution, Protection, Partnership.*

8 *Organization for Security and Cooperation in Europe, Combating Human Trafficking, Permanent Council Decision No. 557: OSCE Action Plan to Combat Trafficking in Human Beings, <https://www.osce.org/actionplan>.*

sektorit të drejtësisë, sidomos në organet e ndjekjes penale dhe të gjyqësorit, për zbatimin e legjislacionit penal kundër trafikimit të qenieve njerëzore, me qasje dhe në praktikë gjyqësore.

Studimi është organizuar duke ndarë analizën në standardet ndërkombëtare e rregullimin vendas me fokus në fazat e procesit penal dhe të drejtave të viktimës, me vëmendje të posaçme në pozitën dhe të drejtat e viktimës së mitur.

**Kreu I** ofron një panoramë të instrumenteve më të rëndësishëm në nivelin ndërkombëtar në fushën e luftës kundër trafikimit për të mundësuar reflektimin krahasimor të kornizave ligjore vendase në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore në kuadër të instrumenteve të të drejtave të njeriut dhe veçanërisht jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

**Kreu II** sjell një zbërthim të detajuar të veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore, objektit dhe elementëve të saj, dallimeve me vepra të tjera penale, duke u qasur në parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe praktikave më të mira të raportuara.

**Kreu III** përcjell një analizë të detajuar të veprës penale të trafikimit sipas legjislacionit penal shqiptar, gërshetuar me zbërthim të rasteve konkrete nga praktika e institucioneve vendase, në vështrim krahasues me rregullime të së drejtës ndërkombëtare, me fokus gjithashtu në të drejtat dhe mbrojtjen e viktimës së veprës penale.

**Kreu IV** ka në fokus të veçantë trafikimin e fëmijëve, hetimin dhe gjykimin e veprave penale të trafikimit të të miturve e mbrojtjes së tyre, duke vënë theksin tek format e reja të trafikimit të të miturve si lypja, puna e detyruar, etj., si dhe tek mbrojtja e veçantë që gëzojnë fëmijët në kuadrin procedural dhe atë të asistencës, në kuadër të parimit kushtetues të interesit më të lartë të fëmijës.

**Kreu V** përqëndrohet në identifikimin e viktimave si kusht për hetimin e trafikimit të qenieve njerëzore, duke dalluar midis kategorive të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore për qëllime të efikasitetit të mekanizmave ligjorë e institucionalë në luftën kundër veprimtarisë kriminale të trafikimit.

**Kreu VI** sjell një analizë të fazës së hetimit dhe ndjekjes penale, pa hequr nga vëmendja gjithashtu të drejtat e viktimës përgjatë kësaj faze. Në fokus të tij është kuadri ligjor për mbrojtjen dhe asistencën ndaj viktimave si dhe standardet ndërkombëtarë të reflektuara në rregullimin vendas.

**Kreu VII** ndalet në analizën e pozicionit procedural të viktimave gjatë gjyqimit të çështjeve të trafikimit si çështje komplekse për shkak të natyrës së fenomenit kriminal, pozicionit të viktimave të trafikimit gjatë gjyqimit, si dhe standardeve ndërkombëtare që duhen përmbushur gjatë gjyqimit për mbrojtjen e tyre. Në fokus të tij është edhe kujdesi që gjyqtarët duhet të tregojnë për të balancuar të drejtat e viktimave me garancitë procedurale e ligjore të ndjekjes penale, gjyqimit të veprave penale të trafikimit dhe kompetencës lëndore të gjykatës.

Së fundmi, **Kreu VIII** i studimit trajton të drejtën e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore për kompensim të përshtatshëm dhe efektiv mbi dëmet materiale dhe jomateriale si dhe aksesin në drejtësi përmes mjeteve procedurale sipas parimeve të së drejtës ndërkombëtare, përsëri në qasje reflektive e krahasimore me rregullimet vendase.

Analiza e çdo Kreu shoqërohet me raste ilustruese nga praktika kryesisht vendase dhe ajo e institucioneve gjyqësore ndërkombëtare, çështje praktike për diskutim dhe pyetje që nxisin debatin e reflektimin e mëtejshëm mbi temat kryesore në fokus të Kreut.

## KREU I



# MBI KONCEPTIN E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

## 1.1 INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI TRAFIKIMIN E QENIEVE NJERËZORE

Trafikimi i qenieve njerëzore, i njohur edhe si skllavëria e kohëve moderne është një krim i rëndë si dhe një shkelje e të drejtave themelore dhe të dinjitetit të njeriut. Qëllimi i trafikimit është shfrytëzimi i personave vulnerabël për qëllimin e vetëm të përfitimit. Çdo shtet është i prekur në ndonjë formë apo trajtë të trafikimit të qenieve njerëzore.

Në literaturë dhe në praktikën e disa shteteve mund të haset dhe termi “trajtë moderne e skllavërisë”, një term i përdorur për të rritur ndërgjegjësimin për mënyrën se si mund të duket trafikimi për personat që janë të painformuar. Ekzistojnë ende shumë mite në lidhje me trafikimin një prej tyre është se trafikimi i ndodh vetëm në nivel ndërkombëtar dhe se elementi ndërkombëtar i veprës së trafikimit është cilësues. Në fakt, ndonëse shumë raste të trafikimit të qenieve njerëzore përfshijnë një element ndërkombëtar, ku viktima merret nga një shtet dhe çohet në një shtet tjetër dhe atje shfrytëzohet, trafikimi ndodh dhe brenda territorit të të njëjtit shtet dhe njihet si **“trafikim i brendshëm”**. Ndonëse termi trafikim tregon një lëvizje, nuk është domosdoshmërisht e nevojshme të provohet lëvizja apo të vërtetohet kalimi i kufirit që vepra të cilësohet si trafikim. Një viktimë mund të trafikohet midis Vlorës dhe Shkodrës, për shembull, apo edhe nga njëra zonë e Tiranës në një tjetër.

Trafikimi mund të marrë trajta të ndryshme dhe mund të përfshijë:

- shfrytëzimin seksual, përfshirë prostitucionin;
- punë apo shërbime e detyruara;
- skllavërinë, punët e shtëpisë, heqjen e lirisë me dhunë dhe praktika që lidhen me to;
- heqjen e organeve jetësore;
- kriminalitetin e detyruar me forcë, p.sh. vjedhja e personave, vjedhja e dyqaneve dhe trafikimi i drogave.

Shfrytëzimi mund të fshihet shpesh pas veprave të tjera kriminale, si prostitucion, migracion i parregullt, krime kundër pronës, apo edhe mosmarrëveshje në marrëdhëniet e punës. Shpesh, viktimat shfrytëzohen në shumë mënyra, ose mund të përfshihen në veprimtari të tjera të paligjshme, duke rezultuar kështu në raste të trafikimit të qenieve njerëzore që nuk hetohen apo regjistrohen si të tilla.

Trafikimi i qenieve njerëzore në Shqipëri vazhdon të mbetet një problem për adresimin e të cilit kërkohet vëmendje e veçantë si e institucioneve shtetërore ashtu edhe organizatave ndërkombëtare e OJF-ve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e parandalimit, mbrojtjes së viktimave dhe ndjekjes penale të veprave të trafikimit të personave. Pavarësisht përpjekjeve të shumta nga institucionet shtetërore dhe organizatat e ndryshme për të adresuar fenomenin ndër vite, Shqipëria ende konsiderohet “një vend burimi, tranziti dhe

destinacioni për burrat, gratë dhe fëmijët subjekt i trafikimit për qëllime seksuale dhe punë të detyruar”.<sup>9</sup>

Në nivel Evropian, Komisioni Evropian raporton se trafikimi me qëllim shfrytëzimi seksual mbetet forma më e përhapur e trafikimit në Bashkimin Evropian.<sup>10</sup> Në shumë vende anëtare është raportuar edhe një rritje e trafikimit për qëllime të shfrytëzimit për punë. Pothuajse tri të katërtat e të gjitha viktimave në BE ishin femra (gra dhe vajza), më së shumti trafikuar për qëllime shfrytëzimi seksual. Gratë dhe vajzat kanë qenë në vazhdimësi shumica e viktimave të trafikimit që prej 2008, kur BE-ja filloi të mbledhë të dhëna për trafikimin e qenieve njerëzore. Fëmijët vazhdojnë të përbëjnë një numër të konsiderueshëm të viktimave në BE. Pjesa më e madhe e viktimave të mitura ishin vajza të trafikuar për shfrytëzim seksual dhe ishin shtetase të BE-së. Grupet e krimit të organizuar të përfshira në trafikimin e qenieve njerëzore kanë rrjete kriminale të mirëstrukturuara. Një shqetësim në rritje është dhe keqpërdorimi i teknologjisë së informacionit nga ana e kriminelëve për rekrutimin dhe shfrytëzimin e viktimave të trafikimit. Të gjitha sa më sipër do të jenë fokus të pjesëve në vijim të studimit.

## 1.2 PËRKUFIZIMI I TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE DHE KUADRI LIGJOR NDËRKOMBËTAR

Trafikimi i qenieve njerëzore është një krim me normë të lartë fitimi për trafikantët dhe kosto të jashtëzakonshme për shoqërinë. Ai është një prej shqetësimeve kryesore në rang global në kohët moderne dhe një problem madhor në Evropë dhe më gjerë. Çdo vit, mijëra njerëz, në pjesën më të madhe gra dhe fëmijë, bien viktimë e trafikimit për shfrytëzim seksual, për punë, apo për veprimtari të tjera të paligjshme në shtetin e tyre apo jashtë në shtete të tjera. Të gjithë treguesit sugjerojnë një rritje progresive të numrit të viktimave. Trafikimi i qenieve njerëzore është një trajtë e skllavërisë “moderne” dhe një krim i rëndë, dhe shpesh drejtohet nga grupe ndërkombëtare ose të brendshme të krimit të organizuar. Personat vulnerabël mund të bëhen viktimë të formave të ndryshme shfrytëzimit. Kufiri midis trafikimit të qenieve njerëzore dhe “kontrabandimit” të migrantëve është bërë më i padallueshëm gjatë viteve të fundit. Duke qenë se trafikimi i qenieve njerëzore si krim i rëndë shpesh realizohet nga krimi i organizuar, grupi kriminal i organizuar përkufizohet në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (UNTOC) si: **“grup i strukturuar, i përbërë nga tre a më shumë persona, i cili ka ekzistuar për një periudhë kohe të caktuar, dhe që vepron në harmoni me njëri-tjetrin, me qëllim që të kryejnë një ose më shumë vepra penale të rënda, ...me qëllim që të sigurojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, përfitime financiare ose materiale.”**

Organizata kriminale ndërkombëtare që mundësojnë kalimin e paligjshëm të kufirit shihen nga migrantët si kompani shërbimi që mund t’u sigurojnë udhëtimin për në vendin e destinacionit. Krimi i organizuar ka marrë në mënyrë të rreme rolin e shpresëdhënësit, sepse shihet si i vetmi instrument për të realizuar një ëndërr, për të arritur në atë vend që, në sytë e migrantit, është një investim jete për të ardhmen, arrati nga varfëria, konflikte të armatosura, etj. Kështu, ata që e ofrojnë këtë shërbim në mënyrë të paligjshme, edhe me pëlqimin e personave përkatës realizojnë fitime të mëdha financiare. Mbështetur në këtë qasje strategjike, krimi i organizuar ka kaluar një transformim të thellë, duke dalë nga niveli lokal e duke marrë gjithmonë e më shumë karakterin e një veprimi ndërkombëtar. Kjo është sidomos e ndjeshme në kontekstin

<sup>9</sup> Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit mbi Trafikimin e Personave, 2020: Shqipëria, [https://al.usembassy.gov/ep-content/uploads/sites/140/TIP\\_ENG.pdf](https://al.usembassy.gov/ep-content/uploads/sites/140/TIP_ENG.pdf), faqe 69.

<sup>10</sup> Raporti i 3të i Komisionit Evropian për Parlamentin Evropian dhe Këshillin mbi Progresin e Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (2020) në zbatim të Direktivës 2011/36/BE për Parandalimin dhe Luftën ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave, [https://ec.europa.eu/anti-trafficking/sites/default/files/third\\_progress\\_report.pdf](https://ec.europa.eu/anti-trafficking/sites/default/files/third_progress_report.pdf).

e lëvizjeve migratore e atyre që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare si refugjatë.

Lufta ndaj trafikimit të qenieve njerëzore është në vëmendje parësore në nivelin ndërkombëtar e kombëtar sepse trafikimi i qenieve njerëzore kërcënon të drejtat e njeriut dhe vlerat themelore të shoqërive demokratike. Strategjitë për të luftuar këtë dhunim të dinjitetit njerëzor udhëhiqen nga organizata ndërkombëtare dhe rajonale. Trafikimi i qenieve njerëzore mori vëmendjen e komunitetit ndërkombëtar nga fundi i viteve 1980. Në fillimin e shekullit të 21-të, ai cilësohet si një problem serioz global që ka nevojë për përgjigje globale. Kështu, Kombet e Bashkuara u përgjigjën në vitin 2000 me miratimin e Konventës kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe Protokolleve Shtesë. Protokollin mbi Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, Veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve (Protokollin e Palermos) përcaktoi përkufizimin e parë të trafikimit të qenieve njerëzore, i cili mbetet ende një referencë për përkufizimin e trafikimit të qenieve njerëzore sot. Për herë të parë, shtetet palë ranë dakord mbi një përkufizim ndërkombëtar të detyrueshëm të trafikimit të qenieve njerëzore, i cili është përkrahur e përdorur dhe nga organizata dhe agjenci të tjera ndërkombëtare, si Këshilli i Evropës (KIE), Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), NATO, INTERPOL, Liga Arabe, etj. Njehsimi i përkufizimit të trafikimit të qenieve njerëzore ishte një prej qëllimeve kryesore të hartuesve të Protokollit të Palermos, siç shprehet dhe në Preambulën e tij “aksionet efektive për të luftuar trafikun ndërkombëtar të personave...kërkojnë një trajtim të gjithanshëm dhe ndërkombëtar”. Për të siguruar që Neni 3 i Protokollit do të reflektohej në legjislacionet e brendshme të shteteve ratifikuese, protokollin detyron shtetet palë “të adaptojnë masa të tilla, që mund të jenë të nevojshme për të përcaktuar si vepra kriminale, në bazë të legjislacionit të brendshëm, veprimet e përcaktuara nënenin 3 të këtij Protokollin, nëse kryhen qëllimisht.”<sup>11</sup>

Në kuadër të Këshillit të Evropës, “Konventa mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre” dhe sidomos Konventa e Këshillit të Evropës “Për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore” e vitit 2005 (Konventa Evropiane kundër Trafikimit), sollën detyrime të reja për shtetet pale duke synuar një balancë midis mbrojtjes së të drejtave dhe ndjekjes penale. Edhe në kuadër të Bashkimit Evropian janë shënuar zhvillime të rëndësishme normative në lidhje me luftën kundër trafikimit.

## 1.2.1 NJË VËSHTRIM I SHKURTËR HISTORIK MBI INSTRUMENTE NDËRKOMBËTARË NË FUSHËN E MASAVE KUNDËR TRAFIKIMIT

Në një vështrim historik, përpjekjet e shteteve për të luftuar format e trafikimit dhe shfrytëzimit të qenieve njerëzore datojnë që në fillimin e shekullit të kaluar. Përpjekjet e para lidhen me masat për të zhdukur përfundimisht shfrytëzimin e dhe skllavërimin e grave dhe fëmijëve nga grupet kriminale në veprim ndërkombëtar. Kështu, në 1904, miratohet në Paris nga disa shtete evropiane Marrëveshja e parë ndërkombëtare për sigurimin e mbrojtjes së efektshme ndaj trafikimit kriminal - të njohur si tregtia e skllavëve të bardhë. Marrëveshja përfshinte gjithashtu mbrojtjen e grave që detyroheshin të prostituonin apo mashtroheshin të prostituonin në vende të huaja. Në vëmendje të saj ishin gjithashtu detyrimet sociale të shteteve për të luftuar veprimtaritë që nxisnin trafikimin.

Në vijim të Marrëveshjes së 1904, në 1910 adoptohet Konventa për Ndalimin e Tregtisë së Skllavëve të Bardhë, e cila në ndryshim nga Marrëveshja e mëparshme, përmbante detyrime reale për kriminalizimin e veprave penale të lidhura me trafikimin. Ky instrument e zgjeroi objektin e tij për të përfshirë situata në të cilat nuk përdoret domosdoshmërisht forca si dhe veprat brenda kufijve kombëtarë dhe jashtë këtyre kufijve. Konventa zhvendosi fokusin nga masat sociale tek kriminalizimi i veprave penale të lidhura me trafikimin,

<sup>11</sup> Neni 5 i Protokollit mbi Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, Veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve (Protokollin e Palermos), 2000.

ndjekja penale dhe dënimi i shkelësve. Gjithashtu Konventa prezantoi dallimin midis viktimave në moshë të re dhe atyre në moshë madhore.

Në vitin 1921 në kuadër të Lidhjes së Kombeve miratohet Konventa Ndërkombëtare për Ndalimin e Trafikimit të Grave dhe Fëmijëve. Konventa zhvilloi me tej angazhimet e marra me Marrëveshjen e 1904 dhe Konventën e 1910. Si arritje e rëndësishme vlen të veçohet shmangia e çdo reference mbi skllavërinë e bardhë duke prezantuar një nocion të ri të «trafikimit imoral» e lidhur me individë të dy gjinive nën moshën 21 vjeç si dhe të femrave mbi 21 vjeç, në kushte shtrëngimi apo mashtrimi.

Më tej në 1926, përsëri në kuadër të Lidhjes së Kombeve, miratohet Konventa për Skllavërinë, në kuadër të përpjekjeve për të luftuar rigjallërimin e kësaj dukurie në disa prej territoreve në Afrikë, si dhe për të parandaluar situata analoge me skllavërinë. Konventa solli përkufizimin e parë juridik të skllavërisë si “gjendja ose rrethanat e një personi mbi të cilin ushtrohet një ose të gjitha të drejtat e pronësisë”.

Në vitin 1930 në kuadër të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO-s) miratohet Konventa për Punën e Detyruar nr. 29/1930. Konventa ka një rëndësi të veçantë për ndalimin e punës së detyruar dhe përfaqëson ende instrumentin ndërkombëtar më të rëndësishëm për përkufizimin dhe kriteret dalluese të punës së detyruar. Puna e detyruar sipas Konventës përfshin dy elementë bazë: punë ose shërbim i kryer nën kërcënimin e një penalteti apo ndëshkimi dhe kryerja e punës në mënyrë jo vullnetare. Ky kërcënim mund të bëhet në forma nga më të ndryshmet dhe mund të ketë edhe natyrën e intimidimit për humbje të të drejtave apo privilegjeve. Sigurisht që forma më ekstreme përfshin dhunën fizike dhe madje edhe kërcënimet për vdekje drejtuar viktimës apo të afërmeve të saj, por mund të ketë edhe forma më të sofistikuar presioni, duke përfshirë edhe ato psikologjike.


Konventa e Lidhjes së Kombeve për Ndalimin e Trafikimit të Femrave në Moshë Madhore e vitit 1933 shërbeu për të luftuar më tej shfrytëzimin e prostitucionit duke përfshirë në qëllimet e veprave të trafikimit të gjitha qëllimet seksuale e jo vetëm prostitucionin. Sipas Konventës, pëlqimi nuk është i vlefshëm sidomos në lidhje me rastet ndërkombëtare ku gratë, pavarësisht nga mosha e tyre, lëvizeshin përtej kufijve ndërkombëtare për qëllime shfrytëzimi. Ashtu si dhe në aktet e mëparshme, Konventa e vitit 1933 u kërkonte Shteteve Palë që të mbronin viktimat dhe të shkëmbenin informacion për qëllime bashkëpunimi.

Në vitin 1948, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi Deklaratën Universale e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, instrumenti i parë në nivelin ndërkombëtar, megjithëse jo juridik, që angazhon shtetet bashkërisht në njohjen dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve. Deklarata nuk citon në mënyrë të drejtpërdrejtë trafikimin si veprimtari dhunues e të drejtave themelore të individëve por neni 4 i saj parashikon që: Asnjëri nuk duhet të mbahet si skllav ose në robëri; skllavëria dhe tregtia e skllavëve janë të ndaluara në të gjitha format.

Konventa për Ndalimin e Trafikimit të Personave dhe Shfrytëzimit të Prostitucionit të tjerëve në 1949 është ndër instrumentet e parë të miratuara në kuadër të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në periudhën pas luftës. Kishte për synim ndalimin dhe luftën ndaj praktikave të trafikimit e shfrytëzimit si brenda dhe jashtë vendit dhe pavarësisht nga mosha apo pëlqimi i viktimave. Sipas Konventës “trafikimi edhe prostitucioni janë në kundërshtim me dinjitetin dhe vlerën e qenies njerëzore si dhe një rrezik për mirëqenien e individit, familjes dhe komunitetit”. Shteteve Palë duhet të ndëshkojnë ata që përfshihen në veprimtari të tilla kriminale, të nxisin bashkëpunimin ndërkombëtar si dhe të ndihmojnë e mbrojnë viktimat.

Në kuadër të Këshillit të Evropës, në 1950 miratohet (hyri në fuqi në 1953) Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, një traktat ndërkombëtar me fuqi juridike për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Evropë. Deklarata Universale shërbeu si model e frymëzimit për formulimin e neneve të Konventës; në nenin 4 të Konventës **ndalohet skllavëria dhe puna e detyruar:**



- 
1. Askush nuk do të mbahet në skllavëri ose në robëri.
  2. Askush nuk do të shtrëngohet të kryejë një punë me dhunë ose të detyruar.
  3. Në kuptim të këtij neni, termi “punë e kryer me dhunë ose e detyruar”, nuk përfshin:
    - (a) çdo lloj pune që i kërkohet të kryejë zakonisht një personi të ndaluar në kushtet e parashikuara nga neni 5 i kësaj Konvente ose gjatë lirit të tij me kusht;
    - (b) çdo lloj shërbimi i karakterit ushtarak ose, në rastin e kundërshtarëve të ndërgjegjes në vendet ku kundërshtimi i ndërgjegjes është i njohur me ligj, shërbimi që kryhet në vend të shërbimit ushtarak të detyrueshëm;
    - (c) çdo lloj shërbimi që kërkohet në rast krizash ose fatkeqësish, që kërcënojnë jetën ose mirëqenien e bashkësisë;
    - (d) çdo lloj pune ose shërbimi që është pjesë e detyrimeve normale qytetare.

Në 1966 vjen Pakti për të Drejtat Civile e Politike (dhe Pakti për të Drejtat Ekonomike Social e Kulturore) adoptuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, i cili parashikon detyrimin juridik për shtetet palë për të siguruar që askush nuk mbahet në skllavëri ose servitud. Pakti gjithashtu parashikon ndalimin e tregtisë së skllavërive, të punës së detyruar si dhe servitudit.

Në vitin 1979, Organizata e Kombeve të Bashkuara adoptoi Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW). Konventa i detyron Shtetet Palë të marrin të gjitha masat për të penguar të gjitha format e trafikimit të grave dhe shfrytëzimit të tyre për prostitucion. Ky akt e njeh trafikimin si formë të dhunës me bazë gjinore si dhe diskriminim gjinor, duke u dalluar dukshëm nga instrumentet e tjerë ndërkombëtare të deri atëhershëm.

Në vitin 1989, po në kuadër të Organizatës së Kombeve të Bashkuara vjen Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (KDF), që përfaqëson aktin themelor bashkëkohor ndërkombëtar për të drejtat e fëmijëve me një reference të qartë edhe ndaj trafikimit. Konventa përfaqëson një kuadër gjithëpërfshirës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, një instrument i vlefshëm për të kuptuar dhe luftuar trafikimin dhe shfrytëzimin e fëmijëve.

Në vitin 2000 vjen Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, një instrument themelor ndërkombëtar kundër krimit të organizuar si dhe protokollet e saj. Dy prej këtyre protokolleve janë Protokollin kundër Trafikimit të Migrantëve me Rrugë Tokësore, Ajrore dhe Detare dhe Protokollin për Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkimin e Trafikut të Personave, Veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve. I pari ofron përkufizimin e mëposhtëm për trafikimin e qenieve njerëzore si më poshtë:

### **Neni 3 - Për qëllimet e këtij Protokollit:**

- (a) Trafik personash nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen ose pritjen e personave nëpërmjet kërcënimit, përdorimit të forcës e formave të tjera të shtrëngimit, mashtrimit, marrjes me forcë, dredhisë ose abuzimit të pushtetit ose të pozitës vulnerabel ose dhënien apo marrjen e pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që kontrollon një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi përfshin, së paku, shfrytëzimin e prostitucionit të tjerëve ose format e tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë ose praktikat e ngjashme me skllavërinë, heqjen e organeve ose servitudet;

- (b) Pëlqimi i viktimës së trafikut për shfrytëzimin e qëllimshëm të përmendur në nënparagrafin (a) të këtij neni është i parëndësishëm nëse janë përdorur mjetet e parashikuara në nënparagrafin (a);
- (c) Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e një fëmijë për qëllime shfrytëzimi, do të konsiderohet trafik personash edhe nëse në të nuk do të përfshihen mjetet e parashikuara në nënparagrafin (a) të këtij neni;
- (d) Fëmijë nënkupton çdo person nën 18 vjeç.

Ndërkohë në vitin 2005 adoptohet në Varshavë Konventa e Këshillit të Evropës për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Njihet si Konventa e Varshavës ose shkurt Konventa e Këshillit të Evropës kundër Trafikimit dhe është e njohur për impaktin në legjislacionin tonë të brendshëm, si dhe në praktikën gjyqësore. Në nenin 39 të saj nënvizohet lidhja me Konventën e Protokollit të Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe, me këtë rast, kjo vendos theksin tek aspektet plotësuese për të rritur mbrojtjen e ofruar prej së parës dhe të zhvillojë standardet e përfshira në të. Objekt i zbatimit të kësaj konvente janë të gjitha format e trafikimit të qenieve njerëzore, qoftë kombëtare, qoftë ndërkombëtare, të lidhura apo jo me krimin e organizuar, duke zgjeruar fushën e aplikimit të saj kundrejt Protokollit shtesë të Konventës së OKB-së. Trafikimi i qenieve njerëzore përkufizohet në nenin 4 që në thelb përsërit përkufizimin për trafikimin e qenieve njerëzore të dakordësuar ndërkombëtarisht në nenin 3 të Protokollit të Kombeve të Bashkuara cituar më sipër. Vlera më thelbësore e saj është përqendrimi tek viktima dhe të drejtat themelore të viktimës:

#### **Neni 4 – Përkufizime**

- a) “Trafikim i qenieve njerëzore” nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen ose marrjen e personave me anë të kërcënimit, përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, kurthit, të shpërdorimit të detyrës, të atyre që kanë një pozicion të pambrojtur apo dhënien ose marrjen e pagesave ose përfitimeve për të arritur miratimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllim shfrytëzimi. Shfrytëzimi do të përfshijë minimalisht shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve, forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë apo praktikatat e ngjashme me skllavërinë ose heqjen e organeve.
- (b) Pëlqimi i viktimës së trafikut për shfrytëzimin e qëllimshëm të përcaktuar në nënparagrafin (a) të këtij neni është i parëndësishëm nëse janë përdorur ndonjë nga mjetet e parashikuara në nënparagrafin (a);
- (c) Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose marrja e një fëmije për qëllim shfrytëzimi do të konsiderohet trafikim i qenieve njerëzore edhe nëse kjo nuk përfshin një nga mjetet e parashtruara në nënparagrafin (a) të këtij neni.
- (d) Fëmijë nënkupton çdo person nën 18 vjeç.
- (e) Viktimë nënkupton çdo person fizik që është objekt i trafikimit të qenieve njerëzore, siç përcaktohet në këtë nen.

Në kuadër të Bashkimit Evropian më 5 prill 2011 është miratuar Direktiva 2011/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për Parandalimin dhe Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave të tij, që zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA. Direktiva 2011/36/BE është akti i tretë ndërkombëtar ligjor që jep një përkufizim të trafikimit. Direktiva përmban një përkufizim më të gjerë të trafikimit se Protokollin e Palermos dhe se Konventa e Këshillit të Evropës.<sup>12</sup> Për t'u përgjigjur zhvillimeve aktuale përsa i përket trafikimit të qenieve njerëzore, kjo Direktivë e ka zgjeruar konceptin e trafikimit në krahasim me Vendimin Kuadër (2002/629/JHA) duke përfshirë në përkufizim forma të reja shfrytëzimi. Në këtë kontekst, lypja e detyruar konsiderohet si formë e punës ose shërbimeve të detyruara, sipas përkufizimit të Konventës Nr 29 të ILO-s e vitit 1930 "Për punën e Detyruar". Rrjedhimisht, shfrytëzimi për lypje të personave në ngarkim të subjektit të veprës penale, konsiderohet si trafikim i qenieve njerëzore ne rastet kur shfaqen të gjithë elementët e punës ose shërbimeve të detyruara.

Direktiva thekson se pëlqimi i personit për të kryer punë ose shërbime të tilla, duhet shqyrtuar rast pas rasti, përveçse në rastin e fëmijëve, pëlqimi i të cilëve nuk merret parasysh. Sipas Direktivës "shfrytëzimi për veprimtari kriminale", duhet kuptuar si shfrytëzim i personit për të kryer vepra penale si vjedhje, trafikim të substancave narkotike dhe vepra të ngjashme me përfitim financiar. Përkufizimi përfshin dhe trafikimin e qenieve njerëzore me qëllim heqjen e organeve si një shkelle e rëndë e dinjitetit njerëzor dhe integritetit fizik. Në përkufizim përfshihen dhe veprimtari të tilla si birësimi i paligjshëm apo martesë e detyruar.

## **Neni 2 i Direktivës - Veprat penale që kanë të bëjnë me trafikimin e qenieve njerëzore**

1. Shtetet anëtare marrin masat e nevojshme për të garantuar ndëshkimin e akteve të qëllimshme në vijim:  
Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave, duke përfshirë shkëmbimin ose transferimin e kontrollit mbi ata persona, nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës ose formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit ose abuzimit me pushtetin ose me pozicionin vulnerabël ose me marrjen ose dhënien e pagesave apo përfitimeve për të siguruar miratimin e personit që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi.
2. Pozicioni vulnerabiliteti është situata në të cilën personi në fjalë nuk ka asnjë alternativë tjetër reale ose të pranueshme, përveçse t'i nënshtrohet abuzimit ku është përfshirë.
3. Shfrytëzimi përfshin, minimalisht, shfrytëzimin për prostitucion të të tjerëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, shërbimet ose punën e detyruar, përfshirë lypjen, skllavërinë ose praktikën e ngjashme me skllavërinë, robërinë ose shfrytëzimin e aktiviteteve kriminale ose heqjen e organeve.
4. Pëlqimi i viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore për shfrytëzim, pavarësisht nëse është i synuar apo i vërtetë, do të jetë i pavend nëse është përdorur ndonjë prej mënyrave të parashtruara në paragrafin 1.
5. Kur sjellja e përmendur në paragrafin 1 përfshin një fëmijë, përbën një veprë të dënueshme të trafikimit të qenieve njerëzore edhe nëse nuk është përdorur asnjë nga mënyrat e përmendura në paragrafin 1.
6. Për qëllime të kësaj direktive, "fëmijë" është çdo person nën moshën 18 vjeç.

<sup>12</sup> Direktiva 2011/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 prill 2011 për Parandalimin dhe Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave të tij, që zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA.

Në kuadër të detyrimeve të shteteve anëtare të BE-së, të gjitha shtetet anëtare kanë realizuar transpozimin e Direktivës në legjislacionin e brendshëm, detyrim që parashtrahet edhe për shtetet në proces aderimi pranë BE si Shqipëria. Direktiva thekson qasjen ndaj veprës penale të trafikimit edhe në drejtim të garancive për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në përputhje me Preambulën 7 të Direktivës.

## 1.3 PARIMET E PËRGJITHSHME TË ZHVILLUARA NGA GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

### 1.3.1 INTERPRETIMI HOMOGEN I GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) është themeluar në kuadër të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Gjykata garanton që shtetet anëtare të Konventës respektojnë të drejtat dhe garancitë e parashikuara në të. Gjykata shpesh referon edhe në parime të së drejtës ndërkombëtare për interpretimin e të drejtave dhe lirive të parashikuara në Konventë. Ajo ka argumentuar shpesh se zbatimi i dispozitave të Konventës duhet të zbatohet tek rregullat interpretuese që përmban Konventa e Vjenës e OKB-së e datës 23 maj 1969 për të drejtën e traktateve. Sipas GJEDNJ, KEDNJ duhet të lexohet si një e tërë dhe të interpretohet në mbështetje të qëndrueshmërisë dhe harmonisë së brendshme mes dispozitave të ndryshme. Përveç kësaj, duhet të merren parasysh edhe parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe standardet e tjera ndërkombëtare në fuqi. Objekti dhe qëllimi i KEDNJ, si një instrument për mbrojtjen e qenieve njerëzore individuale kërkon që dispozitat e saj të interpretohen dhe të zbatohen në mënyrë të tillë që t'i bëjë këto garanci praktike dhe efikase.<sup>13</sup>

Në interpretimin e koncepteve të cilave u referohet neni 4 i KEDNJ, GJEDNJ mbështetet tek instrumentet ndërkombëtare si, p.sh., Konventa e Kombeve të Bashkuara për Skllavërinë e vitit 1926,<sup>14</sup> Konventa e OKB-së për zhdukjen e skllavërisë, tregtisë së skllavëve dhe praktikave të ngjashme me skllavërinë,<sup>15</sup> Konventës së ILO-s për punën e detyruar nr. 29/1930,<sup>16</sup> Konventës së vitit 2005 të Këshillit të Evropës për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, Protokollit të Konventës së Kombeve të Bashkuara për krimin e organizuar transnacional për parandalimin, shtypjen dhe dënimin e trafikimit të personave, sidomos të grave dhe fëmijëve.<sup>17</sup>

Sipas Gjykatës, KEDNJ është një instrument i gjallë që duhet të interpretohet nën dritën e kushteve aktuale dhe se standardi më i lartë që kërkohet të zbatohet në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut kërkon një vendosmëri pashmangshmërisht më të madhe në vlerësimin e shkeljeve të vlerave themelore të shoqërive demokratike.<sup>18</sup> Në lidhje me kontekstin specifik të trafikimit të qenieve njerëzore, neni 4 i KEDNJ nuk e përmend trafikimin, por ndalon shprehimisht skllavërinë, servitudin dhe punën e detyruar.<sup>19</sup>

Sidoqoftë sipas GJEDNJ trafikimi i trajton qeniet njerëzore si mallra që shiten dhe blihen dhe që përdoren për punë të detyruar, shpesh për pagesa të vogla ose kundrejt asnjë pagese, zakonisht në industrinë e seksit, por edhe gjetkë. Trafikimi i qenieve njerëzore, për nga vetë natyra dhe qëllimi i shfrytëzimit, bazohet tradicionalisht tek ushtrimi i pushteteve të lidhura me të drejtën e pronës. Trafikimi i qenieve njerëzore

<sup>13</sup> Rantsev k. Qipros dhe Ruisë, aplikimi nr. 25965/04, vendim i 7 janar 2010, parag. 289.

<sup>14</sup> Siliadin k. Francës, aplikimi nr. 73316/01, vendim i 26 korrik 2005, parag. 85-86.

<sup>15</sup> CN dhe V. k. Francës, aplikim nr. 67724/09, vendim i 11 tetor 2012, parag. 51.

<sup>16</sup> Van der Mussele k. Belgjikës, aplikim nr. 8919/80, vendim i 23 nëntor 1983, parag. 35.

<sup>17</sup> Rantsev k. Qipros dhe Ruisë, shih shënimin 13, parag. 270-280.

<sup>18</sup> Stummer k. Austrisë, aplikim nr. 37452/02, vendim i 7 korrik 2011, parag. 118.

<sup>19</sup> Rantsev k. Qipros dhe Ruisë, shih shënimin 13.

përfshin mbikëqyrjen nga afër të aktiviteteve të viktimave, lëvizjet e të cilave shpesh janë të kufizuara. Në të përfshihet përdorimi i dhunës dhe i kërcënimit ndaj viktimave që punojnë dhe jetojnë në kushte të pafavorshme. Trafikimi i qenieve njerëzore shpesh i përshkruar si një formë skllavërie moderne, është në vetvete një dhunim i dinjitetit njerëzor dhe i papajtueshëm me parimet demokratike të Konventës mund të konsiderohet i pajtueshëm me një shoqëri demokratike dhe me vlerat e parashikuara në Konventë. Rrjedhimisht sipas GJEDNJ, trafikimi, në kuptimin e nenit 3(a) të Protokollit të Palermos dhe neni 4(a) të Konventës kundër trafikimit, përfshihet në objektin e nenit 4 të Konventës.<sup>20</sup>

Sipas GJEDNJ, interpretimi i nenit 4 të Konventës duhet të integrohet me shqyrtimin e standardeve të tjera ndërkombëtare në fushën e antitrafikimit si p.sh. me përkufizimin e nenit 3 (a) të Protokollit të trafikimit dhe nenit 4, germa a) të Konventës së Këshillit të Evropës për Masat kundër Trafikimit, të cilat së bashku me nenin 4 të KEDNJ-së vendosin një kuadër rregullator të përbashkët.<sup>21</sup> Sa i përket veçanërisht paragrafit 1 të pikës 4, sipas të cilës “askush nuk mund të mbahet në gjendje skllavërie apo servitudi”, GJEDNJ mbështetet në përkufizimin klasik të Konventës së OKB-së për skllavërinë të vitit 1926, e cila e përkufizon skllavërinë si “gjendjen apo si kushtet e një subjekti, mbi të cilin ushtrohet një apo të gjitha kompetencat që kanë të bëjnë me të drejtën e pronës”, duke konfirmuar nevojën për integrimin e kuptimit aktual të nenit 4.<sup>22</sup>

GJEDNJ është përqendruar shpesh tek nocioni i punës së detyruar. Neni 4 nuk e përkufizon se çfarë nënkupton punë e detyruar dhe në dokumentet e ndryshme të Këshillit të Evropës lidhur me punimet përgatitore të Konventës Evropiane nuk ka asnjë orientim për të.<sup>23</sup> GJEDNJ ka marrë përkufizimin e parashikuar në Konventën nr. 29 të ILO-s në lidhje me punën e detyruar (“punë e detyruar” nënkupton “çdo lloj pune apo shërbimi që kryhet nga cilido person nën kërcënimin e çfarëdo penalteti apo për të cilin personi në fjalë nuk ofrohet vullnetarisht”) si pikënisje për interpretimin e nenit 4 § 2 të Konventës.<sup>24</sup> Gjykata ka theksuar se puna që duhet të kryejë një person i kërcënuar me një lloj penalteti apo ndëshkimi nuk është gjithmonë domosdoshmërisht punë e detyruar. Termi “e detyruar” të çon tek ideja e një lidhjeje fizike apo mendore. Puna e “detyruar”, nuk mund t’i referohet asnjë lloj forme detyrimi ligjor. GJEDNJ ka vërejtur se sipas ILO-s, nocioni i “ndëshkimit” përdoret në një kuptim të gjerë, duke nënkuptuar se penalteti apo ndëshkimi mund të konsistojë në dhunë fizike, por edhe në forma më të sofistikuara, si kërcënime psikologjike, si p.sh. kërcënimi për raportim të viktimave emigrante pa dokumente në polici apo në autoritetet e emigracionit, etj.

Sa i përket ofrimit vullnetar, shumë viktima futen në situata të punës së detyruar fillimisht me zgjedhjen e tyre, pavarësisht se përmes mashtrimit, për të kuptuar më pas se nuk janë të lira për t’u tërhequr për shkak të shtrëngimit ligjor, fizik apo psikologjik. Dhënia e pëlqimit fillestar është e parëndësishme kur për marrjen e tij është përdorur mashtrimi.<sup>25</sup>

<sup>20</sup> Rantsev k. Qipros dhe Ruisë, shih shënimin 13.

<sup>21</sup> M. dhe të tjerë k. Italisë dhe Bullgarisë, aplikimi nr. 41416/08, vendim i 31 korrik 2012, parag. 151. Rantsev k. Qipros dhe Ruisë, shih shënimin 13.

<sup>22</sup> Siliadin k. France, shih shënimin 15.

<sup>23</sup> Van der Mussele k. Belgjikës, shih shënimin 16.

<sup>24</sup> Van der Mussele k. Belgjikës, shih shënimin 16.

<sup>25</sup> CN and V. v. France, shih shënimin 14.

## 1.3.2 JURISPRUDENCA E GJEDNJ-SË NË LIDHJE ME TRAFIKIMIN DHE ME PËRKUFIZIMIN E TIJ

### 1.3.2.1 NDALIMI I SKLLAVËRISË DHE PUNËS SË DETYRUAR

#### Skllavëria

Për të shqyrtuar kuptimin e “skllavërisë” sipas nenit 4, siç është evidentuar më lart, GJEDNJ i referohet përkufizimit klasik të skllavërisë të parashikuar në Konventën e Skllavërisë të vitit 1926. Për qëllim të Konventës “servituti” i referohet detyrimit për të ofruar shërbimet që imponohen nëpërmjet shtrëngimit dhe lidhet me konceptin e skllavërisë.

#### Siliadin kundër Francës

Në këtë çështje, një vajzë 18 vjeçare me origjinë Togolese, në 1994 udhëtoi për në Francë bashkë me zonjën D, me vizë turistike, me marrëveshjen që Siliadin do të punonte në shtëpinë e zonjës D, derisa shpenzimet e udhëtimit të ishin rimbursuar. Sipas marrëveshjes, zonja D do ta regjistronte në shkollë dhe do të kujdesej për procedurat e emigracionit. Në vend të kësaj, punëdhënësit i morën pasaportën e Siliadinit dhe e detyruan të punonte si një shërbëto e papaguar. Në vite, ajo u angazhua edhe pranë një familjeje tjetër ku u shfrytëzua si një shërbëto e papaguar dhe kujdestare fëmijësh, duke punuar ditë 15 orë, shtatë ditë në javë. Pasi kërkoi ndihmën e një fqinje, e cila njoftoi Komitetin e Francës kundër Skllavërisë Moderne për rastin, në 1998 bashkëshortët e familjes së dytë u proceduan penalisht për (i) marrjen e shërbimeve pa pagesë duke përfituar nga dobësia e një personi ose nga gjendja e varësisë sipas nenit 225-13 të Kodit Penal (Francë) dhe (ii) nënshtrimin e një personi në kushte pune dhe jetese të papajtueshme me dinjitetin njerëzor duke përfituar nga vulnerabiliteti ose gjendja e varësisë së një personi nga neni 225-14 i Kodit Penal (Francë). Dënimi i tyre me 12 muaj burgim, shtatë muaj nga të cilat u pezulluan, dhe 100 000 franga për dëmet ndaj Siliadin, u shfuqizua nga Gjykata e Apelit. Siliadin ndoqi rrugën civile në lidhje me aspektet civile të vendimit, duke marrë vendim në favor nga ana e gjykatës së Apelit të Versajës, e cila vendosi që kishte pasur shkelje të neneve 225-13 duke i njohur Siliadin kompensimin prej 15,245 EUR për traumë psikologjike. Përveç kësaj, Gjykata Industriale e Parisit i njohu të drejtën për dëmshpërblim në shumën 33,049 EURO në lidhje me vonesat e shpërblimit për punën, pushimet vjetoret etj. Siliadin më pas bëri një kërkesë në GJEDNJ, duke pretenduar se Franca kishte dështuar në përmbushjen e detyrimit të saj pozitiv sipas nenit 4, së bashku me nenin 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“KEDNJ”), për të parandaluar dhe ndëshkuar autorët e skllavërisë, robërisë, ose punës së detyruar ose të detyrueshme.<sup>26</sup>

GJEDNJ, në referencë të përkufizimit të parashikuar në Konventën e OKB-së së vitit 1926 mbi Skllavërinë, e argumenton skllavërinë si “statusi ose kushtet në të cilat ndodhet një person mbi të cilin ushtrohen ndonjë ose të gjithë pushtetet që lidhen me të drejtën e pronësisë”. Në lidhje me konceptin e “shërbimit” sipas GJEDNJ-së, kjo gjendje nënkupton një detyrim me forcë për ofrimin e shërbimeve të veta dhe lidhet me konceptin e “skllavërisë”. Ndërsa në lidhje me nocionin “punë e detyruar apo e detyrueshme”, GJEDNJ ka argumentuar se për përmbushjen e saj duhet të ketë disa kufizime fizike ose mendore, si dhe heqje të lirisë së vullnetit të personit.<sup>27</sup> Gjykata argumentoi se aplikantja, megjithëse nuk ishte kërcënuar që do të kishte vuajtur pasoja nëse nuk bindej, ndodhej gjithsesi në një situatë ekuivalente sa i përket seriozitetit të kërcënimit të perceptuar; ajo ishte një minorene në një vend të huaj, me qëndrim të paligjshëm dhe nën frikën e arrestimit nga policia. Frika e saj u ushqye dhe iu la të besonte se statusi i saj do të ishte i rregullt. Në vlerësimin e GJEDNJ-së, ajo ishte subjekt i punës së dhe shërbimeve të detyruara në kuptim të nenit 4 të Konventës dhe se Franca kishte shkelur nenin 4 të KEDNJ duke mos mbrojtur në mënyrë aktive individët

<sup>26</sup> Siliadin k. France, shih shënimin 13.

<sup>27</sup> Siliadin k. France, parag.117-124. Argumente të dhëna edhe në Van der Musselle v. Belgium, shih shënimin 16, parag. 34.

nën juridiksionin e saj nga shfrytëzimi ekonomik.

Sipas GJEDNJ-së, shtetet kanë një detyrim pozitiv sipas nenit 4 të KEDNJ për të kriminalizuar dhe ndjekur penalisht veprimet që mbajnë çdo person në skllavëri, në robëri, ose në punë të detyrueshme, ndërkohë që në Kodin penal francez «skllavëria» dhe «servituti», nuk klasifikohen si vepra penale. Në analizë të të gjithë parashikimeve të tjera të Kodit Penal, GJEDNJ konkludon se Kodi Penal francez nuk i rregullon në mënyrë specifike këto vepra penale duke u kufizuar vetëm në ndalimin e shfrytëzimit nëpërmjet punës në një formë të përgjithshme, e rrjedhimisht duke dështuar në dhënien e mbrojtjes praktike dhe efektive të viktimave si Siliadin e mosdënimin e cenesve të saj.<sup>28</sup>

GJEDNJ konstatoi se trajtimi i viktimës kishte çuar qartësisht në privimin e saj nga liria personale, por jo në skllavëri, pasi nuk kishte pasur ndonjë sjellje që shprehte të drejtën e vërtetë të pronësisë ligjore ndaj viktimës. Gjykata nuk vlerësoi aplikimin e kushteve të skllavërisë në kuptimin tradicional të këtij koncepti në çështje, duke e lënë veprimin e nenit 4 në këtë çështje vetëm në elementët e servitudit dhe punës së detyruar. Argumente të ngjashme GJEDNJ zhvillon edhe në çështjet C.N. dhe V. kundër Francës 2012, dhe C.N. kundër Mbretërisë së Bashkuar 2012, në të cilat vlerësimi i Gjykatës për shkeljen e nenit 4 shtrihet vetëm në klauzolën e servitudit.<sup>29</sup>

### M. dhe të tjerë k. Italisë dhe Bullgarisë

Në këtë çështje, GJEDNJ nuk konstatoi shkelje të KEDNJ për qëllime të trafikimit të qenieve njerëzore. M. dhe prindërit e saj ishin vendosur në Milano pas një premtimi për punë në vilën e një shtetasi nga Roma me origjinë serbe. Prindërit e M. pretenduan, se gjashtë ditë më pas, të rrahur dhe të kërcënuar me vdekje, u detyruan të ktheheshin në Bullgari, duke e lënë vajzën në vilë. Aplikantët u ankuan se Italia kishte shkelur nenin 3 (ndalimi i torturës dhe trajtimi çnjerëzor ose degradues), për shkak se autoritetet nuk e kishin parandaluar keqtrajtimin e mëtejshëm, duke siguruar lirinë e shpejtë të M. Ata u ankuan gjithashtu për trafikim, në bazë të nenit 4 (ndalimi i skllavërisë) dhe për diskriminim racial (neni 14, ndalimi i diskriminimit). Për këtë arsye, Gjykata vërejtë se edhe nëse prezumohej se babai i kërkueses kishte marrë një shumë parash në lidhje me martesën e pretenduar, ky kontribut monetar nuk mund të konsiderohej se përbënte një çmim për kalimin e pronësisë, gjë që çon në konceptin e skllavërisë. Sipas Gjykatës, kjo pagesë mund të pranohet në mënyrë të arsyeshme si një dhuratë nga një familje tek tjetra, një traditë e zakonshme në shumë kultura të ndryshme në shoqëritë e sotme. Gjykata nuk gjeti prova të “servitudi-it” apo “punës së detyruar”, ku e para përfshin shtrëngimin për ofrimin e shërbimeve nga një person, kurse e dyta të sjell ndërmend idenë e shtrëngimit fizik ose mendor. Në këtë rast, do të duhet të kishte një punë “të kryer .... nën kanosjen e çfarëdolloj ndëshkimi” dhe të kryer gjithashtu kundër vullnetit të personit në fjalë, d.m.th. punë, për të cilën ai apo ajo “nuk ishte ofruar me dëshirën e vet”.<sup>30</sup>

Gjykata i rrëzoi të gjitha kërkesat dhe pranoi për shqyrtim vetëm kërkesën për shkelje të Nenit 3 të KEDNJ-së dhe konstatoi vetëm një shkelje bazuar në hetim jo efektiv. Gjykata pranoi se rrethanat mund të kishin çuar në trafikim të qenieve njerëzore, por provat e paraqitura ishin të pamjaftueshme për të arritur në një përfundim të tillë. Kështu Gjykata nuk pranoi se rrethanat përbënin rekrutim, transportim, transferim, pritje, apo marrje të personave me qëllim shfrytëzimin, punën e detyruar, shërbimet, skllavërinë apo praktikat e ngjashme me skllavërinë, servitudin apo heqjen e organeve. Për shkak se nuk ishte përcaktuar nëse L.M ishte viktimë trafikimi, autoritetet italiane nuk ishin të detyruara të dënonin apo ndiqnin penalisht trafikimin.<sup>31</sup>

<sup>28</sup> Siliadin k. France, parag. 118-120.

<sup>29</sup> CN dhe V. k. France, shih shënimin 15, C.N. k. Mbretërisë së Bashkuar aplikim nr. 4239/08, vendim i datës 13 nëntor 2012, parag. 81-84.

<sup>30</sup> M. dhe të tjerë k. Italisë dhe Bullgarisë, shih shënimin 21.

<sup>31</sup> M. dhe të tjerë k. Italisë dhe Bullgarisë, shih shënimin 21.

## Puna e detyruar

### J. e të tjerë k. Austrisë

Në çështjen J. e të tjerë k. Austrisë, tre shtetase filipinase paraqitën çështjen e tyre përpara GJEDNJ-së në pretendimin e cënimit të nenit 4 të KEDNJ. Aplikantja e parë dhe e tretë ishin rekrutuar nga një agjenci punësimi për të punuar si kujdestare fëmijësh në Dubai, Emiratet e Bashkuara Arabe. Aplikantja e dytë nuk kishte përdorur shërbimet e një agjencie. Ajo kishte udhëtuar në Dubai me sugjerimin e aplikantes së parë. Me mbërritjen në Dubai, punëdhënësit e tyre u morën pasaportat, duke i nënshtruar ndaj keqtrajtimeve dhe shfrytëzimit. Punëdhënësi i kërkueseve i mori me vete në një udhëtim të shkurtër pushimi në Austri; ato qëndruan në të njëjtin hotel si punëdhënësi i tyre, u kujdesën për fëmijët dhe kryenin detyra të tjera të brendshme. Pasaportat e tyre mbetën me punëdhënësin e tyre. 1 ose 2 ditë pas arritjes së tyre në Austri, ata iu nënshtruan një forme ekstreme të abuzimit dhe kërcënimeve verbale, pasi një nga fëmijët u zhduk. Natën pas incidentit, aplikantet u larguan nga hoteli me ndihmën e një punonjësi të hotelit dhe bënë kallëzim ndaj punëdhënësve të tyre, duke pretenduar se ishin viktima të trafikimit të qenieve njerëzore dhe se ishin të gatshme të bashkëpunonin me policinë. Autoritetet austriake regjistruan procedimin penal për veprën e trafikimit të qenieve njerëzore, duke vendosur në fund mosvazhdimin e procedimit penal për shkak se veprat e pretenduara ishin kryer jashtë vendit dhe jo nga qytetarët austriakë. Aplikantet iu drejtuan GJEDNJ me pretendimin se Austria nuk kishte ndërmarrë një hetim efektiv në pretendimet e tyre se ata kishin qenë viktima të trafikimit të qenieve njerëzore.<sup>32</sup>

GJEDNJ argumentoi qartë se çështja hynte në fushën e veprimit të nenit 4 të Konventës, sipas jurisprudencës së konsoliduar të saj, por pa detajuar më tej sipas kategorive të veprimeve që ndalon neni 4 i Konventës. Kjo mund të jetë e lidhur edhe me kualifikimin e veprës penale si trafikim nga ana e vetë autoriteteve vendase austriake. GJEDNJ analizoi përmbushjen e detyrimeve të karakterit procedural që parashtron neni 4 i KEDNJ nga ana e Austrisë. Sipas GJEDNJ, rasti i çështjes në thelb ngre dy pyetje: a kanë përmbushur autoritetet austriake detyrimin e tyre pozitiv për të identifikuar dhe mbështetur kërkueset si viktima (të mundshme) të trafikimit të qenieve njerëzore dhe a kanë përmbushur pozitivisht detyrimin për të hetuar veprën e pretenduar. GJEDNJ vlerësoi se nuk kishte shkelje të detyrimeve procedurale sipas nenit 4 të KEDNJ nga ana e Austrisë sepse sipas GJEDNJ-së, neni 4 i KEDNJ nuk parasheh asnjë detyrim që ta detyronte Austrinë të hetonte rekrutimin e aplikanteve filipinase ose pretendimet për shfrytëzim në Emiratet e Bashkuara Arabe sepse vetë kadri ligjor i trafikimit të qenieve njerëzore dhe Konventa e Trafikimit të Këshillit të Evropës nuk parashikojnë juridiksion universal për të hetuar rekrutimin dhe shfrytëzimin jashtë vendit.<sup>33</sup>

Në lidhje me veprimtarinë e realizuar brenda territorit austriak, sipas GJEDNJ meqenëse trafikimi i qenieve njerëzore është përcaktuar në Konventën e Këshillit të Evropës mbi Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, i përmbushur nëpërmjet veprimeve, elementi i veprimit të kimit përfshin “strehimin” dhe “pranimin” e personave me qëllim të shfrytëzimit të tyre. Prandaj ka vlerë argumenti se Austria kishte juridiksion penal bazuar në parimin territorial dhe ishte nën detyrimin për të hetuar strehimin dhe pranimin e kërkueseve në Austri. Sidoqoftë, në thelb në lidhje me këtë pretendim, nuk u gjet shkelje nga ana e GJEDNJ, duke vlerësuar se nga ana e autoriteteve austriake ishin bërë përpjekje të mjaftueshme në lidhje me hetimin dhe procedimin, nuk ekzistonte marrëveshje e ndihmës së ndërsjellë juridike midis Austrisë dhe Emirateve të Bashkuara Arabe, dhe aplikantet vunë në dijeni policinë vetëm afërsisht një vit pas ngjarjeve të supozuara, kur punëdhënësit kishin lënë tashmë Austrinë.<sup>34</sup>

<sup>32</sup> J. dhe të tjerë k. Austrisë, aplikimi nr. 58216/12 vendim i 17 janar 2017, parag. 118.

<sup>33</sup> J. dhe të tjerë k. Austrisë, aplikimi nr. 58216/12 vendim i 17 janar 2017, parag. 114.

<sup>34</sup> J. dhe të tjerë k. Austrisë, aplikimi nr. 58216/12 vendim i 17 janar 2017, parag. 114.



### Chowdury dhe të tjerët kundër Greqisë

Në këtë çështje, GJEDNJ përcjell argumente të vlefshme për zbrërthimin e elementit të përdorimit të forcës apo kërcënimit në vepra penale që kanë lidhje me trafikimin për qëllime pune të detyruar.<sup>35</sup> Sipas çështjes, 42 shtetas të Bangladeshit që jetonin në Greqi pa status e dokumente u rekrutuan për të punuar në një fermë luleshtrydhe në Manolada në Greqi. Punonin në sera plastike çdo ditë nga ora 7 deri në orën 7 të mëngjesit, nën mbikëqyrjen e rojeve të armatosura, me premtimin e pagës 22 euro për shtatë orë punë dhe 3 euro për çdo orë jashtë orarit. Nuk u paguan asnjëherë, arsye për të cilën hynë në grevë disa herë. Punën e vazhdonin nën shpresën e marrjes së pagesës. Kushtet e jetesës ishin gjithashtu të rënda në vende të mbuluara me karton, pa shërbimet bazike. Në një nga protestat e tyre për marrjen e pagesave të punës, rojet e armatosura hapën zjarr duke plagosur disa prej tyre. Pas këtij incidenti autoritetet greke nisën hetim dhe në fund të procesit punëdhënësit dhe rojet u dënuan vetëm për plagosje të rëndë dhe përdorim të paligjshëm të armëve të zjarrit. Sipas gjykatave vendase rrethanat e çështjes ishin te tilla për kualifikimin e veprimeve në veprat penale më sipër e jo trafikimin e qenieve njerëzore duke qenë se mungonin elementët objektivë të veprës penale të trafikimit.<sup>36</sup>

Në argumentimin e çështjes së tyre përpara GJEDNJ, emigrantët pretenduan cënimin e nenit 4 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në drejtim të detyrimeve të shtetit grek për t'i mbrojtur ata kundër punës së detyruar dhe trafikimit të qenieve njerëzore. Ata pretenduan dështimin e autoriteteve greke për të hetuar mbi veprimet e punëdhënësve të tyre dhe gjithashtu ndëshkimin e tyre. Gjykata vlerësoi shkelje procedurale të nenit 4(2) të KEDNJ, sepse megjithëse autoritetet vendase kishin realizuar ndjekje penale, gjykatat e zbrërthyen shumë ngushtë veprën penale të trafikimit të qenieve njerëzore, duke argumentuar se mungesa e kufizimit të lëvizjes kushtëzonte mosaplikimin në çështje të nenit përkatës të Kodit Penal Grek mbi trafikimin e qenieve njerëzore. Në një argumentim të kundërt, GJEDNJ thekson se kufizimet mbi lirinë e lëvizjes nuk përbëjnë një element të domosdoshëm për kualifikimin e veprimeve të tilla, si në rastin në fjalë, si trafikim i qenieve njerëzore.

Në drejtim të fushës së veprimit të KEDNJ, GJEDNJ argumentoi se rrethanat e punëtorëve emigrantë binin brenda fushës së veprimit të Nenit 4(2) të KEDNJ. Sidoqoftë, sipas GJEDNJ-së situata e punëtorëve nuk është e ngjashme me skllavërinë; veprimet e përmëshura në vlerësimin e Gjykatës ngrihen në nivelin e trafikimit njerëzor dhe punës së detyruar. GJEDNJ përqasi përmëshjen e detyrimeve pozitive nga ana e Greqisë, në drejtim të (i) parashikimit të një kornizë efektive ligjore; (ii) marrjen e masave mbrojtëse operative; (iii) kryerjen e hetimeve procedurave penale efektive, duke konkluduar se ndërsa në drejtim të rregullimeve të përshtatshme në nivelin legjislativ sipas kërkesave të akteve evropiane, në veprimet e autoriteteve ligjzbatuese për të marrë masa mbrojtëse kishte pasur mangësi në konsideratë të faktit se autoritetet kishin informacion për mënyrat e shfrytëzimit të punëtorëve emigrantë në Manolada, e megjithatë nuk ndërmorën masa mbrojtëse pozitive për adresimin e kërkesave ligjore e të Konventës së Këshillit të Evropës kundër Trafikimit.<sup>37</sup>

### 1.3.3 DETYRIMET POZITIVE QË RRJEDHIN NGA NENI 4 I KEDNJ

GJEDNJ gjatë praktikës së saj ka mbajtur qëndrimin e qartë lidhur me shumë nene të KEDNJ se fakti që një shtet frenohet nga shkelja e të drejtave të garantuara në të nuk mjafton për të dalë në përfundimin nëse janë përmëshur apo jo detyrimet e parashikuara në nenin 1 të Konventës. Kështu respektimi i kufizuar

<sup>35</sup> Chowdury dhe të tjerë k. Greqisë, aplikim nr. 21884/15, vendimi i 30 mars 2017, parag. 128.

<sup>36</sup> Chowdury dhe të tjerë k. Greqisë, aplikim nr. 21884/15, vendimi i 30 mars 2017, parag. 117-123


<sup>37</sup> Chowdury dhe të tjerë k. Greqisë, aplikim nr. 21884/15, vendimi i 30 mars 2017, parag. 110-15.

apo thjesht formal i nenit 4 të Konventës nga ana e autoriteteve shtetërore nuk është në përputhje me instrumentet ndërkombëtare dhe do të çonte në mungesën e efikasitetit të tij. Sipas GJEDNJ, neni 4 i Konventës përcakton detyrime pozitive për shtetet.<sup>38</sup>

### 1.3.3.1 DETYRIMI POZITIV PËR KRIJIMIN E NJË KUADRI EFIKAS LIGJOR

Neni 4 kërkon që shtetet anëtare të KEDNJ të vendosin një kuadër rregullator efikas dhe të ndjekin çdo akt që ka për qëllim mbajtjen e një personi në një situatë skllavërie, servitudi apo pune të detyruar.<sup>39</sup> Për përmbushjen e këtij detyrimi, shteteve anëtare u kërkohet që të ngrenë një kuadër ligjor të përshtatshëm për goditjen dhe ndëshkimin e akteve të tilla.

Në kontekstin specifik të trafikimit, Gjykata ka theksuar se Protokollin i Palermos i OKB-së dhe Konventa e Këshillit të Evropës kundër Trafikimit shprehin nevojën për një qasje gjithëpërfshirëse në luftën kundër trafikimit, duke përfshirë masat me qëllim:

- 
- a) parandalimin e trajtimeve të tilla;
  - b) mbrojtjen e viktimave;
  - c) ndëshkimin e trafikantëve.<sup>40</sup>

Siç del qartë nga dispozitat e këtyre dy instrumenteve, vetëm një kombinim i masave që i përfshin të tre këto komponentë së bashku mund të jetë një qasje efiçase në luftën kundër trafikimit. GJEDNJ ka theksuar se parashikimi i sanksioneve dhe ndjekja penale e veprave të trafikimit nuk janë të vetmet elemente të angazhimit të shteteve anëtare për të luftuar trafikimin; shtrirja e detyrimeve pozitive që rrjedhin nga neni 4 duhet të konsiderohet gjithashtu. Për këtë arsye, instrumentet e ngritura nga e drejta kombëtare duhet të jenë të përshtatshme për të garantuar mbrojtjen konkrete dhe efiçase të të drejtave të viktimave apo të viktimave potenciale të trafikimit. Përveç masave të së drejtës penale për ndëshkimin e trafikantëve, neni 4 kërkon që shtetet anëtare të marrin masa të përshtatshme për të ndërhyrë në fusha që përbëjnë një terren për zhvillimin e trafikimit të qenieve njerëzore.<sup>41</sup> Shembull tipik janë rregullat kombëtare të emigracionit që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në identifikimin e viktimave dhe në ndjekjen penale të trafikantëve. Përmbushja e një detyrimi të tillë kërkon zhvillimin e programeve specifike trajnimi për punonjësit në sektorin e emigracionit dhe ata të zbatimit të ligjit. Më konkretisht, në Chowdury e të tjerë k. Greçisë, GJEDNJ theksoi se në mënyrë që në një çështje të caktuar të evidentohet përmbushja e detyrimeve pozitive nga ana e shtetit për marrje masash operacionale, duhet të demonstron se autoritetet shtetërore kanë qenë në dijeni ose duhet të kishin qenë në dijeni ose që rrethanat të kishin çuar në një dyshim të besueshëm se individi i identifikuar kishte qenë, ose ishte ekspozuar ndaj një rreziku real dhe të atypëratyshëm të trafikimit ose shfrytëzimit në kuptimin e nenit 3 (a) të Protokollit të Palermos dhe nenit 4 (a) të Konventës së Këshillit të Evropës. GJEDNJ ka theksuar se parimet e mësipërme janë njësoj të rëndësishme, pavarësisht nga qëllimi i shfrytëzimit në rastet e trafikimit, për shfrytëzim seksual, shfrytëzim për punë apo shfrytëzimi për ndonjë qëllim tjetër. Duke shkuar përtej tendencës tradicionale të identifikimit të trafikimit si një vepër me qëllim kryesor shfrytëzimit seksual, Gjykata theksoi se neni 4, paragrafi 2 i Konventës nënkupton një detyrim pozitiv për shtetet që

<sup>38</sup> Siliadin k. Francës, shih shënimin 14.

<sup>39</sup> CN dhe V. k. Francës, shih shënimin 15, C.N. k. kundër Mbretërisë së Bashkuar shih shënimin 29.

<sup>40</sup> Rantsev k. Qipros dhe Ruisë, shih shënimin 13.

<sup>41</sup> Rantsev k. Qipros dhe Ruisë, shih shënimin 13.

të adresonin edhe kategoritë e tjera të shfrytëzimit, si shfrytëzimin për punë të detyruar, në formën e një kuadri ligjor dhe rregullator që lejon parandalimin e trafikimit me qëllim shfrytëzimin për punë, mbrojtjen e viktimave dhe hetimin efikas edhe në raste të tilla, bashkë me parashikimin e rregullave specifike penale në këtë sektor.

### 1.3.3.2 DETYRIMI POZITIV PËR MARRJEN E MASAVE EFKASE PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE

Siç është shprehur dhe më sipër, gjatë praktikës së saj GJEDNJ ka mbajtur qëndrimin e qartë se neni 4 i Konventës u kërkon shteteve anëtare që të marrin masa për mbrojtjen e viktimave (të mundshme) të trafikimit.<sup>42</sup> Detyrimi lidhet me rastet kur autoritetet shtetërore kanë një dyshim të arsyeshëm se një person është apo ka qenë objekt i një veprimtarie në shkelje të nenit 4 të Konventës ose që do të kishin qenë në dijeni nëse do të kishin vepruar me kujdes. Në një rast të tillë, autoritetet janë në shkelje të KEDNJ nëse nuk marrin masat e duhura brenda kompetencave të tyre për nxjerrjen e personit nga ajo situatë ose nga ai rrezik. Detyrimi për marrjen e masave operacionale duhet të interpretohet sidoqoftë në mënyrë të tillë që të mos vendosë një barrë të pamundur apo joproporcionale mbi autoritetet. Në Rantsev k. Cyprus dhe Russia, GJEDNJ vlerësoi se neni 4 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar) vepron kundër trafikimit; ajo arriti në përfundimin Qipro nuk kishte përmbushur detyrimet pozitive që lindin nga neni 4 i Konventës në dy drejtime:

Së pari, në dështimin për të krijuar një kuadër të përshtatshëm ligjor dhe administrativ për të luftuar trafikimin si rezultat i regjimit ekzistues të vizave për të punuar në rrugë.

Së dyti, dështimi i policisë për të marrë masa aktive për të mbrojtur vajzën e aplikantit nga trafikimi, pavarësisht nga rrethanat që shkaktuan dyshim të besueshëm se ajo mund të kishte qenë viktimë e trafikimit.

Sipas GJEDNJ kishte shkelje të nenit 4 të Konventës edhe nga Rusia për shkak të dështimit për të hetuar se si dhe ku vajza e paditësit ishte rekrutuar dhe veçanërisht, të ndërmerreshin hapa për të identifikuar ata që u përfshinë në rekrutimin e saj ose metodat e rekrutimit që u përdorën. GJEDNJ përcaktoi se shtetet anëtare të Konventës kanë detyrime pozitive në lidhje me zbatimin e nenin 4 në drejtim të zhvillimit të një kornizë të përshtatshme legislative dhe administrative për të luftuar trafikimin, marrjen e masave mbrojtëse për viktimat ose viktimat e mundshme dhe detyrime të natyrës procedurale për të hetuar veprat penale të trafikimit.

Në çështjen V.F. k. Francës, GJEDNJ nuk gjen shkelje të detyrimeve pozitive nga ana e Francës duke argumentuar se kërkuesja nuk kishte tentuar të kontaktonte autoritetet dhe as autoritetet nuk kishin pasur mundësinë që ta ekzaminonin apo të hetonin situatën e saj. Megjithë raportimet e shumta mediatike mbi fenomenin të trafikimit të grave nigeriane në Francë dhe vështirësive të hasura prej tyre në kontaktimin e autoriteteve për të përftuar mbrojtje, GJEDNJ vlerësoi se nga këndvështrimi i rrethanave të çështjes – në zbatim të kriterit të sipërpërmendur të barrës së arsyeshme ndaj shteteve – provat e paraqitura nga kërkuesja nuk ishin të mjaftueshme për të vërtetuar se autoritetet vendase e kishin ditur apo se duhet të kishin qenë në dijeni se ajo ishte një viktimë e trafikuar kur kishin vendosur që ta riatdhesonin. Ndërkohë, në Chowdury e të tjerë k. Greqisë, GJEDNJ shfaqet më e qartë ndaj detyrimeve pozitive të shteteve duke konkluduar se Greqia nuk i kishte përmbushur detyrimet e saj pozitive. Sipas GJEDNJ, duke qenë në dijeni përmes raporteve zyrtare dhe mediatike mbi situatën në të cilën shfrytëzoheshin dhe/ose punësoheshin punëtorët emigrantë në kushte të vështira, autoritetet vendase nuk kishin marrë masa të mjaftueshme për parandalimin e trafikimit dhe për mbrojtjen e viktimave, emigrantë nga Bengali.

<sup>42</sup> CN and V. k. Francës, shih shënimin 14.

### 1.3.3.3 DETYRIMI POZITIV PËR TË HETUAR

Neni 4 i Konventës parashikon gjithashtu detyrimin pozitiv të fillimit të hetimeve në rastin e një dyshimi të bazuar për shkeljen e të drejtave të viktimës në kuadrin e këtij neni.<sup>43</sup>

GjEDNJ ka theksuar se detyrimi për hetim nuk duhet të varet nga ankesa ose jo e viktimës apo nga persona të afërt të saj; autoritetet duhet të veprojnë ex officio në momentin që vihen në dijeni të rastit. Që hetimi të jetë efikas, ai duhet të jetë proaktiv dhe duhet gjithashtu të çojë në identifikimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës. Kuptohet që ky është një detyrim jo për rezultatet, por për rrugën e ndjekur. Përveç kësaj, hetimi duhet të jetë i menjëhershëm në të gjitha rastet, por nëse nevojitet nxjerrja e viktimës nga një situatë e rrezikshme dhe potencialisht e dëmshme, ai duhet të ndërmerret në mënyrë urgjente. Në rastet kur kërkuesi pretendon se ka qenë viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, lind detyrimi pozitiv për marrjen e masave operacionale mbrojtëse. Në fund, viktimat duhet të përfshihen në proces, duke u mbështetur me çfarëdolloj informacioni apo ndihme që duhet për garantimin e të drejtave të tyre.<sup>44</sup>

Identifikimi dhe dhënia zyrtare e statusit një viktime të trafikimit të qenieve njerëzore (masa që shtetet duhet t'i marrin me qëllim përmbushjen e detyrimeve të tyre në kuadrin e Konventës së Këshillit të Evropës kundër trafikimit dhe legjislacionit të BE-së për trafikimin) janë pjesë e kuadrit të detyrimit pozitiv për marrjen e masave operacionale mbrojtëse në kuadrin e nenit 4 të KEDNJ.

Në kontekstin specifik të trafikimit të qenieve njerëzore, përveç detyrimit të kryerjes së hetimeve për ngjarje që ndodhin në territorin e tyre, shtetet anëtare janë gjithashtu të detyruara për bashkëpunim efikas me autoritetet kompetente të shteteve të tjera të përfshira, duke pasur parasysh natyrën transnacionale të fenomenit. Në *Chowdury e të tjerë k. Greqisë*, GJEDNJ konstatoi se Greqia nuk i kishte përmbushur detyrimet e saj procedurale, sidomos për shkak se prokurori nuk kishte pranuar të fillonte hetimin ndaj çështjes së 21 kërkuesve, me argumentin se ata i kishin paraqitur ankesat me vonesë, pavarësisht specifikës e kushtet e përgjithshme psikologjike të viktimave të trafikimit, mundësisë për kërcënime e dhunë intimiduese ndaj tyre që nuk i lejonte që të paraqisnin në kohë ankesën ndaj autoriteteve.

Në *Rantsev k. Qipros dhe Ruisë*, GJEDNJ vlerësoi se autoritetet ruse nuk kishin hetuar nëse në rekrutimin dhe shfrytëzimin e znj. Rantsev në Qipro ishin përfshirë individë apo rrjete që operonin në Rusi. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që neni 4 i Konventës, në kontekstin e tij procedural, kërkon që shtetet të parashikojnë një juridiksion universal për veprat penale të trafikimit që kryhen jashtë shtetit.<sup>45</sup>

43 *Id. Rantsev k. Qipros dhe Ruisë, shih shënimin 13.*

44 *L.E. k. Greece, aplikim nr. 71545/12, vendim i 21 janar 2016, parag. 74-78.*

45 *J. dhe të tjerë kundër v. Austrisë, shih shënimin 31.*

## KREU II



# ZBËRTHIMI I VEPRËS PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

## 2. 1 ELEMENTËT E VEPRËS PENALE

Vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore ka tri elementë të cilët duhen interpretuar në tërësi. Kjo veprë përfshin disa veprime të cilat kryhen në forma të shumta. Shumëllojshmëria e mënyrës së kryerjes së këtyre veprimeve dhe shpesh mungesa e vullnetit të viktimës së kësaj veprë për të denoncuar autorin, e bëjnë dhe më të vështirë evidentimin e kësaj veprë. Trafikimi i qenieve njerëzore duhet kuptuar si proces; Trafikimi i qenieve njerëzore shpesh nuk është një ngjarje e thjeshtë apo e atypëratyshme. Ai është një fenomen që zgjat në kohë, është një proces i tërë, ku shpesh marrin pjesë shumë persona. Këta tri elementë mund të ndodhin në faza të ndryshme, siç për shembull ndodh në shumë raste: nis me rekrutimin e viktimës, vijon me zhvendosjen e tij/saj brenda vendit apo përtej kufirit dhe, në fund, me shfrytëzimi i tij/i saj.

### I. VEPRIMI

### II. MJETET

### III. QËLLIMI

Secili prej këtyre komponentëve duhet të jetë i pranishëm për të dalë në përfundimin se jemi para veprës penale të trafikimit, me përjashtim të rasteve të fëmijëve, ku nuk është e domosdoshme që të vërtetohen mjetet apo mënyrat e përdorura. Trafikimi i qenieve njerëzore përbën një kombinim të këtyre elementëve dhe jo trajtim të izoluar nga njëri-tjetri. Për shembull, (akti i) strehimit të personave që përfshin kërcënimin apo përdorimin e forcës (mjetet) për shfrytëzim seksual (qëllimi) përbën një veprim që duhet të trajtohet si trafikim i qenieve njerëzore. Po kështu, duhet trajtuar edhe rekrutimi i personave (veprimi) përmes mashtrimit (mjetet) për shfrytëzim për punë (qëllimi).

VEPRIMI	MJETET	QËLLIMI
Rekrutimi	Forca	Shfrytëzimi
Marrja në dorëzim	Mashtrimi	
Transporti	Shtrengimi	
Transferimi	Rrëmbimi	
Strehimi	Shpërdorimi i detyrës	
	Abuzimi i pozitës vulnerabël	
	Pagesa apo marrja e një përfitimi nga një person përmes kontrollit të një personi tjetër	

Në çështjen S.M. k. Kroacisë, Gjykata pohoi se një sjellje apo një situatë mund të ngrihet në nivelin e veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore kundër të cilit mbrohen neni 4 i KEDNJ, vetëm nëse janë të pranishëm që të tre elementët përbërës të përkufizimit ndërkombëtar të trafikimit të qenieve njerëzore në Konventën Evropiane kundër Trafikimit dhe Protokollin e Palermos:



- (1) akti (rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi apo marrja në dorëzim e personave);
- (2) mjetet (kërcënimi apo përdorimi i forcës ose formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të pushtetit apo pozicionit të vulnerabilitetit ose marrja ose dhënia e pagesave apo përfitimeve për arritjen e marrjes së pëlqimit të një personi, duke pasur kontroll mbi një person tjetër);
- (3) qëllim shfrytëzues (duke përfshirë, minimalisht, shfrytëzimin e prostituimit të të tjerëve ose format e tjera të shfrytëzimit seksual, punës apo shërbimeve të detyruara, skllavërisë apo praktikave të ngjashme me skllavërinë, servitudin ose heqjen e organeve).

Nga këndvështrimi i nenit 4, koncepti i trafikimit të qenieve njerëzore lidhet si me trafikimin brenda vendit, ashtu edhe me trafikimin transnacional të qenieve njerëzore, pavarësisht nëse ai është apo jo i lidhur me krimin e organizuar.

## I. VEPRIMI

Veprimet e përshkruara në përkufizim kanë të bëjnë me: rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin ose marrjen në dorëzim të personave. Përkufizimi përpiqet të përfshijë të gjitha aktet që çojnë në shfrytëzimin e viktimës. Mjafton që të ndodhë edhe një prej këtyre veprimeve për të përmbushur veprën penale.

### Rekrutimi

Përkufizimi i trafikimit i mbulon të gjitha llojet e rekrutimit. Aty përfshihen si format tradicionale të rekrutimit, ashtu edhe ato moderne. Përdorimi i teknologjive të reja të informacionit ka rëndësi të madhe vitet e fundit, pasi viktimat mund të rekrutohen në të gjithë botën përmes internetit dhe aplikacioneve të tij. Rekrutimi përfshin çdo formë dhe çfarëdolloj mënyre.

### Transportimi

Transportimi përfshin kalimin nga viktimat të një ose më shumë kufijve ndërkombëtarë ose udhëtimin brendavendit (trafikimi i brendshëm), pavarësisht nëse udhëtimi bëhet në mënyrë të ligjshme apo të paligjshme; ai përfshin gjithashtu edhe marrjen dhe pritjen e viktimave nga vendi i punës.

Duhet theksuar se nuk është e nevojshme që transporti të kryhet nëpërmjet kalimit të kufirit që të konsiderohet si element i veprës së trafikimit. Kuadri ligjor ndërkombëtar zbatohet si për trafikimin ndërkombëtar dhe atë brenda vendit. Gjithashtu në rastet e trafikimit ndërkombëtar është e parëndësishme nëse viktimat ka hyrë në mënyrë të paligjshme apo ka status të rregullt në territor. Dikush mund të jetë viktimë trafikimi dhe nëse ka kaluar kufirin në mënyrë të ligjshme dhe ka qëndrim të rregullt në territor.

### Transferimi

Kuptimi i zakonshëm i transferimit të personave është ai që duhet të zbatohet në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore, duke përfshirë aktet e shkëmbimeve të transferimit apo transferimit të kontrollit, pa u kushtëzuar nga aktiviteti material që zhvillohet apo radha e veprimit.

## Strehimi

Strehimi mund të përfshijë mbajtjen e një personi në një vend të caktuar para apo gjatë fazës së shfrytëzimit. Prandaj, ai përfshin akomodimin e viktimës në vendin e shfrytëzimit, p.sh.:



- akomodimin e individit në një shtëpi publike ose në një shtëpi private me qëllim shfrytëzimin seksual;
- akomodimin e një personi në një shtëpi private me qëllim servitudin në familje apo shfrytëzimin për punë dhe për aktivitete të tjera kriminale;
- akomodimin e burrave dhe grave apo fëmijëve të tyre për të jetuar në kasolle ose tenda afër fushave apo fabrikave ku ata shfrytëzohen për punë të detyruar ose për lypje;
- akomodimin ose strehimin e personave në çfarëdolloj mënyre, qoftë gjatë udhëtimit për në vendet ku do të kryhet heqja e paligjshme e organeve të tyre ose jo.

## Marrja në dorëzim

Marrja në dorëzim është akti i marrjes apo pranimit të personave për akomodim, strehim apo për punësim ose me qëllim angazhimit të tyre seksual për çfarëdolloj arsyeje tjetër që lidhet me trafikimin e qenieve njerëzore.

## II. MJETET

Elementi i dytë i trafikimit të qenieve njerëzore është prania dhe përdorimi i një ose më shumë mjeteve. Rëndësia e përdorimit të një ose më shumë mjeteve mund të vlerësohet, duke marrë parasysh rrethanat objektive edhe ato subjektive të viktimës si dhe veprimet konkrete të trafikantëve.

### Kërcënimi ose përdorimi i forcës

Kuptimi i përdorimit të kërcënimeve të drejtpërdrejta dhe/ose forcës fizike nuk ka nevojë për shpjegime të mëtejshme, për shkak se ai është *in re ipsa*.

### Format e tjera të shtrëngimit

Mënyrat alternative të formave të tjera të shtrëngimit duhet të përfshijnë kërcënimet e drejtpërdrejta ose llojet e tjera të shtrëngimit jo të dhunshëm, por sidoqoftë psikologjik duke përfshirë:



- kërcënimet për të dëmtuar apo për kufizime fizike;
- çdo akt apo plan që ka për qëllim ta bëjë një person të besojë se moskryerja e një akti do të çonte në pasoja dhe dëme serioze ose në kufizime fizike ndaj cilitdo person;
- abuzimin ose çdo kërcënim që lidhet me statusin juridik të personit;
- presioni psikologjik.

Ky interpretim mund të gjendet në:

Ligjin Model të Zyrës së Kombeve të Bashkuara mbi Drogën dhe krimin (UNODC) kundër trafikimit të personave (2009) në [https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/UNODC\\_Model\\_Law\\_on\\_Trafficking\\_in\\_Persons.pdf](https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/UNODC_Model_Law_on_Trafficking_in_Persons.pdf)

Udhëzimi i OSBE-së: Trafikimi i qenieve njerëzore, identifikimi i viktimave potenciale apo të prezumuara; qasja e policimit në komunitet (2011).

<https://www.osce.org/secretariat/78849>

### RRËMBIMI

Shfrytëzimi mund të jetë pasojë e rrëmbimit apo marrjes peng të viktimës, sidomos, por jo vetëm, të grave të shfrytëzuara seksualisht apo të fëmijëve.

### MASHTRIMI

Mashtrimi mund t'i referohet natyrës së shërbimeve, ku do të përfshihet viktima, si dhe kushteve në të cilat personi do të jetë i detyruar t'i kryejë ato shërbime. Për shembull:

- ▶▶ personit i premtohet një punë e caktuar, por pastaj detyrohet të prostituojë;
- ▶▶ personi pritët që të prostituojë duke i mbajtur vetë paratë e fituara, por pastaj detyrohet që t'i japë fitimet trafikantëve;
- ▶▶ personit i premtohet mundësia për një punë të ligjshme në kushte të ligjshme, por nuk paguhet dhe detyrohet të punojë në kushte të vështira, i privuar nga dokumentet e udhëtimit apo të identitetit, pa pasur asnjë mundësi zgjedhjeje përveç punës.

### SHPËRDORIMI I PUSHTETIT

Shpërdorimi i pushtetit nënkupton përdorimin në mënyrë të parregullt ose të paligjshme të një pozicioni epërsie.

Dhënia ose marrja e pagesave ose përfitimeve për marrjen e pëlqimit të një personi që ka kontroll mbi një person tjetër

Kjo kërkesë ka kuptimin e saj të zakonshëm: për shembull, pagesa që u bëhen prindërve të viktimave të reja në moshë për marrjen e pëlqimit të tyre apo drejtuesit të një jetimoreje për marrjen e përfitimeve për shfrytëzimin e tyre.

### SHPËRDORIMI I POZICIONIT TË VULNERABILITETIT

Abuzimi me pozicionin e vulnerabilitetit apo dobësisë po haset gjithmonë e më shumë në praktikë. Është shumë e rëndësishme për profesionistët e fushës së drejtësisë që të kuptojnë shumë mirë se çfarë nënkupton kjo formë, duke qenë se abuzimi i pozicionit të vulnerabilitetit është më pak i prekshëm në dukje. Kjo nënkupton abuzimin me çfarëdo situatë, në të cilën viktima nuk ka asnjë alternativë të pranueshme



përveçse t'i nënshtrohet abuzimit. Me vulnerabilitet apo dobësi nënkuptohet gjendja fizike, psikologjike, emocionale, sociale, familjare apo edhe situata e lidhur me traditat kulturore të vendit të origjinës të viktimës. Këtu mund të përfshihet edhe pasiguria apo paligjshmëria e viktimës, sa i përket statusit të saj ligjor, varësia ekonomike, shëndeti i brishtë dhe çdo situatë tjetër vështirësie, ku personi detyrohet të shfrytëzohet.

Për vlerësimin e pozicionit të vulnerabilitetit, duke përfshirë edhe disa shembuj të qartë situatash, ku mund të lindë një vulnerabilitet i tillë, janë identifikuar disa tregues të dobishëm nga OSBE<sup>46</sup> në botimin e vitit 2011 "Trafikimi i Qenieve Njerëzore: Identifikimi i Viktimave të Mundshme dhe të Presumuara".

### **Këtu përfshihet:**

- hyrja në një vend në mënyrë të paligjshme ose pa dokumentacionin e duhur;
- shtatzënia ose çdo sëmundje fizike ose aftësi e kufizuar, duke përfshirë edhe varësinë nga përdorimi i çfarëdolloj substance;
- kapaciteti i ulët i gjykimit si rrjedhojë e të qenit i mitur ose për shkak të një sëmundjeje apo një aftësie të kufizuar fizike ose mendore;
- premtime të bëra ose shuma parash ose avantazhe të tjera dhënë personave që kanë autoritet mbi personin e abuzuar apo të qenit në një situatë të rrezikshme nga pikëpamja e mbijetesës sociale apo faktorë të tjerë relevantë.

Udhëzime të tjera të dobishme vijnë nga UNODC në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e "abuzimit të pozitës vulnerabël"<sup>47</sup>, ku sqarohet se abuzimi me pozitën vulnerabël ka të njëjtin kuptim si për nenin 4 të Konventës së Trafikimit të Këshillit të Evropës-s, ashtu edhe për nenin 3 të Protokollit të anti-trafikimit të OKB-së (si dhe për nenin 3 të Direktivës së BE-së për antitrafikimin). Në dokument theksohet abuzimi me pozicionin e vulnerabilitetit si një prej mënyrave më të sofistikuar që po përdoret gjithmonë e më shumë nga trafikantët, arsye për të cilën është jashtëzakonisht e rëndësishme që të diktohet në mënyrë të menjëhershme. Ky dokument i UNODC sugjeron se vlerësimi më i mirë bëhet rast pas rasti, duke marrë parasysh llojin e dobësisë apo të vulnerabilitetit të viktimës.

### **Kështu dallohen disa gjendje vulnerabiliteti:**

- Vulnerabiliteti personal mund të lidhet me aftësinë e kufizuar fizike apo mendore të personit;
- Vulnerabiliteti rrethanor mund të lidhet me të qenit në mënyrë të parregullt të një personi në një vend të huaj, ku është i izoluar nga ana sociale apo gjuhësore;
- Vulnerabiliteti për shkak të kushteve mund të lidhet me papunësinë apo me varfërinë ekonomike të një personi.

Po kështu vulnerabilitetet mund të ekzistojnë para trafikimit, por mund edhe të krijohen nga trafikantët.

46 OSCE, "Trafficking in Human Beings: Identification of Potential and Presumed Victims" (2011). <https://www.osce.org/files/f/documents/4/e/78849.pdf>

47 Zyra e Komisionerit të Lartë për Drogën dhe Krimin, "Abuse of a Position of Vulnerability", [https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/2012/UNODC\\_2012\\_Guidance\\_Note\\_-\\_Abuse\\_of\\_a\\_Position\\_of\\_Vulnerability\\_E.pdf](https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/2012/UNODC_2012_Guidance_Note_-_Abuse_of_a_Position_of_Vulnerability_E.pdf)

Vulnerabiliteti para trafikimit mund të lidhet me varfërinë, aftësinë e kufizuar mendore apo fizike, moshën e re apo të vjetër, gjininë, shtatzëninë, kulturën, etninë, gjuhën, besimet, situatat familjare ose statusin e të qenit i parregullt. Vulnerabiliteti i krijuar mund të lidhet me izolimin social, kulturor apo linguistik, statusin e të qenit i parregullt apo varësitë e ndryshme (varësi nga droga apo lidhje romantike/emocionale) ose me përdorimin e ritualeve apo praktikave kulturore ose fetare ose me arsyet ekonomike (p.sh. lidhja për shkak të borxhit). Si përfundim, abuzimi me një pozicion vulnerabiliteti ndodh kur gjendja vulnerabël e personit shfrytëzohet në mënyrë të qëllimshme për rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin apo marrjen e atij personi për qëllime shfrytëzimi në mënyrë të tillë që personi beson se nënshtrimi ndaj vullnetit të abuzuesit është e vetmja rrugë reale ose e pranueshme që ka dhe ai besim është i arsyeshëm nga pikëpamja e situatës së viktimit.

Për të përcaktuar nëse është e arsyeshme që viktima të besojë se ky opsion është i vetmi opsion real apo i pranueshëm, duhet të merren parasysh karakteristikat dhe rrethanat personale të viktimit.

### III. QËLLIMI

Qëllimi i trafikantëve për të shfrytëzuar viktimat qëndron në themel të të gjithë sipërmarrjes së trafikimit. Kuadri ndërkombëtar ligjor ofron një listë joshteruese të qëllimeve të shfrytëzimit, ku vlerësohet se format e shfrytëzimit mund të ndryshojnë dhe të zhvillohen me kalimin e kohës dhe me daljen e tendencave të reja. Karakteri joshterues i kësaj liste manifestohet në dy mënyra: - përmes shprehjes “minimalisht”; ose përmes përfshirjes së shembujve të shfrytëzimit që nuk përkufizohen në të drejtën ndërkombëtare. Shtetet mund ta zgjerojnë këtë listë ose duke shtuar koncepte të reja ose duke interpretuar konceptet e papërkufizuara në mënyrë të tillë që të përfshijnë sjellje apo qëndrime të caktuara në vende apo kontekste të caktuara kulturore.

Duhet theksuar se ky element i veprës penale ka nevojë të vërtetohet, duke treguar se autori ka vepruar me qëllim shfrytëzimin e viktimit. Nuk është e domosdoshme që viktima të jetë shfrytëzuar, për sa kohë ky ka qenë në të vërtetë qëllimi i autorit. Qëllimet lidhen me shfrytëzimi i prostitucionit të personave të tjerë ose format e tjera të shfrytëzimit seksual, puna ose shërbimet e detyruara, skllavëria ose praktikat e ngjashme me skllavërinë, servitudi, heqja e organeve si dhe forma të tjera shfrytëzimi.

#### **Shfrytëzimi i prostitucionit të personave të tjerë dhe forma të tjera të shfrytëzimit seksual**

Shfrytëzimi i prostitucionit të personave të tjerë dhe forma të tjera të shfrytëzimit seksual nuk përkufizohen në instrumente ndërkombëtare, gjë që çon në mosparagjykimin e mënyrës se si e trajtojnë shtetet prostitucionin në ligjin e tyre vendas. Shfrytëzimi i prostitucionit të personave të tjerë mund të përfshijë marrjen në mënyrë të paligjshme të përfitimeve financiare ose përfitimeve të tjera materiale nga prostituimi i një personi tjetër.

Kuptimi i formave të tjera të shfrytëzimit seksual mund të përfshijë, p.sh., përfshirjen e një personi në shërbime seksuale ose në lloje të tjera shërbimesh seksuale, duke përfshirë aktet pornografike ose prodhimin e materialeve pornografike. Me këto terma mund të ofrohen shumë shembuj dhe secili shtet duhet të ketë ligjet e veta penale që ndalojnë trafikimin për qëllime seksuale, si dhe format e tjera të shfrytëzimit seksual, pavarësisht se objekti dhe përmbajtja e secilit legjislacion vendas mund të jenë të ndryshme.

#### **Puna e detyruar (shfrytëzimi për punë)**

Deklaratat dhe konventat për të drejtat e njeriut që i referohen punës së detyruara janë të bazuara te Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, sidomos Konventa e ILO-s për punën e detyruar nr. 29/1930. Konventa gëzon pothuajse ratifikim universal, që do të thotë se pothuajse të gjitha vendet janë të detyruara ligjërisht t'i respektojnë këto dispozita dhe të raportojnë sistematikisht lidhur me to pranë organeve mbikëqyrëse të ILO-s për standardet. Mosnënshtrimi ndaj punës së detyruar përbën një të drejtë

themelore të njeriut. Ndërkohë të të gjitha shtetet anëtare të ILO-s duhet të respektojnë parimin e eliminimit të punës së detyruar, pavarësisht ratifikimit.

Puna e detyruar përkufizohet si punë që kryhet në mënyrë jovullnetare dhe nën kërcënimin e çfarëdolloj ndëshkimi. Sipas Konventës 29/1930 të ILO-s, e rikonfirmuar nga Protokollin i ILO-s për punën e detyruar të vitit 2014, puna e detyruar nënkupton: “të gjitha punët apo shërbimet që kryhen nga çdo person nën kërcënimin e ndëshkimit dhe për të cilat personi nuk është ofruar në mënyrë vullnetare.” Viktimat mund shtrëngohen të punojnë të detyruar përmes përdorimit të dhunës apo intimidimit ose përmes mjeteve më të sofistikuar, si borxhet e manipuluar, mbajtja e dokumenteve të identitetit ose kërcënimeve për denoncim pranë autoriteteve të emigracionit, e të tjera.<sup>48</sup>

Ky përkufizim bazohet në tre elementë:

- **Puna ose shërbimi** të gjitha llojet e punës që ndodhin në një aktivitet, industri apo sektor, duke përfshirë edhe ekonominë informale.
- **Kërcënimin për ndëshkim** një gamë e gjerë ndëshkimesh që përdoren për ta detyruar një person që të punojë.
- **Mos ofrimi vullnetar** termat “ofrim vullnetar” i referohen pëlqimit të lirë dhe të informuar të personit për të marrë përsipër një punë dhe lirinë e tij për t’u larguar prej saj në çfarëdolloj kohe.

Konventa 29/1930 e ILO-s i detyron shtetet që ta parashikojnë punën e detyruar si vepër penale përveç përjashtimeve të mëposhtme:

- Shërbimi i detyruar ushtarak
- Detyrimet qytetare normale
- Puna në burg (në kushte të caktuara)
- Puna në situata të jashtëzakonshme (si në kushte lufte, fatkeqësish natyrore apo kërcënime për fatkeqësi, si p.sh. gjatë kërcënimit për zjarr, përmytje, uri, tërmet)
- Shërbimet e vogla në komunitet.<sup>49</sup>

Puna e detyruar, në të gjitha vendet e botës, sipas Konventës për zhdukjen e punës së detyruar nr. 105, miratuar nga ILO në vitin 1957, ndalon specifikisht përdorimin e punës së detyruar: si ndëshkim për shprehjen e pikëpamjeve politike; për qëllime të zhvillimit ekonomik; si një mënyrë e disiplinimit të punës; si ndëshkim për pjesëmarrjen në greva; si mënyrë e diskriminimit racial, fetar ose ndonjë diskriminimi tjetër.

**Puna e detyruar dallon nga kushtet e padrejta të punës.** Për të përcaktuar nëse një situatë e caktuar përbën apo jo punë të detyruar, mund të përdoren tregues të ndryshëm, si kufizimet e lirisë së lëvizjes së punëtorëve, mbajtja e pagave ose dokumenteve të identitetit, dhuna fizike ose seksuale, kërcënimet dhe intimidimi ose borxhet mashtruese, nga të cilat punëtorët nuk mund të shmangen. ILO ka identifikuar 11

<sup>48</sup> Shih edhe Protokollin e 2014 të Konventës së ILO mbi Punën e Detyruar 1930, Neni 1(4).

<sup>49</sup> Anketa e Përgjithshme për punën e detyruar, Komiteti i Ekspertëve i ILO-s mbi zbatimin e Konventës së Punës së Detyruar, Nr. 29, viti 1930.

tregues të punës së detyruar; kur ekziston një ose disa prej këtyre treguesve, mund të kemi një situatë trafikimi me qëllim shfrytëzimin për punë:

- abuzimi me vulnerabilitetin
- mashtrimi
- kufizim lëvizjeje
- izolim
- dhunë fizike dhe seksuale
- intimidim dhe kërcënime
- mbajtja e dokumenteve të identitetit
- mbajtja e pagave
- lidhja përmes borxhit
- kushte abuzive jetese dhe pune
- punë e tepruar jashtë orarit<sup>50</sup>

Këta tregues nuk përfshijnë ndonjë mekanizëm automatik. Në disa raste, mund të jetë edhe një tregues i vetëm që mund të nënkuptojë ekzistencën e punës së detyruar; në raste të tjera, edhe pse mund të ketë disa tregues, duhet një vlerësim i thelluar për të vendosur nëse punëtori është viktimë e punës së detyruar apo thjesht i nënshtruar ndaj kushteve të padrejta të punës.

### Puna e detyruar e fëmijëve

Në rastet e punës së detyruar të fëmijëve duhet të vërtetohen kushte të tjera krahasuar me punën e detyruar të të rriturve. **Konventa e ILO-s për format më të këqija të punës së fëmijëve e vitit 1999** (nr. 182) e përkufizon punën e fëmijëve të shfrytëzuar rëndë (neni 3) si:

- të gjitha format e skllavërisë apo praktikave të ngjashme me skllavërinë, si shitja dhe trafikimi i fëmijëve, servituti për borxhin dhe ulja e tij përmes punës së detyruar, duke përfshirë edhe rekrutimin me forcë ose të detyrueshëm të të miturve për t'u përdorur në konfliktet e armatosura;
- punësimi, kontraktimi apo ofrimi i të miturve me qëllim prostituimin, prodhimin e materialeve pornografike ose performancave pornografike;
- përdorimi, përfshirja ose ofrimi i fëmijës për qëllime të aktiviteteve të paligjshme, sidomos për prodhimin dhe trafikimin e drogës, siç përkufizohet nga traktatet ndërkombëtare përkatëse;
- puna që për nga vetë natyra dhe rrethanat në të cilat duhet të kryhet rrezikon komprometimin e shëndetit, sigurisë ose moralit të fëmijëve.

Duhet kujtuar se nuk është i nevojshëm vërtetimi i mënyrave apo detyrimit përmes të cilëve është trafikuar një fëmijë apo i është nënshtruar punës së detyruar. Ajo çka nevojitet është që fëmijës t'i jetë kërkuar të

<sup>50</sup> Treguesit e punës së detyruar, sipas ILO-s. [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed\\_norm/---declaration/documents/publication/wcms\\_203832.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_norm/---declaration/documents/publication/wcms_203832.pdf)

kryejë një punë të ndaluar për fëmijët. Puna e ndaluar për fëmijët është puna që kryhet në dëm të fëmijës apo duke rrezikuar fëmijën që punon në shkelje të së drejtës ndërkombëtare dhe legjislacionit vendas në përputhje me standardet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Kjo lloj pune ose e privon fëmijën nga shkollimi, është e rrezikshme ose kërkon që fëmija t'i nënshtrohet një barre të dyfishtë të arsimit dhe punës.

### **Rasti praktik nga praktika e vendeve në Evropë, çështje gjyqësore në Francë<sup>51</sup>**

Një shtetas nga Bregu i Fildishtë ishte sjellë në mënyrë të paligjshme në Francë në moshën 15 vjeçare për të punuar në shtëpinë e të akuzuarit dhe për t'u kujdesur për fëmijët e tij. Viktima ishte veçanërisht vulnerabël, pasi ajo ishte e mitur dhe pa statusin e ligjshëm të qëndrimit. Prindërit i kishin vdekur gjatë kohës që ajo i nënshtrohej punës së detyruar. Ajo nuk kishte pasaportë dhe ishte krejtësisht e varur nga familja për të cilën punonte. Më specifikisht, viktima nuk merrte shpërblim për kujdesin për fëmijët dhe për punët e tjera të shtëpisë. Ajo nuk shkonte në shkollë dhe nuk merrte asnjë ditë pushim. Nuk kishte hapësirën e vet private në shtëpi, pasi flinte në një dyshek në dysheme në të njëjtën dhomë me fëmijët.

Vendimi i Gjykatës së Apelit: Gjykata e Apelit nuk e pranoi padinë e bazuar tek kushtet e jetesës dhe të punës në kundërshtim me dinjitetin e njeriut. Gjykata theksoi veçanërisht se viktima e supozuar kishte pasur marrëdhënie afektive me fëmijët e familjes dhe kishte të njëjta kushte strehimi si edhe anëtarët e familjes. Gjykata e Apelit lëshoi një penaltet civil të bazuar tek punësimi i paligjshëm i një emigranti dhe tek abuzimi me situatën e vulnerabilitetit të personit për marrjen e shërbimeve të papaguara.

Vendimi i Gjykatës së Kasacionit: Gjykata iu referua përkufizimit të punës së detyruar, sipas të cilit çdo lloj pune e detyruar është në kundërshtim me dinjitetin e njeriut. Ajo iu përmbajt argumentit të viktimës se sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), fakti i nënshtimit të një të mituri në një vend të huaj, në një situatë të paligjshme, duke pasur frikë nga arrestimi nga policia, një pune konstante pa shpërblim përbën punë të detyruar sipas nenit 4 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata vendosi se viktima i ishte nënshtuar punës së detyruar, siç përkufizohet nga KEDNJ-ja dhe për këtë arsye ajo kishte punuar dhe kishte jetuar në kushte që nuk janë të pajtueshme me dinjitetin e njeriut.

Penalitetet/dëmshpërblimet: Gjykata e Kasacionit konfirmoi dhënien e shpërblimit monetar të vendosur nga Gjykata e Apelit, bashkë me dënimin në burg për një muaj. Shpërblimi ishte 5 000 euro dhe mbulonte dëmet materiale dhe morale.

### **Skllavëria ose praktika të ngjashme me skllavërinë**

Përkufizimi bazë i skllavërisë jepet në Konventën e OKB-së për skllavërinë të vitit 1926, e cila e përkufizon skllavërinë si "gjendjen ose kushtet e një personi ndaj të cilit ushtrohen një ose të gjitha kompetencat në lidhje me të drejtën e pronësisë". Në fakt, nevoja për shtrirjen e kuptimit të "skllavërisë" sa i përket fenomenit aktual të trafikimit është qartësuar në forma të ndryshme nga përdorimi i viktimës si objekt. GJEDNJ ka theksuar se në kohët moderne, është gjithsesi e rrallë që të anashkalohet e drejta e pronësisë ndaj një personi tjetër. Ky koncept tradicional është zëvendësuar nga situata, ku një person ushtron kontroll ndaj një

<sup>51</sup> Database e çështjeve gjyqësore, UNODC: <https://sherloc.unodc.org/clid/v3/htmls/cldb/index.html?lng=en>

personi tjetër, sikur i pari ta kishte pronë të vetën këtë të fundit.

Një vendim i rëndësishëm ndërkombëtar i dhënë nga Gjykata Penale Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për ish Jugosllavinë në çështjen Kuranac të vitit 2002. Ishte rasti i parë ndërkombëtar i skllavërisë së “epokës moderne”, ku përkufizimi i skllavërimit për shfrytëzim (seksual) si krim ndaj njerëzimit që nuk kërkon pronësinë e një personi sa i përket ndikimit që ai person ka tek viktimën. GJEDNJ e konsideroi vendimin në rastin e Kuranac në vendimet e saj kryesuese për trafikimin e qenieve njerëzore (si për shembull në çështjen Rantsev k. Qipros dhe Ruisë), duke vërejtur se koncepti tradicional i skllavërisë është zhvilluar, duke përfshirë forma të ndryshme bashkëkohore të skllavërisë, të bazuara në ushtrimin e një apo që të gjitha kompetencave që lidhen me të drejtën e pronësisë. Kontrolli ndaj një personi mund të ushtrohet jo vetëm fizikisht, por edhe psikologjikisht apo bashkë me çfarëdolloj mase tjetër për të mos e lënë viktimën që të bëjë një zgjedhje alternative. Për këtë arsye, vendosja apo mbajtja e një personi në gjendje skllavërie ndodh kur përdoret dhuna, kërcënimi, mashtrimi apo abuzimi me pushtetin apo kur një person, cilido qoftë ai, përfiton nga një situatë inferioriteti fizik ose mendor apo një situatë varfërie, ose kur premtohen pagesa apo kur bëhen pagesa në para apo çfarëdolloj përfitimi tjetër personave që janë përgjegjës për personin në fjalë.

Sa u përket praktikave të ngjashme me skllavërinë, ato mund të konsiderohen si një listë e hapur, ku mund të jepen shumë shembuj. Lidhja përmes borxhit, martesë e detyruar, aktivitetet kriminale, lypja e detyruar, adoptimet e paligjshme, rekrutimi i detyruar në konflikte të armatosura mund të jenë pjesë e kësaj kategorie. Sipas Konventës Plotësuese për Skllavërinë (1956) lidhja përmes borxhit është gjendja apo kushtet që lindin nga zotimi/angazhimi i borxhmarrësit për të shlyer borxhin për shërbimet e tij personale apo ato të një personi tjetër nën kontrollin e tij si siguri për borxhin, nëse vlera e atyre shërbimeve, e vlerësuar në mënyrë të arsyeshme, nuk merret parasysh për likuidimin e borxhit apo kur kohëzgjatja dhe natyra e atyre shërbimeve nuk kufizohen apo përkufizohen. Vitet e fundit, rastet e lidhjes përmes borxhit janë identifikuar në rastet kur viktimën ka pasur mundësinë që ta shlyejë borxhin edhe nëse kjo është arritur në kushtet e një shkeljeje të rëndë dhe të vazhdueshme të të drejtave të saj.



#### **Martesa e detyruar mund të përkufizohet si një praktikë e tillë në rastet kur:**

- një gruaje pa të drejtën për të refuzuar i ofrohet martesë kundrejt pagesës ose premtimit për para ose shpërblimit në natyrë prindërve, kujdestarit të saj, familjes apo kujtdo personi apo grupi tjetër;
- bashkëshorti i një gruaje, familja apo fisi i tij kanë të drejtën që t’ia kalojnë atë (gruan) një personi tjetër për një shumë parash;
- një grua, pas vdekjes së bashkëshortit, ka detyrimin që të trashëgohet nga një person tjetër.

Sigurisht që në vende të ndryshme këto përkufizime përshtaten sipas kontekstit, duke përfshirë praktikat ku si gratë ashtu edhe burrat janë viktimë të martesave të detyruara.

Direktiva 2011/36 e BE-së përmend shprehimisht aktivitetet e lypjes dhe aktivitetet kriminale ndër qëllimet e trafikimit, kurse Protokollin i OKB-së dhe Konventa e Këshillit të Evropës kundër Trafikimit i konsiderojnë ato në mënyrë të nënkuptuar si “forma të tjera shfrytëzimi”. Kriminaliteti dhe lypja e detyruar janë sipërmarrje fitimprurëse dhe me nivel të ulët rreziku për trafikantët. Rastet ku fëmijët trafikohen me qëllim lypjen (që përbën aktivitet të paligjshëm në disa vende) apo për vjedhje ordinere janë raste të njohura gjerësisht. Ka shembuj viktimash që janë shtrënguar të kryejnë edhe krime të tjera të rënda, si p.sh., prodhimin dhe

trafikimin e narkotikëve. Viktimat shpesh detyrohen të përfshihen në disa lloje aktivitesh kriminale në të njëjtën kohë. Trajtimi i viktimave të trafikimit si kriminel cenon rëndë nevojën e tyre për mbrojtje dhe, ndërkohë që kontribuon në krim, mund të çojë edhe në pandëshkueshmëri për trafikantët. Në këto raste, është jashtëzakonisht e rëndësishme të mos ndiqen penalisht të rriturit apo fëmijët në rastet kur ata kanë kryer një vepër penale si rrjedhojë e të qenit viktimë të trafikimit (neni 8 i Direktivës 2011/36/BE).

### Servitudi

Ligji Model i UNODC për trafikimin<sup>52</sup> jep një përkufizim praktik të servitudit që merr parasysh përkufizimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në çështjen Siliadin k. Francës dhe shpjegon se: servitudi nënkupton kushtet e punës dhe/ose detyrimin për të punuar apo për të ofruar shërbime, nga të cilat personi në fjalë nuk mund të shpëtojë dhe që nuk mund t'i ndryshojë. Baza e këtij përkufizimi jepet në instrumente të tjera ndërkombëtare, si në Deklaratën universale të OKB-së për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (1966) edhe pse asnjë prej këtyre instrumenteve ndërkombëtare nuk përmban një përkufizim të shprehur të servitudit.

### Heqja e organeve

Shfrytëzimi përfshin edhe heqjen e organeve. Ajo nuk është e lejueshme për organet e njeriut apo për pjesë të tyre, pasi çon në përfitime financiare të personave që përfitojnë duke përdorur aktet dhe mjetet e përshkruara më sipër. Trafikimi i qenieve njerëzore me qëllim heqjen e organeve nuk përbën fenomen të ri, por ky krim vazhdon të mbetet i fshehur, një aktivitet që kryhet *underground* dhe duket se nuk raportohet në shifra reale. Kjo shkon në një linjë me rastet e trafikimit të personave në përgjithësi, ndonëse trafikimi i personave për heqjen e organeve ka veçori specifike që mund ta bëjnë edhe më të vështirë për t'u identifikuar dhe për t'u adresuar si problem. Vetë natyra teknike e disa prej proceseve dhe përfshirjes së mundshme të profesionistëve të sektorit të shëndetësisë janë dy prej problemeve kryesore.

Për ta kuptuar më mirë këtë temë, Konventa e Këshillit të Evropës për trafikimin e organeve të njeriut, e miratuar në vitin 2015, duhet të përmendet, duke pasur parasysh se trafikimi i organeve përbën një fenomen të ndryshëm nga trafikimi i qenieve njerëzore, por që mbetet prapë se prapë qëllim në vetvete.

### Dhënia e pëlqimit nga viktimë

Sic është theksuar më sipër, Protokollin e OKB-së për trafikimin e personave parashikon një përkufizim të trafikimit që përfshin tre elementë: aktin, mënyrën dhe qëllimin. Një problem themelor në identifikimin e rasteve të trafikimit lidhet me këtë pyetje: Çfarë roli ka pëlqimi i dhënë nga viktimë në identifikimin dhe vlerësimin e rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore?

Sipas Protokollit të Palermos për trafikimin e personave dhënia e pëlqimit nga një viktimë në moshë madhore për shfrytëzimin e synuar është jo i nevojshëm nëse përdoret një apo disa nga mjetet apo mënyrat e renditura më sipër. Sipas nenit 3(b) dhënia e pëlqimit të viktimës së trafikimit të personave për shfrytëzimin e synuar parashikuar në nënparagrafin (a) të këtij neni është e parëndësishme në rastet kur është përdorur cilido nga mjetet e parashikuara në nënparagrafin (a). Sipas neni 3(d) rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi apo marrja e një fëmije me qëllim shfrytëzimin konsiderohet "trafikim personash" edhe nëse nuk përfshin asnjë prej mjeteve të parashikuara në nënparagrafin (a) të këtij neni. Dhënia e pëlqimit të viktimës së mitur të trafikimit është e parëndësishme pavarësisht nëse janë përdorur apo jo mjetet e parashikuara në të.

52 [https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/UNODC\\_Model\\_Law\\_on\\_Trafficking\\_in\\_Persons.pdf](https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/UNODC_Model_Law_on_Trafficking_in_Persons.pdf)

Kjo do të thotë se në përputhje me Ligjin Model të UNODC të vitit 2009 për Protokollin e Palermos<sup>53</sup> dhe sipas Udhëzimit të vitit 2014 të UNODC për konceptin “e dhënies së pëlqimit” në Protokollin e trafikimit të personave<sup>54</sup>, me vërtetimin e elementëve të krimit të trafikimit, duke përfshirë edhe përdorimin e një prej mjeteve të identifikuar (shtrëngimin, detyrimin etj.), çdo mbrojtje apo pretendim për “dhënien e pëlqimit” nga viktimë është e parëndësishme për të provuarit e veprës. Për shembull, fakti që një person mund të ketë qenë në dijeni se është punësuar për aktivitete prostituimi apo kriminale apo i shfrytëzuar për punë nuk e përjashton faktin që ky person është shndërruar në viktimë të trafikimit. Ndonëse ka qenë në dijeni të natyrës së punës, personi mund të jetë keqdrejtuar sa u përket kushteve të punës, gjë që ka çuar në shfrytëzimin apo shtrëngimin e tij dhe/ose në pamundësinë për t'u tërhequr lirshëm prej tyre. Dhënia e vërtetë e pëlqimit pranohet si e mundshme dhe e ligjshme vetëm kur njihen të gjitha rrethanat relevante dhe kur personi ka pasur mundësi të ushtrojë i lirë vullnetin e vet.

Konventa e Këshillit të Evropës kundër Trafikimit e riprodhon përkufizimin e trafikimit të parashikuar në Protokollin për trafikimin e personave, duke përfshirë elementin e mjeteve dhe dispozitën në lidhje me mungesën e relevancës së dhënies së pëlqimit në momentin e vërtetimit të cilitdo prej mjeteve që janë përdorur. Raporti shpjegues i Konventës së Këshillit të Evropës për dhënien e pëlqimit të viktimës në punën e detyruar i referohet çështjes Van Der Mussele k. Belgjikës, ku GJEDNJ-ja u shpreh se kriterit të dhënies së pëlqimit paraprak duhet t'i jepet një “peshe relative” duke e trajtuar çështjen në vlerësim të të gjitha rrethanave të saj.<sup>55</sup>

Edhe Direktiva 2011/36/BE e Bashkimit Evropian është në të njëjtën linjë. Sipas nenit 2, pika 4, dhënia e pëlqimit të viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore për t'u shfrytëzuar, qoftë kjo për një shfrytëzim të synuar apo real, është e parëndësishme në rastet kur është përdorur cilido nga mjetet e ndryshme. Në kontekstin e diskutimeve për shfrytëzimin e lypjes si një formë e punës apo shërbimeve të detyruara, Direktiva e BE-së, thekson se çfarëdolloj pëlqimi që mund të jetë dhënë nga viktimë për kryerjen e punëve apo shërbimeve të tilla duhet të vlerësohet rast pas rasti.<sup>56</sup> Megjithatë, në rastet e të miturve, asnjë formë pëlqimi i mundshëm nuk duhet të konsiderohet i vlefshëm. Pavlefshmëria e dhënies së pëlqimit nga të miturit ka të bëjë me mungesën e kapacitetit të të miturit për të dhënë pëlqimin; në disa shtete kjo është zgjeruar edhe më tej, duke përfshirë qartë edhe ata që mund të kenë arritur moshën madhore por që kanë një kufizim në aftësinë e tyre mendore.

Neni 7 i Statutit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare (1998) identifikon si krime ndaj njerëzimit një sërë veprash penale që mund të lidhen me trafikimin. Rregullorja dhe evidencat bashkëngjitur këtij Statuti përcaktojnë parimet e mëposhtme për mbledhjen e provave në rastet e dhunës seksuale që hyjnë në veprimin e këtij neni:



- ▶▶ pëlqimi nuk mund të merret si i dhënë për shkak të çfarëdolloj sjelljeje të viktimës, në rastet kur forca, kërcënimi për ushtrim force, shtrëngimi apo përfitimi nga një mjedis shtrëngues ka cënuar aftësinë e viktimës për të dhënë pëlqimin e vet të vërtetë dhe me dëshirë;
- ▶▶ e njëjta gjë vlen kur viktimë nuk është në gjendje të japë pëlqimin;
- ▶▶ pëlqimi nuk mund të merret si i dhënë duke u nisur nga heshtja, mungesa e rezistencës nga viktimë ndaj veprës penale të supozuar seksuale;
- ▶▶ besueshmëria, karakteri apo predispozita për disponueshmëri seksuale e një viktime apo

53 [https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/UNODC\\_Model\\_Law\\_on\\_Trafficking\\_in\\_Persons.pdf](https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/UNODC_Model_Law_on_Trafficking_in_Persons.pdf)

54 [https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/2014/UNODC\\_2014\\_Issue\\_Paper\\_Consent.pdf](https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/2014/UNODC_2014_Issue_Paper_Consent.pdf)

55 Van Der Mussele k. Belgjikës, aplikim nr. 8919/80, vendim i 23 nëntor 1983.

56 Paragrafi 11.



dëshmitari nuk mund të interpretohet duke marrë si shkak natyrën seksuale të sjelljes së mëparshme apo të mëvonshme të viktimës apo të dëshmitarit.<sup>57</sup>

Në Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë, çështja e famshme e Prokurorisë k. Kunarac (2001) trajtoi pikërisht dhënies së pëlqimit në lidhje me akuzën penale të skllavërisë. Gjykata përcaktoi treguesit e skllavërisë duke konfirmuar se në situata të tilla, dhënia e pëlqimit apo vullneti i lirë i viktimës mungon. Si përmbledhje, e drejta penale ndërkombëtare konfirmon përgjithësisht të njëjtën qasje të ndërmarrë nga Protokollin për Trafikimin e Personave, rregullimet e të cilit trajtohen më sipër.

### **Rast praktik mbi ndërthurjen e skllavërisë dhe trafikimit të qenieve njerëzore**

Prokuroria kundër Dragoljub Kunarac, Radomir Kovac dhe Zoran Vukovic, ‘Vendimi i Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë, 22 shkurt 2001.

Çështja e Kunarac para Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë (ICTY) është çështja më e rëndësishme që shtjellon skllavërimin si krim kundër njerëzimit. Dhoma e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë rishikoi përkufizimin ligjor ndërkombëtar të skllavërisë në të drejtën ndërkombëtare zakonore. Kunarac dhe Kovač u akuzuan për skllavëri dhe përdhunim të grave dhe vajzave myslimane, të cilat i kishin marrë fillimisht në disa qendra të improvizuara ndalimi dhe më pas lëvizur në vende të tjera, i kishin përdhunuar ose i kishin mbajtur në servitud nga anëtarët e forcave serbe nga viti 1992 dhe 1993. Dhoma u mbështet në përkufizimin klasik që gjendet në Konventën e vitit 1926 për skllavërinë. Konkretisht actus reus i skllavërisë konsiston në vendosjen e një pushteti apo që të gjitha pushteteve të drejtës së pronësisë ndaj një personi.

Dhoma vazhdoi më pas me identifikimin e faktorëve që duhet të mbahen parasysh për identifikimin nëse kishte pasur apo jo skllavëri, si: kontrolli i lëvizjeve të personit, kontrolli i mjedisit fizik, kontrolli psikologjik, masat e marra për parandalimin ose frenimin e arratisjes, forca, kërcënimi për ushtrim force apo shtrëngimi, kohëzgjatja, konfirmimi i ekskluzivitetit, nënshtrimi ndaj trajtimit çnjerëzor dhe abuzimit, kontrolli i seksualitetit dhe puna e detyruar”.

Dhoma doli në përfundimin se megjithëse konceptet e skllavërimit dhe trafikimit të qenieve njerëzore mbivendosen shpesh, ato nuk përkojnë me njëri-tjetrin. Dhoma u fokusua në ushtrimin real të kompetencave/pushteteve që i lidhen me të drejtën e pronësisë- ushtrimin de facto të së drejtës së pronësisë mbi katër gratë nëpërmjet kontrollit të plotë mbi to dhe trajtimit si pronën e vet.

57 <https://www.icc-cpi.int/resource-library/documents/rs-eng.pdf>

## 2. 2 DALLIMET DHE TË PËRBASHKËTAT E VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË PERSONAVE DHE VEPRAVE TË EMIGRACIONIT TË PALIGJSHËM (NJOHUR NDRYSHE SI KONTRABANDIMI I EMIGRANTËVE)

Trafikimi i personave dhe veprave të emigracionit të paligjshëm, njohur edhe si kontrabandimi i emigrantëve, janë vepra penale të ndryshme që shpesh ngatërrohen. Në kontekstin vendas këto të fundit lidhen me veprat penale të kalimit të paligjshëm të kufirit së bashku me ndihmën në kalimin e paligjshëm të kufirit. Është e rëndësishme të bëhet dallimi midis këtyre veprave penale, pasi pasojat e mosidentifikimit korrekt të tyre mund të jenë të konsiderueshme. Siç përshkruhet edhe në kapitujt vijues, viktimat e trafikimit të personave kanë të drejtën e një sërë masave mbrojtëse dhe ndihmëse që janë specifike për statusin që ato kanë si viktimat të trafikimit. Aksesit i tyre në një mbrojtje dhe asistencë të tillë mund të garantohet vetëm nëse identifikohet në mënyrë korrekte vepra penale e trafikimit. Përveç kësaj, rastet që përfshijnë trafikimin e personave kërkojnë shpesh shumë më shumë sanksione penale sesa ato që kanë të bëjnë me kontrabandimin e emigrantëve. Dallimet kryesore mes trafikimit të personave dhe ndihmës për kalimin e paligjshëm të emigrantëve mund të shpjegohen duke analizuar si më poshtë:



- **Cilësimi juridik**
- **Shfrytëzimi dhe burimi i fitimit**
- **Natyra transnacionale e krimit**
- **Viktimizimi dhe dhënia e pëlqimit**

### **Cilësimi juridik**

Ndihma në kalimin e paligjshëm të kufirit përbën krim kundër shteteve, kundër kufijve të tyre kombëtarë dhe të drejtës së tyre për rregullimin e mënyrës se si lejohen të huajt për të hyrë dhe për të qëndruar në territorin e tyre. Trafikimi i qenieve njerëzore është krim ndaj të drejtave themelore të njeriut të çdo individi të trafikuar.

### **Shfrytëzimi dhe burimi i fitimit**

Objektivi kryesor i trafikantëve është gjenerimi i fitimeve përmes shfrytëzimit të viktimave të tyre. Viktimat e trafikimit shfrytëzohen përgjithësisht për një periudhë kohe e cila mund të zgjasë edhe për vite të tëra. Nga ana tjetër, shfrytëzimi nuk përbën element të ndihmës për kalimin e paligjshëm të emigrantëve. Kontrabanduesi dhe emigrantët përgjithësisht lidhin një marrëdhënie të përkohshme, duke shkëmbyer para për sigurimin e hyrjes së paligjshme në një shtet tjetër. Megjithatë, pavarësisht se shfrytëzimi nuk përbën qëllim në vetvete të ndihmës për kalimin e paligjshëm të emigrantëve, emigrantët mund të keqtrajtohen ose të shfrytëzohen gjatë rrugës dhe kjo sjellje mund të përbëjë një rrethanë rënduese për krimin, por mund të çojë edhe në mbivendosje të të dy këtyre veprave penale.

Këtu ka disa përjashtime: trafikimi me qëllim heqjen e organeve nuk është i vazhdueshëm, pasi shfrytëzimi përfundon me heqjen e organeve.

## Natyra ndërkombëtare


Kalimi i paligjshëm i emigrantëve është si rregull ndërkombëtar, pasi kërkon kalimin e paligjshëm të një kufiri ndërkombëtar. Megjithatë trafikimi i personave nuk është domosdoshmërisht ndërkombëtar: ai mund të përfshijë transportimin e viktimave nga një vend në një tjetër, por mund të ndodhë edhe brendapërbrenda të njëjtit vend (trafikimi i brendshëm). P.sh., një viktimë mund të rekrutohet në një fshat dhe më pas të transportohet drejt një qyteti më të madh për t'u shfrytëzuar ose mund edhe të shfrytëzohet në qytetin apo në zonën ku jetonte, ku edhe ra edhe viktimë e trafikantëve.

## Viktimizimi dhe dhënia e pëlqimit


Trafikimi i personave është gjithmonë një krim që përfshin një viktimë. Edhe në rastet kur ka shenja që tregojnë se viktima ka dhënë pëlqimin e saj për shfrytëzimin, përdorimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale e zhvlerëson dhënien e pëlqimit. Nga ana tjetër, emigrantët e kaluar në mënyrë të paligjshme zakonisht japin pëlqimin për aktin e kalimit të paligjshëm, pasi qëllimi i tyre është që të mbërrinë në një vend, ku nuk do të mund të futeshin dot ndryshe në mënyrë të ligjshme. Përgjithësisht, emigrantët e kontrabanduar lidhin me vullnetin e tyre një kontratë me kontrabanduesit për të mbërritur në vendin ku synojnë të shkojnë, kështu që ata nuk janë viktima të ndonjë sjelljeje kriminale. Megjithatë, ka raste kur emigrantët kanë dhënë pëlqimin për aktin e kontrabandimit, pa qenë në dijeni ose duke pranuar rrethanat e udhëtimit, gjatë të cilave mund të përballen me rreziqe të konsiderueshme, me kërcënime e madje edhe me keqtrajtime dhe abuzime. Në këto raste, emigrantët bëhen viktima të krimeve të tjera gjatë udhëtimit.

Duhet të shmanget shkrija e trafikimit të personave me kontrabandimin e emigrantëve. Megjithatë, nuk duhet harruar se, në praktikë, këto dy lloje krimesh ndërveprojnë shpesh në mënyrë të konsiderueshme me njëri-tjetrin. Për shembull, të njëjtët rrjete kriminale që bëjnë trafikimin transnacional të personave përfshihen ndonjëherë në kontrabandimin e emigrantëve dhe anasjelltas; ata mund të përfshihen edhe në aktivitete të tjera kriminale transnacionale, si trafikimi i armëve të zjarrit ose trafikimi i drogës. Dallimi mes tyre është bërë edhe më i vështirë me lëvizjet e fundit të emigracionit (për shembull përmes itinerarit mesdhetar apo atij ballkanik), ku si trafikimi, ashtu edhe kontrabandimi nxiten nga vulnerabiliteti i refugjatëve dhe azilkërkuesve. Ndërveprimi mes tyre rritet edhe më shumë në zonat e konfliktit; lëvizjet e mëdha të njerëzve nga zonat e konfliktit dhe mungesa e aksesit në rrugë të sigurta dhe të zakonshme për emigracionin ka krijuar një treg fitimprurës për kontrabanduesit, të cilët në disa raste përcipen të maksimizojnë fitimet duke përfshirë edhe shfrytëzimin e njerëzve. Kështu, një person, nga një emigrant i paligjshëm mund të kthehet në një viktimë trafikimi gjatë udhëtimit të emigracionit ose me mbërritjen në vendin e destinacionit. Një person mund të paguajë për të kaluar kufirin me qëllim udhëtimit në mënyrë të parregullt drejt një vendi të sigurt për të kërkuar strehim të sigurt ose punë të denjë, por mund të përfundojë në një vend të pasigurt dhe të shfrytëzohet.

Një analizë e posaçme mbi dallimin midis veprave të trafikimit të personave dhe kalimit të paligjshëm të kufirit në kontekstin vendas ofrohet në Kreun në vijim.



## KREU III



# KONCEPTI I TRAFIKIMIT SIPAS LEGJISLACIONIN PENAL SHQIPTAR

## 3. 1 KONCEPTI I TRAFIKIMIT NË LEGJISLACIONIN PENAL SHQIPTAR

Legjislacioni ynë penal ka reflektuar frymën e normave ndërkombëtare të cituara sa më sipër duke përbushur detyrimin e tyre për cilësimin si vepër penale trafikimin e qenieve njerëzore.<sup>58</sup> Edhe këtu është e rëndësishme të kujtohet se detyrimi në Protokollin për Trafikimin për ta cilësuar si vepër penale trafikimin e qenieve njerëzore nuk kërkon që legjislacioni vendas të përdorë të njëjtën mënyrë shprehjeje me përkufizimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Në vend të kësaj, është e mira që legjislacioni vendas të përpilohet në një mënyrë që të përputhet me kuadrin ligjor të brendshëm të vendit tuaj, me kusht që të përmbajë një ndërthurje të elementeve përbërës mban përkufizimi. Kodi Penal i yni ka pësuar disa ndryshime në veprat penale të trafikimit, por në thelb ai përmban pothuajse mot a mot përkufizimin e dhënë nga Protokollin i Palermos dhe Konventa e Varshavës.<sup>59</sup> Kodi ynë penal parashikon si forma të trafikimit të qenieve e njerëzore atë të emigrantëve, femrave për prostitucion dhe si formë më vete atë të trafikimit të të miturve. “Trafikimit të qenieve njerëzore”, neni 110/a i Kodit Penal dhe “Trafikimi i të miturve”, neni 128 i Kodit Penal.<sup>60</sup>

### **Neni 110/a i Kodit Penal “Trafikimi i personave” parashikon:**

Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dënohen me burgim nga tetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur kjo vepër kryhet ndaj një personi të rritur të gjinisë femërore dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

<sup>58</sup> Detyrim që rrjedh nga neni 5 i Protokollit shtesë mbi Trafikimin, pjesë e Konventës së OKB.

<sup>59</sup> Neni 110/a, Trafikimi i personave të rritur (shtuar me ligjin 8733, datë 24.1.2001; ndryshuar me ligjin nr. 9188, datë 12.2.2004; ndryshuar titulli, fjalët në paragrafin e parë dhe paragrafi i tretë dhe shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimin me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013).

<sup>60</sup> Me ligjin nr. 144/2013 vepra penale e “Trafikimit të femrave” neni 114/b u shfuqizua duke përfshirë trafikimin e femrave tek neni 110/a i Kodit Penal.

Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të personave dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, sjell pasoja të rënda për shëndetin, ose rrezikon jetën e tij, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.

Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohet me  $\frac{1}{4}$  e dënimit të dhënë.

Nenet vijuese 110/b dhe 110/c kanë penalizuar përfitimin e shërbimeve të ofruara nga personat e trafikuar si dhe veprimet që lehtësojnë trafikimin.<sup>61</sup>

#### **Neni 128/b “Trafikimi i të miturve” parashikon se:**

Rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të të miturve dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike të të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.

Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohet me  $\frac{1}{4}$  e dënimit të dhënë.

**Objekt i përgjithshëm** i këtyre dispozitave janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar të drejtat dhe liritë e personit nga çdo veprim ose mosveprim kriminal. **Objekt i drejtpërdrejtë** i kësaj dispozite, janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar lirinë e personit, përfshirë lirinë seksuale të tij, të drejtën e personit për të qenë i lirë dhe për të vendosur në mënyrë të vullnetshme mbi jetën e tij dhe veprimet që ai dëshiron të kryejë në raport me subjektet e tjerë të së drejtës, i cili përbën objektin parësor të kësaj vepre

<sup>61</sup> Shtuar me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013. Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar, apo i shërbimeve që janë objekt i shfrytëzimit nga trafikimi, duke pasur dijeni që personi është i trafikuar, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Kur kjo vepër kryhet ndaj një fëmije dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet. Falsifikimi, zotërimi ose sigurimi i dokumentit të identitetit, i pasaportave, i vizave ose i dokumenteve të tjera të udhëtimit apo mbajtja, heqja, fshehja, dëmtimi ose shkatërrimi i tyre, që kanë shërbyer për trafikimin e personave të rritur, por pa pasur dijeni për këtë fakt, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, apo është kryer nga personi që ka për detyrë të lëshojë letërnjoftimin, pasaportën, vizën apo dokumentin e udhëtimit, ose ka mundësiuar trafikimin e fëmijëve, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.

penale. **Si objekt dytësor** i kësaj vepre penale, janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar jetën dhe shëndetin e personit, dinjitetin dhe personalitetin e tij nga çdo veprim ose mosveprim kriminal.

**Nga ana objektive**, kjo vepër penale kryhet me veprime aktive të kundërligjshme, të cilat konsistojnë detyrimisht në tre elementët në vijim: rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen ose pritjen e personit.

**Rekrutimi i personit**, si pjesë të anës objektive të figurës së kësaj vepre penale, ka të bëjë me gjetjen e personave dhe me nënshtrimin e tyre, qoftë me anë të dhunës fizike apo psikike, apo me anë të mashtrimit ose duke përfutur nga gjendja vulnerabël e tij, etj., me qëllim trafikimin e tyre.

**Transportimi i personit**, nënkupton zhvendosjen e këtij personi, nga një vend në një vend tjetër, qoftë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, qoftë jashtë këtij territori, me qëllim trafikimin e tij. Në mënyrë që të jemi para kësaj vepre penale të kryer në formën e transportimit të personit, nuk ka rëndësi, nëse viktima transportohet me anë të mjeteve të transportit rrugor, ujor, ajror apo hekurudhor, e rëndësishme është, që viktima, jashtë vullnetit të saj dhe me qëllim trafikimin e saj, transportohet dhe lëviz nga një vend në tjetrin.

**Transferimi i personit**, me qëllim trafikimi, është një koncept i ngjashëm me transportimin, ku subjekti i veprës penale, e transferon një person nga një vend, në një vend tjetër, zakonisht jashtë shtetit, me qëllim që ta trafikojë. Transferimi i personit me qëllim trafikimi, është një koncept i ngjashëm me transportimin e personit, por jo në çdo rast që kemi transportim të personit, kemi edhe transferim të tij nga një vend në tjetrin. Në këtë kontekst ligji ynë njeh trafikimin e brendshëm sipas së cilit transferimi mjafton të kryhet nga një vend në një tjetër pa patur nevojë të kalojë territorin e shtetit.

**Fshehja e personit**, nënkupton mbajtjen e në mënyrë të fshehtë e të izoluar të personit nga ambienti i jashtëm dhe moslejimin e kontakteve të tij me mjedisin social, me persona të afërm të familjes apo me persona të tjerë, e bërë kjo, me qëllim trafikimin e tij. Në mënyrë që të jemi para kësaj forme të kryerjes së veprës penale, kërkohet detyrimisht, që viktima të privohet nga liria e saj dhe të mbahet e izoluar jashtë vullnetit të saj, duke i hequr çdo mundësi që ajo të komunikojë me persona të tjerë dhe me botën e jashtme.

**Pritja e personit**, nënkupton, veprime që kryhen nga ana e subjektit të veprës penale, që kanë të bëjnë me pritjen, përcjelljen, strehimin e personit dhe me shoqërimin e tij për në një vend të caktuar, zakonisht banesë ose hotel, me qëllim trafikimin e tij. Kjo formë e veprës penale mund të kryhet në bashkëpunim, ndërmjet dy ose më shumë personave, ku një prej bashkëpunëtorëve bën “rekrutimin e personit”, bashkëpunëtori tjetër bën “transportimin dhe/ose transferimin e viktimës”, ndërsa bashkëpunëtori tjetër, bën “pritjen e viktimës”.<sup>62</sup>

Në mënyrë që vepra penale të konsiderohet si plotësisht e kryer nga ana e autorit të saj, mjafton që prej tij të kryhet edhe vetëm në një nga format e mësipërme të realizimit të veprës penale, kuptohet, kur ekzistojmë edhe dy elementët e tjerë të anës objektive, të cilët do të trajtohen më poshtë. Kjo do të thotë, se kur plotësohen edhe dy elementët e tjerë të anës objektive të kësaj vepre penale, subjekti do të konsiderohet se e ka kryer në mënyrë të plotë këtë vepër penale, në rastet kur ai ka bërë vetëm **rekrutimin e personit**, ose vetëm **transportimin e personit**, ose vetëm **transferimin e personit**, ose vetëm **fshehjen e personit**, ose vetëm **pritjen e personit**, me anë të mashtrimit apo kërcënimit apo përfitimit nga gjendja shoqërore e tij, etj. dhe me **qëllim trafikimin e tij**, pavarësisht se nuk e ka trafikuar këtë person, si dhe pavarësisht se nuk e ka shfrytëzuar këtë person.

<sup>62</sup> Kryerja e veprës penale në bashkëpunim sipas paragrafëve 2, 3 etj të neneve 110/a është një nga format e shpeshta të kryerjes së saj.

**Rast praktik:** Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në lidhje me veprën penale të trafikimit, arsyeton: ...Gjykata çmon me këtë rast të sqarojë se, vepra penale e “Trafikimit të femrave”, e parashikuar nga neni 114/b i Kodit Penal, është veprë penale formale, do me thënë që nuk kërkon ardhjen e ndonjë pasoje kriminale, në mënyrë që ajo të konsiderohet e kryer. Kjo veprë, që të konsiderohet e konsumuar, mjafton që të provohen të gjithë elementët e saj, që kanë të bëjnë me objektin, anën objektive, subjektin dhe anën subjektive dhe nuk kërkon ardhjen e asnjë lloj pasoje...”.<sup>63</sup>

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, Tiranë, me vendimin e saj nr. 47, datë 23.10.2007, në lidhje me këtë çështje, ndër të tjera ka arsyetuar: “...Figura e veprës penale të trafikimit të femrave, konsiderohet e formuar edhe me ekzistencën e njërit nga elementët e saj, kur bëhet në format dhe qëllimet e sipërcituara të kësaj dispozite. Pra, do të mjaftonte edhe vetëm elementi i rekrutimit apo i transportimit etj., nëpërmjet formave dhe qëllimeve të lartpërmendura, që i pandehuri të ketë përgjegjësi penale sipas kësaj dispozite. Fakti, që i pandehuri nuk ia arriti qëllimit që ta shfrytëzojë të dëmtuarën për prostitutë, nuk bën që ai të mos përgjigjet penalisht, pasi ai i ka konsumuar të gjithë elementët e kësaj figure veprë penale...”.<sup>64</sup>

Nuk është kusht i domosdoshëm ekzistenca e shfrytëzimit, por shfrytëzimi mund të shoqërojë apo pasojë trafikim ose mund të përbëjë trafikimin në vetvete,



- rekrutimi ose transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale, të bëhet ose me anë të kërcënimit, ose me anë të përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, ose me anë të rrëmbimit, me anë të mashtrimit, me anë të shpërdorimit të detyrës, me anë të përfitimit nga gjendja shoqërore e të të dëmtuarit, me anë të përfitimit nga gjendja fizike apo psikike, me anë të dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër.

Kjo nënkupton që rekrutimi, ose transportimi, ose transferimi, ose fshehja, ose pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të kërcënimit që i bëhet personit, me qëllim trafikimin e tij, ku kërcënimi i personit, nënkupton dhunën psikike ose kanosjen që i bëhet personit.

Rekrutimi, ose transportimi, ose transferimi, ose fshehja, ose pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të përdorimit të forcës, me të cilën kemi parasysh përdorimin e dhunës fizike, që subjekti i veprës penale ushtron ndaj të dëmtuarit. Dhuna fizike, nënkupton dëmtime dhe lëndime fizike, që i bëhen personit si: rrahje, goditje me sende të ndryshme, shtyrje, rrëzim përtokë, deri tek plagosja e lehtë, që i bëhen të dëmtuarit me qëllim trafikimin e tij.

Rekrutimi, ose transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të formave të tjera të shtrëngimit, me të cilat do të kuptojmë, të gjitha ato veprime, të cilat ndikojnë në mënyrë thelbësore në vullnetin e të të dëmtuarit, duke i hequr atij plotësisht lirinë që të disponojë për veten e tij, të cilat janë të ndryshme nga dhuna fizike apo psikike. Si veprime të tilla, mund të përmendim për shembull: lënien e të dëmtuarit pa ushqim, ose mospërkujdesi për të dëmtuarin i kushteve

63 Vendimin nr.31, datë 14.06.2007, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndaj të pandehurit E.M [www.gjkr.gov.al](http://www.gjkr.gov.al)

64 Vendimin nr.47, datë 23.10.2007, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, ndaj të pandehurit E.M.



minimale të jetesës, higjiëno-sanitare ose të fjetjes etj.

Rekrutimi, ose transportimi, ose transferimi, ose fshehja, ose pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të rrëmbimit. Rekrutimi, ose transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të mashtrimit, kur subjekti përdor gënjeshtëri ose shpërdoron besimin e të dëmtuarit, me qëllim trafikimin e tij.

Rekrutimi, ose transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të shpërdorimit të detyrës, kur në veprimet e subjektit të veprës penale, ekzistojnë të gjithë elementët e figurës së veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.<sup>65</sup> I vetmi dallim që ekziston në këtë rast, është fakti se subjekti, veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, e kryen me qëllim trafikimin e të dëmtuarit.

Rekrutimi, ose transportimi, ose transferimi, ose fshehja, ose pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të përfitimit nga gjendja shoqërore e viktimës, kur subjekti e kryen veprën penale, duke shfrytëzuar disa nga këto rrethana, që lidhen me të dëmtuarin, gjendja e rëndë ekonomike e të dëmtuarit, kur i dëmtuari nuk ka asnjë mjet për jetesë, gjendja familjare e të dëmtuarit, për shembull, e dëmtuara është rritur pa prindërit, ose është rritur me prindër të divorcuar, të cilët kanë ribërë martesë të re, ose e dëmtuara është e divorcuar dhe është e vetme, me ose pa fëmijë të mitur, niveli i ulët arsimor i të dëmtuarit, izolimi nga bota e jashtme që mund të ketë patur i dëmtuari, si pasojë e kushteve të rënda ekonomike ku është rritur. Morali shoqëror i një zonë të caktuar, prapambetja intelektuale etj.

**Në një rast në gjykim në Gjykatën e Krimeve të Rënda, e mitura ishte dhënë për shfrytëzim seksual për një periudhë të caktuar në Greqi me qëllim të shlyerjes së një borxhi që e ëma e saj ia kishte marrë trafikantit e nuk kishte mundur t’ia shlyente.<sup>66</sup>**

Rekrutimi, ose transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të përfitimit nga gjendja fizike apo psikike e të dëmtuarit, ku me gjendje të rëndë fizike, do të kuptojmë rastet kur i dëmtuari është i dëmtuar rëndë fizikisht, p.sh.: paraplegjik Me gjendje të rëndë psikike të të dëmtuarit, do të kuptojmë rastet kur i dëmtuari ka zhvillim të vonuar mendor ose vuan nga sëmundje mendore, të cilat e bëjnë të paaftë për të kuptuar plotësisht veprimet që kryhen në dëm të tij dhe pasojat që vijnë prej tyre.

Rekrutimi, ose transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të dhënies së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, kur subjekti i veprës penale, jep një shumë të caktuar parash ose një përfitim tjetër tek një person tjetër, me qëllim që ky i fundit të marrë pëlqimin e personit që ai kontrollon, me qëllim trafikimin e tij.

**Në një rast viktimja ishte dhënë për shfrytëzim kundrejt një pagese prej 4000 Euro që autori mori si kundravleftë.**

<sup>65</sup> Neni 248 i Kodit Penal përcakton: “Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet dhe me gjobë nga treqind mijë deri në një milion lekë”.

<sup>66</sup> Vendimi nr. 72 datë 23.10.2008 i Gjykatës së Shkallës së Parë për për Krime të Rënda, www.gjkr.gov.al.

Rekrutimi, ose transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale, bëhet me anë të marrjes së pagesave ose të përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, kur subjekti i veprës penale, merr një shumë të caktuar parash ose një përfitim tjetër tek një person tjetër, me qëllim që ky i fundit, të marrë pëlqimin e personit që ai kontrollon, me qëllim trafikimin e tij.

Në mënyrë që vepra e “Trafikimit të personave” të konsiderohet e kryer në mënyrë të plotë nga ana e subjektit të veprës penale, mjafton të provohet se ai ka përdorur, qoftë edhe një nga format e mësipërme për të realizuar trafikimin e personit. Pra, vepra penale, do të konsiderohet plotësisht e kryer, në qoftë se subjekti, rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen ose pritjen e personave, e ka bërë qoftë edhe vetëm me anë të kërcënimit ose qoftë edhe vetëm me anë të përdorimit të forcës ose qoftë edhe vetëm me anë të formave të tjera të shtrëngimit, ose qoftë edhe vetëm me anë të rrëmbimit, ose qoftë edhe vetëm me anë të mashtrimit, ose qoftë edhe vetëm me anë të shpërdorimit të detyrës, ose qoftë edhe vetëm me anë të përfitimit nga gjendja shoqërore, psikike apo fizike, ose qoftë edhe vetëm me anë të marrjes ose dhënies së pagesave për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër.

Në qoftë se, rezulton që subjekti e ka kryer veprën në dy ose më shumë prej këtyre formave të trajtuara më lart dhe të parashikuara në dispozitë, ai nuk do të përgjigjet aq herë në sa forma e ka kryer veprën, por do të përgjigjet vetëm një herë dhe fakti, që ai e ka kryer veprën me anë të disa prej këtyre formave, tregon për rrezikshmërinë e madhe të tij, fakt që duhet të mbahet parasysht nga gjykata në caktimin e dënimit.

- **rekrutimi ose transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nga ana e subjektit të veprës penale, i bërë ose me anë të kërcënimit ose me anë të përdorimit të forcës, apo formave të tjera të shtrëngimit, ose me anë të rrëmbimit, ose me anë të mashtrimit, ose me anë të shpërdorimit të detyrës ose me anë të përfitimit nga gjendja shoqërore e të të dëmtuarit, ose me anë të përfitimit nga gjendja fizike apo psikike, ose me anë të dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, duhet që të bëhet ose me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve apo formave të tjera të shfrytëzimit seksual, ose me qëllim shfrytëzimin e punës ose shërbimeve të detyruara, ose me qëllim skllavërimin e personit ose formave të ngjashme me të, ose me qëllim vënien në përdorim ose transplantimin e organeve, ose me qëllim të çdo shfrytëzimi tjetër.**

Nga sa sipër del që trafikimi kryhet nëpërmjet formave të shfrytëzimit për qëllime prostitucioni, pune të detyruar, shërbime të tjera të detyruara, për transplantim të organeve. Siç mund të konstatohet secili prej këtyre rasteve të elementit të tretë të anës objektive të figurës së veprës penale është i lidhur me konceptin “Shfrytëzim i të dëmtuarit”. Ky koncept ka kuptimin që në çdo rast i dëmtuari jashtë vullnetit të tij dhe kundër dëshirës së tij, dhe i detyruar nga subjekti i veprës penale, shfrytëzohet, në një nga format e përmendura më lart.<sup>67</sup> Tek kjo veprë penale në të gjitha format e kryerjes së saj, mungon vullneti i të dëmtuarit në kryerjen e veprimeve, i dëmtuari është totalisht i kontrolluar nga subjekti i veprës penale dhe kryen çdo veprim që i kërkohet prej tij.

Ndikimi që ushtron subjekti i veprës penale tek i dëmtuari, realizohet kryhet me anë të kërcënimit, ose me anë të përdorimit të forcës, ose me anë të formave të tjera të shtrëngimit, ose me anë të rrëmbimit, me anë të mashtrimit, me anë të shpërdorimit të detyrës ose duke përfituar nga gjendja shoqërore apo fizike ose psikike e të dëmtuarës etj. Gjatë gjithë kohës së kryerjes së veprës penale, çdo fitim i nxjerrë nga ana e të dëmtuarit si pasojë e shfrytëzimit të tij, përfitohet, si rregull, nga ana e subjektit të veprës penale. Të

<sup>67</sup> Forma të cilat janë të parashikuara në mënyrë të shprehur nga neni 110/a i Kodit Penal.

dëmtuarit, gjatë kohës së kryerjes së kësaj veprë penale nga ana e subjektit, i është hequr në mënyrë të plotë liria, si një nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe ai shndërrohet në një vegël të bindur të subjektit të veprës penale, duke mos pasur fare rëndësi që të kryejë veprime sipas vullnetit të tij, dhe kjo përbën dhe një nga dallimet bazë, ndërmjet veprës penale të “Trafikimit të personave” dhe me veprat të “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, apo kontrabandimi siç quhet në të drejtën ndërkombëtare.<sup>68</sup>

Në mënyrë që vepra të konsiderohet e kryer, nga ana e subjektit, mjafton që ai ta ketë pasur qëllimin për të kryer atë, qoftë dhe vetëm me anë të një prej formave të shfrytëzimit, të parashikuara nga dispozita, pra qoftë edhe me anë të shfrytëzimit të prostitucionit të të tjerëve apo formave të tjera të shfrytëzimit seksual, ose qoftë edhe vetëm me anë të shfrytëzimit të punës ose shërbimeve të detyruara, ose qoftë edhe vetëm me anë të skllavërimit të personit ose formave të ngjashme me të, ose qoftë edhe vetëm me vënien në përdorim ose transplantimin e organeve, ose me çdo shfrytëzimi tjetër. Në qoftë se subjekti e ka pasur si qëllim për të kryer veprën, në dy ose më shumë prej formave të parashikuara më lart, pra, e ka pasur si qëllim për ta kryer edhe për shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve, edhe me anë të shfrytëzimit të punës së detyruar, edhe me anë të vënies në gjendje skllavërie të personit, etj. subjekti, nuk do të përgjigjet, aq herë, në sa forma ka pasur si qëllim për të kryer veprën, por vetëm një herë të vetme, ndërsa fakti që ai ka pasur si qëllim për ta kryer veprën, në disa forma tregon për rrezikshmërinë e lartë të tij, dhe ky fakt duhet të mbahet parasysh nga gjykata në caktimin e dënimit.

Për kuptimin e drejtë të veprës penale të “Trafikimit të personave”, në mënyrë që kjo vepër të konsiderohet si plotësisht e kryer, elementi i tretë i saj, qëllimi për shfrytëzim prostitucioni, ose për çdo qëllim tjetër të kundërligjshëm të të dëmtuarit, nuk është e domosdoshme që të realizohet nga subjekti i veprës penale, por, mjafton që të provohet qëllimi i subjektit për të shfrytëzuar në mënyrë të kundërligjshme personin e dëmtuar.

### Çështje për diskutim:

1. Shfrytëzimi a duhet të përfshihet tek trafikimi apo konkurron me trafikimin ?
2. A është shfrytëzimi element i domosdoshëm i veprës penale të trafikimit ?
3. A mund të kemi formë të tentativës së trafikimit ?

Shfrytëzimi i kundërligjshëm i të dëmtuarit nuk është konsideruar si pjesë e domosdoshme e anës objektive të veprës penale të “Trafikimit të personave”.

Rast praktik: Gjykata e Apelit për Krime të Rënda në një vendim shprehet se „...i pandehuri R.E ka bashkëpunuar me të pandehurin F.S vetëm në shfrytëzimin e prostitucionit të të dëmtuarës M.G në shtetin italian e se trafikimi është bërë nga i pandehuri tjetër... „ duke e ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale nga trafikim në shfrytëzim prostitucioni, neni 114/a pika 5 e Kodit Penal.<sup>69</sup> Ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ndër të tjera arsyeton se: „Që të konsiderohet e formuar figura e veprës penale të trafikimit të femrave, mjafton që të jetë prezent qoftë edhe njëra nga elementët e saj, pra do të mjaftonte edhe vetëm elementi i rekrutimit apo ai i transportimit apo transferimit apo i fshehjes apo i pritjes së femrës, në një nga format dhe për qëllimin e përcaktuar në dispozitën e lartpërmendur”.<sup>70</sup>

68 Në Protokollin e Palermos kjo vepër penale njihet si emigracioni ilegal ose kontrabandimi i emigrantëve.

69 Vendimi nr. 44 datë 02.07.2012 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda

70 Vendimi nr.5 datë 17.01.2008, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, www.gjkr.gov.al

Subjekti i kësaj vepre penale, është i përgjithshëm, pra, çdo person që ka arritur moshën për përgjegjësi penale, dhe është i përgjegjshëm para ligjit për veprimet që kryen. Nga ana subjektive, kjo vepër penale, kryhet në çdo rast me dashje direkte dhe me qëllim realizimin e përfitimeve monetare ose pasurore, ose të çdo qëllimi tjetër. Në mënyrë të veçantë Kodi ynë Penal ndëshkon trafikimin e të miturve sipas nenit 128/b duke iu përmbajtur përkufizimit të Konventës për të të miturin – fëmijë nënkuptohet çdo person nën 18 vjeç.<sup>71</sup> Në këtë rast kur viktimë është një i mitur - fëmijë elementët e figurës së veprës penale janë të njëjtat me ato sa argumentuam më sipër por sanksionet janë më të larta.

Në lidhje me dallimin me dhënien ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit ose kontrabandimin e emigrantëve siç cilësohet në legjisllacionet e huaja, kemi të bëjmë me elementin e vullnetit të personit dhe lidhjen me autorin e kryerjes së veprës penale, me qëllim realizimin në rrugë kriminale të përfitimeve materiale. Kodi Penal (nenet 297-298), nuk përdor termin kontrabandimi i personave apo trafikimi i migrantëve, por kriminalizon kalimin e paligjshëm të kufirit apo ndihmën për kalimin e paligjshëm të kufijve. Dallimi qëndron në faktin se në rastin e kalimit të paligjshëm apo dhënies ndihme për kalim të paligjshëm emigrantët apo personat kalohen me dëshirën e vullnetin e tyre e lidhja me autorët përfundon me kalimin e territorit shqiptar në një vend tjetër kufitar ndërsa në rastin e trafikimit emigranti/femra/ i mituri përdoren si *corpus delicti* për të nxjerrë fitime, transferohen, kalohen jashtë territorit pa dëshirën e vullnetin e tyre ose duke e vesuar atë vullnet dhe lidhje me trafikantin nuk përfundon me kalimin e territorit.

### 3.1.1 TRAFIKIMI I BRENDSHËM SIPAS KODIT TONË PENAL

Veprat penale që kanë lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore mund të kryhen edhe brenda territorit shqiptar, mjafton të provohet qoftë edhe njëri nga këta elementë:

- rekrutimi,
- transportimi,
- transferimi,
- fshehja,
- pritja e personave për qëllime të shfrytëzimit të tyre për prostitucion,
- punë të detyruar,
- skllavërim, si dhe
- formave të tjera të shfrytëzimit,

e realizuar kjo nëpërmjet

- kërcënimit,
- mashtrimit,
- përdorimit të forcës,
- shpërdorimit të detyrës etj.

<sup>71</sup> Shtuar me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001; ndryshuar me ligjin nr. 9188, datë 12.2.2004; shtuar me ligjin nr. 9859, datë 21.1.2008; ndryshuar fjalët në paragrafin e parë me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013

Përkufizimi i veprës penale të trafikimit jodomosdoshmërisht është i lidhur me kalimin e territorit të RSH. Neni 110/a i Kodit Penal citon shprehimisht "...si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë". Sipas frymës së Konventës së Varshavës edhe Kodi ynë Penal në përkufizimin e veprës penale të trafikimit nuk pengon ndjekjen penale kur trafikimi ka ndodhur brenda vendit e nuk e lidh atë domosdoshmërisht me kalimin e kufijve shtetërorë.<sup>72</sup> Kjo pasi trafikimi mund të konsumohet brenda territorit të vendit dhe mund të ketë natyrë kombëtare nëpërmjet shfrytëzimit për prostitucion apo punë të detyruar brenda vendit. Format e kryerjes së trafikimit të brendshëm zakonisht janë ato të shfrytëzimit për prostitucion të të miturve brenda vendit ose femrave /të mitura apo të rritura nga pakicat rome kryesisht ose nga grupet shoqërore vulnerabël duke i detyruar të ushtrorë prostitucion në Tiranë ose në zonat bregdetare gjatë sezoneve turistike.

### 3.1.2. DALLIMI NDËRMJET TRAFIKIMIT TË PERSONAVE TË RRIUR DHE SHFRYTËZIMIT TË PROSTITUCIONIT


Shfrytëzimi i prostitucionit nënkupton shtyrjen e personit, me anë të këshillave, bisedave, udhëzimeve, premtimeve apo mashtrimeve për të ushtruar prostitucion. Ndërmjetësimi, realizohet nga persona të ndryshëm, të cilët luajnë rolin e ndërmjetësit midis të dëmtuarit dhe klientit të tij ose marrjes së shpërblimit nga i dëmtuari ose person tjetër.

Dallimi konsiston në pëlqimin e viktimës/të qenit i përgjegjshëm dhe me vullnet të lirë për të ushtruar prostitucion. E ndërsa shfrytëzimi për prostitucion në veprën penale të trafikimit bëhet duke e zhveshur viktimën nga vullneti pasi ajo detyrohet të prostitutojë nga shtrëngimi, presioni, mashtrimi, apo kushtet në të cilat ndodhet, në rastet e shfrytëzimit të prostitucionit, personi pranon vetë me dëshirë që të ushtrorë prostitucion. Kufiri i ndarjes në mes të dy formave është i hollë por gjithnjë duhet vërtetuar qenia si e/i lirë në vullnetin për të ushtruar lirisht e jo e/i shtrënguar prostitucionin.

Dallimi, ndërmjet paragrafit të dytë të nenit 114 dhe nenit 128/b të Kodit Penal, qëndron në faktin se mënyrat/format e realizimit të këtyre dy veprave penale janë të ndryshme (neni 114 parashikon se një person shtyn, ndërmjetëson apo merr shpërblim për shfrytëzimin e një fëmije/të mituri për prostitucion). Në rastin e trafikimit të të miturve, qëllimi i shfrytëzimit është më i gjerë sesa shfrytëzimi vetëm për prostitucion. Nëse kemi shtytje, ndërmjetësim apo marrje shpërblimi për shfrytëzimin e një të mituri për prostitucion, jemi para një rasti trafikimi të qenieve njerëzore. Në pamje të parë, të krijohet përshtypja, që neni 114 paragrafi i dytë, kriminalizon vetëm pjesën e shfrytëzimit të një të mituri, por kjo nuk do të thotë që i mituri nuk është i trafikuar. Me ndryshimet e vitit 2013, koncepti i 'trafikimit të brendshëm' – (si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë), nuk është reflektuar edhe në përmbajtjen e nenit 128/b të Kodit Penal.

Në çdo rast kur viktimë është e mitur – pëlqimi që jep i mituri për të ushtruar prostitucion nuk merret në konsideratë/nuk ka vlerë, pavarësisht faktit, nëse është cenuar ose jo vullneti, për shkak të gjendjes vulnerabël ose rrethana të tjera. Konventa e Varshavës, parashikon: Trafikimi i fëmijëve, për çfarëdo lloj forme shfrytëzimi, do të konsiderohet trafikim edhe nëse nuk përdoren mjetet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, pavarësisht vullnetit të fëmijës".

<sup>72</sup> Konventa e Këshillit të Evropës "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore ", e ratifikuar nga Parlamenti shqiptar me ligjin nr. 9642 datë 20.11.2006  
[https://www.mb.gov.al/Wp-content/uploads/2019/12/Ligj\\_Nr.\\_9642\\_dat%C3%AB\\_20.112006\\_%E2%80%9CP%C3%ABr\\_ratifikimin\\_e\\_Konvent%C3%ABs\\_s%C3%AB\\_K%C3%ABshillit\\_t%C3%AB\\_Evrop%C3%ABs\\_dhe\\_masat\\_-1.pdf](https://www.mb.gov.al/Wp-content/uploads/2019/12/Ligj_Nr._9642_dat%C3%AB_20.112006_%E2%80%9CP%C3%ABr_ratifikimin_e_Konvent%C3%ABs_s%C3%AB_K%C3%ABshillit_t%C3%AB_Evrop%C3%ABs_dhe_masat_-1.pdf)



## KREU IV



# TRAFIKIMI I FËMIJËVE

## 4.1 LEGJISLACIONI MBI TRAFIKIMIN E FËMIJËVE

Njohja e bazës ligjore është hapi i parë në trajtimin e problematikës së hetimit dhe gjyqimit të veprave penale të trafikimit të të miturve dhe mbrojtjes së tyre. Ka një interes të shtuar ndaj veprës penale për trafikimin e fëmijëve duke vënë theksin tek format e reja të trafikimit të të miturve: lypja, puna e detyruar, dallimet nga shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese, apo keqtrajtimi i të miturit, etj. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton në nenin 3 se dinjteti, të drejtat dhe liritë e personit, ... janë baza e këtij vendi, i cili ka detyrimin t'i respektojë dhe mbrojë ato. Sipas nenit 54 të Kushtetutë fëmijët gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti dhe se fëmijët kanë të drejtë të jenë të mbrojtur nga shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, veçanërisht nën moshën minimale lidhur me punën që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojnë jetën a zhvillimin normal të fëmijës. Ndalimi i punës së detyruar është parashikuar edhe në nenin 26 të Kushtetutës i cili sanksionon: "Askujt nuk mund t'i kërkohet të kryejë një punë të detyruar, përveçse në rastet e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor, të kryerjes së shërbimit ushtarak, të një shërbimi që rrjedh nga një gjendje lufte, nga një gjendje e jashtëzakonshme ose një fatkeqësi natyrore, që kërcënon jetën ose shëndetin e njerëzve".

Një mbrojtje e veçantë për të miturit është përfshirë në kuadrin ligjor të brendshëm në fuqi duke veçuar ligjet e reja dhe ndryshimet e kohëve të fundit siç janë Ligji nr. 37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur" dhe Ligji nr. 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve". Këto dy paketa normative kërkojnë që fëmijëve viktimë të trafikimit t'u sigurohen masa të veçanta mbrojtëse në praktikë. Mbetet me rëndësi që autoritetet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë masave të marra për të adresuar tendencat e reja në trafikimin e qenieve njerëzore dhe cënueshmërinë e fëmijëve ndaj trafikimit.

Konventa e OKB për të Drejtat e Fëmijëve (1989) ka shndërruar në detyrime ligjore afirmimet e Deklaratës së të Drejtave të Fëmijëve të adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara të 1959. Konventa është ratifikuar nga Shqipëria në shkurt të vitit 1992 dhe ka hyrë në fuqi në mars të vitit 1992. Kjo Konventë monitorohet nga Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve, i cili bën sugjerime dhe rekomandime se si mund të realizohen detyrimet që burojnë nga Konventa.

Sa i përket të drejtave kryesore që burojnë nga Konventa e me rëndësi në kontekstin e trafikimit veçojmë nenet më poshtë:



- neni 2 lidhur me parimin e mosdiskriminimit;
- neni 3 lidhur me parimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe detyrimin e shtetit që t'i sigurojë fëmijës mbrojtje dhe kujdes kur familja nuk e bën këtë;
- neni 6 mbi të drejtën e jetës;

- neni 12 mbi të drejtën për t'i shprehur lirisht pikëpamjet dhe për ti vlerësuar këto në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë;
- neni 16 mbi të drejtën për jetë private dhe familjare;
- neni 19 mbi mbrojtjen nga keqtrajtimi dhe çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja ose mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual;
- neni 22 mbi mbrojtjen e fëmijëve refugjatë; neni 40 mbi të drejtën për një proces të drejtë;
- neni 32 mbi detyrimin për të mbrojtur fëmijët nga shfrytëzimi ekonomik dhe nga kryerja e çdo pune që paraqet rreziqe ose që cenon edukimin e tij ose dëmton shëndetin ose zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror;
- nenet 33-36 mbi të drejtën të mbrohen nga përdorimi i paligjshëm i drogës, nga çdo lloj forme e shfrytëzimit dhe e keqtrajtimit seksual, nga rrëmbimi, shitja ose trafikimi i çdo lloj forme qoftë dhe nga çdo formë tjetër shfrytëzimi, që dëmton në çfarëdo aspekti mirëqenien e tij;
- neni 39 mbi rehabilitimin.

Me rëndësi është edhe **“Protokolli Opsional për Shitjen, Prostitucionin, Pornografinë e Fëmijëve”**, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 9834, datë 22.11.2007, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së, “Për të drejtat e fëmijëve”, Fletorja Zyrtare nr. 165, viti i botimit 2007. **Konventa e OKB-së Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar** (dhe Protokollat Shtesë nënshkruar në Palermo), është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8920/11.07.2002. Ratifikimi i saj solli ndryshime me rëndësi në Kodin Penal në vitin 2004. Vlen të nënvizojmë **Protokollin shtesë të kësaj Konvente mbi Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkimin e Trafikut të Personave, Veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve, 2000 (Protokolli i Palermos)**. Ky protokoll ka bërë të qartë qysh në nenin 2(a) fokusin tek gratë dhe fëmijët. Ky instrument ka përcaktuar se çfarë kuptohet me “trafik personash”, duke synuar njësimin e interpretimeve dhe të praktikave gjyqësore si dhe ka saktësuar kuptimin e trafikimit të të miturve. Na tërheq vëmendjen neni 3 germa (c) në të cilën nënvizohet se: Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e një fëmijë për qëllime shfrytëzimi, do të konsiderohet “trafik personash” edhe nëse në të nuk do të përfshihen mjetet e parashikuara në nënparagrafin (a) të këtij neni. Gjithashtu Protokollin e Palermos në neni 6 pika 4 nënvizon rëndësinë që ka marrja në konsideratë e moshës, gjinisë dhe nevojave të veçanta të viktimave të trafikut dhe, në veçanti, nevojat e veçanta të fëmijëve, përfshirë banesën, arsimimin dhe kujdesin e përshtatshëm. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar masave që duhen marrë për mbrojtjen e fëmijëve dhe parandalimin e trafikimit (shih neni 9 i këtij protokoll). Në nenin 4 të këtij protokollin përcaktohet se fusha e zbatimit të tij shtrihet në ato raste kur veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore kanë një natyrë ndërkombëtare dhe përfshijnë një grup të organizuar kriminal. Direktiva e parlamentit Evropian dhe e Këshillit 2011/36/EU “Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave” i jep përparësi parandalimit, identifikimit dhe asistencës së viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, duke treguar një kujdes të veçantë për të miturit.

Në kuadrin e instrumenteve të Këshillit të Evropës, përveç 2 instrumenteve kryesore të organizatës, Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut si dhe Konventës kundër Trafikimit nevojitet të njihet edhe Konventa e Këshillit të Evropës për Krimin Kibernetik sepse ekziston ne lidhje me shfrytëzimin online si dhe Konventa për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual (Konventa e Lanzarotë).



## 4.2 PËRKUFIZIMI I TRAFIKIMIT TË FËMIJËVE

Fëmijët janë veçanërisht të cënueshëm nga vepra penale e trafikimit për shkak se ata i binden autoritetit të personit që i trafikon dhe mund t'i nënshtrohen formave të ndryshme të shfrytëzimit, siç mund të jenë shfrytëzimi seksual, për lypje të detyruar, për punë të detyruar, për aktivitete kriminale deri dhe për shitblerjen e organeve.

Siç evidentohet nga përmbajtja e Neni 3 të Protokollit që përkufizon trafikimin e qenieve njerëzore, në rastin e fëmijëve nuk është e nevojshme të provohen mjetet për të siguruar trafikimin e fëmijës. Pra në rastin e fëmijëve, nuk është e nevojshme të provohet që fëmija i është nënshtruar mjeteve abuzuese të përmendura më lart, që rasti të konsiderohet si trafikim fëmijësh. Është e mjaftueshme të provohet që fëmija është rekrutuar posaçërisht me qëllim për t'u shfrytëzuar (nuk ka rëndësi nëse është zhvendosur ose jo). Gjithashtu, nuk është e nevojshme që të provohet pëlqimi i fëmijës për shfrytëzimin që të provohet vepra penale e trafikimit të fëmijës.

Fëmijët mund t'u nënshtrohen të gjitha formave të shfrytëzimit të parashikuara në Protokollin e Palermos dhe në Konventa të tjera që trajtojnë çështje të shfrytëzimit dhe trafikimit të fëmijëve. Udhëzimi i UNICEF për mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi i përmbledh si më poshtë format e shfrytëzimit të fëmijëve të trafikuar, në një adresim të dispozitave përkatëse në konventat kryesore që trajtojnë trafikimin e fëmijëve: trafikimi i fëmijëve kryhet me qëllim format e shfrytëzimit për prostitucion ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënie në përdorim ose transplantim të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, përdorimi i fëmijëve për grupe ose forca të armatosura, lypje, aktivitete të paligjshme apo aktivitete sportive dhe kulturore.<sup>73</sup>

Sipas Zyrës së Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, "dëmet e veçanta fizike, psikologjike dhe psikosociale që vuajnë të mitur e trafikuar dhe vulnerabiliteti i tyre i shtuar ndaj shfrytëzimit duhet të trajtohen veçmas nga personat madhorë të trafikuar sa u përket ligjeve, politikave, programeve dhe ndërhyrjeve. Interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë faktori kryesor në të gjitha veprimet në lidhje me fëmijët e trafikuar, qofshin këto veprime të ndërmarra nga institucione të mbrojtjes sociale, publike apo private, gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislativë."<sup>74</sup>

### 4.2.1 SHFRYTËZIMI I FËMIJËVE

Të miturit e çdo moshe mund të jenë subjekte të trafikimit brenda vendit dhe përtej kufijve për të gjitha format e shfrytëzimit. Viktimat mund të shfrytëzohen seksualisht dhe të detyrohen të bëjnë punë seksuale; viktima të mitur janë gjetur në shtëpi publike, në vende rekreative si SPA, në klube lap dancing. Shfrytëzimi gjithashtu mund të përfshijë mitur që detyrohen të punojnë në kultivimin e kanabisit, trafikimin e drogës, lypje dhe vjedhje ordinere. Llojet e tjera të shfrytëzimit përfshijnë detyrimin nëpërmjet borxhit (detyrimin për të punuar për të shlyer borxhet që në kushte reale viktima nuk do të mund t'i shlyente kurrë), heqjen e organeve, mashtrimi financiar (duke përfshirë edhe mashtrimin për përfitime), si dhe adoptimi i paligjshëm.

Ndërkohë shumë të mitur i janë nënshtruar punës së detyruar duke punuar në ferma, fabrika, sallone

<sup>73</sup> Udhëzimi i UNICEF për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Trafikimi, [https://www.unicef.org/protection/Unicef\\_Victims\\_Guidelines\\_en.pdf](https://www.unicef.org/protection/Unicef_Victims_Guidelines_en.pdf)

<sup>74</sup> Parimet dhe udhëzimet e rekomanduara për të drejtat e njeriut dhe trafikimin e qenieve njerëzore, Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, trajton masat e posaçme për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të mitura të trafikimit në Udhëzimin 8. <https://www.ohchr.org/documents/publications/traffickingen.pdf>

thonjsh, lavazhe, hotele dhe restorante për një pagë të vogël ose për asnjë lloj page<sup>75</sup>. Shërbimet shtëpiake përfshijnë viktimat të detyruara të punojnë për shumë orë për një shpërblim të vogël ose duke mos marrë asnjë lloj shpërblimi, shpesh në kushte shumë të vështira pune. Ndonjëherë, edhe martesat e detyruara mund të çojnë në shërbime shtëpiake.

Viktimat shpesh përballen me më shumë sesa një lloj abuzimi dhe skllavërie; ato mund t'i shiten një trafikanti dhe më pas të detyrohen t'i nënshtrohen një tjetër forme shfrytëzimi. Po ashtu të miturit mund të shfrytëzohen nga prindërit, kujdestarët ose familjarët. Shpesh, të miturit nuk e kuptojnë që në shfrytëzimin e tyre përfshihen edhe vetë familjarët. Identifikimi i të miturve si viktimat të mundshme të skllavërisë moderne/ trafikimit mund të jetë i vështirë, pasi mund të mos ketë shenja të dukshme stresi apo abuzimi. Disa fëmijë nuk janë të vetëdijshëm se janë trafikuar, kurse disa të tjerë mund të marrin pjesë aktive në fshehjen e faktit të trafikimit të tyre. Edhe në rastet kur fëmija e kupton se çfarë ka ndodhur, ai ose ajo mund të duket sikur i nënshtrohet me vullnet të plotë asaj çka duket se është vullneti i prindërve të tyre apo të rriturve që i shoqërojnë. Është e rëndësishme që të mbrohen edhe këta fëmijë. Fëmijët nuk kanë zotësinë juridike të “dhënies së pëlqimit” për trafikimin apo shfrytëzimin e tyre.

#### 4.2.2 SHFRYTËZIMI SI ELEMENT I TRAFIKIMIT

Shfrytëzimi është elementi kryesor i dispozitës së trafikimit dhe shfaqet në forma të ndryshme. Shfrytëzimi i fëmijës kundrejt përfitimit material është qëllimi kryesor i trafikantëve dhe duhet provuar shfrytëzimi apo qëllimi për të shfrytëzuar që të ndodhemi përpara cilësimit të kësaj vepre. Por vetë koncepti i përkufizimit është problematik dhe jo i lehtë për t'u cilësuar. Ka situata trafikimi, si për shembull ajo e shfrytëzimit të fëmijëve për lypje, ku trafikanti përfiton nga shërbimi që ofron fëmija nëpërmjet shfrytëzimit të fëmijës. Në kuptimin e parashikimeve të Protokollit të Palermos, termi “shfrytëzim” përfshin përdorimin e një fëmije për qëllime përfitimi. Ky përfitim mund të vijë nga shfrytëzimi seksual apo format e ndryshme të shfrytëzimit ekonomik përfshirë edhe për qëllime të trafikimit të organeve për përfitime financiare. Në praktikë mund të jetë e vështirë të dallohen rastet e influencës së një fëmije nga anëtarë të familjes së tij për kryerjen e aktiviteteve të tilla përfituese si lypja apo vjedhja dhe rasteve të shfrytëzimit të tyre në kuptimin e veprës penale. Për më tepër, në parashikimet e Protokollit nuk përmendet specifikisht rekrutimi i fëmijëve për punë të tilla si lypje ose vjedhje që janë rastet më të spikatura në realitetin shqiptar; interpretimi më i saktë do të ishte ai që e lidh këtë aktivitet me kategorinë e “punës apo shërbimeve të detyruara ose shërbime”. Ky interpretim është rregulluar edhe në akte të BE, në veçanti Direktiva e BE-së për Masat kundër trafikimit e cila në piken 11 të Preambulës se saj parashikon si më poshtë:

Për të trajtuar zhvillimet e fundit në lidhje me fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore, kjo Direktivë adopton një koncept më të gjerë në lidhje me çfarë duhet të konsiderohet trafikim i qenieve njerëzore raport me Vendimin Kuadër 2002/629 / JHA dhe për këtë arsye përfshin në të forma shtesë të shfrytëzimit. Në kontekstin e kësaj direktive, lypja e detyruar duhet të kuptohet si një formë e punës së detyruar ose shërbimeve siç përcaktohet në Konventën Nr. 29 të Organizatës Ndërkombëtare të Punë 1930 në lidhje me punën e shtrënguar ose të detyruar. Prandaj, shfrytëzimi i lypjes, përfshirë përdorimin e një personi familjar të trafikuar për lypje bie brenda fushës së trafikimit të qenieve njerëzore kur përmbushen të gjitha elementet e punës së detyruar ose shërbimeve. Në dritën e praktikës ligjore, vlefshmëria e çdo pëlqimi të mundshëm për të kryer punë ose

<sup>75</sup> Raporti i 3të i Komisionit Evropian për Parlamentin Evropian dhe Këshillin mbi progresin e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore (2020) në zbatim të Direktivës 2011/36/BE për parandalimin dhe luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave. [https://ec.europa.eu/anti-trafficking/sites/default/files/third\\_progress\\_report.pdf](https://ec.europa.eu/anti-trafficking/sites/default/files/third_progress_report.pdf)

shërbime të tilla duhet të vlerësohet rast pas rasti. Sidoqoftë, kur bëhet fjalë për një fëmijë, asnjë pëlqim nuk duhet të konsiderohet kurrë i vlefshëm. Shprehja “shfrytëzim i veprimtarive kriminale” duhet të kuptohet si shfrytëzim i një personi për të kryer, mes të tjerash, vjedhje të formave të ndryshme, trafik droge dhe aktivitete të tjera të ngjashme të cilat janë të ndëshkueshme dhe sjellin përfitim financiar. Përkufizimi gjithashtu përfshin trafikimin e qenieve njerëzore me qëllim të heqjes së organeve, që përbën një dhunim të rëndë të dinjitetit njerëzor dhe integritetit fizik, si dhe sjellje të tjera siç janë adoptimi i paligjshëm ose martesë e detyruar për aq kohë sa ato plotësojnë elementët përbërës të trafikimit të qenieve njerëzore.<sup>76</sup>

Siç evidentohet qartë, ndërsa në rastin e një personi madhor vlefshmëria e çdo pëlqimi të mundshëm për të kryer punë ose shërbime të tilla duhet të vlerësohet rast pas rasti, vullneti i fëmijës për të kryer një punë a shërbim që sjell përfitime për shfrytëzuesit të tij nuk merret në konsideratë dhe nuk ka rëndësi për cilësimin juridik të faktit penal. Protokollin Opsional i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve në lidhje me Shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin me Fëmijë dhe Pornografinë me Fëmijë nuk rregullon në mënyrë të posaçme të drejtat e fëmijëve kundër trafikimit por sidoqoftë përfshin konsiderata të rëndësishme mbi masat që duhen marrë kundër formave të ndryshme të shfrytëzimit të fëmijëve sipas përkufizimeve të nenit 2:

Për qëllimin e këtij protokollit:

- a) Shitje e fëmijëve është çdo veprim ose transaksion me anë të të cilit një fëmijë transferohet prej një personi ose grupi personash te një tjetër me pagesë ose në çdo mënyrë tjetër.
- b) Prostitucion me fëmijë është përdorimi i fëmijës në aktivitete seksuale me pagesë ose çdo mënyrë tjetër.
- c) Pornografia me fëmijë është çdo formë përfaqësimi, me çfarëdo mjeti, i një fëmije të përfshirë në aktivitete të qarta seksuale, të vërteta ose të simuluar, ose çdo demonstrim i pjesëve seksuale të një fëmije për qëllime kryesisht seksuale.<sup>77</sup>

Neni 3 i Protokollit i kërkon shteteve palë që të garantojnë rregullimin e plotë nga ana e kuadrit ligjor penal, të veprimeve dhe aktiviteteve të mëposhtme, pavarësisht faktit nëse këto vepra penale janë kryer brenda apo jashtë vendit, nga një individ apo grup individësh të organizua në çështjet më poshtë:

- a) në kontekstin e shitjes së fëmijëve sipas nenit 2:
  - i) Ofrimi, dorëzimi ose pranimi me çfarëdo mjeti i një fëmije për qëllimin e shfrytëzimit seksual të fëmijëve, transferimit të organeve të një fëmije për qëllime fitimi, përfshirjes së fëmijëve në punë të detyruara.
  - ii) Marrja e pëlqimit në mënyrë të papërshtatshme, si ndërmjetës për adoptimin e një fëmije duke shkelur instrumentet e zbatueshme ligjore ndërkombëtare për miratimin.
- b) Ofrimi, marrja, gjetja ose dorëzimi i një fëmije për prostitucion me fëmijë, sipas përcaktimit të nenit 2.
- c) prodhimi, shpërndarja, importimi, eksportimi, ofrimi, shitja ose mbajtja e pornografisë me fëmijë për qëllimet e sipërsënuara, sipas përcaktimit të nenit 2.

<sup>76</sup> Direktiva 2011/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 prill 2011 për Parandalimin dhe Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave të tij, që zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA.

<sup>77</sup> [https://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg\\_no=IV-11-c&chapter=4&clang=\\_en](https://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=IV-11-c&chapter=4&clang=_en)

Protokolli është ratifikuar nga ana e Kuvendit të Shqipërisë me anë të Ligjit Nr. 9834, datë 22.11.2007, “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Fëmijëve”, që e bën rrjedhimisht burim të së drejtës në kuadrin ligjor shqiptar. Siç evidentohet në Kapitullin 3, parashikimet e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë në lidhje me veprimin e ligjit penal, pas ndryshimeve të vitit 2013, janë në linjë me kërkesat e nenit 3 të Protokollit.

Sipas parashikimeve të Konventave ndërkombëtare, nuk është e nevojshme të ndodhë shfrytëzimi që vepra të konsiderohet si trafikim. Mjafton që të provohet qëllimi për të trafikuar dhe rrjedhimisht trafikimi konsiderohet i përmbushur edhe pa nisur shfrytëzimi konkret i viktimës, të rritur ose të mitur. Ky është dhe qëndrimi i mbajtur edhe nga Gjykatat e Krimeve të Rënda në gjykimin e çështjeve të trafikimit të fëmijëve. Në shumë raste këto veprime përmbushen nga persona të njohur ose dhe në lidhje familjare me fëmijën. Në rastet e praktikës, gjykatat kanë mbajtur qëndrimin se kur provohet kryerja e veprimeve në të paktën njërën prej formave, me qëllim shfrytëzimin e viktimës, nuk ka rëndësi nëse shfrytëzimi faktik është përmbushur. Gjithashtu, sipas praktikës elementët e trafikimit konsiderohen të konsumuar, edhe në rastet kur nuk janë përdorur ose nuk provohet se janë përdorur mjetet e deformimit të vullnetit apo kur pretendohet pëlqimi i personit të mitur.<sup>78</sup>

### 4.2.3 LYPJA E DETYRUAR

Shfrytëzimi i fëmijëve për lypje është një prej formave më të rënda të shfrytëzimit të fëmijës, që përbën shkelje të një sërë të drejtash të garantuara nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës. Nisur nga pasojat në jetën, shëndetin, edukimin dhe zhvillimin e fëmijës, lypja e detyruar, e analizuar rast pas rasti, mund të përbëjë nga keqtrajtimi i fëmijës deri te trafikimi me qëllim shfrytëzimin për punë. **Por cili është dallimi mes këtyre formave të shkeljes së të drejtave të fëmijës? Fëmijët që lypin ndodhen në kushtet e punës së rëndë, formave më të rënda të punës së fëmijës apo trafikimit?**

Në të drejtën ndërkombëtare dhe interpretimet e konventave të OKB-së dhe të ILO-s hasen ende debate dhe paqartësi në lidhje me kategorizimin e punës së palejueshme të fëmijës për lypje, si formë e rëndë e punës së fëmijës apo trafikim. ILO vë theksin tek elementi i “transferimit” dhe shfrytëzimi nga palë të treta (jo prindërit) për të identifikuar veprën e trafikimit të fëmijës. ILO sqaron se “trafikimi i fëmijës” kryhet nëpërmjet zhvendosjes dhe pikërisht ky element bën dallimin nëse ndodhemi para “shfrytëzimit të fëmijës për punë” apo “trafikimit të fëmijës”.<sup>79</sup> Sipas ILO shfrytëzimi i fëmijës nga palë të treta është elementi i dytë thelbësor për klasifikimin e trafikimit. Duke kujtuar përkufizimin e punës së detyruar sipas Konventës Nr. 29 të ILO si “punë apo shërbim e kryer nga personi si formë dënimi apo për të cilën personi nuk ka ofruar veten vullnetarisht”, theksojmë se të provuarit e vullnetit të fëmijës është pothuajse e pamundur, veçanërisht në situatat ku fëmija detyrohet nga vetë prindërit.

Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishme për adresimin e fenomenit shqetësues të shfrytëzimit të fëmijëve për lypje, duke e trajtuar këtë çështje në kuadrin e legjislacionit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Me mbështetjen e OSBE-së, janë hartuar procedura të posaçme për trajtimin e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht dhe së fundi është miratuar dhe një Plan Kombëtar Veprimi për adresimin e fenomenit dhe monitorimin e masave. Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 129, datë 13.03.2019 “Për procedurat për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë

<sup>78</sup> Gjykata e Krimeve të Rënda në çështjen me numër 135 dhe vendim të datës 27/07/2016.

<sup>79</sup> Manual Trajnimi për luftën kundër trafikimit të fëmijëve, ILO, UNICEF dhe UN.GIFT 2009, faqe 15. <https://www.unicef.org/exploitation.html>

fëmijët në situatë rruge” ngarkon bashkitë për ngritjen e skuadrave të terrenit dhe marrjen e masave për identifikimin proaktiv të fëmijëve në situatë rruge. Vendimi gjithashtu përcakton rolet, përgjegjësitë dhe detyrat e strukturave të policisë si dhe të Inspektoratit Shtetëror të Punës për bashkëpunimin në lidhje me identifikimin dhe referimin e rasteve.

Legjislacioni penal shqiptar e trajton keqtrajtimin e të miturve në nenin 124/b të Kodit Penal “Keqtrajtimi i të miturve”, rrjedhojë e disa amendimeve të viteve 2008, 2012 dhe 2013, në një dispozitë konfuze për shkak se nuk përkufizon ekzaktësisht punën e detyruar apo shfrytëzimin. Gjithashtu është e nënkuptueshme po jo e qartë nëse detyrimi buron nga prindërit dhe familjarët apo dhe nga persona të tretë. Paragrafi i parë lidhet me keqtrajtimin e fëmijës nga familjarët që kanë detyrimin të kujdeset për fëmijën. Paragrafi i dytë i dispozitës cilëson “detyrimi, shfrytëzimi, shtytja ose përdorimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij mendor dhe/ose fizik, apo arsimimin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet”. Paragrafi i dytë i lidhur drejtpërdrejt me detyrimin e fëmijës për lypje, i trajtuar në këndvështrimin e të gjithë dispozitës, e lidh detyrimin me prindërit, familjarët, pra personat që kanë detyrimin të kujdesen për fëmijët. Në këtë këndvështrim, mund të konkludojmë se ky nen i përafrohet më së shumti përkufizimit të “punës së rëndë të fëmijës”, sipas Konventave të ILO-s. Neni ndalon keqtrajtimin fizik ose psikologjik të të miturit nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, kujdestari ligjor ose çdo person që është i detyruar të kujdeset për të si dhe detyrimin shfrytëzimin, shtytjen ose përdorimin e të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij mendor dhe/ose fizik, apo arsimimin e tij, duke parashikuar dënim më të ashpër kur nga vepra është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit ose vdekja e të miturit. Në mënyrë të rëndësishme, dispozita shtjellon pasojat që ka te fëmija kjo formë keqtrajtimi, duke cilësuar dëmtimin e zhvillimit mendor dhe/ose fizik, apo arsimimin e fëmijës si pasoja të veprimeve të detyrimit për të punuar. Përkufizimi i pasojave shërben për të analizuar pikërisht konceptin e interesit më të lartë të fëmijës në lidhje me punën që kryen dhe për profesionistët për të vendosur shkallën e rrezikut dhe masat që duhen marrë për largimin e menjëhershëm të fëmijës nga një situatë e tillë keqtrajtimi.

Siç u evidentua me sipër, sipas Direktivës së BE-së për Masat kundër trafikimit, lypja e detyruar duhet të kuptohet si një formë e punës së detyruar ose shërbimeve siç përcaktohet në Konventën Nr. 29 të Organizatës Ndërkombëtare të Punë të vitit 1930 dhe shfrytëzimi i lypjes, përfshirë nga një person i familjes duhet të përfshihet brenda fushës së trafikimit të qenieve njerëzore kur përmbushen të gjitha elementet e punës së detyruar ose shërbimeve. Kompleksiteti dhe vështirësia e kualifikimit të saktë të veprës penale në rastet e shfrytëzimit të të miturve për lypje nga ana e familjarëve të tyre është hasur edhe në praktikën e gjykatave shqiptare.

### **Rast për diskutim nga praktika gjyqësore vendase - Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda.**

E dëmtuara, motër e të pandehurve sipas aktit të ekspertimit psikiatriko-ligjor paraqiste probleme të zhvillimit intelektual duke u vlerësuar nga ekspertiza me një moshë mendore, gjendje emocionale, shpirtërore etj. të një 13-14 vjeçareje. Në kushtet e varfërisë e të braktisur nga prindërit e tyre, për të siguruar jetesën e saj, vëllezërit saj e nxitën dhe përdorën të dëmtuarën për të lypur duke e shoqëruar në vende e qytete të ndryshme të Shqipërisë. Si person me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore, shkak të për të cilën lëvizte me karrocë invalidi, dëmtuara ishte e varur nga familjarët e saj për përmbushjen e

nevojave bazike njerëzore, përfshirë edhe lëvizjen e saj.<sup>80</sup>

Sipas Gjykatës së Krimeve të Rënda, familjarët e saj e kanë shtyrë dhe përdorur të dëmtuarën që ajo të lypë, por duke qenë se, kjo shtetase, është madhore, gjykata, argumenton se shtytja dhe ndërmjetësimi për të lypur i personave të rritur, nuk është një veprë e dënueshme nga legjislacioni penal shqiptar, i cili ndëshkon penalisht, shtytjen dhe përdorimin për të lypur të personave të mitur sipas parashikimit në paragrafin e dytë të nenit 124 të Kodit Penal. Gjithashtu sipas Gjykatës, veprimet e kryera ndaj të dëmtuarës nuk ngrihen as në nivelin e veprës penale të trafikimit sepse si rregull kjo veprë penale kërkon si element të parë të domosdoshëm, rekrutimin e personit dhe më pas, heqjen ose kufizimin e lirisë së vullnetit si dhe detyrimin e për të realizuar jashtë vullnetit veprime të caktuara, ku përfshihet edhe lypja, të cilat nuk i gjen të përmbushura në rastin në fjalë. Gjykata argumenton se e dëmtuara është madhore dhe shtytja dhe ndërmjetësimi për të lypur i personave të rritur, nuk është një veprë e dënueshme nga legjislacioni penal shqiptar, ndërkohë që të ardhurat që sigurohen nga lypja përdoren për të siguruar jetesën e vetë të dëmtuarës dhe të anëtarëve të familjes të cilët ashtu si ajo ushtronin të njëjtin aktivitet për të jetuar.<sup>81</sup>

Në të njëjtën kohë, Gjykata argumenton, sidoqoftë se subjekti duhet konsideruar si e mitur por për qëllimet e një veprë tjetër penale, asaj të keqtrajtimit të të miturve, neni 110 i Kodit Penal.

Përtej diskutimit të bazës së argumenteve mbi miturinë e të dëmtuarës për qëllime të nenit 110 të Kodit Penal por jo për qëllime të neneve të tjera të Kodit Penal, vendimi i Gjykatës në këtë rast është evidencë e kompleksitetit të rasteve të shfrytëzimit të personave vulnerabël në praktikë dhe praktikës së pakonsoliduar ende të organeve të drejtësisë në lidhje me aplikueshmërinë e legjislacionit penal.

#### **4.2.4. DALLIMI NDËRMJET TRAFIKIMIT TË TË MITURIT NGA KEQTRAJTIMI I TË MITURIT (LYPJA E DETYRUAR APO SHFRYTËZIMI PËR PUNË TË DETYRUAR)**

Kodi ynë penal ka përfshirë tek vepra penale e keqtrajtimit të të miturit edhe keqtrajtimin nga prindërit, familjarët por dhe rastin e detyrimit të fëmijëve për të punuar apo lypur. Në rastin e parë<sup>82</sup> dallimi kryesor ndërmjet këtyre dy dispozitave trafikimi, neni 128/b, dhe keqtrajtimi i të miturit neni 124/b është subjekti aktiv i veprës penale, që në rastin e veprës penale ‘keqtrajtimi i të miturit’ është i posaçëm: prindi, kujdestari ose personi që është përgjegjës për rritjen dhe edukimin e tij. Në rastin e veprës penale “trafikimi i të miturve”, subjekti aktiv është i përgjithshëm, por mund të jetë edhe një subjekt i posaçëm – personi që ka për detyrë të kujdeset për të miturin. Ky rast i fundit, evidentohet në kryerjen e trafikimit përmes “shitjes së të miturit” si një formë e trafikimit të tyre, që është një veprim i cili në praktikë, është realizuar edhe nga prindi, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, kujdestari ligjor.

Shfrytëzimin për punë, shtytjen për të siguruar të ardhura, apo për të lypur Kodi ynë Penal i përfshin sërish tek vepra penale e keqtrajtimit të të miturit pag. 2 i nenit 124/b i cili parashikon: Detyrimi, shfrytëzimi, shtytja,

<sup>80</sup> Të pandehur I.Xh. dhe Xh.Xh, vendosur nga Gjykata e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda më 4.4.2016.

<sup>81</sup> Të pandehur I.Xh. dhe Xh.Xh, vendosur nga Gjykata e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda më 4.4.2016.

<sup>82</sup> Paragrafi i parë i nenit 124/b të KP: “Keqtrajtimi fizik ose psikologjik i të miturit nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, kujdestari ligjor ose çdo person, që është i detyruar të kujdeset për të, dënohet me burgim nga tre muaj gjer në dy vjet”.

ose përdorimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij mendor/ fizik apo arsimimin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.”<sup>83</sup> Nëse autori i detyrimit për shfrytëzim në punë, punë të detyruar apo lypje është një person tjetër që nuk është prindi ose i afërm i të miturit atëherë kemi veprën penale të trafikimit në njërin nga format e saj. Këto norma mbrojnë fëmijët nga kryerja e këtyre veprimeve edhe kur ato kryhen nga prindërit.

Legjislacionet e tjera evropiane pas miratimit të direktivave të BE<sup>84</sup> në mënyrë që të ndalohen zhvillimet e fundit në lidhje me fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore, e kryesisht të të miturve e konkretisht shfrytëzimin në punë dhe lypjen e detyruar, kanë adoptuar një koncept më të gjerë të asaj se çfarë duhet konsideruar trafikim i qenieve njerëzore. Krahasuar me vendimin kuadër 2002/629/JHA, Direktiva 2011/36 BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 prillit 2011, përfshin forma shtesë të shfrytëzimit. Brenda kontekstit të kësaj direktive, lypja e detyruar duhet kuptuar si një formë e punës apo shërbimeve të detyruara siç përcaktohet në Konventën e 1930 të ILO, nr. 29, në lidhje me Punën e Detyruar, prandaj, shfrytëzimi në lypje, duke përfshirë trafikimin e personit në kujdestari për lypje, përkufizohet si trafikim i qenieve njerëzore vetëm kur ndodhin të gjithë elementët e punës ose shërbimeve të detyruara. Në dritën e një çështjeje gjyqësore që ka lidhje me një rast të tillë, vlefshmëria e ndonjë pranimi të mundshëm për të kryer një punë apo shërbim të tillë, do të vlerësohet mbi bazën e vlerësimit rast pas rasti. Megjithatë, kur shqetësimi është për një fëmijë, asnjë pranim i mundshëm nuk duhet të konsiderohet i vlefshëm. Shprehja “ shfrytëzim i të miturit për punë të detyruar ose për të siguruar të ardhura ” duhet kuptuar si shfrytëzim i të miturit në punë apo orare punë në kundërshtim me Kodin e Punës në lidhje me përcaktimin e moshës për të kryer atë punë.

#### Çështje për diskutim :

Paragrafi i dytë nuk citon shprehimisht subjektin e posaçëm, mirëpo nëse subjekti nëse autori nuk është prindi ose i afërmi në këtë rast kemi formën e veprës penale të trafikimit sipas nenit 128 / b të KP:

## 4.3 TRAFIKIMI I FËMIJËVE SI NJË SHKELJE E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Trafikimi shkel një sërë të drejtash themelore të fëmijës, si:

- ▶▶ për mos iu nënshtruar torturës dhe trajtimit poshtërues, dënimit të padrejtë.
- ▶▶ e drejta për arsimim
- ▶▶ për kujdes shëndetësor
- ▶▶ për nivel jetese të përshtatshëm
- ▶▶ për pushim dhe argëtime kulturore e sportive
- ▶▶ e drejta për të ruajtur identitetin

Legjislacioni shqiptar e trajton trafikimin dhe shfrytëzimin e fëmijëve në kuadrin e sistemit të mbrojtjes së fëmijës, nëpërmjet masave parandaluese dhe adresimit të shkeljes së të drejtave të fëmijës duke i njohur

<sup>83</sup> Ky paragraf në nenin 124/b është shtuar me ligjin nr. 144 datë 2.05.2013.

<sup>84</sup> Direktiva 2011/36BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 prillit 2011, mbi Parandalimin dhe Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave të këtij Trafikimi, dhe zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA, Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 25 tetorit 2012

fëmijët viktima të trafikimit si një kategori fëmijësh në nevojë për mbrojtje të veçantë. Ligji 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” i referohet konceptit “mbrojtje e fëmijës” si parandalimi dhe përgjigjja ndaj dhunës, keqtrajtimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijës, përfshirë rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin dhe punën e fëmijës. Ky ligj e trajton trafikimin dhe shfrytëzimin e fëmijës si një formë e dhunës ndaj fëmijës dhe shkelje e të drejtave të fëmijës duke vënë në qendër të procesit të menaxhimit të rastit, nga identifikimi proaktiv deri te zgjidhja e rastit Punonjësin e Mbrojtjes së Fëmijës.

## 4.4 PARIMET QË UDHËHEQIN MBROJTJEN E FËMIJËVE VIKTIMA TË TRAFIKIMIT

Çdo veprim për parandalimin e trafikimi, marrjen në mbrojtje dhe ofrimin e shërbimeve fëmijëve të trafikuar apo në rrezik trafikimi duhet të udhëhiqet nga parimet e të drejtave të fëmijës. Masat për mbrojtjen e fëmijëve dhe ato posaçërisht për mbrojtjen e fëmijëve viktima të trafikimit dhe të shfrytëzimit bazohen në parimet e Konventës për të Drejtat e Fëmijës, të reflektuara në legjislacionin shqiptar dhe veçanërisht në Ligjin 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Këto parime i gjejmë të reflektuara dhe në procedurat që rregullojnë bashkëpunimin ndër-institucional në fushën e anti-trafikimit.

### Interesi më i lartë i fëmijës

Parimi i parë dhe kryesor është ai i “interetit më të lartë të fëmijës”. Çdo veprim i kryer ndaj një fëmije trafikuar apo në tërësi veprimtaria në kuadrin e masave kundër trafikimit të fëmijëve, duhet të udhëhiqet nga parimi i “interetit më të lartë” të fëmijës, si parimi kryesor kundrejt të cilit duhet konsideruar çdo vendimmarrje në lidhje me fëmijën.

Në ligjin për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, ky parim spikat në një nen të posaçëm, duke marrë kështu një vlerë të veçantë në raport me parime të tjera mbi të cilat realizohet mbrojtja e fëmijës. Ligji bën dhe një shtjellim të hollësishëm të interesit më të lartë të fëmijës, duke parashikuar se zbatimi i këtij parimi është i detyrueshëm si në nivel hartimi dhe zbatimi të legjislacionit dhe në nivel trajtimi rasti individual, nga çdo institucion publik e jopublik dhe nga gjykatat.



**Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën. Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh:**

- nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri si dhe rritjen/përkatësinë në një familje;
- mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;
- historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;
- aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirëritjen e fëmijës për t’iu përgjigjur nevojave të fëmijës;
- vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore.<sup>85</sup>

<sup>85</sup> Ligji 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, neni 6.



## Mosdiskriminimi

Parim i dytë i rëndësishëm është ai i mbrojtjes nga diskriminimi, i cili merr një rëndësi të veçantë në kontekstin e mbrojtjes së fëmijës së trafikuar, veçanërisht në rastet e fëmijëve që u përkasin pakicave dhe fëmijëve migrantë. Këta të fundit gëzojnë të njëjtat të drejta si fëmijët shqiptarë përsa kohë identifikohen për mbrojtje brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Ky parim i rëndësishëm mishërohet dhe në Ligjin për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, fusha e zbatimit të së cilit, krahas fëmijëve me shtetësi shqiptare, përfshin dhe fëmijët pa shtetësi ose me shtetësi të huaj, që ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë<sup>86</sup>.

## Respektimi i mendimit të fëmijës

Parimi i tretë lidhet me të drejtën e fëmijës për të marrë pjesë, për t'u dëgjuar dhe për t'iu respektuar mendimi gjatë procesit të mbrojtjes. Institucionet publike dhe jopublike që trajtojnë një fëmijë të trafikuar duhet të marrin vendime që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e fëmijës. Në varësi të moshës dhe aftësisë për të kuptuar, fëmija jep mendimin e vet në lidhje me masat mbrojtëse, ku mund të përfshihet dhe mendimi për të qëndruar ose jo me prindërit<sup>87</sup>, vendimi për t'u kthyer ose jo në vendin e origjinës në rastin e fëmijëve që ndodhen jashtë vendit të origjinës jo domosdoshmërisht si viktima trafikimi.

Legjislacioni shqiptar parashikon se për vendosjen e masave të mbrojtjes ndaj fëmijës që ka mbushur moshën 14 vjeç, është e detyrueshme të merret pëlqimi i vetë fëmijës. Në rast se fëmija nuk jep pëlqimin, atëherë marrja e masës së mbrojtjes merret nga drejtori i strukturës përgjegjëse të shërbimeve shoqërore, vendim, i cili është i vlefshëm deri në marrjen e një vendimi gjyqësor nga gjykata për lënien në fuqi, kur për këtë masë përkatëse parashikohet shqyrtimi gjyqësor<sup>88</sup>.



### Parimet e tjera që udhëheqin zbatimin e çdo veprimi që lidhet me fëmijët janë:

- ▶▶ parimi i jetës
- ▶▶ rritja në një mjedis të përshtatshëm familjar
- ▶▶ respektimi i dinjitetit, nderit dhe personalitetit
- ▶▶ e drejta për informacion
- ▶▶ e drejta e ruajtjes së konfidencialitetit
- ▶▶ e drejta për të qenë i mbrojtur

## 4.5 DËMET QË PËSOJNË FËMIJËT E TRAFIKUAR GJATË DHE PAS TRAFIKIMIT

Fëmijët e trafikuar pësojnë dëme fizike dhe psikologjike të rënda në secilën fazë të trafikimit. Sigurisht forma dhe shkalla e dëmit varet nga forma e trafikimit të cilës i nënshtrohet fëmija. Tabela e mëposhtme e hartuar nga UNICEF paraqet situatën fizike, emocionale, psikike të fëmijës së trafikuar.

Shëndeti jo i mirë mendor është një dukuri e zakonshme te viktimat e trafikimit për shkak të traumës dhe abuzimit që kanë përjetuar. Çrregullimi Komplex i Stresit Pas Traumës (CPTSD) mund të ndodhë shpesh si pasojë e trafikimit të qenieve njerëzore. Simptomat kyçe përfshijnë ripërzetimin e ngjarjes/ve traumatike, shmangien e mendimeve/kujtimeve/situatave që sjellin në kujtesë ngjarjen/t dhe perceptimin e vazhdueshëm të kërcënimit të madh.

86 Ligji 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës", neni 4.

87 Ligji 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës", neni 9.

88 Ligji 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës", neni 59.

### Rast praktik për diskutim (i raportuar nga Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës)

L. është një djalë 12 vjeçar, i cili lyp në Tiranë. Prindërit e tij janë të papunë në Tiranë, në kushte shumë të vështira social-ekonomike. Fëmija deklaroi se babai është i dhunshëm dhe se shpesh ai e rreh. Në kohën e identifikimit në situatë rruge, në vitin 2018, ai u gjet në gjendje intoksikimi. Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës u shpreh se ai qëndron në shoqërinë e një mashkulli në moshë madhore, i njohur si trafikues i disa djemve të rinj për qëllime lypjeje. Gjatë një interviste të përbashkët nga policia, shërbimi social shtetëror dhe njësisia e mbrojtjes së fëmijës, L bëhej shumë agresiv sa herë i përmendej familja, duke shfaqur nivele të larta të stresit emocional. Në mënyrë të përsëritur ai kërkonte që familja të mos njoftohej sepse i frikësohej abuzimit fizik që mund të pësonte më pas. Ai nuk donte të kthehej pranë familjes së tij. Autoritetet e klasifikuan si viktimë të mundshme të trafikimit dhe ai u referua për asistencë në shtëpinë e fëmijës në Tiranë. Rasti u referua në Prokurori.<sup>89</sup>

## 4. 6 MBROJTJA E VIKTIMËS SË MITUR GJATË HETIMIT TË VEPRËS PENALE TË TRAFIKIMIT TË FËMIJËVE

Zbatimi i parimit të interesit më të lartë të fëmijës nga ana e prokurorit në ndjekjen penale të veprave të trafikimit të të miturve është i lidhur ngushtësisht me interesin më të lartë të fëmijës gjatë procesit penal. Gjatë analizës së këtij parimi duhet mbajtur parasysh natyra e trefishtë e cilësisë që gëzon i mituri në terma proceduralë:

- ▶▶ Cilësia e tij/saj si dëshmitar;
- ▶▶ Cilësia e tij/saj si viktimë;
- ▶▶ Cilësia e tij/saj si i mitur.

Interesi më i lartë i fëmijës arrihet nëpërmjet gërshetimit dhe harmonizimit të respektimit rigoroz të parashikimeve ligjore procedurale të lidhura me secilën prej cilësive të mësipërme, me aktivitet e tjera jashtëproceduralë të analizuara më lart. Kjo nënkupton ndërtimin dhe funksionimin e njëmendësie të re të punonjësve të drejtësisë që siguron një qasje respekti maksimal ndaj viktimave të mitur si dhe një qasje miqësore dhe e orientuar drejt synimeve për të siguruar një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën, sipas kërkesave të nenit 10 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Qasja e re nënkupton një rol aktiv të prokurorit dhe strukturave të tjera në bashkëpunimin efektiv me organizmat e tjerë shtetërorë apo organizata jofitimprurëse në mënyrë që interesi më i lartë i fëmijës të realizohet efektivisht. Vetëm një qasje e tillë do të mund të sigurojë një situatë sigurie dhe komforti për të miturin dhe kujdestarin e ti ligjor dhe do të shtojë mundësitë për një bashkëpunim në realizimin e funksionit kryesor të prokurorit/gjyqtarit. Çdo veprim apo vendim që do të duhet të ndërmerret dhe që ka lidhje me viktimën e mitur, prokurori detyrimisht do të duhet ta analizojë në raport me sa më sipër dhe me gjithë elementët e tjerë pjesë përbërëse e parimit të interesit më të lartë të fëmijës, të parashikuara në nenin 10 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur. Kjo analizë duhet të bëhet në bashkëpunim me subjekte apo

<sup>89</sup> Rast i trajtuar në Studimin "Tipologji e Trafikimit të Fëmijëve në Shqipëri", Prezenca e OSBEsë 2020. <https://www.osce.org/files/f/documents/f/e/457549.pdf>

organizma të tjerë të përfshirë në mbrojtjen e të drejtave të viktimës së mitur, pas marrjes së mendimit të tij/saj për aq sa mundet të kuptojë, si dhe ta pasqyrojë atë në aktet proceduralë që do të hartojë. Në këtë përpjekje Koordinatori dhe Psikologu i Sektorit të asistencës ndaj subjekteve me status të posaçëm pranë prokurorisë luajnë një rol të rëndësishëm përgjatë gjithë procedimit penal si në vlerësimin e viktimës së mitur dhe në koordinim e aktiviteteve të prokurorit, strukturave të pushteti lokal që merren me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës sikurse Njësia për Mbrojtjen e të Miturit, Grupin teknik Ndërsektorial, shërbimet e ndryshme të domosdoshme për viktimën, qendrat e strehimit të viktimave të trafikut e në tërësi etj.

### Si dëshmitar.

Duke analizuar të drejtat e të miturit në cilësinë e dëshmitarit të cilat do të duhet të mbahen parasysh nga prokurori përgjatë procedimit penal rezulton se me ndryshimet e reja, është synuar të materializohet në rregullime procedurale ILF në to. Kujdesi për të shmangur dëshmitarin e mitur nga riviktimizimi dhe veçanërisht nga viktimizimi i përsëritur është gjithmonë parësor. Në kuadër të cilësisë si dëshmitar, i mituri gëzon të drejtat e mëposhtme:



- Të bashkëpunojë ose jo me drejtësinë duke vlerësuar nëse do të bëjë kallëzim apo do të japë dëshmi.
- Të vlerësojë rrethanat se si do të mund të jepte dëshminë apo të bashkëpunonte me drejtësinë.
- Të mos ketë pasoja nga mosbashkëpunimi me drejtësinë në përfitimin e mbrojtjes apo shërbimeve.
- Të përfitojë mbrojtje nga Ligji Nr. 10173, datë 22.10.2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë” duke u përfshirë në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve.<sup>90</sup>
- Të garantohet për mbrojtjen e të dhënave personale sipas nenit 103/4 të Kodit të Procedurës Penale.
- Të garantohet se të dhënat e përfuara gjatë hetimit apo të deklaruar prej saj nuk do të përdoren për qëllime të tjera që janë të domosdoshme për vërtetimin e akuzës.
- Të përfitojë nga e drejta për moskryerjen e ballafaqimit me autorin sipas nenit 169/2 të Kodit të Procedurës Penale.
- Të përfitojë të drejtën për t’u pyetur në distancë me video konferencë, jashtë seancës apo forma të tjera që fshehin identitetin sipas neni 361 të Kodit të Procedurës Penale.
- Të përfitojë nga e drejta për të patur praninë e prindit ose kujdestarit, ose e një personi të

90 Neni 12 i Ligjit nr. 10173, datë 22.10.2009 “Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë” përfshin në kuadër të programeve të mbrojtjes, një ose disa nga masat e mbrojtjes që zbatohen për personat e mbrojtur si më poshtë:

a) ndryshimi i identitetit;

b) ndryshimi i vendbanimit;

c) dhënia e dokumenteve të rreme;

d) mbrojtja e përkohshme e identitetit, e të dhënave dhe e dokumenteve;

e) dhënia e dëshmisë me një identitet tjetër dhe administrimi me mjete të veçanta për deformimin e zërit a të pamjes së tij dhe forma të tjera të caktuara sipas ligjit, në përputhje me nenin 361/a të Kodit të Procedurës Penale;

dh) mbrojtja fizike dhe teknike në vendin ku qëndron personi, si dhe gjatë lëvizjeve të tij;

e) rehabilitimi social;

ë) dhënia e ndihmës financiare;

f) rikualifikimi profesional;

g) dhënia e këshillave dhe e ndihmës së specializuar ligjore;

gj) çdo masë tjetër, e cila vlerësohet dhe miratohet si e nevojshme në përputhje me këtë ligj.

rritur, të zgjedhur nga i mituri, si dhe të psikologut kur do të janë dëshmi sipas nenit 297/3 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 18 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

- ▶▶ Të kërkojë nëpërmjet përfaqësuesit ligjor sigurimin e dëshmisë sipas nenit 318 të të Kodit të Procedurës Penale.
- ▶▶ Të përfitojë nga e drejta për mosshoqërimin e detyrueshëm në gjykatë apo mosvendosjen e gjobave për mosparaqitje sipas nenit 164/5 të Kodit të Procedurës Penale.
- ▶▶ Të mos publikohen të dhëna për identifikimin e tij.

### Si viktimë

Viktima dhe viktimja e mitur është një subjekt me status të posaçëm në procedimin penal pasi Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur i njohin asaj një mori të drejtash të diferencuara nga subjektet e tjerë. Trajtimi me respekt për dinjitetin e tyre njerëzor dhe mbrojtja nga ridëmtimi, gjatë ushtrimit të të drejtave të parashikuara nga të dy Kodet është detyrim ligjor për autoritetet proceduese.

Të drejtat e viktimës mund të ndahen në të drejta procedurale, sociale dhe të drejta ekonomike.

Në të drejta procedurale përfshihen të drejtat që lidhen me rolin aktiv të saj në ndjekjen penale të autorëve. Në të drejtat sociale përfshihen të drejtat e saj që lidhen me mbrojtjen, shërbimet e nevojshme për rikuperimin dhe riaftësimin shëndetësor si dhe të drejtat për riintegrimin social të saj. Në të drejtat ekonomike përfshihen ato të drejta që synojnë shpërblimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e trafikimit. Janë një mori aktesh ligjorë e nënligjorë të cilat parashikojnë mundësinë për viktimën për të realizuar të drejtat e mësipërme dhe është detyrë e prokurorit që përgjatë procedimit penal ta informojë viktimën për mundësitë e mësipërme.

Viktimat e mitur të trafikimit hyjnë në kategorinë e viktimave veçanërisht vulnerabël e për këtë arsye kujdesi që duhet treguar përgjatë procedimit penal duhet të jetë i veçantë. Është detyrim i prokurorit të sigurohet se këto të drejta i janë garantuar gjatë procesit apo viktimja e mitur dhe përfaqësuesi ligjor është vënë në dijeni të tyre. Të drejta procedurale janë si më poshtë:



- ▶▶ Të kërkojë ndjekjen penale të autorit sipas nenit 58 të Kodi i Procedurës Penale.
- ▶▶ Të marrë letën e të drejtave të viktimës sipas nenit 47 të Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe neni 58/2 i Kodit të Procedurës Penale.
- ▶▶ Të përfitojë nga e drejta e mospasjes së përgjegjësisë penale për vepra të kryera prej saj përgjatë procesit të trafikimit sipas nenit 52/a të Kodit Penal.
- ▶▶ Të komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit.
- ▶▶ Të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor.
- ▶▶ Të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtrojë kërkesa të tjera përpara organit procedues.
- ▶▶ Të thirret në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore.
- ▶▶ Të dëgjohet nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e saj si dëshmitar.
- ▶▶ Të informohet në vijimësi për procedurat që do të ndiqen përgjatë procesit penal.
- ▶▶ Të informohet paraprakisht për një veprim procedural apo vendimmarrje që ndikon për të,

për aq sa nuk cenohet procesi sipas nenit të 34 Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

- Të japë mendimin e vet në lidhje me sa më lart për ndikimin që mendon se mund të ketë veprimi i prokurorit apo oficerëve të policisë gjyqësore.

### Të drejta sociale:



- Të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale sipas nenit 58 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.
- Të përfitojë shërbimet ligjore, shëndetësore etj. pa pagesë sipas nenit 23 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.
- Të përfitojë ndihmë psikologjike pa pagesë sipas nenit 20 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.
- Të përfitojë mbrojtje fizike nga autori apo bashkëpunëtorët sipas nenit 37 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.
- Të vihet në dijeni për lirimin e autorit nga masa e sigurimit sipas nenit 58 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.
- Të pyetet pa vonesë nga një oficer i policisë gjyqësore ose prokuror i të njëjtës gjini kur është viktimë trafikimi.

### Të drejta ekonomike:



- Të kërkojë kompensimin e dëmit duke ngritur padi në procesin penal për kthimin e sendit apo shpërblimin e dëmit sipas nenit 61 Kodit të Procedurës Penale dhe neni 45 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.
- Të kërkojë marrjen e masave të sigurimit pasuror për të garantuar padinë civile sipas neni 63 dhe 270 të Kodit të Procedurës Penale.
- Të përfitojë ndihmë falas për përkthim në rastet se nuk njih gjuhën shqipe sipas neni 123 të Kodit të Procedurës Penale
- Të përfitojë nga fondi për dëmshpërblimin e viktimave të trafikimit sipas parashikimeve në nenin 37/ç të ligjit Nr. 10192/3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë".

### I mitur.

Gëzimi i cilësisë së miturisë së viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore i jep asaj një sërë të drejtash e njëkohësisht detyrime për subjektet që trajtojnë ato në kuadër të procesit penal apo jashtë tij. Të drejtat lidhen kryesisht me ekuilibrimin e pamundësisë së të kuptuarit të situatës apo procedurave që do të zhvillohen për shkak të mospasjes së pjekurisë jetësore, emocionale, ligjore dhe të brishtësisë së tij për shkak të qenies në proces formimi. Këto të drejta mund të përmbledhen:



- ▶▶ Të jenë në praninë e prindit/personit të besuar përgjatë gjithë procesit penal.
- ▶▶ Të përfaqësohet nga personat e përshtatshëm (neni 36 i udhëzimit) të cilët kanë të drejtë të bëjnë kërkesa apo të përfshihen në vendimmarrje që ndikojnë mbi të miturin.
- ▶▶ Të informohet për gjithë ecurinë e procesit, të drejtat dhe mundësinë për të përfituar shërbime, mekanizmat dhe organizmat mbështetëse, mundësinë dhe mjetet për dëmshpërblim sipas nenit 34 Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.
- ▶▶ Të ndihmohet nga një psikolog sipas nenit 297/3 të Kodit të Procedurës Penale dhe neni 18 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.
- ▶▶ Të përfitojë nga ndalimi i publikimit të të dhënave dhe mbrojtja e jetës private sipas nenit 21 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe neni 9/2 i Ligjit 97/2016.
- ▶▶ Të përfitojë ndihmë ligjore e psikologjike falas sipas nenit 20 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

## KREU V



# IDENTIFIKIMI

## 5.1 IDENTIFIKIMI I VIKTIMAVE SI NJË KUSHT PËR HETIMIN E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE.

Problemi i identifikimit të viktimave është shumë i rëndësishëm në luftën kundër trafikimit dhe formave të tjera të shfrytëzimeve të rënda. Viktimat pothuajse asnjëherë nuk mund të identifikohen në mënyrë të menjëhershme si të tillë. Gjithashtu, edhe ndjekja penale e veprës penale të trafikimit nuk fillon pothuajse asnjëherë si e tillë. Shpesh, viktimat e mundshme trajtohen si emigrantë të paligjshëm dhe më pas dëbohen dhe riatdhesohen menjëherë pa asnjë set masash mbi atë se çfarë ndodh më vonë. Prandaj, është shumë e rëndësishme të dallohen mirë kategoritë e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, refugjatët, azilkërkuesit dhe emigrantët ekonomikë.

Identifikimi i trafikimit të qenieve njerëzore nuk është një proces i lehtë. Trafikantët bëjnë përpjekje të konsiderueshme për t'u siguruar që veprimtaritë e tyre të mos zbulohen lehtë. Nuk ka mundësi që të gjitha rastet e trafikimit të jenë të njëjta. Treguesit e trafikimit me shumë gjasë mund të jenë të ndryshëm nga rasti në rast. Identifikimi mund të jetë një proces afatgjatë. Një incident mund të tregojë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme se po ndodh trafikim i personave, por në shumë raste mund të ketë vetëm një apo dy tregues. Zakonisht, ka shumë pak informacion konkret apo shenja të dukshme të trafikimit të qenieve njerëzore. Shpesh, ka vetëm një ndjenjë ngacmuese se jeni përballë një rasti trafikimi. Trafikimi i qenieve njerëzore mund të ngatërrohet lehtë me forma të tjera kriminaliteti si për shembull, kontrabandimi i migrantëve, sulme seksuale apo të thjeshta. Efekti i traumatizimit të viktimave të trafikimit është i tillë sa që ata mund të mos tregojnë asgjë nga situata tyre për javë apo edhe për muaj të tërë.

Viktimat potenciale të trafikimit duhet të konsiderohen si viktimat dhe si rrjedhim nuk duhet të ndiqen penalisht për mungesën e statusit tyre të ligjshëm, mungesën e dokumenteve përkatëse. Identifikimi i viktimave të trafikimit është veçanërisht i vështirë dhe mund të kërkojë kohe, duke konsideruar këtu edhe frikën dhe nënshtrimin e tyre ndaj gjendjes në të cilën ndodhen. Megjithatë, aktorët e mirëinformuar dhe të trajnuar mund të arrijnë të identifikojnë që në një fazë shumë të hershme treguesit që vërtetojnë statusin e një personi si viktimë trafikimi.

Për operatorët e ndryshëm (organet e zbatimit të ligjit dhe punonjësit socialë) ka një seri treguesish. Duhet theksuar se treguesit janë të dobishëm në procesin e identifikimit të viktimave potenciale, por pa trajnime të mira nuk mund të ketë rezultate. Treguesit janë ndihmë, por nuk janë e vetmja rrugë; ata duhet të verifikohen dhe të monitorohen vazhdimisht duke pasur parasysh se fenomenet kriminale janë dinamike. Treguesit kanë në vëmendje tipare etnikë, fetarë, gjinorë, kulturorë, shtetësinë si dhe me karakteristikat e shfrytëzimit. Kështu që treguesit janë të ndryshëm në rastet e shfrytëzimit seksual, punës së detyruar, lypjes, etj.

### 5.1.1 PËRKUFIZIMI I TERMIT VIKTIMË E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Ligji Model kundër trafikimit të personave i Zyrës së Kombeve të Bashkuara për drogën dhe krimin<sup>91</sup> shprehet se “viktimë trafikimi” nënkupton çdo person fizik që ka qenë objekt i trafikimit të personave ose që autoritetet kompetente, duke përfshirë edhe organizatat e shpallura joqeveritare sipas rastit, besojnë në mënyrë të arsyeshme të jetë viktimë e trafikimit të personave, (ose në rastin e Bashkimit Evropian, shtetas të vendeve të treta) ose person pa shtetësi, pavarësisht nëse autori është identifikuar, kapur, ndjekur penalisht apo ndëshkuar.<sup>92</sup>

Neni 4(e) i Konventës së Këshillit të Evropës për Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore shprehet se për qëllime të kësaj Konvente, “viktimë” nënkupton çdo person fizik që është objekt i trafikimit të qenieve njerëzore, sipas përkufizimit në këtë nen. Viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore është kushdo që i nënshtrohet një kombinimi të këtyre elementeve – veprimit, mjeteve, qëllimit. Kur ky person është i mitur, ai ose ajo duhet të konsiderohet viktimë edhe nëse nuk është përdorur asnjë prej mjeteve të specifikuara në përkufizimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Është e rëndësishme të bëhet dallimi mes “viktimave të trafikimit”, “viktimave potenciale” dhe “viktimave të prezumuara”.

- ▶▶ “Viktima të prezumuara” është një term që përdoret përgjithësisht për të përshkruar persona që mund të jenë viktima të trafikimit dhe që duhet për këtë arsye të futen në objektin e përgjithshëm të programeve dhe shërbimeve kundër trafikimit.
- ▶▶ “Viktimë e mundshme e trafikimit”: Individë nga grupe vulnerabël që mund të bëhen viktima të trafikimit të qenieve njerëzore

Identifikimi i hershëm dhe i saktë i individëve si viktima duhet të trajtohet me përparësi, me qëllim që të sigurohet që:

- ▶▶ ata të largohen prej shfrytëzimit, të vendosen nën kujdes të sigurt, të marrin mbrojtje, asistencë dhe mbështetje;
- ▶▶ ata të ndahen nga trafikantët e dyshuar në mënyrë që të shmanget rreziku i intimidimit;
- ▶▶ Rrjetet e trafikimit të identifikohen dhe të çmontohen, dhe autorët e veprave penale të arrestohen dhe ndiqen penalisht; dhe
- ▶▶ Modelet e trafikimit të monitorohen me qëllim përgatitjen e a) programeve parandaluese të efektshme e të targetuara, dhe b) hartimin e strategjisë dhe politikës së efektshme kundër trafikimit.

Çështja e identifikimit është kaq shumë e rëndësishme për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore sa që natyrshëm është përcaktuar në ligj, në nivel ndërkombëtar dhe në nivel kombëtar. Neni 10 i Konventës së Këshillit të Evropës kundër Trafikimit kërkon nga shtetet palë marrjen e masave konkrete për identifikimin e viktimave të trafikimit jo vetëm nga institucionet shtetërore por nëpërmjet përfshirjes së të gjithë aktorëve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këtë fushë. Identifikimi si fillimi i procesit të mbrojtjes së viktimave të trafikimit kërkohet të normohet në akte të brendshme rregullatore të cilat do t’u ofrojnë viktimave mbrojtjen e nevojshme.

91 [https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/2014/UNODC\\_2014\\_Issue\\_Paper\\_Consent.pdf](https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/2014/UNODC_2014_Issue_Paper_Consent.pdf)

92 [https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/UNODC\\_Model\\_Laë\\_on\\_Trafficking\\_in\\_Persons.pdf](https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/UNODC_Model_Laë_on_Trafficking_in_Persons.pdf) faqe 21.



- //////////
- ▶▶ “Çdo Palë do t’u sigurojë autoriteteve të veta kompetente persona të trajnuar dhe të kualifikuar në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore, në identifikimin dhe ndihmën ndaj viktimave, përfshirë fëmijët dhe do të sigurojë që autoritetet e ndryshme bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, si dhe me organizata të ngjashme mbështetëse, në mënyrë që viktimat të mund të identifikohen me një procedurë që merr parasysh situatën e veçantë të viktimave gra dhe fëmijë dhe në raste të përshtatshme, i pajis me lejet e qëndrimit, sipas kushteve të parashikuara në nenin 14 të kësaj Konvente.”
  - ▶▶ “Çdo Palë do të miratojë masa legjislative ose masa të tjera sipas nevojës, për të identifikuar viktimat, si të jetë e përshtatshme në bashkëpunim me Palë të tjera dhe organizata të ngjashme mbështetëse. Secila Palë do të sigurojë që, nëse autoritetet kompetente kanë shkaqe të arsyeshme të besojnë se një person ka qenë viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, ai person nuk do të largohet nga territori i saj derisa autoritetet kompetente të kenë kryer procesin e identifikimit si viktimë e një shkeljeje, të parashikuar në nenin 18 të kësaj Konvente dhe gjithashtu do të sigurojë që personi të marrë ndihmën e parashikuar në nenin 12, paragrafët 1 dhe 2.”
  - ▶▶ Kur moshja e viktimës nuk dihet dhe ka arsye të besohet që viktima është fëmijë, ai ose ajo do të prezumohet të jetë një fëmijë dhe do t’i sigurohen masa të posaçme mbrojtëse, në pritje të verifikimit të moshës së tij/saj.”
  - ▶▶ “Pas identifikimit të një fëmije të parashikuar si viktimë, çdo Palë:

- //////////
- ▶ do të parashikojë përfaqësimin e fëmijës nga një kujdestar ligjor, organizatë ose autoritet ligjor që do të veprojë në emër të interesave më optimale të këtij fëmije;
  - ▶ do të marrë hapat e nevojshëm për të përcaktuar identitetin dhe kombësinë e tij/saj;
  - ▶ do të bëjë çdo përpjekje për të lokalizuar familjen e tij/saj, kur kjo është në interesat më optimale të fëmijës.”

Sipas Zyrës së Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, në Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara për të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Qenieve Njerëzore, mosidentifikimi si duhet i një personi të trafikuar ka gjasë të rezultojë në një mohim të mëtejshëm të të drejtave të atij personi.<sup>93</sup> Kur bëhet vlerësimi nëse një individ është viktimë apo jo, kërkohet vetëm shkaqe të arsyeshme dhe jo provë absolute. Në disa raste, do të jetë e qartë nga informacioni i disponueshëm se personi është viktimë. Në raste të tjera, situata do të jetë më pak e sigurt. Në këto raste, duhet t’i besohet fjalës së personit deri sa të qartësohet statusi i tyre me anë të hetimeve të mëtejshme. Po ashtu, kur nuk është e qartë nëse personi është fëmijë (nën moshën 18 vjeç), duhet të trajtohet si i tillë deri sa të përcaktohet moshja e saktë. Në rastet e trafikimit të personave për qëllime të shfrytëzimit seksual, janë parë edhe raste të “shpëtimit nga klientët”. Një shembull i shpëtimit nga klientit është kur një burrë paguan për marrëdhënie seksuale me një femër dhe ajo i tregon atij se është e trafikuar.

<sup>93</sup> Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara për të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Qenieve Njerëzore, Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, Udhëzimi 2. <https://www.ohchr.org/documents/publications/traffickingen.pdf>

Identifikimi i viktimave të trafikimit nuk është objekt veprimtarie vetëm i Policisë apo i ndonjë agjencie tjetër ligjzbatuese, pasi trafikimi i qenieve njerëzore është një krim i rëndë, shpesh lidhet me krimin e organizuar, ndaj është e nevojshme që oficerët ligjzbatues të jenë në gjendje të identifikojnë një viktimë trafikimi në të njëjtën mënyrë që ata janë në gjendje të identifikojnë forma të tjera kriminaliteti.

## 5.2 IDENTIFIKIMI I VIKTIMËS SË MUNDSHME OSE VIKTIMËS SË TRAFIKIMIT NË SHQIPËRI

Në legjislacionin shqiptar, treguesit e trafikimit shtjellohen hollësisht në dokumentin e Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 499, datë 29.8.2018.

Në bazë të këtyre procedurave, procesi i identifikimit të një viktime trafikimi kalon në dy faza kryesore, faza e identifikimit të hershëm apo fillestar dhe faza e identifikimit formal apo zyrtar:



- ▶▶ **Faza 1:** Personi apo institucioni i parë që bie në kontakt me personin zakonisht “ndërmerr një veprim” gjatë një bisede apo interviste të shkurtër me viktimën e mundshme të trafikimit dhe bën një vlerësim të treguesve të trafikimit të qenieve njerëzore që përshkruhen në Procedurat Standarde të Operimit që vënë në lëvizje Mekanizmat Kombëtar të referimit.
- ▶▶ **Faza 2:** Nëse ka një ose më shumë tregues të trafikimit të qenieve njerëzore, struktura e parë që ka identifikuar viktimën e mundshme të trafikimit duhet të veprojë në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit, duke njoftuar autoritetet, si p.sh. policinë, shërbimet sociale dhe/ose punonjësën e mbrojtjes së fëmijëve në rastin e personave të mitur.

Me qëllim që të zgjerohet mundësia e kontaktit dhe të përshpejtohet aksesi i një viktime tek ndihma, identifikimi fillestar i fazës së parë i është ngarkuar një numri të madh institucionesh dhe agjencish. Këto agjenci apo institucione mund të arrijnë në konkluzionin se një person është viktimë e mundshme e trafikimit duke u mbështetur në tregues të identifikimit dhe duke zhvilluar një intervistë të thjeshtë që quhet intervista fillestare. Viktimë “e mundshme” ka kuptimin që “të gjitha të dhënat të tregojnë se personi është i/e trafikuar”.

Identifikimi formal apo zyrtar i është ngarkuar vetëm një grupi të kufizuar *ad hoc* të përbërë gjithmonë nga një punonjës i policisë antitrafik dhe një punonjës social i drejtorisë rajonale të shërbimit social shtetëror në rastin kur personi që mund të jetë trafikuar është i rritur ose një punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve kur personi që mund të jetë trafikuar është fëmijë.

Procesi në vetvete nuk është thjesht një veprim burokratik, por shoqërohet me marrjen e masave konkrete në lidhje me rastin, siç shprehet dhe në vetë formulimin e konceptit ku fjala “reagim” shoqëron fjalën identifikim. Masat reaguese, pra ndjekja e rastit me hapa konkrete kryesisht të orientuara drejt asistencës fillestare janë të domosdoshme veçanërisht në çështjet e trafikimit të fëmijëve, ku marrja e menjëhershme në mbrojtje e fëmijës që është në një situatë rreziku, pavarësisht nëse më vonë zbulohet që është ose jo viktimë trafikimi, është parimi që duhet të udhëheqë vendimmarrjen e çdo profesionisti në një rast të mundshëm trafikimi të fëmijës. Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore shpesh nuk duan që ta bëjnë të ditur historinë dhe eksperiencën e tyre para autoriteteve shtetërore për disa arsye:

- Kërcënimet për dhunë nga trafikantët
- Frika nga hakmarrja e dhunshme e trafikantëve ndaj atyre vetë dhe familjarëve të tyre
- Mungesa e besimit tek autoritetet zyrtare
- Viktimat e huaja mund t'i druhen deportimit për shkak të statusit të tyre ligjor.

Identifikimi i një viktime trafikimi priorizon dhënien e ndihmës pa vënë kushte që viktima të ketë kontakt me autoritetet e zbatimit të ligjit, e të bashkëpunojë për hetimin dhe ndjekjen penale të trafikantëve.

Procedurat Standarde të Veprimit cilësojnë si “Identifikim dhe reagim fillestar” tërësinë e veprimeve të ndërmarra nga punonjësit e institucioneve shtetërore dhe joshtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e personave të trafikuar në kufijtë dhe brenda territorit të RSH-së, si të institucioneve vendore, ashtu edhe qendrore që bën të mundur përcaktimin se një person i/e mitur apo i/e rritur është viktimë e mundshme e trafikimit të personave.

Identifikimi i viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore është vendimtar me qëllim që atyre t'u jepet mbrojtja dhe asistenca e nevojshme, si dhe të mbështeten gjatë procesit të ndjekjes penale dhe gjykimit, duke siguruar dëshmitarët e nevojshëm në procedimin penal. Identifikimi korrekt i viktimave të trafikimit shërben para se gjithash për sigurinë dhe të drejtat e marrjen prej tyre të asistencës së nevojshme. Identifikimi mund të garantojë edhe akses në drejtësi për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, pasi çuarja në një numër më të madh hetimesh penale mund të ndihmojë edhe në zbulimin e krimeve të tjera të kryera nga trafikantët. Identifikimi i duhur i viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore mbetet metoda kryesore e identifikimit të veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore. Procesi i identifikimit është i pavarur nga çdo procedim penal ndaj personave përgjegjës për trafikimin

## 5.3 IDENTIFIKIMI I FËMIJËS VIKTIMË E TRAFIKIMIT

Një prej aspekteve kryesore të parimit të mbrojtjes së të drejtave të fëmijës në çështjet e trafikimit është identifikimi i shpejtë dhe i saktë i tyre si viktima të trafikimit dhe sigurimi i mbrojtjes së menjëhershme. Identifikimi i një të mituri viktimë e trafikimit ose viktimë e mundshme e trafikimit është një proces i gjatë dhe kompleks për shkak të natyrës komplekse që ka ky krim dhe ndërveprimet të disa personave. Identifikimi mund të bëhet nga strukturat e policisë, punonjësit socialë, etj, bazuar në një sërë treguesish, si në rastin e të rriturve dhe procedurash zyrtare si përsa i përket identifikimit dhe referimit të rastit. Procesi i identifikimit bazohet në treguesit e trafikimit, të cilët janë elemente përshkruese të procesit të trafikimit dhe reflektojnë paraqitjen e efekteve/pasojave të trafikimit tek i mituri.

Treguesit e trafikimit në vetvete nuk janë prova se trafikimi është kryer si vepër penale, por konsiderohen si pikënisje për hetime të trafikimit. Treguesit e trafikimit i shërbejnë kryesisht strukturave që kanë ballafaqimin e parë me një viktimë të mundshme trafikimi dhe duhet t'i zbërthejnë këta tregues për të kryer identifikimin e një viktime trafikimi dhe/ose për të nisur hetimin e rastit. Njohja me treguesit e trafikimit dhe procesin e identifikimit fillestar të viktimës së trafikimit mund t'i shërbejë punonjësve të sistemit të drejtësisë për të kryer veprime më të thelluara në lidhje me çështjen dhe nëse përbën një rast trafikimi.

Sipas dokumentit të Treguesve të Trafikimit të Qenieve Njerëzore të përgatitur nga Agjencia e Kombeve të Bashkuara mbi Drogën dhe Krimet treguesit kryesorë në rastin e fëmijëve të trafikuar janë si më poshtë:

- ▶▶ fëmijët janë shkëputur nga prindërit ose kujdestarët e tyre
- ▶▶ fëmijët janë të frikësuar dhe sillen në mënyra që nuk korrespondojnë me sjelljen tipike për fëmijët në moshën e tyre
- ▶▶ fëmijët nuk kanë shokë bashkëmoshatarë të tyre jashtë ambientit ku gjenden.
- ▶▶ fëmijët nuk janë në shkollë
- ▶▶ fëmijët nuk kanë kohë për të luajtur
- ▶▶ fëmijët jetojnë pa prani fëmijësh të tjerë dhe në kushte banimi jo të përshtatshme
- ▶▶ fëmijët ushqehen veçmas anëtarëve të tjerë të “familjes” së tyre
- ▶▶ U jepen për të ngrënë vetëm ushqime të mbetura nga konsumimi i të tjerëve
- ▶▶ fëmijët janë të angazhuar në punë që nuk janë të përshtatshme për fëmijët
- ▶▶ Udhëtojnë të pashoqëruar nga të rritur
- ▶▶ Udhëtojnë në grup me persona që nuk janë të afërm të tyre<sup>94</sup>

Interesi më i lartë i fëmijës prevalon mbi balancimin e interesave të procesit të drejtësisë, identifikimin dhe sjelljen e trafikantëve para drejtësisë.. Siguria e tyre nuk duhet të vihet asnjëherë në rrezik nga veprimet e organeve të zbatimit të ligjit dhe statusi i tyre si viktimë duhet të garantohet e përmbushet. Fëmijët nuk duhet në asnjë rast të diskriminohen për shkak të statusit të tyre ligjor në vendin ku realizohet procesi i drejtësisë, shtetësisë, natyrës së veprës penale, etj.

Sipas ligjit janë disa struktura që kanë detyra të posaçme në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve, në mënyrë të veçantë:

- ▶▶ Agjencia për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;
- ▶▶ Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës.

Në bazë të Kodit të Drejtësisë Penale për të mitur dhe legjislacionit për mbrojtjen e fëmijëve, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës luan një rol thelbësor në çdo rast kur fëmija bëhet viktimë e veprës penale. Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës funksionon në çdo bashki dhe ka për detyrë të posaçme, parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje. Është Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës në bashki struktura që harton dhe përshtat, një herë në vit, listën e përfaqësuesve proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktimë dhe dëshmitarë në procesin penal dhe ia dërgon atë strukturave vendore të Policisë së Shtetit, Prokurorisë dhe gjykatës së rrethit gjyqësor e të apelit përkatës.<sup>95</sup>

<sup>94</sup> [https://www.unodc.org/pdf/HT\\_indicators\\_E\\_LOWRES.pdf](https://www.unodc.org/pdf/HT_indicators_E_LOWRES.pdf)

<sup>95</sup> Ligji 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”.

Lista e përfaqësueseve e përfaqësuesve proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktimë dhe dëshmitarë në procesin penal përgatitet dhe rishikohet çdo vit nga ana e Njesisë për mbrojtjen e fëmijës në bashki dhe dërgohet çdo vit pranë strukturave vendore të Policisë së Shtetit, Prokurorisë dhe gjykatës së rrethit gjyqësor e të apelit përkatës. Njësia për mbrojtjen e fëmijës funksionon pranë bashkisë si njësi e posaçme brenda strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie dhe ka detyrë të posaçme, parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje.


Nëse rastet kur fëmija nuk ka prind apo kujdestar, punonjësi i policisë vë në dijeni Njësinë për mbrojtjen e fëmijëve dhe organizatat e shoqërisë civile për të drejtat e fëmijëve.<sup>96</sup>

Sipas UNICEF, masat proaktive për identifikimin e fëmijëve viktimë trafikimi përfshijnë:<sup>97</sup>

- Procedura efektive për identifikimin e shpejtë të fëmijëve viktimë
- Bashkërendimi dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet strukturave shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile;
- Procedura të posaçme në kufi dhe brenda territorit për identifikimin e fëmijëve viktimë nga ana e policisë;
- Njoftimi i menjëhershëm i organeve të policisë nga shërbimet shoqërore, shëndetësore dhe arsimore, si dhe organizatat e shoqërisë civile, që kanë informacion ose dyshim se një fëmijë është në rrezik apo është i shfrytëzuar ose i trafikuar.

Si në rastin e të rriturve, treguesit e trafikimit të fëmijëve gjenden në dokumentin e Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 499, datë 29.8.2018.

Fazat e identifikimit së viktimës së mitur të trafikimit:



<sup>96</sup> Neni 101 pika 2 ligji nr. 108/2014 "Per Policinë e Shtetit"

<sup>97</sup> Përshtatur nga UNICEF "Reference Guide on Protecting the Rights of Child Victims of Trafficking in Europe", 2004.


**Udhëzimi i posaçëm i Prokurorit të Përgjithshëm, “Për garantimin e ndihmës për viktimat dhe dëshmitarët e krimeve”, nr. 05, datë 26.10.2018.**

Sipas nenit 15 të Udhëzimit prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë janë të detyruar nga ligji dhe udhëzimi të identifikojnë viktimat e krimit, t'i njoftojnë për të drejtat dhe t'u ofrojnë asistencën e përshkruar në këtë udhëzim duke mbajtur parasysh gjithsesi se viktima nuk është e detyruar t'i ushtrojë të drejtat e saj apo ta pranojë këtë asistencë dhe mund të zgjedhë, në çdo fazë të procedimit penal, të refuzojë marrjen e asistencës ose ushtrimin e të drejtave.

**Çështje për diskutim**

**Udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm nuk ka fuqi formale detyruese për prokurorët e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. A ka nevojë për rregullim të ngjashëm për viktimat e veprave penale në juridiksionin e krimit të organizuar?**

## KREU VI



# HETIMI DHE NDJEKJA PENALE

## 6.1 OBJEKTI I HETIMIT DHE NDJEKJES PENALE

### 6.1.1 HETIMET PROAKTIVE DHE BAZUAR NË TË DREJTAT E VIKTIMËS

Hetimi dhe ndjekja penale duhet të orientohen ndaj kategorive të personave të përmendur në nenet 18 - 22 të **Konventës së Këshillit të Evropës për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore**, si vijon:

- ▶▶ personat që kanë kryer veprën penale të trafikimit të qenieve njerëzore (neni 18)
- ▶▶ personat që kanë përdorur shërbimet e viktimës (neni 19)
- ▶▶ personat që kanë kryer vepra penale në lidhje me udhëtimin dhe dokumentet e identitetit me qëllim mundësimin e trafikimit (neni 20)
- ▶▶ personat që kanë tentuar apo që kanë ndihmuar ose bashkëpunuar për vepra të tilla penale (neni 21)
- ▶▶ personat juridikë nën përgjegjësinë e një korporate (neni 22)

Kuadri ligjor ndërkombëtar përcakton të drejtat dhe liritë themelore, të cilat i detyrojnë shtetet që të hetojnë shkeljet dhe të ofrojnë zgjidhje ligjore. Llojet e veprave penale që shoqërojnë trafikimin e qenieve njerëzore, si krimet e rënda dhe të dhunshme seksuale, si dhe krimet e shfrytëzimit ekonomik dhe skllavërisë përbëjnë pothuajse gjithmonë shkelje të të drejtave të njeriut. Shtetet kanë detyrimin t'i mbrojnë njerëzit nga shkeljet e të drejtave të njeriut dhe të hetojnë në mënyrë efektive abuzimet me të drejtat e njeriut. Ky detyrim vlen veçanërisht për personat më vulnerabël, në rastet kur ka pretendime të besueshme se një individ ka qenë i sëmurë rëndë ose i është nënshtruar një trajtimi çnjerëzor ose degradues ose është bërë objekt i skllavërisë ose punës së detyruar, i është privuar liria apo i është nënshtruar shkeljeve të rënda kundër të drejtës për jetë private dhe familjare. Organet e zbatimit të ligjit dhe prokuroria hetimit dhe ndjekjes penale të rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore.

Hetimi dhe ndjekja penale efektive e bazuar në respektimin e të drejtave të njeriut është vendimtar për:

- ▶▶ Parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore;
- ▶▶ Dekurajimin e kërkesës për trafikim;
- ▶▶ Identifikimin, ndihmën dhe mbrojtjen e viktimave;
- ▶▶ Ofrimin e dëmshpërblimeve dhe asistencës ligjore për viktimat;
- ▶▶ Ndëshkimin e trafikantëve.

Në instrumentet ndërkombëtare, si neni 27 i Konventës së Këshillit të Evropës për Masat kundër Trafikimit

të Qenieve Njerëzore, apo neni 9 i Direktivës së BE-së 2011/36, etj. theksohet se hetimi dhe ndjekja penale e trafikimit të qenieve njerëzore nuk duhet të varet nga denoncimi i viktimës. Hetimet e veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore nuk duhet të jenë vetëm reaguese, por kryesisht proaktive. Deklarimet e viktimave ofrojnë prova vendimtare në çdo hetim të trafikimit të qenieve njerëzore dhe në procedimet penale. Megjithatë, profesionistët e fushës së drejtësisë vlerësojnë se të bazuarit e gjykimeve ndaj autorëve tek bashkëpunimi i viktimave mund të përbëjë një rrezik për shumë arsye.

Për këtë arsye, thëniet e viktimave duhet të mbështeten me prova të tjera, pasi p.sh., deklaratimet e tyre mund të mos jenë të mjaftueshme për të vërtetuar qëllimin kriminal apo për të ekspozuar të gjithë zinxhirin e aktivitetëve të trafikimit (viktimat shpesh “shohin” vetëm një pjesë të vogël të zinxhirit të trafikimit).

Numri i vogël i hetimeve proaktive të trafikimit të qenieve njerëzore mund të shpjegohet me disa arsye:



- Mungesa e përvojës dhe njohurive të specializuara për hetimin e rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore (për shembull hetimet e infiltuara përdoren rrallë në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore, pasi kërkojnë ekspertizë specifike).
- Në shumë shtete, agjentët e infiltuar nuk lejohen që të nxisin të dyshuarit për të kryer vepra penale të ndryshme nga ato për të cilat hetohen.
- Përdorimi i dorëzimeve të kontrolluara parashikohet në teori, por në praktikë është rrallë i pranueshëm në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore; kjo teknikë ka shumë gjasa që t'i vendosë viktimat në rrezik.
- Teknikat e posaçme të hetimit paraqesin disa kufizime: ato kërkojnë periudha të gjata kohe (gjatë të cilave vazhdon situata e paligjshme në dëm të viktimave) dhe një masë të vazhdueshme burimesh.

Megjithatë, nevojitet një ndryshim i mentalitetit, ndërkohë që hetimet proaktive duhet të bëhen të zakonshme në hetimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Përveç kësaj, edhe pse interneti po përdoret gjithmonë e më shumë si një mjet për rekrutimin e viktimave dhe për reklamimin e shërbimeve seksuale, shërbimeve të punës dhe shërbimeve të tjera, janë të pakta vendet që e përdorin atë për të mbledhur prova të mëtejshme, si p.sh. duke monitoruar dhomat e chat-it, ku bëhen transaksionet seksuale. Gjithashtu duhet mbajtur parasysh se teknikat e posaçme të hetimit, si survejimi dhe përgjimi i telefonave përdoren ende rrallë në hetimet e trafikimit të qenieve njerëzore; edhe pse flitet në takime dhe seminare për rëndësinë e tyre, ato ende nuk përdoren shpesh.

Referenca e parë ndaj hetimit proaktiv gjendet në nenin 20 të Konventës për krimin e organizuar për Teknikat e posaçme të hetimit. Neni 20, paragrafi 1 i Konventës për krimin e organizuar trajton specifikisht teknikat hetimore:



- Dorëzimet e kontrolluara (edhe pse për arsye etike dhe duke qenë shqetësimi kryesor për sigurinë e viktimave reale apo viktimave potenciale, dorëzimet e kontrolluara mund të mos jenë të përshtatshme në rastin e trafikimit të personave).
- Format elektronike dhe format e tjera të survejimit.
- Operacionet e infiltrimit.

Neni 20, paragrafi 2 i nxit shtetet që të lidhin marrëveshje të përshtatshme dypalëshe ose shumëpalëshe për përdorimin e teknikave të posaçme të hetimit në kontekstin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Njëkohësisht



paragrafi 3 thekson se në mungesë të marrëveshjeve të tilla, duhet të ndërmerren vendime për përdorimin e teknikave të posaçme të hetimit në nivel ndërkombëtar rast pas rasti si dhe të merren parasysht masat financiare e mirëkuptimi sa i përket ushtrimit të juridiksionit nga shtetet palë. Këto teknika janë të dobishme sidomos kur bëhet fjalë për grupe të sofistikuara të krimit të organizuar, për shkak të rreziqeve dhe vështirësive në mbledhjen e provave gjatë ndjekjes penale (përmes edhe ofrimit të ndihmës ligjore reciproke shteteve të tjera palë). Në shumë raste, metoda të tjera më pak intruzive ose nuk rezultojnë efikase ose nuk mund të kryhen pa risqet që ato përfshijnë. Nga ana tjetër, sot në epokën e internetit grupet e sofistikuara kriminale përdorin teknologjinë dhe lënë edhe gjurmë në të. Interneti po përdoret gjithmonë e më shumë si një mjet për rekrutimin e viktimave dhe për reklamimin e shërbimeve seksuale ose shërbimeve të tjera shfrytëzuese; për shembull, monitorimi i dhomave të chat-it ku bëhen marrëveshje transaksionesh seksuale ose faqet e internetit ku kërkohen shërbime pune mund të sigurojë të dhëna të rëndësishme për hetimin e veprave të trafikimit. Disa metoda të vlefshme janë përmbledhur në vijim.

### Survejimi elektronik

Survejimi elektronik në formën e pajisjeve monitoruese ose përgjimit të komunikimeve përmbush një funksion të ngjashëm me operacionet e infiltruara dhe është shpesh mënyra e preferuar, aty ku infiltrimi fizik do të përbente një rrezik për hetimin apo për sigurinë e hetuesve. Duke pasur parasysht natyrën e tij, survejimi elektronik i nënshtrohet përgjithësisht një kontrolli të rreptë gjyqësor për parandalimin e abuzimeve. Organet ligjzbatuese duhet të kenë gjithmonë parasysht se trafikantët shpesh janë në dijeni të teknikave të survejit. Survejimi duhet të kryhet me shumë kujdes dhe në mënyrë kreative.

Regjistrimi i komunikimeve telefonike, përgjimet ambientale që kryhen në godina publike, transport, vende pune, përgjimi i email-eve, videove, survejime me GPS, janë mënyra të mundshme survejimi. Nga ana tjetër, siç u theksuar më sipër, Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (ICT) janë një instrument në përdorim në rritje për të rekrutuar, për të transferuar, menaxhuar, shfrytëzuar viktimat si dhe për shkëmbim parash. Nëpërmjet këtyre formave të reja kapaciteti kriminal i organizatave kriminale rritet dhe fiton strukturën tipike të krimit të organizuar mafioz. Rrjedhimisht hetimet dixhitale duhet të ecin në të njëjtin hap me aktivitetin e trafikantëve. Në të gjithë botën, po zhvillohet një debat i rëndësishëm në lidhje me mundësinë e përdorimit të pajisjeve përgjuese kompjuterike si software të vendosur në sistemin operativ të çdo pajisjeje dixhitale, duke pasur mundësi që të aksesojë atë sistem, të kontrollojë audiot, duke e kthyer kështu në një përgjim klasik, por duke qenë në gjendje që të lokalizojë dhe të gjurmtojë personin ose të mbledhë çdo lloj informacioni që lidhet me të, email-et apo mesazhe private në rrjetet sociale.

Instalimi i përgjuesve të tillë mund të bëhet në terren ose në distancë. Përdorimi i këtyre mjeteve duhet të inkurajohet dhe të zbatohet, duke u kujdesur rigorozisht për respektimin e të drejtave themelore të individëve përmes kontrollit gjyqësor efikas të përdorimit të tyre.

### Përdorimi i informatorëve

Informatorët janë persona që i japin informacion policisë për krime të ndryshme. Ata mund të jenë anëtarë të zakonshëm të publikut, viktima të një krimi, apo oficerë policie. Në hetimin e trafikimit të personave, informatorët mund të përdoren për të dhënë informacione për:



- ▶▶ Strukturën dhe natyrën e organizatave kriminale
- ▶▶ Nëse viktima potenciale të trafikimit ndodhen në ambiente të caktuara

- ▶▶ Kur viktimat transferohen nga një vend në tjetrin dhe lidhur me destinacionin e tyre
- ▶▶ Qarkullimin e parave të trafikimit të personave (sa para paguhen, kujt i paguhen paratë dhe ku shkojnë ato?)
- ▶▶ Çështje të tjera që lidhen me krimin e trafikimit

Procesi i trafikimit përfshin shumë persona. Rrjetet janë shpesh të mëdha dhe trafikantët mund të hyjnë në kontakt me shumë njerëz; secili prej këtyre personave mund të jetë një informator potencial. Megjithatë, në rekrutimin dhe përdorimin e informatorëve, duhet të mbahet parasysh siguria e informatorëve dhe çdo rrezik që mund të përbëjnë ata ndaj viktimave reale dhe viktimave të mundshme të trafikimit. Mbrojtja e identitetit të informatorëve është e një rëndësie thelbësore. Në përzgjedhjen dhe përdorimin e informatorëve, duhet të merret parasysh edhe kujdesi në vlerësimin e informacionit që përcillet tek oficerët e policisë; disa prej këtyre informacioneve mund të përcillen jo gjithmonë për arsyet e duhura, mund të jenë madje edhe paragjyquese për suksesin e operacioneve të zbatimit të ligjit. Disa motive joetike etj. mund t'i çojnë informatorët dhe informacionet që ata ofrojnë në diskreditimin e tyre në gjykatë, duke cenuar kështu ndjekjen e suksesshme penale. Kjo është edhe arsyeja pse pesha e deklarimeve të informatorëve nuk duhet të theksohet më shumë sesa duhet e çdo informacion duhet të filtrohet e mbështet me burime të tjera të ligjshme.

### Operacionet e infiltuara

Operacionet e infiltuara mund të përdoren në rastet kur një agjent i forcave të zbatimit të ligjit apo një person tjetër mund të infiltrohet në një organizatë kriminale për të mbledhur prova. Operacionet e infiltuara duhet të kryhen vetëm nga staf i mirëtrajnuar dhe me eksperiencën e duhur. Siguria e agjentëve të infiltuar përbën një parim jashtëzakonisht të rëndësishëm në planifikimin dhe zhvillimin e operacioneve të infiltuara. Ashtu sikurse me të gjitha teknikat e hetimit, rreziqet me të cilat përballen agjentët, viktimat dhe familjet e tyre duhet të merren parasysh në planifikimin e këtyre operacioneve dhe në çdo hap të ekzekutimit të tyre.

## 6.1.2 HETIMI FINANCIAR

Hetimi financiar luan një rol vendimtar në hetimin e suksesshëm të trafikimit të personave. Duhet të ketë një koordinim me zyrat që kryejnë hetimin financiar sa më herët që të jetë e mundur për ta bërë këtë pjesë të ndjekjes penale kundër trafikimit. Kjo është kërkesë edhe e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, nenet 7, 12, 14. Kapaciteti i agjencive të zbatimit të ligjit për identifikimin, hetimin, kapjen dhe konfiskimin e aseteve që rrjedhin nga trafikimi i qenieve njerëzore është shtylla kryesore e masave kundër trafikimit. Forcimi i këtij kapaciteti ndihmon në ndryshimin e perceptimit të trafikimit të qenieve njerëzore si një aktivitet me fitime të larta dhe me risk të ulët.

Trafikimi i qenieve njerëzore, si dhe kalimi i paligjshëm i emigrantëve kryhen me qëllim përftimin e fitimeve të larta. Me qëllim parandalimin e grupeve kriminale, aktivitete si gjurmimi, gjetja e vendndodhjes, ngrirja, konfiskimi, menaxhimi dhe kthimi i aseteve etj, kanë të rëndësishme që të zhvillohen në këtë proces. Ato janë komplekse dhe të vështira për t'u kryer, sidomos për shkak se komponenti ndërkufitar kërkon përfshirjen e dy ose më shumë juridiksioneve me legjislacion material dhe procedural të ndryshëm. Prokurorët mund të gjenden para shumë vështirësive, si p.sh. me ato që kanë të bëjnë me ekspertizën dhe burimet, mungesën e regjistrave të centralizuar bankarë dhe bazave qendrore të të dhënave në disa vende, transferimin e aseteve dhe pastrimin e parave, problemet me pranueshmërinë e provave në gjykatë sipas rregullimeve të ndryshme procedurale penale.

Duke iu referuar Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, nenet

përkatëse për hetimin financiar përfshijnë:



- Nenin 6 për parashikimin si vepër penale të pastrimit të të ardhurave të krimit;
- nenin 7 për masat në luftën kundër pastrimit të parave;
- nenin 12 për konfiskimin e asetëve;
- nenin 13 për bashkëpunimin ndërkombëtar me qëllim konfiskimin;
- nenin 20 për teknikat e posaçme të hetimit.

Ka gjithashtu një sërë dokumentesh ligjore të Bashkimit Evropian që trajtojnë çështjet lidhur me pastrimin e parave. Mes tyre, direktiva 2014/24/BE për ngrirjen dhe të ardhurat e konfiskuara të krimit është një ndër dokumentet e fundit, e cila nxit:



- gjurmimin e të ardhurave të krimit
- rezervimin e asetëve të identifikuar në pritje të një urdhri nga gjykata
- marrjen e urdhrit të konfiskimit dhe zbatimin e tij.

Rol të rëndësishëm luan asistenca e ndërsjellë juridike, në raste kur asetet ndodhen jashtë juridiksionit të një vendi. Gjithashtu, edhe Direktiva e BE-së kundër trafikimit u kërkon shteteve anëtare që të marrin masat e nevojshme për t'u garantuar që autoritetet kompetente të kenë të drejtë të konfiskojnë instrumentet dhe të ardhurat nga krimi i trafikimit të qenieve njerëzore dhe veprat penale që lidhen me të.

Përdorimi i hetimeve financiare për qëllime edhe të dëmshpërblimit të viktimave trajtohet edhe nga Konventa e Këshillit të Evropës kundër Trafikimit sipas së cilës asetet e konfiskuara mund të konvertohen për dëmshpërblimin e viktimave ose për ngritjen e fondeve kombëtare me synim integrimin social të viktimave dhe dëmshpërblimin e tyre. Neni 15 i Konventës thekson se secila palë duhet të miratojë masa legjislative ose masa të tjera sipas nevojës për garantimin e dëmshpërblimit të viktimave në përputhje me kushtet e parashikuara në të drejtën e brendshme, si p.sh. përmes ngritjes së një fondi për dëmshpërblimin e viktimave ose marrjes së masave ose programeve me synim asistencën sociale dhe integrimin social të viktimave, që mund të financohet me asetet që vijnë si rrjedhojë e masave të marra në kuadrin e nenit 23.



#### **Veprime të rekomandueshme:**

- hetimet financiare duhet të nisin në një fazë të hershme bashkë me hetimin penal;
- përdorimi i teknikave të tjera të hetimit, si përgjimi i telekomunikimeve në mbështetje të hetimeve financiare. Edhe hetimet e përbashkëta mund të jenë një mënyrë e kryerjes së hetimeve financiare;
- përdorimi i të gjitha mbështetjeve administrative nga institucionet private dhe publike;
- përdorimi i të gjitha mekanizmave të bashkëpunimit ndërkufitar financiar dhe policor;
- përfshirja e institucioneve rajonale (p.sh. Eurojust) si një lehtësues kyç në bashkëpunimin gjyqësor ndërkufitar.

## 6.2 BASHKËPUNIMI ME AGJENCITË E TJERA PËR HETIMIN

### DHE NDJEKJEN PENALE

Përveç qasjes ndërsektoriale dhe metodologjisë së bazuar tek të drejtat e njeriut, si shtyllat kryesore të hetimit të trafikimit të qenieve njerëzore është e rëndësishme që njësitë e hetimit të posaçëm dhe shërbimi i prokurorisë të punojnë ngushtësisht me agjenci të tjera relevante, pasi bashkëpunimi ndërsektorial përbën një vlerë kyçe në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Në të njëjtën kohë, organizata të shoqërisë civile duhet të jenë partnerë të përhershëm të organeve të zbatimit të ligjit.

Një shembull i qartë vjen nga ndjekja e rasteve të shfrytëzimit për punë, ku bashkëpunimi me inspektorët e punës është i një rëndësie të jashtëzakonshme.

Përveç kësaj, hetimi efikas kërkon shpesh prova të marra nga një gamë ekspertësh në fusha të ndryshme për shkak të kompleksitetit të trafikimit të qenieve njerëzore, origjinën e ndryshme të trafikantëve dhe të viktimave, llojin e shfrytëzimit, etj.

P.sh. ndërmjetësit kulturorë dhe ekspertët janë thelbësorë për ofrimin e qartësisë të kontekstit në raste të posaçme. Të kuptuarit e vendit nga vijnë viktimat dhe e kulturës së tyre mund të kontribuojë shumë në procesin e hetimit. Po ashtu, ekspertët nga fusha e mjekësisë janë ndihmë për të verifikuar pretendimet për keqtrajttime apo abuzime. Sistemi i kujdesit shëndetësor duhet të përfshihet gjithashtu për qëllime të identifikimit dhe dhënien e asistencës viktimave të trafikimit, si dhe për të mundësuar prova të dhunës dhe të keqtrajtimit. Në fushën e shëndetësisë, ekspertët e psikologjisë duhet gjithashtu të përfshihen jo vetëm për të përcaktuar pasojat që një vepër penale ka pasur mbi viktimën, por edhe për të vërtetuar rrethana para trafikimit që mund t'i kenë bërë viktimë shënjestra të trafikantët apo që mund të ketë kontribuar në sjelljen e tyre gjatë rekrutimit dhe shfrytëzimit.

Së fundmi, puna e ekspertëve mjekoligjorë është e rëndësi të lartë për mbledhjen e çdo materiali apo prove në skenën e krimit, gjurmët shkencore, etj, të cilat duhet të administrohen me kujdes dhe sipas rregullave procedurale përkatëse.

## 6.3 VIKTIMA NË QENDËR TË VEPRIMEVE NË LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT

Është e pamundur që trafikimi i qenieve njerëzore të luftohet në mënyrë efektive pa një mbrojtje të të drejtave të njeriut të personave të trafikuar. Edhe nga këndvështrimi hetimor, personat e trafikuar duhet të jenë në qendër të veprimeve kundër trafikimit, pikërisht sepse janë viktimat e një shkeljeje të rëndë të të drejtave të njeriut. Asistenca që u jepet viktimave duhet të synojë rehabilitimin e tyre dhe përfshirjen e tyre sociale. Nga perspektiva e hetimit, qasja e bazuar tek të drejtat e njeriut kërkon që personat e trafikuar të mos procedohen penalisht për asnjë vepër penale që mund të lidhet me statusin e tyre. Përveç kësaj, duhet të mbahet parasysh se mos ofrimi i mbrojtjes dhe asistencës së duhur mund të pengojë bashkëpunimin e personave të trafikuar, mund t'i bëjë ata më vulnerabël ndaj trafikantëve madje mund t'i çojë drejt një situatë e paqëndrueshme emocionale, psikologjike duke u kthyer në shënjestra të lehta nga personat e akuzuar. Efikasiteti i hetimit dhe procedimit të veprave penale të trafikimit lidhet fort me vullnetin e personit të trafikuar për të bashkëpunuar. Ky vullnet varet shpesh nga mbrojtja që i ofrohet për sigurinë dhe privatësinë e personit dhe familjes, si dhe nga kujdesi dhe trajtimi me respekt nga të gjitha autoritetet ligj zbatuese e gjyqësore. Po kështu, vullneti i bashkëpunuesit të viktimës mund të çenohet nga rreziku i riatdhesimit dhe/ose arrestimi apo ndjekja penale për vepra penale që lidhen me emigrimin e paligjshëm apo me përdorimin e dokumenteve të falsifikuara.

Përveç kësaj, qasja e përqendruar tek respektimi i të drejtave të njeriut kërkon një analizë të fenomenit në lidhje me llojin e viktimës. Çdo viktimë ka historinë e vet. Gjinia, kombësia, rolet tradicionale që u caktojnë grave në shoqëri të ndryshme, praktikat diskriminuese të llojeve të ndryshme që i përkasin një vendi apo një grupi të caktuar janë të rëndësishme për t'u vlerësuar. Politikat aktuale kundër trafikimit kanë veçanërisht në vëmendje gratë e shfrytëzuara seksualisht, por po aq i mprehtë është situata e burrave, fëmijëve apo dhe grave në fusha të tjera të shfrytëzimit. Në çdo rast aksesit në skemat e mbrojtjes apo dhe për të marrë lejen e qëndrimit nuk duhet të kushtëzohet nga bashkëpunimi i viktimave të trafikimit duhet me autoritetet kompetente gjatë procedimit penale për të pasur; kjo është kundërproduktive për luftën kundër trafikimit dhe të drejtat e njeriut. Me qëllim respektimin e plotë të të drejtave të njeriut të personave të trafikuar dhe për t'u dhënë atyre mundësi që të rindërtojnë jetën e tyre, shtetet duhet të zbatojnë në mënyrë korrekte dispozitat ligjore për t'u dhënë atyre një periudhë reflektimi, e cila nuk duhet të kushtëzohet me bashkëpunimin me autoritetet. Eksperienca në disa vende, statistika dhe vlerësime të kohëve të fundit tregojnë qartë se dhënia e lejes së qëndrimit viktimave, të cilat për arsye të ndryshme nuk janë të gatshme ose nuk kanë vullnetin të bashkëpunojnë me autoritetet kompetente – kryesisht nga frika e hakmarrjes ndaj familjeve të tyre – rrit ndjeshëm jo vetëm numrin e viktimave, por edhe efikasitetin e luftës kundër trafikimit. Mundësia për përfshirje sociale afatgjatë është një prej komponentëve më të rëndësishëm të fuqizimit të viktimave, bashkë me aksesin në drejtësi dhe zgjidhjet ligjore që përfshijnë edhe dëmshpërblimin.<sup>98</sup>

Në veçanti, Direktiva e BE-së 2011/36, neni 11, përcakton objektivat dhe rregullat për identifikimin, asistencën dhe mbrojtjen e viktimave të mundshme të trafikimit.

Konventa e Këshillit të Evropës, në nenin e saj 35, i kërkon Secilës palë që t'i inkurajojë autoritetet shtetërore dhe zyrtarët publikë që të bashkëpunojnë me organizatat joqeveritare, organizatat e tjera relevante dhe anëtarët e shoqërisë civile për ndërtimin e partneriteteve strategjike me qëllim arritjen e qëllimit të kësaj Konvente. Kjo vlen edhe për fazën e hetimit.

Një shembull specifik i lidhjes mes mbrojtjes së të drejtave të viktimave dhe teknikave të hetimit vjen nga parashikimet e nenit 18 të Dekretit Legjislativ 286/1998 në Itali. Sipas nenit, asistenca për mbrojtjen sociale jepet kur konstatohet se personi ndodhet në situatë dhune apo shfrytëzimi dhe shfaqen rreziqe konkrete ndaj sigurisë së tij, për shkak të tentativave për t'i shpëtuar ndikimit të asocimit të tij me një prej krimeve apo deklarimeve të mësipërme që mund të bëhen gjatë hetimeve paraprake apo gjatë gjyqimit.

Në këto situata, autoriteti kompetent duhet të lëshojë një leje të posaçme për t'i dhënë mundësi personit që t'i shpëtojë dhunës dhe kushteve të organizatës kriminale dhe të marrë pjesë në programe asistence dhe integrimi social. Leja e qëndrimit e lëshuar sipas këtij neni duhet të jetë e vlefshme për gjashtë muaj dhe të mund të rinovohet për një vit ose për më shumë nëse kjo është e nevojshme për qëllime të drejtësisë. Leja hiqet në rast të ndërprerjes së programit apo në rast sjelljeje jo në përputhje me qëllimet e tij, siç raportohet nga prokurori, nga OJQ-të ose siç konstatohet nga autoritetet policore administrative/ Leja e qëndrimit e parashikuar në këtë nen lejon aksesin në shërbime sociale dhe studime, si dhe përfshirjen në listat e punësimit dhe angazhimit në punësim, në varësi të moshës minimale. Nëse, me skadimin e lejes së qëndrimit, aplikanti ka një marrëdhënie të vazhdueshme pune, leja mund të shtyhet më tej dhe të rinovohet për kohëzgjatjen e asaj marrëdhënieje

<sup>98</sup> Raporti i 3të i Komisionit Evropian për Parlamentin Evropian dhe Këshillin mbi progresin e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore (2020) në zbatim të Direktivës 2011/36/BE për parandalimin dhe luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave, faqe 9. [https://ec.europa.eu/anti-trafficking/sites/default/files/third\\_progress\\_report.pdf](https://ec.europa.eu/anti-trafficking/sites/default/files/third_progress_report.pdf)

ose, nëse kjo marrëdhënie zgjat për një kohë të pacaktuar, leja rinovohet sipas rregullave të parashikuara për shkaqet e qëndrimit. Leja e qëndrimit e parashikuar në këtë nen mund të konvertohet gjithashtu në leje qëndrimi për qëllime studimi, nëse mbajtësi i saj regjistrohet në një program të rregullt studimi. Leja e qëndrimit e parashikuar në këtë nen mund të jepet edhe në kohën e daljes nga burgu, madje me propozim të Prokurorisë, edhe ndaj personit që ka përfunduar periudhën e paraburgimit dhe që ka dhënë prova konkrete të pjesëmarrjes në një program asistence dhe integrimi social.

Ky instrument tregon mbrojtje të dyfishtë: 1) një rrugë gjyqësore që mundëson asistencë dhe mbrojtje edhe me anë të lejeve të qëndrimit të vlefshme për të punuar, studiuar etj, me qëllim zhvillimin e një perspektive që çon në shkëputjen e plotë nga e kaluara 2) Mundësinë e një programi social që i jep mundësi viktimës që të marrë shërbime sociale nga agjenci apo OJQ përmes një qasjeje më të lehtë dhe më pak traumatike sesa ajo që lidhet me raportimin e vazhdueshëm pranë organeve ligjzbatuese. Mundësia e një rrugë "sociale" nuk krijon konflikt mes nevojave hetimore dhe prioritetëve të të drejtave të njeriut edhe për arsye se, në një hap të dytë, informacionet e mbledhura OJQ-të janë të detyruara t'i komunikojë pranë organeve të ndjekjes penale. Roli ndërmjetësues i OJQ-ve është shumë i dobishëm për policinë dhe për prokurorinë, pasi gjatë "periudhës së reflektimit", këto struktura kanë mundësinë që, përveçse të japin asistencë, edhe ta fuqizojnë viktimën duke i ofruar asaj këshillim ligjor dhe psikologjik për ta informuar për rëndësinë e paraqitjes së një ankese kundër trafikantëve dhe rreth të gjitha hapave që priten në të ardhmen dhe gjatë gjykimit.

Zbatimi i instrumenteve të mira të identifikimit, asistencës dhe mbrojtjes së viktimave ka ndikim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm në efikasitetin e hetimeve dhe kapacitetin e viktimave për të bashkëpunuar me autoritete të besueshme të zbatimit të ligjit.

### 6.3.1 KUADRI LIGJOR NDËRKOMBËTAR PËR MBROJTJEN DHE ASISTENCËN NDAJ VIKTIMAVE

Viktimat që arrijnë të dalin nga kontrolli i trafikantëve e gjejnë përgjithësisht veten në një situatë pasigurie dhe vulnerabiliteti të ndjeshëm. Viktimat mund të vuajnë trauma psikologjike; dëmtime fizike; mund të mos kenë asnjë mjet jetese; mund të jenë në një situatë të parregullt emigrimi, pa dokumente dhe pa mundësi për t'u kthyer në vendin e tyre; mund të kenë frikë nga hakmarrja ndaj atyre vetë ose ndaj familjeve të tyre. Zbatimi i një qasjeje të bazuar tek të drejtat e njeriut kërkon që shtetet të garantojnë të drejtën e zgjidhjeve ligjore për viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut, ku përfshihet edhe përfshirja sociale;<sup>99</sup> të ofrojnë asistencë pa kushte në bashkëpunim me viktimën në kuadrin e sistemit të drejtësisë penale,<sup>100</sup> si dhe të marrin masa që asistencë për viktimat të mos kushtëzohet me vullnetin e tyre për të vepruar si dëshmitar sipas nenit 12(6) i Konventës së Këshillit të Evropës kundër Trafikimit)

Protokolli i Palermos, në nenet 6-8 të tij, parashikon një listë të përfitimeve të mbështetjes sociale, si këshillimin, strehimin, edukimin, asistencën mjekësore dhe psikologjike, si dhe mundësinë që viktimat të marrin status të ligjshëm që u lejojnë të qëndrojnë në vendin e destinacionit, qoftë përkohësisht apo përgjithmonë (neni 7). Protokolli kërkon që të gjitha shtetet anëtare të marrin parasysh si duhet sigurinë e viktimës dhe statusin e saj në çfarëdo procedurë të mëtejshme ligjore (neni 8(1), (2)). Në tekst nuk

<sup>99</sup> Raporti i Raportuesit të Posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për Trafikimin e Personave, sidomos të Grave dhe Fëmijëve, A/HRC/41/46, 23 prill 2019, paragrafi 11.

<sup>100</sup> Raporti i Raportuesit të Posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për Trafikimin e Personave, sidomos të Grave dhe Fëmijëve, A/HRC/41/46, 23 prill 2019, paragrafi 61.

ka dispozitë të posaçme për viktimat që janë edhe dëshmitarë, por neni 24 (dëshmitarët) dhe neni 25 (viktimat) të Konventës janë nene që vlejnë edhe për viktimat e trafikimit. Protokollin e Palermos përfshin edhe asistencën për personat e trafikuar, por nuk i detyron shtetet palë që t'i zbatojnë këto masa. Sipas Protokollit, shtetet palë “duhet të shohin mundësinë e zbatimit të këtyre masave”.

Konventa e Këshillit të Evropës kundër Trafikimit, në nenin 12 parashikon masat e ndihmës që palët duhet t'u ofrojnë viktimave të trafikimit. Duhet theksuar se neni 12 vlen për të gjitha viktimat, qofshin ato viktimat të trafikimit brenda vendit apo të trafikimit transnacional. Dispozita për ndihmën për viktimat është një prej dispozitave kyçe të Konventës së Këshillit të Evropës-s për veprimin kundër trafikimit. Kjo Konventë krijon një gur themeli sa u përket standardeve për mbrojtjen e viktimave, duke qenë se, krahasuar me Protokollin e Palermos, ajo u vendos shteteve palë një detyrim të qartë për ofrimin e masave të ndihmës. Përveç kësaj, kjo Konventë përmban edhe një listë të hollësishme të asaj çka duhet të bëjnë shtetet palë për personat e trafikuar. Neni 12(1) përmban një listë të masave minimale në ndihmë të rikuperimit fizik, psikologjik dhe social të viktimave. Ndihma e dhënë sipas nenit 12 duhet të jepet e bazuar tek konsensusi dhe informimi. Përveç kësaj, mundësia për marrjen e kësaj ndihme nuk duhet të kushtëzohet me vullnetin e personit të trafikuar për të vepruar si dëshmitar.

**Direktiva e BE-së 2011/36/BE** për parandalimin dhe luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe për mbrojtjen e viktimave. Kjo direktivë i detyron shtetet anëtare të BE-së që të japin asistencë “para, gjatë dhe për një periudhë të përshtatshme kohe pas përfundimit të procedimit penal”

Udhëzuesi i OSBE/ODIHR për Mekanizmat Kombëtarë të Referimit (MKR) identifikon tre komponentë që përbëjnë një program gjithëpërfshirës mbështetjeje dhe mbrojtjeje për personat që prezumohet të jenë trafikuar. Ky program përfshin: asistencë financiare, strehim dhe shërbime të specializuara.

**Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut** në dokumentin “Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara për të Drejtat e Njeriut dhe për Trafikimin e Qenieve Njerëzore”, parashikon në Parimin 8 se shtetet duhet që, para së gjithash, të marrin masat që viktimat të mbrohen nga shfrytëzimi dhe dëmtimi i mëtejshëm – nga personat që i kanë shfrytëzuar deri në atë moment dhe nga kushdo tjetër. Shtetet duhet gjithashtu që ta pajisin viktimën me kujdes fizik dhe psikologjik të përshtatshëm për përmbushjen të paktën të nevojave të saj urgjente. Ofrimi i një kujdesi të tillë identifikohet si një e drejtë e panegociueshme e viktimës: një e drejtë që duhet të njihet dhe të zbatohet pavarësisht kapacitetit apo vullnetit të personit për të bashkëpunuar me autoritetet e drejtësisë penale në hetimin apo ndjekjen penale të trafikantëve.

### 6.3.2 DETYRIMET E SHTETEVE PËR ASISTENCËN PËR VIKTIMAT

Detyrimet e shteteve për mbrojtjen dhe asistimin e viktimave të trafikimit mishërohen në disa instrumente ndërkombëtare. Natyra e detyrimit të shteteve për të ofruar kujdes dhe mbështetje për viktimat e trafikimit lidhet edhe me statusin e tyre si viktimat të krimit dhe viktimat të shkeljeve të të drejtave të njeriut. Ky status, siç theksohet më sipër, u jep këtyre viktimave të drejtën për t'u trajtuar me humanizëm dhe duke iu respektuar dinjiteti dhe të drejtat e njeriut, si dhe kanë të drejtën të përfitojnë nga masat që garantojnë mirëqenie dhe që parandalojnë riviktimizimin e tyre.

Në çështjen Rantsev k. Qipros dhe Ruisë, GjEDNj-ja shpjegon se detyrimi pozitiv i parashikuar në nenin 4 të KEDNj-së përfshin edhe detyrimin e shteteve, në rrethana të caktuara, për të marrë masa operacionale për mbrojtjen e viktimave ose viktimave të mundshme të trafikimit. Autoritetet shtetërore duhet të veprojnë kur janë në dijeni ose kur duhet të kishin qenë në dijeni për rrethana që çojnë në dyshimin e arsyeshëm se një individ

i identifikuar ka qenë trafikuar dhe ka qenë i rrezikuar realisht nga trafikimi ose shfrytëzimi (...). Ky detyrim mbrojtjeje mund të përfshijë, p.sh., garantimin e sigurisë së menjëhershme fizike të personit të trafikuar duke e vendosur në një strehëz. Sidoqoftë, shtetet kanë përgjegjësinë që të kenë një “kuadër legjislativ dhe administrativ që ofron mbrojtje reale dhe efikase të të drejtave të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore”.

Përgjegjësitë kryesore të shteteve përcaktohen në vijim:



Mbrojtje nga dëmtimi i mëtejshëm

- ▶▶ Protokoll i Palermos, neni 6.5, kërkon që secili shtet palë të “marrë masat për të ofruar siguri fizike për viktimat e trafikimit gjatë kohës që ato janë në territorin e tij”. Pavarësisht se kjo dispozitë kufizohet tek siguria fizike, ajo i detyron shtetet palë që “të marrin të paktën disa hapa që çojnë në “përpjekjen” për mbrojtjen e sigurisë”.
- ▶▶ Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut thekson se përgjegjësia e shteteve për “të mbrojtur personat e trafikuar nga shfrytëzimi dhe dëmtimet e mëtejshme”, si dhe nevoja e shteteve dhe e të tjerëve për “të garantuar mbrojtjen efikase të personave të trafikuar nga dëmtimet, kërcënimet apo intimidimi nga ana e trafikantëve dhe personave të lidhur me ta”.<sup>101</sup>
- ▶▶ Neni 12 (2) i Konventës Evropiane kundër Trafikimit përmban një detyrim të përgjithshëm për shtetet palë për “të marrë parasysh si duhet nevojat e viktimave për siguri dhe mbrojtje”.

### Privatësia



- ▶▶ Protokoll i Palermos, neni 6, kërkon që shtetet palë të mbrojnë privatësinë dhe identitetin e viktimave të trafikimit “në rastet e përshtatshme dhe në shkallën që mundën sipas legjislacionit të tyre vendas”.
- ▶▶ Konventa Evropiane e Trafikimit, neni 11, përcakton një detyrim të përgjithshëm për “mbrojtjen e jetës private dhe identitetin e viktimave”, duke parashikuar masat specifike për përmbushjen e këtij objekti, ku përfshihet vendosja e standardeve për ruajtjen e të dhënave personale dhe marrja e masave për respektimin nga ana e medias të privatësisë dhe identitetit të viktimave.
- ▶▶ Parimi 8 në Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara të Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, thekson se si duhet të zgjerohet mbrojtja e privatësisë për të përfshirë të gjithë personat e trafikuar, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe të arsyeshme që justifikojnë ndërhyrjen në këtë privatësi. Këto justifikime të arsyeshme duhet të përfshijnë marrjen parasysh të të drejtave të personave të akuzuar në një proces të drejtë gjyqimi.

<sup>101</sup> Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara të Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, udhëzimi 8. <https://www.ohchr.org/documents/publications/traffickingen.pdf>



- Udhëzuesi i OSBE/ODIHR për Mekanizmat Kombëtarë të Referimit “Bashkimi i përpjekjeve për mbrojtjen e të drejtave të personave të trafikuar” e adreson privatësinë në kontekstin e të dhënave, duke theksuar se strehëzat konfidenciale duhet të krijojnë një ambient të sigurt për personat e trafikuar, duke garantuar standarde të larta sigurie dhe duke respektuar në të njëjtën kohë të drejtën e tyre për privatësi dhe për autonomi.

### Asistenca minimale



- Sigurimi i akomodimit të përshtatshëm
- Asistencë psikologjike dhe materiale
- Akses në trajtim mjekësor në rast emergjence
- Shërbime përkthimi me shkrim dhe me gojë
- Këshillim dhe asistencë për mundësimin e marrjes parasysh të të drejtave dhe interesave të viktimës në procedimin penal

### Përfshirja sociale



- Akses në arsim për fëmijët
- Asistenca e nevojshme mjekësore ose e llojeve të tjera për viktimat me leje qëndrimi
- Akses në tregun e punës, në arsimin dhe formimin profesional për viktimat me leje qëndrimi
- Ofrimi i asistencës pa u kushtëzuar nga vullneti i viktimës për të vepruar si dëshmitar

Aplikimi i një qasjeje të bazuar tek të drejtat e njeriut kërkon që asistenca ndaj personave të trafikuar të mos kushtëzohet me bashkëpunimin e tyre me autoritetet kompetente. Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut udhëzon në lidhje me parimin e moskushtëzimit, duke qartësuar se strehimi “nuk duhet të varet nga vullneti i viktimës për të dëshmuar në një procedim penal”.<sup>102</sup> Konventa e Këshillit të Evropës për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, thekson se asistenca për viktimat nuk duhet të kushtëzohet me rënien dakord nga vetë viktimat për të bashkëpunuar me autoritetet kompetente për hetimin dhe ndjekjen penale.<sup>103</sup> Procedurat Standarde të Veprimit Për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 499, datë 29.8.2018, theksojnë se mbrojtja e të drejtave të personave të trafikuar do të jetë në qendër të të gjitha përpjekjeve për parandalimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e tyre, pavarësisht dëshirës apo aftësisë së viktimës për të dëshmuar në gjykatë.<sup>104</sup>

<sup>102</sup> Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara të Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut Neni 6/1.

<sup>103</sup> Konventa e Këshillit të Evropës për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, neni 12.6.

<sup>104</sup> Neni 3, Parime të Përgjithshme.

## 6.4 QASJA PËRMES BASHKËPUNIMIT TË AGJENCIVE

### 6.4.1 MEKANIZMI KOMBËTAR I REFERIMIT

Masat për ofrimin e asistencës parashikohen zakonisht si pjesë e “Mekanizmit Kombëtar të Referimit” (MKR). MKR-ja “është një kuadër bashkëpunimi, përmes të cilit aktorët shtetërorë përmbushin detyrimet e tyre për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut të personave të trafikuar, për koordinimin e përpjekjeve të tyre në një partneritet strategjik me shoqërinë civile” Manuali për mekanizmat kombëtare të referimit i publikuar nga OSBE-ja, shprehet se “Mekanizmi Kombëtar i Referimit (MKR) është një kornizë bashkëpunuese nëpërmjet së cilës aktorët shtetërorë plotësojnë detyrimet e tyre për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut të personave të trafikuar, duke i koordinuar përpjekjet e tyre në partneritet strategjik me shoqërinë civile.”<sup>105</sup> Qëllimet themelore të një MKR-je janë sigurimi i respektimit të të drejtave të njeriut të personave të trafikuar dhe sigurimi i një mënyrë të efektshme për referim të viktimave të trafikimit të shërbimet. Në të njëjtën kohë, MKR-të mund të punojnë për të ndihmuar për përmirësimin e politikave dhe procedurave kombëtare në lidhje me një spektër të gjerë çështjes që kanë të bëjnë me viktimat, siç janë rregulloret e qëndrimit dhe riatdhesimit, kompensimi i viktimave dhe mbrojtja e dëshmitarëve. MKR-të mund të krijojnë plane kombëtare veprimi dhe mund të vendosin standarde referuese për të vlerësuar nëse janë duke u arritur qëllimet. MKR-të nuk janë struktura të ngurta, por mekanizma fleksibël, të krijuar sipas rastit për t’iu përshtatur modeleve të trafikimit të secilit vend si dhe mjedisit të tij social, politik, ekonomik dhe ligjor. Për këtë arsye MKR-ja nuk ndërtohet mbi bazën e një plani të vetëm të përgjithshëm, por ndërtohet mbi një vlerësim të kujdesshëm të nevojave dhe kushteve specifike për atë shtet.

#### Elemente kyçe: identifikimi dhe bashkëpunimi

Në thelb të çdo MKR-je është procesi i identifikimit të viktimave të mundshme të trafikimit, të cilët njihen në përgjithësi si “presona të prezumuar të trafikuar”. Ky proces përfshin të gjitha organizatat e mundshme të përfshira në MKR, të cilat duhet të bashkëpunojnë për t’u siguruar ndihmë viktimave nëpërmjet referimit të shërbimeve të specializuara. Identifikimi i personave të trafikuar është një problem themelor në të gjitha strategjitë antitrafik. Për një mori arsyes, ata që janë të bllokuar në trafikimin e qenieve njerëzore, shpesh nuk dëshirojnë t’ua tregojnë statusin apo përjetimet autoriteteve shtetërore. Viktimat mund të kenë ndjenja të thella mosbesimi ndaj organeve zyrtare, që rrjedhin nga përvoja në shtetin e tyre të origjinës. Shpeshherë, viktimat kanë frikë nga një hakmarrje e mundshme nga trafikantët kundër atyre vetë dhe anëtarëve të familjes në vendin e origjinës. Këto kërcënime për dhunë pas kthimit në atdhe e rrisin frikën e viktimave për dëbimin e tyre për shkak të statusit të paligjshëm. Duke qenë se viktimat e trafikimit ngurrojnë shpeshherë ta identifikojnë veten si të tillë, përdoret përgjithësisht termi “persona të prezumuar të trafikuar” për të përshkruar person që me gjasë janë viktimat të trafikimit dhe që për rrjedhojë duhet të klasifikohen në objektin e përgjithshëm të programeve dhe shërbimeve antitrafik. Prosesi dhe rregullat e identifikimit janë trajtuar në Kreun paraardhës.

### 6.4.2 MEKANIZMI KOMBËTAR I REFERIMIT NË SHQIPËRI

Marrëveshja e bashkëpunimit për “Funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit” rregullon funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe ndihmën për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit,

<sup>105</sup> OSCE, *National Referral Mechanisms - Joining Efforts to Protect the Rights of Trafficked Persons: A Practical Handbook*, 2004. <https://www.osce.org/odihr/13967>

**Palë në marrëveshje janë:**

- Ministria e Brendshme
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Arsimit dhe Rinisë,
- Ministria e Shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale
- Prokuroria e Përgjithsme
- Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
- Organizata Ndërkombëtare “World Vision”-Tiranë
- Organizata jofitimprurëse “Arsis”
- Organizata jofitimprurëse “Të ndryshëm dhe të barabartë”-Tiranë
- Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit -Tiranë
- Organizata Jofitimprurëse Qendra Psiko Sociale “Vatra” Vlorë
- Organizata jofitimprurëse “Tjetër Vizion”-Elbasan

Qëllimi kryesor i kësaj marrëveshje është sigurimi i zbatimit të procedurave standard të Veprimit për identifikimin, referimin, mbrojtjen, ndihmën dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit si dhe përforcimi i partneritetit të aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë në funksion të mbështetjes së viktimave që prej identifikimit e deri në riintegrimin e plotë të tyre.

Çdo palë në marrëveshje merr angazhimet sipas fushës së përgjegjësisë në funksion të identifikimit dhe mbrojtjes së viktimave e viktimave të mundshme të trafikimit.

Palë e kësaj marrëveshje mund të bëhet çdo organizëm shtetëror dhe jo shtetëror që shpreh interesin për anëtarësim dhe që plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 të saj.

## 6.5 KONCEPTI I PARIMIT TË PËRJASHTIMIT NGA DËNIMI

Siç është theksuar edhe në pjesët e tjera të këtij studimi, dhënia e pëlqimit nga viktimat e trafikimit për çfarëdolloj akti që përbën trafikim të qenieve njerëzore është e parëndësishme në çdo rast që viktimat i është nënshtruar një ose disa mjeteve trafikimi, duke ia bërë të pamundur asaj që të ushtrojë vullnetin e saj të lirë në këto rrethana. Në rastin e një të mituri, për të vërtetuar se kemi të bëjmë me trafikim të qenieve njerëzore nuk është e domosdoshme që të vërtetohet asnjë prej këtyre mjeteve, pasi fëmijët janë vulnerabël ndaj trafikimit thjesht për shkak të moshës së tyre. Aplikimi i të gjitha këtyre kriterëve ligjorë është i rëndësishëm kur bëhet fjalë për zbatimin e parimit të mosndëshkimit. Parimet dhe udhëzimet e rekomanduara të vitit 2002 për të drejtat e njeriut dhe për trafikimin e qenieve njerëzore të Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR) vlerësoi se viktimat e trafikimit duhet të pajisen me mbrojtje, të mos ndëshkohen për akte të tyre të paligjshme që vijnë si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e trafikimit të tyre. Kështu, veprimet e organeve të zbatimit të ligjit në lidhje me hetimin e trafikimit nuk duhet të zhvillohen asnjëherë në dëm të të drejtave të viktimave. Instrumente të tjera ndërkombëtare kundër trafikimit përfshijnë shprehimisht një dispozitë detyruese të mosndëshkimit. Për shembull, Direktiva e BE-së kundër trafikimit e

vitit 2011/36/BE<sup>106</sup>, njeh specifikisht një fenomen në rritje, ku trafikantët i detyrojnë viktimat të kryejnë krime, duke përmendur mes formave të ndryshme të shfrytëzimit edhe “shfrytëzimin për aktivitete kriminale”, përveç “lypjes së detyruar” si një formë e punës apo shërbimeve të detyruara.

Viktimat e trafikimit mbahen shpesh përgjegjëse për aktivitete të paligjshme të kryera prej tyre si pasojë e situatës së të qenit viktimë, jo vetëm në lidhje me format specifike të shfrytëzimit, të cilave mund t’u jenë nënshtruar, por edhe për akte që vijnë si rrjedhojë e tyre apo thjesht si incidente, si p.sh. për çfarëdolloj shkeljeje në lidhje me emigracionin, shkelje administrative apo civile që mund të kenë kryer, qoftë gjatë procesit të trafikimit, qoftë si pasojë e drejtpërdrejtë e situatës së tyre të trafikimit. P.sh., kjo ndodh kur një viktimë ndiqet penalisht për zotërim të dokumenteve të falsifikuara apo të një lejeje të paligjshme hyrjeje apo qëndrimi në një vend. Në të gjithë këta skenarë, është shumë e rëndësishme që viktimat e trafikuar të identifikohet sa më herët që të jetë e mundur, si dhe të sigurohet mbrojtja e menjëhershme dhe e plotë, duke përjashtuar ndjekjen penale apo dënimin e viktimës. Në këto raste, mund të thuhet qartë se ndjekja penale e viktimave të trafikimit përbën shkelje të rëndë të të drejtave të tyre për mbrojtje.

Dispozitat për përjashtimin nga dënimi synojnë që viktimave të trafikimit t’u jepet mbrojtja që kanë të drejtë ta kenë me ligj, duke u kujdesur në të njëjtën kohë për parandalimin e ritrafikimit të tyre dhe ndëshkimin e autorëve në përputhje të plotë me qëllimet e përcaktuara nga standardet ligjore ndërkombëtare.

### 6.5.1 PËRJASHTIMI NGA DËNIMI NË INSTRUMENTET KRYESORE LIGJORE RAJONALE DHE NDËRKOMBËTARE

Konventa e Këshillit të Evropës kundër Trafikimit është traktati i parë që përmban dispozita ligjrisht të detyrueshme për mosndëshkimin. Neni 26 e identifikon mosndëshkimin me mundësinë e mosvendosjes së penalteteve ndaj viktimave të trafikimi në shkallën që ato kanë qenë të detyruara të angazhohen në aktivitete të paligjshme. Raporti shpjegues i Konventës së KiE-s thekson më tej se “Palët mund të përfshijnë në legjislacionin e tyre vendas dispozita ligjore në legjislacionin material penal ose penal procedural ose të marrin çfarëdolloj mase tjetër që lejon mosndëshkimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore”. Direktiva e BE-së për trafikimin 2011/36/BE përmban një dispozitë të shprehur dhe të detyrueshme për mosndëshkimin në nenin e saj 8, ku theksohet se “Shtetet anëtare, në përputhje me parimet bazë të sistemeve të tyre juridike, duhet të marrin masat e nevojshme për të garantuar që autoritetet kombëtare kompetente të kenë të drejtë të mos ndjekin penalisht dhe të mos vendosin penaltete ndaj viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore për përfshirje në aktivitete kriminale, që ato kanë qenë të detyruara të kryejnë si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e statusit të tyre si viktimë”. Protokollin e vitit 2014 i ILO-s i Konventës së punës së detyruar përmban një dispozitë për mosndëshkimin e viktimave të punës së detyruar, të cilat kanë kryer akte të paligjshme që lidhen me nënshtrimin e tyre ndaj punës së detyruar, duke u kërkuar shteteve anëtare që “të marrin masat e nevojshme për të garantuar që autoritetet kompetente të kenë të drejtë të mos ndjekin penalisht dhe të mos vendosin penaltete”<sup>25</sup> ndaj viktimave të punës së detyruar”. Konventa e Shoqatës së Kombeve të Azisë Juglindore kundër trafikimit të personave, sidomos fëmijëve dhe grave (“Konventa ASEAN”) e vitit 2015, në nenin e saj 14 u kërkon shteteve anëtare “të shohin mundësinë e mos shpalljes së viktimave të trafikimit përgjegjëse penalisht apo administrativisht”.

Në sistemin e OKB-së, detyrimi për zbatimin e dispozitës së mosndëshkimit kërkon që shtetet t’i mbrojnë viktimat e trafikimit nga mbajtja e përgjegjësisë për çfarëdolloj akti të paligjshëm të kryer si rrjedhojë e nënshtrimit të tyre ndaj trafikantëve. Ky është një detyrim që gjendet në shumë rekomandime që fillojnë që nga parimet dhe udhëzimet e vitit 2002 të Zyrës së Komisionerit të Lartë për të drejtat e njeriut. Parimi i

106 <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?uri=CELEX%3A32011L0036>

rekomanduar 7 në lidhje me mbrojtjen dhe asistencën e viktimave e trafikimit parashikon përgjithësisht që “personat e trafikuar nuk duhet të ndalohen, të akuzohen apo të ndiqen penalisht.” Sa u përket të miturve, OHCHR rekomandon që shtetet të shohin mundësinë e “marrjes së masave që të miturit që janë viktime të trafikimit të mos u nënshtrohen procedurave penale apo sanksioneve për vepra penale që lidhen me situatën e tyre si persona të trafikuar.” Gjithashtu, Protokollin i OKB-së për kontrabandimin e emigrantëve shprehet në nenin 5 se emigrantët “nuk duhet të shpallen përgjegjës në procedimet penale sipas këtij Protokollin për faktin se kanë qenë objekt i veprimeve të parashikuara në nenin 6 të këtij Protokollin”. Edhe nëse gjërat janë ndryshe, parimi i mosndëshkimit bazohet tek mosdhënia e pëlqimit për një aktivitet të paligjshëm të organizuar dhe të planifikuar nga persona të tjerë (trafikantë ose kontrabandues).

Që të gjitha këto instrumente ndërkombëtare përfshijnë një element të forcës në dispozitat e tyre të mosndëshkimit, pasi u kërkojnë shteteve të mos i ndëshkojnë viktimat e trafikimit “për atë që ato kanë qenë të detyruara ta kryejnë një vepër penale si rrjedhojë e drejtpërdrejtë” të të qenit të nënshtroara ndaj trafikimit të qenieve njerëzore ose ndaj punës së detyruar. Në rastet e trafikimit, aplikimi i testit të “detyrimit” do të ishte bindës nëse viktimi i është nënshtroar një apo disa mjeteve të shtrëngimit në kohën e kryerjes së veprës penale. Përveç kësaj, duhet gjithashtu të vlerësohen situatat, ku viktimi ka qenë objekt i abuzimeve të rënda dhe të vazhdueshme mendore dhe fizike.

## 6.5.2 ZBATIMI PRAKTIK I PARIMIT TË PËRJASHTIMIT NGA DËNIMI

Sa i përket zbatimit praktik të përjashtimit nga dënimi, shteteve u rekomandohet që të përfshijnë në legjislacionin e tyre vendas dispozita ligjore specifike. Sipas standardeve ndërkombëtare, viktimi e trafikimit të personave nuk duhet të mbahet përgjegjëse për akte të paligjshme, vepra penale apo shkelje civile dhe administrative dhe as për vepra penale që lidhen me emigracionin dhe që janë kryer prej tyre për atë kohë sa përfshirja e tyre në këto vepra ka ardhur si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e situatës së tyre si viktime të trafikimit. Përveç kësaj, viktimat e mitura të trafikimit nuk duhet të ndiqen penalisht dhe as të ndëshkohen për akte të paligjshme që lidhen me trafikimin e tyre.

Nëse shtetet nuk kanë parashikuar në legjislacionin e brendshëm dispozita të posaçme mbi përjashtimin nga dënimi i viktimave ato duhet ta përmbushin këtë përmes interpretimit të normave të tyre ekzistuese – si p.sh. normat që parashikojnë përjashtimin bazuar në gjendjen e nevojës. Megjithatë, duhet të theksohet se, siç përmendet më sipër, këto klauzola “tradicionale” justifikimi duhet t’i përshtaten kontekstit të trafikimit dhe mund të jetë jo gjithmonë e lehtë për prokurorë e gjykatë që të përmbushin zbatimin praktik të këtij parimi. Për ta bërë këtë parim efikas, është e rëndësishme që shtetet të ngrenë mekanizma që operojnë qysh në fazat shumë të hershme të hetimit, pasi përjashtimi nga dënimi duhet të kuptohet si një mjet i detyrueshëm që duhet të zbatohet nga të gjitha institucionet në fazën e parë të identifikimit të një aplikimi të mundshëm. Institucionet nuk duhet të lejojnë që viktimat e trafikimit të konsiderohen si autorë të veprave penale në sistemin e drejtësisë penale, kur plotësohen kushtet për zbatimin e parimit të përjashtimit nga dënimi. Në rastet kur ky devijim nuk ka funksionuar në shkallën e parë dhe kur këto viktime të trafikimit janë akuzuar dhe janë ndjekur penalisht, organeve të posaçme u takon detyrimi i ndërprerjes sa më shpejt që të jetë e mundur të procesit që ndaj viktimave të trafikimit për kryerje të veprave penale që lidhen me trafikimin. Kështu, detyrimi për zbatimin e mosndëshkimit vazhdon të mbetet në fuqi derisa viktimës t’i garantohet mbrojtje e plotë nga ndjekja penale dhe dënimi.

Për të garantuar mbrojtjen e plotë të viktimave të trafikuar, përjashtimi nga dënimi nuk mund të zbatohet si duhet thjesht nëpërmjet zbutjes së masës së dënimit. Përveç kësaj, ky parim vlen edhe për ndalimin: siç theksohet edhe në Rekomandimet e OSBE-së, viktimat duhet të jenë “immune jo vetëm ndaj dënimit, por edhe ndaj ndjekjes penale dhe ndalimit” ose, të paktën, ndjekja penale dhe ndalimi duhet të ndërpriten

sapo situata të identifikohet si një situatë trafikimi. Në fakt, viktimat e trafikimit në kushte ndalimi zakonisht nuk pajisjen me mbrojtjen dhe asistencën që kanë të drejtë të gëzojnë, pasi strukturat përkatëse shpesh nuk janë të trajnuar si duhet për t'i identifikuar dhe asistuar viktimat e trafikimit. Duke pasur parasysh këto kushte, është e qartë se autoritetet duhet të jenë në gjendje të identifikojnë të drejtën e viktimave për të mos u dënuar që nga momenti i parë që ato identifikohen si të tilla dhe vetëm në këtë rast dispozitat e mosndëshkimit mund të zbatohen në mënyrë efikase në praktikë. E megjithatë, edhe në këtë kontekst, është e qartë se si që të gjithë elementët e përfshirë në trafikimin e qenieve njerëzore – në dukje të ndryshëm – janë pjesë e së tërës. Për zbatimin sa më herët të parimit të përjashtimit nga dënimi është i domosdoshëm identifikimi në fazë të hershme.

Për ta bërë këtë mekanizëm efikas, që të gjithë punonjësit e organeve të zbatimit të ligjit duhet të trajnohen për identifikimin e situatave të trafikimit. Nëse viktimat identifikohen në një fazë shumë të hershme dhe asistohen e mbrohen, ato mund të jenë në gjendje të bashkëpunojnë me autoritetet për hetimin dhe identifikimin e trafikantëve, duke ofruar informacione e prova, madje edhe duke shërbyer si dëshmitarë në procedimet penale kundër tyre. Në mënyrë të veçantë, autoritetet e hetimit dhe ndjekjes penale duhet të trajnohen për identifikimin e veprave penale që lidhen me trafikimin dhe që vijnë si rrjedhojë e tij. Përjashtimi nga dënimi mund të zbatohet siç duhet nëse të gjithë punonjësit e fushës së drejtësisë dhe organeve të zbatimit të ligjit mbështeten me udhëzime praktike të hollësishme dhe të përditësuara si për identifikimin e situatave të trafikimit, ashtu edhe me zbatimin e dispozitave jondëshkuese për viktimat.

Parimi i përjashtimit nga dënimi i viktimës duhet të shtrihet ndaj çdo shkelje ligjore që lidhet me trafikimin, pra edhe shkeljeve të natyrës administrative apo civile. Çdo aktivitet i paligjshëm që lidhet me trafikimin i kryer nga një viktimë trafikimi duhet të mbulohet nga garancia e përjashtimit nga dënimi, pavarësisht sesa e rëndë apo serioze ka qenë vepra e kryer.

Kjo nuk ka për qëllim një lloj imuniteti të përgjithshëm, por synon:



- identifikimin e rrethanave të vërteta në të cilat ka ndodhur vepra penale;
- dhënien e mundësisë viktimave për të përfutur mbrojtjen dhe sigurinë që u jep ligji;
- mbështetjen ndaj hetimit të trafikimit të qenieve njerëzore, lehtësimin e pozitës së viktimave për vepra penale që ato kanë kryer nën ndikimin e trafikantëve/shfrytëzuesve, etj.

Ndryshe nga viktimat në moshë madhore, në rastin e viktimave të mitura të trafikimit, ajo çfarë duhet të vërtetohet është vetëm marrëdhënia mes veprës së kryer dhe statusit të tyre si viktimë të trafikimit; kjo që duhet të përbëjë arsye të mjaftueshme për ndërprerjen e procedimit si dhe për lirimin e menjëhershëm të viktimës së mitur.


### 6.5.3 DISPOZITA E PËRJASHTIMIT NGA DËNIMI NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR

Kodi ynë penal në nenin 52/a “Përjashtimi ose ulja e dënimit për bashkëpunëtorët e drejtësisë dhe viktimat” parashikon shprehimisht përjashtimin nga dënimi për personat e dëmtuar nga veprat penale, që lidhen me trafikimin e personit. Përjashtimi zbatohet për kryerjen e veprave penale gjatë periudhës së trafikimit dhe në masën që ka qenë i detyruar t'i kryejë ato veprime apo mosveprime të kundërligjshme. Në këtë mënyrë dispozita parashikon një prag që reflekton plotësimin e dy kushteve: 1) kushti shkakësor dhe 2) masa e detyrimit. Kushti i parë përshkruhet nga OSBE në “Rekomandime për politikën dhe legjislacionin drejt zbatimit efektiv të parimit të mos dënimit të viktimave të trafikimit” duke theksuar se trajtimi këtij parimi nga perspektiva e kushtit shkakësor, siguron që viktimat e trafikimit nuk dënohen për veprat penale të

kryera gjatë procesit të trafikimit.<sup>107</sup> Shembuj të veprave të tilla janë ushtrimi i prostitucionit, përdorimi i dokumenteve të rremë, migrimi i parregullt. Kjo qasje është më e lehtë për t'u provuar dhe për t'u zbatuar më gjerësisht. Ndërkohë qasja e bazuar në masën e detyrimit nuk është plotësisht e qartë në drejtim të kriterëve për përcaktimin e pragut të pranueshëm të detyrimit në mënyrë që të garantohet zbatimi korrekt të kësaj dispozite.

---

<sup>107</sup> Rekomandime për politikën dhe legjislacionin drejt zbatimit efektiv të parimit të mos dënimit të viktimave të trafikimit. OSBE, 2014. <https://www.osce.org/files/f/documents/d/c/110471.pdf>





## KREU VII



## POZICIONI PROCEDURAL DHE MBËSHTETJA E VIKTIMAVE GJATË GJYKIMIT TË ÇËSHTJEVE TË TRAFIKIMIT

### 7.1 ÇËSHTJE TË GJYKIMIT TË VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT DHE KOMPETENCËS LËNDORE TË TYRE. NDRYSHIMET E REJA LIGJORE NË LEGJISLACIONIN PROCEDURAL.

Trafikimi i qenieve njerëzore është krim i rëndë dhe shkelja më e rëndë e të drejtave themelore të njeriut, që bie ndesh me vlerat e humanizmit njerëzor pasi ka si *corpus delicti* vetë qenien njerëzore: femrën, të miturin, emigrantin etj. Prandaj dhe gjykimi i veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore ka kompleksitetin e vet për shkak të natyrës së këtij fenomeni kriminal, pozicionit të viktimave të trafikimit gjatë gjykimit, dhe standardeve ndërkombëtare për trajtimin e tyre që duhen përmbushur gjatë gjykimit, si dhe kujdesit që gjyqtarët duhet të tregojnë për të balancuar të drejtat e viktimave e interesin e tyre me garancitë procedurale e ligjore të të akuzuar. Gjikimi i tyre kërkon njohje të mirë të kuadrit ligjor shqiptar dhe atij ndërkombëtar e në të njëjtën kohë njohjen e praktikës gjyqësore të deritanishme të gjykimit të këtyre veprave penale. Kodi ynë penal parashikon si forma të trafikimit të qenieve e njerëzore ku futen trafikimi me qëllime prostitucioni dhe ai i emigrantëve, dhe si formë më vete atë të trafikimit të të miturve. “Trafikimit të qenieve njerëzore”, neni 110/a i KP<sup>108</sup> dhe “Trafikimi i të miturve”, neni 128 i KP. Vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore ishte në kompetencën e hetimit e gjykimit të institucioneve të veçanta të ngritura në vitin 2004<sup>109</sup>si Prokurorisë për Krime të Rënda dhe Gjykata e Krimeve të Rënda, pasi trajtoheshin në mënyrë të veçantë si krime të rënda e në të njëjtin nivel me ato të krimit të organizuar.

Neni 75/a i KPrP parashikonte që veprat penale “Trafikimi i qenieve njerëzore”, neni 110/a i KP<sup>110</sup> dhe “Trafikimi i të miturve”, neni 128 i KP ishin në kompetencën lëndore të Gjykatës së Krimeve të Rënda. Kjo përkonte më strategjinë në nivel shtetëror dhe kombëtar në luftën kundër trafikimit<sup>111</sup> dhe një praktikë të konsoliduar hetimore dhe gjyqësore në trajtimin e këtyre veprave penale, e në mënyrë të veçantë në trajtimin e viktimave nga kjo veprimtari kriminale.

108 Me ligjin nr. 144/2013 vepra penale e “Trafikimit të femrave”, neni 114/b u shfuqizua duke përfshirë trafikimin e femrave tek neni 110/a i KP.

109 Ligji nr. 9110 datë 24.07.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”.

110 Me ligjin nr. 144/2013 vepra penale e “Trafikimit të femrave”, neni 114/b u shfuqizua duke përfshirë trafikimin e femrave tek neni 110/a i KP.

111 Strategjia e luftës kundër trafikimit të personave dhe plani i veprimit 2014 – 2017, VKM nr. 663 datë 17.07.2013 dhe VKM nr. 814 datë 26.11.2014.

Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale<sup>112</sup> vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore ku përfshihet dhe trafikimi i femrave si dhe ajo e trafikimit të të miturve do të gjykohej nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm.<sup>113</sup> Gjykimi për një periudhë 14 vjeçare i këtyre çështjeve nga Gjykata për Krime të Rënda ka bërë të mundur zbatimin e standardeve mbi trajtimin e viktimave, aplikimin e bashkëpunëtorëve të drejtësisë, dëshmitarëve të mbrojtur, pyetjen në distancë dhe zbatimin e një politike penale adekuate ndaj autorëve të këtyre veprave penale.

Nga 19 dhjetor 2019, Gjykata e Krimeve të Rënda u emërtua si Gjykata e Posaçme për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar dhe nuk ka më në kompetencë veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore përveçse kur ata kryhen në kuadër të formave të veçanta të bashkëpunimit, por në memorien e saj institucionale, në arkivat e saj gjyqësore dhe në përvojën e gjyqtarëve ekzistues të kësaj Gjykate ka qindra çështje të veprave penale të trafikimit të femrave për prostitucion e trafikimit të të miturve.

Prandaj dhe është e rëndësishme përcjellja e kësaj eksperience të mirë në trajtimin e këtyre çështjeve edhe për prokuroritë e gjykatat e tjera të juridiksionit të përgjithshëm, gjyqtarët e të cilëve do të kenë tashmë para tyre për gjykim këto çështje delikate. Këtë synon dhe ky manual.

## 7.2 NDRYSHIMET E REJA NË LEGJISLACIONIN TONË PENAL DHE PROCEDURAL

Legjislacioni penal dhe ai procedural kanë ndryshuar në drejtim të adaptimit të “viktimologjisë” si koncept. Me ndryshimet në legjislacionin penal në vitin 2013 në nenin 52/a të Kodit Penal, u fut për herë të parë termi “viktima”, duke u parashikuar përrjashtimi ose ulja e dënimit për viktimat e trafikimit sipas së cilës, personat e dëmtuar nga vepra penale që lidhen me trafikimin e personit, mund të përfitojnë përrjashtimin nga dënimi, për kryerjen e veprave penale gjatë periudhës së trafikimit dhe në masën që ka qenë i detyruar ti kryejë ato veprime apo mosveprime të kundërligjshme.<sup>114</sup>

Ndryshimet në Kodin Penal sigurojnë mbrojtjen e viktimave nga vepra penale si në rastet vrasjeve ndaj personit, krimeve seksuale, ashtu dhe ndaj veprave penale të trafikimit. Kështu përsa i përket rrethit të personave të cilët gëzojnë mbrojtje Kodi Penal ka përrshirë dhe bashkëjetuesin apo ish-bashkëjetuesin, ndërsa tek krimet seksuale sigurojnë mbrojtje më të madhe për dinjitetin e personit ndaj veprimeve kërcënuese, degraduese apo ofenduese që mund të përbëjnë ngacmim seksual.<sup>115</sup>

Neni 110 mbi trafikimin e personave përrshin tashmë dhe trafikimin brenda territorit të vendit, një koncept ky i njohur nga Konventa e Këshillit të Evropës kundër Trafikimit. Viktima nga vepra penale e trafikimit është subjekt procedural me të drejta procedurale të caktuara ndaj së cilës organet proceduese duhet të përrmbushin një sërë detyrimesh. Kodi ka sanksionuar detyrimin pozitiv të organeve publike që të garantojnë që viktimat e veprës penale të trajtohen me respekt për dinjitetin e tyre njerëzor dhe të mbrohem nga ridëmtimi, gjatë ushtrimit të të drejtave të tyre.<sup>116</sup> Kështu, është parashikuar detyrimi për pjesëmarrjen si pale ne proces te viktimës se veprës penale, duke garantuar aksesin e saj ne procesin penal ne referim te përcaktimit te Vendimit Kuadër te BE mbi statusin e viktimave ne gjykimin penal te datës 15/03/2001.<sup>117</sup>

<sup>112</sup> Ligji nr. 35/2017 „Për disa ndryshime në ligjin nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale në RSH”

<sup>113</sup> Sipas dispozitave kalimtare të ligjit nr. 35/2017, nenet që rregullojnë kompetencën bëhen të zbatueshme me krijimin e Gjykatës së Posaçme Antikorrupsion dhe Krimin të Organizuar çështjet penale prandaj deri atëherë çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore e të miturve do të gjykohej nga Gjykata për Krime të Rënda.

<sup>114</sup> Ligji nr. 144/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895 datë 27.01.1995 “Kodi Penal i RSH”, të ndryshuar .

<sup>115</sup> Ligji nr. 144/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895 datë 27.01.1995 “Kodi Penal i RSH”, të ndryshuar.

<sup>116</sup> Neni 9/a i KPrP “Të drejtat e viktimës nga vepra penale”

<sup>117</sup> [https://ec.europa.eu/anti-trafficking/sites/antitrafficking/files/frameëork\\_decision\\_2001\\_220\\_on\\_standing\\_of\\_victims\\_in\\_criminal\\_proceedings\\_en\\_1.pdf](https://ec.europa.eu/anti-trafficking/sites/antitrafficking/files/frameëork_decision_2001_220_on_standing_of_victims_in_criminal_proceedings_en_1.pdf)

Gjithashtu, është zëvendësuar figura e “të dëmtuarit nga vepra penale” me termin “viktimë” dhe atë të «të dëmtuarit akuzues» me termin «viktima akuzuese», duke dhënë edhe përkufizimet e rregullimet përkatëse për këto subjekte në përputhje me Vendimin Kuadër të 15 marsit 2001 mbi qëndrimin e viktimave në procedimet penale, si dhe Direktivën 2012/29 /BE që e ka zëvendësuar këtë vendim.<sup>118</sup>

- ▶▶ Neni 58 i Kodit të Procedurës Penale të RSH, është riformuluar tërësisht dhe pas tij janë shtuar nenet 58/a dhe 58/b, në të cilin janë parashikuar si figura të posaçme viktimave e mitur dhe viktimave e abuzuar seksualisht apo subjekt i trafikimit. Në këto dy raste është parashikuar që viktimave të ketë edhe disa të drejta të posaçme që lidhen me vetë cilësitë e saj të veçanta;
- ▶▶ Është shtuar neni 59/a, i cili parashikon rastin e viktimave të shumta nga vepra penale, me qëllim shmangien e zvarritjes së procesit për këtë shkak, duke garantuar përfaqësimin e tyre nga i njëjti mbrojtës në rastet kur nuk ka pengesë;
- ▶▶ Në nenin 60 është parashikuar në mënyrë të detajuar përmbajtja e kërkesës së viktimës akuzuese, me qëllim mundësimin e zhvillimit të një procesi gjyqësor normal;
- ▶▶ Gjithashtu, është parashikuar se padinë civile në procesin penal mund ta ngrejë vetëm viktimave ose trashëgimtarët e saj.

## 7.3 GJYKIMI I VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT DHE TË DREJTAT E VIKTIMAVE GJATË PROCESIT GJYQËSOR PENAL

Në gjykimin e veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore, e në veçanti rastet kur kemi trafikim nëpërmjet shfrytëzimit seksual të femrave dhe të miturve, faza më e rëndësishme dhe delikate është ajo e gjykimin për shkak se në këtë fazë viktimat ballafaqohen me persona të tjerë, të akuzuarin e mbrojtësin e tij, sallën e gjykimin e publikun. Kontakti i gjykatës me viktimën e trafikimit mund të jetë dhe gjatë fazës së hetimeve paraprake, kur kërkohet sigurimi i provës së thënieve të viktimave të abuzuara nga trafikantët sipas nenit 316 të Kodit të Procedurës Penale (KPrP). Shkronja b) e këtij neni parashikon rastin tipik të sigurimit të provës së thënieve të dëshmitares/rit/viktimë nga veprimet e trafikimit të qenieve njerëzore:

- ▶▶ kur ka arsye të bazuara për të menduar se personi mund të jetë objekt dhune, kanosje
- ▶▶ për të dhënë para ose përfitime të tjera me qëllim që të mos bëjë dëshmi ose të bëjë dëshmi të gënjeshtërt.

Kërkesa për sigurimin e provës mund të paraqitet edhe në fillim të seancës paraprake sipas nenit 317 të KPrP.<sup>119</sup> Ndërkohë që me ndryshimet e fundit në KPrP, në nenin 318 është parashikuar që viktimave/ në këtë rast viktimave nga trafikimi, mund ti drejtohet prokurorit që ai të kërkojë sigurimin e provës.<sup>120</sup> Viktimave e

<sup>118</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?uri=CELEX%3A32012L0029>

<sup>119</sup> Neni 317 i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i RSH”.

<sup>120</sup> Neni 318 i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i RSH”.

trafikimit nga veprat penale të trafikimeve të qenieve njerëzore janë persona vulnerabël e në paaftësi për të njohur e kërkuar të drejtat e tyre si subjekte procedurale prandaj në këtë rast është e rëndësishme asistencë e nevojshme juridike e psikologjike në mënyrë që tu sigurohet mbrojtja falas. Viktima ose përfaqësuesi i saj marrin pjesë në seancën e sigurimit të provës.

Ky pozicionim i ri viktimës dhe kapaciteti i të drejtave procedurale efektive të tyre në legjislacionin tonë procedural, vjen si detyrim i zbatimit të Konventave të OKB<sup>121</sup> dhe Këshillit të Evropës<sup>122</sup> në të cilat ne kemi aderuar si vend e që janë pjesë e legjislacionit të brendshëm, (cituar më sipër në këtë punim) por edhe në njohje e duke i paraprirë adaptimit të legjislacionit evropian nën frymën akteve të tjera në kuadër të BE si:



- ▶▶ Direktiva 2011/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 5 prillit 2011, mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të këtij trafikimi, dhe zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA.123
- ▶▶ Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 25 tetorit 2012 “Vendosja e Standardeve Minimum mbi të Drejtat, Mbështetjen dhe Mbrojtjen e Viktimave të Krimit dhe Zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA.124

**Kujdes.** Vlerësimi i kriterëve mbi të cilat është bazuar kërkesa pasi kjo kategori dëshmitarësh janë kategoria me e dobët e personave ndaj të cilëve qofte presioni, dhuna psikologjike por dhe vetë ambienti apo fakti që janë të përfshirë në një procedim si persona që kanë dhënë deklaramë ndikon në qëndrueshmërinë thënieve të tyre e në mënyrë të veçantë në trajtimin e viktimave të trafikimit, shoqërimin e tyre në gjykatë, asistencën psikologjike dhe atë ligjore.

**E rëndësishme.** Kujdesi në trajtimin e viktimës në mënyrë që të shmanget jo vetëm dërgimi i deklaramit, të dhënave përfituese për procedimin apo ndryshimi i tyre para se ato të sigurohen por dhe riviktimizimi si rezultat i presionit të ambienteve të seancave të sigurimit të provës, kontakti me të pandehurin, ballafaqimi me të, avokatët apo familjarët e tij.

**Avantazhi.** Kur viktimat e trafikimit i janë nën proces mbrojtje efektive se mbrojtje të posaçme dhe gjenden përkohësisht në strehëzat antitrafik ose asistohen nga organizata dhe agjencive e organizatat e tjera që asistojnë psikologjikisht apo materialisht këtë kategori.<sup>125</sup> Si të tilla janë qendrat pritëse si Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit (QKPVT) që është institucion buxhetor nën varësinë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Qendra e saj ndodhet në Linzë, Tiranë dhe është qendra pritëse e cila ka mbuluar pritjen dhe akomodimin për viktimat e trafikimit që kanë qenë dëshmitarë në Gjykatën e Krimeve të Rënda. Qendra Psikologjike Vatra gjithashtu është një organizatë joqeveritare që ushtron aktivitetin në qytetin e Vlorës dhe ka strehuar një sërë viktimash të trafikimit, të gjitha raste të të integruara në kuadër të Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Antitrafik.<sup>126</sup>

Në çdo rast gjyqtari si ai i hetimeve paraprake, i seancës paraprake apo i gjykimit të çështjes duhet të kenë parasysh tërësinë e të drejtave të viktimave në tërësi e të miturve e atyre të trafikimit në veçanti të

121 Konventa e kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar dhe dy protokollet shtesë të tij, të ratifikuara me ligjin nr. 8920 datë 11.07.2002.

122 Konventa e Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, e ratifikuar me ligjin nr. 9642 datë 20.11.2006

123 <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?uri=CELEX%3A32011L0036>

124 <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?uri=CELEX%3A32011L0036>.

125 Këto qendra dhe agjenci janë në përbërje të Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Antitrafik dhe ndihmohen e asistohen nga Koordinatori Kombëtar Antitrafik, Ministria e Brendshme, ajo e Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale, IOM, OSBE etj.

126 [https://www.Koalicioni-Kombetar-i-Strehzave-Anti-trafik-ne-Shqiperi-935356589841050/?\\_rdc=1&\\_rdr](https://www.Koalicioni-Kombetar-i-Strehzave-Anti-trafik-ne-Shqiperi-935356589841050/?_rdc=1&_rdr)

parashikuara në mënyrë eksplicite nga KPrP.si më poshtë:



- ▶▶ Të ketë ndihmë mjekësore, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat, 127
- ▶▶ Të ketë në dispozicion një avokat mbrojtës, duke u përjashtuar në të njëjtën kohë nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarife gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale;
- ▶▶ të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen;
- ▶▶ të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal; të thirret në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore;
- ▶▶ të dëgjohet nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e saj si dëshmitar;

Gjykata duhet t'ia bëjë të ditur këto të drejta viktimës, megjithëse ky detyrim është dhe për prokurorinë gjatë fazës së hetimeve. Momenti i bërjes së ditur të këtyre të drejtave duhet të dokumentohet në procesverbal qoftë të sigurimit të provës, të seancës paraprake apo gjykimit të çështjes. Gjyqtari i seancës paraprake verifikon nëse prokuroria gjatë fazës së hetimeve ka përmbushur detyrimet nga subjekti procedural të viktimës. Gjatë seancës paraprake viktimja ka të drejtë të paraqesë pretendime në lidhje me veprimet hetimore të kryera ndaj autorit apo në njohje të saj/tij menjëherë pas të pandehurit.<sup>128</sup>

Viktima që nuk ka zotësi për të vepruar i ushtron të drejtat e saj nëpërmjet përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit të tij, përveçse kur kjo nuk është në interesin e viktimës. Kur vëren papajtueshmëri mes interesave të viktimës dhe atyre të përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit, gjykata cakton një kujdestar të posaçëm, në përputhje me dispozitat e Kodit të Familjes. Trashëgimtarët e viktimës kanë të drejtat e parashikuara.<sup>129</sup> Nëse trashëgimtari i viktimës është i mitur, ai përfaqësohet nga kujdestari ligjor.

### Çështje për diskutim:



- ▶▶ Cili do të jetë trashëgimtari ligjor dhe nëse referenca duhet të bëhet në dispozitat e Kodit Civil bazuar në radhën e preferimit.
- ▶▶ Trashëgimia a është gjendje fakti që mund të vlerësohet për shkak të raporteve të afërsisë e kujdesit ?
- ▶▶ Përcaktimi i viktimës duhet të jetë i varur nga trashëgimia.

Mund të ketë persona në një lidhje shumë të afërt me viktimën si dhe trashëgimtarë ligjorë në radhë preferimi të lartë, të cilët mund të kenë shpërndarur lidhjet me viktimën. Termi **“trashëgimtarë”** lehtëson proceduralisht fazën e hetimit e gjykimit, por në fakt si e tillë mund të jetë çdo anëtar i familjes.

<sup>127</sup> Neni 58 i KPrP “Të drejtat e viktimës së veprës penale”

<sup>128</sup> Paragrafi 4 i nenit 332/c sipas ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017.

<sup>129</sup> Të drejtat e parashikuara në shkronjat “a”, “e”, “ë”, “f”, “g” dhe “j”, të paragrafit 1, të nenit 58 të KPrP

Në mënyrë të veçantë Kodi ka shprehur e përcaktuar të drejtat e viktimës së abuzuar seksualisht dhe viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore<sup>130</sup> që veç të drejtave të parashikuara në nenet 58 dhe 58/a, të këtij Kodi, viktimat e abuzuar seksualisht dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore kanë gjithashtu të drejtë:

- ▶▶ të refuzojnë t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me jetën private, e cila qartësisht nuk ka lidhje me veprën penale;
- ▶▶ të kërkojnë të dëgjohen nëpërmjet mjeteve audiovizive, sipas parashikimeve të këtij Kodi.<sup>131</sup>

Për të miturin viktimat të veprës penale të trafikimit apo shfrytëzimit seksual, Kodi ka parashikuar në mënyrë të veçantë të drejtat dhe garancitë që njohu Konventa e Lanzarote,<sup>132</sup> sipas së cilave fëmija viktimë e trafikimit ka të drejtë:

- ▶▶ të shoqërohet nga një person i besuar prej tij;
- ▶▶ të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave personale;
- ▶▶ të kërkojë, nëpërmjet përfaqësuesit, që gjykimi të zhvillohet pa praninë e publikut.<sup>133</sup>

Gjykata duhet ta trajtojë viktimën e mitur të veprës penale duke mbajtur parasysh moshën, personalitetin dhe rrethana të tjera, me qëllim shmangien e pasojave të dëmshme për zhvillimin dhe edukimin e saj të ardhshëm. Nëse ekziston mundësia që viktimat është e mitur dhe mosha e viktimës nuk dihet, prezumohet se ajo është e mitur.

**Në lidhje me mundësinë e përdorimit si provë të pyetjes së të miturit gjatë fazës së hetimeve,** viktimat e mitur pyetet pa vonesë nga persona të specializuar për këtë qëllim. Biseda regjistrohet me mjete audiovizive, sipas parashikimeve të këtij Kodi. Ky regjistrim mund të përdoret si provë në procedimin penal dhe vlerësohet së bashku me provat e tjera, sipas kriterëve që parashikohen nga paragrafi 4, i nenit 361/a, të këtij Kodi. Kur viktimat e mitur është nën 14 vjeç, biseda zhvillohet në mjedis të përshtatura për të. Një gjë të tillë e parashikon dhe Kodi i Drejtësisë për të Miturit, i cili në nenin 39, 41 të tij ka parashikuar rregulla të veçanta për pyetjen e të miturit viktimë ose dëshmitar, dhe të miturin viktimë e shfrytëzimit seksual dhe dhunës seksuale.<sup>134</sup>

**Njoftimi i viktimës** për seancën gjyqësore mund të bëhet në mënyra alternative të njoftimit të saj, ai bëhet njëloj sikurse dhe njoftimi për herë të parë i të pandehurit në gjendje të lirë, referim ky në kryerjen e njoftimit sipas nenit 140 të KPrPdhe kur kjo nuk është e mundur pasi nuk dihen vendet ku ndodhet viktimat, njoftimi do të bëhet nëpërmjet depozitimit të aktit në kryesekretari.<sup>135</sup>

130 Neni 58/b i Kodit i shtuar me ligjin nr. 35/2017.

131 Këto të drejta janë reflektim i të drejtave të garantuara për viktimat nga Konventa e Palermos, ajo e Varshavës Konventa e Këshillit të Evropës "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore", e ratifikuar me ligjin nr. 9642 datë 20.11.2006 në mënyrë të veçantë nga Rekomandimi nr. (85) 11-Këshilli I Evropës, Vendimi Kuadër i BE mbi Statusin e Viktimave në Gjykimin Penal e datës 15.03.2001, Direktiva 2011/36BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 5 prillit 2011, mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të këtij trafikimi, dhe zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA, Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 25 tetorit 2012 "Vendosja e Standardeve Minimum mbi të Drejtat, Mbështetjen dhe Mbrojtjen e Viktimave të Krimin dhe Zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA.

132 Konventa e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual, e ratifikuar nga Parlamenti shqiptar me ligjin nr. 10 071 datë 9.2.2009

133 Shkronjat a, b, c të paragrafit të parë të nenit 58/a të KP.

134 Ligji nr. 37/2017 datë 30.03.2017 "Kodi i Drejtësisë për të Miturit". i cili hyn në fuqi me datën 1 janar 2018

135 Njoftimi për herë të parë i të pandehurit në gjendje të lirë.

- Në rastet e viktimave të trafikimit nuk mund të bëhet njoftimi publik nëpërmjet shpalljes siç bëhet për të pandehurit në gjendje të lirë sipas pag. 5 të nenit 140 të KPrP sepse një mënyrë e tillë njoftimi ekspozon atë në publik.
- Në rastin e viktimave të trafikimit për të njëjtën arsye nuk mund të zbatohet neni 138 i KPrP i cili parashikon njoftimin e viktimave nëpërmjet shpalljes publike pasi kjo mënyrë njoftimi i referohet rastit kur kemi viktimë një numër të madh personash nga një dëm në shëndet apo material e jo rasti i viktimës nga trafikimi.

**Procedura e gjykimit të veprave penale të trafikimit** duhet të mbrojë viktimën e në veçanti viktimën e mitur nga riviktimizimi dhe ekspozimi i jetës private apo detajeve që cenojnë personalitetin e integritetin e saj/ tij.<sup>136</sup>

Gjykata mund të vendosë që gjykimi të bëhet me dyer të mbyllura kur publiciteti dëmton moralin shoqëror, kur gjykohet e nevojshme për pyetjen e të miturit, ose viktimë vetë kërkon të zhvillohet gjykimi me dyer të mbyllura.<sup>137</sup>

Ndërsa shqyrtimi gjyqësor zhvillohet gjithmonë me dyer të mbyllura kur të miturit janë autorë të një veprë të tillë ose kur gjykohe të pandehur të rritur, të cilët akuzohen për kryerjen e veprave penale ndaj të miturve si viktimë, pavarësisht moshës së viktimës gjatë gjykimit.<sup>138</sup>

Në lidhje me zhvillimin e gjykimit me dyer të mbyllura, viktimë ose përfaqësuesi i të miturit viktimë mund të kërkojë që procesi të zhvillohet me dyer të mbyllura, qoftë edhe vetëm për një pjesë të procesit. Procedohet gjithmonë me dyer të mbyllura kur personi i dëmtuar është i mitur. Kjo dispozitë ka një rëndësi të madhe sistematike dhe praktike. Futja e normave të reja, që nuk kanë patjetër natyrë seksuale, pasi trafiku mund të ketë si qëllim punën e detyrueshme ose servitutit shtëpiak, - nënkupton që *la ratio* e normës nuk është mbrojtja më e madhe e nevojshme e personit të dëmtuar, sepse seksualiteti i tij është implikuar në kryerjen e veprës.

La ratio është për të kërkuar tek mbrojtjen e nevojshme të jetës personale të viktimës, kur janë dëmtuar nga veprat të mirat personale, që përfshihen në një gamë më të gjerë, duke përfshirë lirinë personale, lirinë e vetëvendosjes si në sferën seksuale ashtu edhe më në përgjithësi, kur pra personi ka qenë objekt i një dëmtimi të tillë sa e ka cenuar autostimën e tij dhe kuptimin e vetë vlerës së personit të tij. Në këtë situatë, publiciteti vetë mund të jetë një faktor rëndimi i pasojave të dhunimit.

Personi i dëmtuar duhet të informohet gjithmonë në momentin e kontaktit me autoritetin gjyqësor, të së drejtës së tij për të kërkuar që debati ose një pjesë e tij-tipikisht dëshmia e tij- të zhvillohet me dyer të mbyllura. Gjyqtari ose kryetari duhet më pas të vlerësojnë në një mënyrë jo shumë shtrënguese ekzistencën e rrethanave për marrjen e një vendimi të tillë. Kjo sipas Rekomandimit të Këshillit të Evropës nr. 85 (2011)<sup>139</sup>. Në çdo rast kjo e drejtë vihet në balancë me të drejtën e të akuzuarit për garantimin e barazisë së armëve gjatë procesit.

<sup>136</sup> Konventa e Këshillit të Evropës "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore", e ratifikuar me ligjin nr. 9642 datë 20.11.2006/Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 25 tetorit 2012, "Vendosja e Standardeve Minimum mbi të Drejtat, Mbështetjen dhe Mbrojtjen e Viktimave të Krimin dhe Zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA.

<sup>137</sup> Neni 340 i KPrP, paragrafi 1 shkronjat a, c, d.

<sup>138</sup> Rregullat Minimale Standard të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të miturit (Rregullat e Pekinit 1985) Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimin dhe Legjislacionit të Rinjtë (Udhëzimet e Riadit).

<sup>139</sup> Rekomandimi nr. (85) 11 i Këshillit të Evropës mbi Pozicionin e Viktimës në kuadrin e Legjislacionit dhe Procedurës Penale. Politikat e informimit dhe të marrëdhënies me publikun në kuadrin e instruksionit dhe të gjykimit të veprave penale duhet të kenë parasysh nevojën për të mbrojtur viktimën nga çdo publicitet që mund të paragjykojë jetën private ose dinjitetin. Nëse lloji i veprave penale, statusi i veçantë, situata ose siguria personale e palës së dëmtuar kërkojnë një mbrojtje të veçantë, procesi penal para vendimit duhet të zhvillohet me dyer të mbyllura dhe përhapja e të dhënave personale të viktimës duhet të jetë objekt i shtrëngimeve të përshtatshme.

Kërkesat për zhvillimin me dyer të mbyllura në Gjykatën e Krimeve të Rënda gjithmonë kanë patur rezistencën e të pandehurve të akuzuar e mbrojtësve të tyre të cilët kërkonin ballafaqimin me viktimë akuzuese në sallën e gjykimit. Në disa raste të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre janë larguar nga salla e gjykimit në shenjë proteste të pranimit nga ana e gjykatës së kërkesës për zhvillimin e seancës me dyer të mbyllura.

Një disavantazh në gjykimin e çështjeve të trafikimit është mungesa e njohurive apo pranimi i standardeve ndërkombëtare të avokatëve mbrojtës përse i përket trajtimit të viktimave të trafikimit të parashikuara nga normat ndërkombëtare të OKB e BE e të cilat ishin pjesë e legjislacionit të brendshëm tonin por akoma nuk ishin reflektuar në legjislacionin procedural. Prandaj parashikimi tashmë i këtyre të drejtave ndër të cilat dhe ajo për të kërkuar vetë viktimë apo përfaqësuesi i saj/tij/të miturit zhvillimin me dyer të mbyllura apo përdorimin si provë të pyetjes audio vizive gjatë hetimeve ndihmon gjyqtarët në praktikën e zbatimit të këtyre standardeve.

## 7.4 PRANIA E VIKTIMËS SË TRAFIKIMIT NË SEANCË GJYQËSORE DHE PYETJA E SAJ ME CILËSINË E DËSHMITARES NË SEANCË GJYQËSORE.

Gjatë seancës gjyqësore të shqyrtimit të çështjes viktimë e trafikimit mund të marrë pjesë në pozicionin e viktimës duke asistuar në proces gjyqësor ose në pozicionin e dëshmitares kur është e nevojshme pyetja e saj me këtë cilësi.<sup>140</sup> Pyetja e viktimës së trafikimit si dëshmitare e sidomos rasti kur kjo / ky është i mitur është pjesa me delikate e procesit.

Kur thëniet e dëshmitares/viktimë trafikimi janë siguruar gjatë hetimeve paraprake, apo seancës paraprake situata është më e thjeshtë pasi në seancë gjyqësore lexohen procesverbali i sigurimit të provës. Prania e viktimës së trafikimit si dëshmitar në seancë kërkon plotësimin e disa komponentëve që lidhen me:



- ▶▶ sigurinë
- ▶▶ shoqërimin
- ▶▶ pozicionimin e saj në ambientet e gjykatës apo sallën e gjykimit

Pyetja e viktimës së trafikimit mund të bëhet nëpërmjet mjeteve audio dhe audio vizive sipas nenit 361 paragrafi 8 i KPrP.<sup>141</sup> Kjo realizohet nëpërmjet lidhjeve me video konferencë ose duke e pyetur dëshmitaren, viktimën, nga një ambient i rezervuar për të ngjitur me sallën e gjykimit, ambient në të cilin ajo nuk ka pamje të drejtpërdrejtë me të pandehurin, avokatin dhe publikun.

Kjo mënyrë pyetje bëhet për të siguruar mbrojtjen e dëshmitarëve, viktimave të trafikimit nga kërcënimet serioze të të pandehurve dhe personave të tjerë, nëpërmjet të cilave krijoheshin vështirësi serioze për vërtetimin e fajësisë dhe dënimin e tyre.

Sallat e gjykimit duhen konceptuar për të realizuar një pyetje të tillë nëpërmjet video konferencës duke e vendosur dëshmitaren në një ambient në gjykatë ose nga një ambient tjetër jashtë gjykatës ose nëpërmjet lidhjes audio me ambientin e veçantë për të ngjitur me sallën e gjykimit. Kjo mënyrë pyetje nëpërmjet lidhjes

<sup>140</sup> Sipas nenit 58 paragrafi 1 shkronja h) viktimë ka të drejtë të thirret nga gjykata në seancën e parë gjyqësore.

<sup>141</sup> Viktimat e veprave penale seksuale, veprave të trafikimit ose veprave të kryera brenda familjes kur e kërkojnë, mund të pyeten si dëshmitare nëpërmjet mjeteve audio dhe audiovizive.



audio apo audiovizive është praktikuar me sukses në proceset gjyqësore në gjykim në GJKR.<sup>142</sup>

Në një rast të tillë kryesuesi i seancës bën verifikimin e prezencës së dëshmitares/ viktimë dhe një sekretare mban paralelisht një procesverbal në ambientin ku ndodhet dëshmitari. Procesverbali i bashkëngjitet procesverbalit kryesor të seancës gjyqësor ose regjistrimit audio.

Sipas pikës 7 të nenit 361 të KPrP, pyetja e dëshmitares/viktimë në distancë mund të bëhet brenda territorit të vendit tonë ose jashtë vendit nëpërmjet video konferencës. Ligji parashikon që gjatë kësaj pyetje në distancë duhet të respektohen rregullat e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe dispozitat e Kodit tonë të Procedurës Penale. Dëshmitarja /viktimë trafikimi pyetet nëpërmjet lidhjes audio-vizive dhe personi i autorizuar nga Gjykata qëndron në vendin ku ndodhet ajo dhe bën identifikimin e tij, si dhe kujdesit për zhvillimin e rregullt të marrjes në pyetje e për zbatimin e masave të mbrojtjes. Këto veprime ai i pasqyron në proces-verbal.

Në rastet kur viktima/ e trafikuar zgjedh të jetë prezent gjatë gjykimit dhe të pyetet në prani të të pandehurit, gjykata duhet të bëjë kujdes mbi situatat në vijim:

- ▶ Viktima trafikimit/dëshmitarja, të shoqërohet nga punonjës policie dhe punonjës social ose psikologë mundësisht të së njëjtës gjini.<sup>143</sup> Në rastet kur viktima ndodhet e akomoduar në qendrat pritëse mbi viktimat mundësia e shoqërimit të tyre në mënyrë të asistuar është më e lehtë pasi gjykata urdhëron shoqërimin e saj nga punonjësit e qendrës pritëse.<sup>144</sup>
- ▶ Ajo shoqërohet në ambientet e gjykatës nga një hyrje që nuk është e aksesueshme për publikun dhe shoqërohet në një ambient të përcaktuar në mënyrë të posaçme për dëshmitaret (dhoma e dëshmitarëve) ambient në të cilën është e shoqëruar nga punonjësja sociale ose psikologjia, ku dhe qëndron derisa nëpunësi gjyqësor e thërret për tu paraqitur për pyetje.<sup>145</sup>
- ▶ Viktima /dëshmitare pozicionohet në një ambient në sallë që të ketë distancë të përshtatshme nga i akuzuari/ i pandehuri në mënyrë që ajo të mos intimidohet e të ndjejë presion psikologjik nga ballafaqimi më të pandehurin.
- ▶ Gjykata bën kujdes që gjatë pyetjes nga palët, prokurori, avokatët apo i pandehuri të mos përdoren pyetje, gjeste, sjellje, intonacione që të shkaktojnë presion psikologjik, intimidim, ekspozim të intimitetit apo fyerje e denigrim të viktimës së trafikimit e cila është paraqitur si dëshmitare.

Sipas nenit 361 b/ të KPrP, kur viktima e trafikimit është dëshmitare e mbrojtur dhe ka përfituar nga programi i mbrojtjes së dëshmitarëve ajo mund të pyetet sipas tonikave të veçanta të marrjes bën pyetje ndër të cilat përveç pyetjes në distancë, është dhe ajo e fshehjes së identitetit.<sup>146</sup>

<sup>142</sup> Shih vendimin nr. 77 datë 19.07.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të rënda në ngarkim të pandehurit L.M i akuzuar për veprën penale të "Trafikimit të të miturve" neni 128/b/3 i KP ku përshkruhet mënyra e pyetjes me video konferencë nga një ambient i brendshëm i Gjykatës i të miturës/ viktimë trafikimi A. F.

<sup>143</sup> Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 25 tetorit 2012 "Vendosja e Standardeve Minimum mbi të Drejtat, Mbështetjen dhe Mbrojtjen e Viktimave të Krimit dhe Zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA

<sup>144</sup> Bashkëngjitur këtij manuali do gjeni një listë të qendrave sociale në rang qarku të cilat mund të ofrojnë këtë shërbim.

<sup>145</sup> Shkronja b) e nenit 58 të KPrP.

<sup>146</sup> Teknikat e veçanta të marrjes në pyetje.

Në ligjin nr. 10173, datë 22.10.2009 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë" i ndryshuar, janë të përcaktuara rastet kur merret statusi i dëshmitares së mbrojtur dhe detyrimi i organeve të posaçme administrative për marrjen e masave të veçanta mbrojtëse, fizike dhe teknike, në vendin ku qëndron personi i mbrojtur, si dhe gjatë lëvizjes së tij, përfshirë edhe ato për përmbushjen e detyrimeve ndaj organeve të drejtësisë.<sup>147</sup> Në lidhje me ndryshimi i identitetit të dëshmitarit të personit që do të pyetet nga gjykata sipas nenit 361/b të KPrP, gjykata urdhëron marrjen e masave të përshtatshme në rast se është e domosdoshme njohja e identitetit ose këqyrja e personit, gjykata urdhëron thirrjen ose shoqërimin e detyrueshëm të tij me qëllim që të përmbushë këtë detyrim. Masat mbrojtëse që mund të urdhërojnë gjykata janë ato që kanë të bëjnë me fshehjen e të gjithë shënimeve që do të zbulonin identitetin e palës së dëmtuar apo të dëshmitarit, masat për të fshehur tiparet apo përshkrimin fizik të dëshmitarit, seancat me dyer të mbyllura për publikun.

Gjatë gjykimit të këtyre çështjeve nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nuk ka patur raste të dhënies së këtij statusi viktimave të trafikimit por gjithsesi kur ato kanë qenë dëshmitarë gjatë sigurimit të provës apo dëshmisë janë shoqëruar me punonjës policie për në Gjykatë të asistuar nga aktiviste të shoqërisë civile apo të organizatave të ndryshme që ushtrojnë aktivitete në këtë fushë.

#### 7.4.1 PYETJA E TË MITURIT VIKTIMË E TRAFIKIMIT

Për pyetjen e të miturit/rës viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, legjislacioni procedural penal dhe ai i drejtësisë për të miturit kanë parashikuar tashmë rregulla të reja për të ofruar garancitë maksimale për sigurimin e efektivitetit të marrjes së dëshmisë por ajo që është më kryesore trajtimin e përshtatshëm të të miturit.

Kodi i Drejtësisë për të Miturit jep përkufizimin e "të miturit", "të miturit viktimë", "riviktimizimit" si dhe "interesi më të lartë të të miturit."<sup>148</sup>

Neni 361 i KPrP parashikon rregulla të veçanta për pyetje e të miturit.<sup>149</sup> Kështu pyetja e të miturit/viktimë trafikimi në 14 vjeç bëhet pa praninë e gjyqtarit apo të palëve në ambientin ku ai ndodhet dhe kryhet nëpërmjet lidhjeve audiovizive ose audio. Pyetja bëhet nëpërmjet psikologut, edukatorit etj.

Pyetja e të miturit viktimë mbi 14 vjeç bëhet nga gjyqtari/kryesues i trupi gjykues që në rastin tonë të gjykimit në shkallë të parë korrespondon me gjyqtarin e çështjes duke bërë kujdes për të shmangur pasojat e dëmshme në shëndetin e tij në mënyrë që të mos impresionohet apo tensionohet emocionalisht gjatë pyetjes. Kur i mituri është dëgjuar gjatë hetimit dhe deklaratimet e tij janë regjistruar sipas paragrafit 4 të nenit 58/a të KPrP, ato përdoren si provë në gjykim nëse i pandehuri dhe mbrojtësi japin pëlqimin. Një gjë të tillë e parashikon dhe Kodi i Drejtësisë për të Miturit i cili në nenet 39 dhe 41 të tij ka parashikuar rregulla të veçanta për pyetjen e të miturit viktimë ose dëshmitar, dhe të miturin viktimë e shfrytëzimit seksual dhe dhunës seksuale.

Kjo e fundit përbën shmangie nga parimi i marrjes së provës në mënyrë të drejtpërdrejtë nga gjykata, dhe në dukje përbën një element të sistemit inkuizitor të procesit gjyqësor por duhet të kemi parasysh që e drejta e

<sup>147</sup> Ligji nr. 9205 dt. 15.03.2004 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë", i ndryshuar me ligjin nr. 10173 datë 22.10.2009 dhe ligjin nr. 32/2017 datë 30.03.2017. Sipas ligjit, Dëshmitari i drejtësisë" është personi, ndaj të cilit zbatohen masat e posaçme të mbrojtjes, i cili në cilësinë e dëshmitarit ose personit të dëmtuar, bën njoftime ose dëshmon për fakte dhe rrethana, që përbëjnë objekt prove në një procedim penal, për vepra penale të parashikuara në pikën 7 të këtij neni (përfshihen edhe veprat penale lidhur me trafikimin). Viktimat e trafikimit mund të paraqiten shpesh në këtë pozitë procedurale.

<sup>148</sup> Neni 3 "Përkufizime", Kodi i drejtësisë për të Miturit i miratuar me ligjin nr. 37/2017.

<sup>149</sup> Neni 361 i KPrP "Pyetja e të miturit", i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017.

viktimës së mitur në këtë rast konkurren këtë parim në kuadër të parimit të përgjithshëm të procesit të drejtë gjyqësor që ka si komponent thelbësor po respektimin e garancive për viktimat /të miturit.

### **Rast praktik 1:**

Pyetja me video konferencë e në të miture/ viktimë. Vendimi nr. 77 datë 19.07.2017. I pandehuri L.M akuzohet për veprën penale të “ Trafikimit të personave të mitur “ nenin 128/b/3 i K. Penal, ne dëm të viktimës së mitur A.F, vepër penale e kryer në bashkëpunim me persona të tjerë. Gjatë pyetjes së viktimës së mitur, Gjykata zbatoi dispozitat e parashikuara nga neni 361 i K.Pr.Penale dhe nenit 8 të ligjit 9110 datë 24.07.2003 “ Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave për Krime të Rënda “ , duke e pyetur të miturën nëpërmjet lidhjes audio-vizive, video konferencës e vendosur në dhomën e dëshmitarëve në Gjykatën e Krimeve të Rënda, duke arsyetuar se viktimë e mitur A.F është një person i mitur, vulnerabël , për shkak të moshës së saj të mitur por dhe gjendjes familjare, ekonomike në të cilën ndodhet. Në fund Gjykata ka arritur në konkluzionin se e mitura është trafikuar duke u shfrytëzuar fillimisht nga i dashuri i saj dhe më pas nga i pandehuri në një qytet në juglindje të Shqipërisë.

### **Çështje për diskutim :**

- A garanton pyetja e viktimës me anë të video konferencës mbrojtjen e saj nga sjellja e palëve dhe si duet vepruar në rastet kur nuk është e mundur aplikimi i pyetjes në një mënyrë të tillë.
- Çfarë kushtesh duhet të plotësojë pyetja në distancë për të garantuar debatin gjyqësor dhe kontradiktoritetin me qëllim vlerësimin e provës.

### **Rast Praktik 2:**

Vendimi nr. 47 datë 28.07.2009 e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tirane, ka dhënë Vendimin nr. 29 datë 11.06.2007 sipas të cilit i pandehuri A. K. është gjetur fajtor për veprat penale të “Trafikimit të femrave për prostitucion”, ne dem të shtetasës H. Xh.; “Shfrytëzim prostitucioni ne rrethana renduese”, kryer ne dem të shtetasës L. K., dhe “Falsifikim të dokumenteve”, “Falsifikim të pasaportave” , të parashikuara nga nenet 114/b/1, 114/a, pika 3,4,5,6 -25, 189/1, 186 dhe 278/a/2 i K.Penal dhe përfundimisht, ne bashkim të dënimeve është dënuar me 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjet burgim. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda.

Ndaj këtij vendimi është bere rekurs nga palët dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka dhënë Vendimin nr. 555 datë 03.12.2008, sipas të cilit Vendimi nr. 29 datë 11.06.2007 të Gjykatës së shkallës së Parë dhe Vendimi nr. 56 datë 11.12.2007 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, janë marrë në shkelje të ligjit procedural penal dhe si të tillë jane prishur duke e kthyer çështjen për rigjykim ne Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka konstatuar se “vendimet gjyqësore janë marrë në shkelje të ligjit procedural penal, posaçërisht dispozitave të nenit 158/ç/2 e 151/4 të K.Pr.Penale”. Pasi citohet neni 158/ç/2 i K.Pr.Penale, në faqen 8 të Vendimit nr. 555 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë arsyetohet se:

“Duke analizuar përmbajtjen e kësaj dispozite, vërehet se ligjvënësi, për shkak të ruajtjes së parimeve të një marrëdhënie shoqërore të rëndësishme, sikundër është ajo mes bashkëshortëve apo bashkëjetuesve, e ka përjashtuar këtë rreth subjektësh nga detyrimi

për te dëshmuar gjatë gjykimit të procedimit penal në ngarkim të të afërmeve të tyre, në lidhje me ngjarje e fakte mbi të cilat ato kanë dijeni. Posaçërisht, ligjvënësi i ka njohur një status të veçantë bashkëshortit, ish bashkëshortit, bashkëjetuesit apo personit të lidhur me birësim me të pandehurin në një procedim penal, duke e bërë të detyrueshme për organin procedurës që në çdo rast, edhe kur kallëzimi i veprës të jetë bërë nga këto subjekte, në momentin e administrimit të dëshmisë atyre duhet t'u bëhet e njohur e drejta për të mos dëshmuar. Në këtë mënyrë, vet ligjvënësi e ka veçuar këtë rreth subjektësh nga personat e tjerë që parashikon neni 16, te cilët pavarësisht lidhjes me të pandehurin, për sa kohë janë në cilësinë e kallëzuesit nuk mund të përjashtohen nga detyrimi për të dëshmuar...

Në rastin konkret, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson se ka qenë detyrim i gjykatës që zhvilloi seancën gjyqësore dhe mori dëshminë e shtetases H. Xh., që konform nenit 158/ç të K.Pr.Penale, në momentin kur mori dijeni për lidhjen mes të pandehurit dhe të dëmtuarës, t'i bënte të njohur kësaj te fundit te drejtën që ajo kishte për të mos dëshmuar..... Për shkaqet e mësipërme, dëshmia e te dëmtuarës H. Xh. përben një prove të administruar ne shkelje te ligjit (neni 151/4 I K.Pr.Penale), e për rrjedhojë vendimet gjyqësore te cilat u bazuan ne te duhet te prishen.....Ne marrjen e provave gjate rigjykimit te çështjes është detyrim i gjykatës respektimi me rigorozitet i dispozitave te procedurës penale me qellim përmbushjen e parimit te zhvillimit te një procesi te drejte ligjor. Duke qene se ne vetvete prova, dëshmia e te dëmtuarës H. Xh., nga pikëpamja juridiko-formale nuk është e një karakteri te papërsëritshëm, atëherë gjykata e faktit do të duhet të sigurojë rimarrjen e saj, konform dispozitave procedurale penale”

Në bazë të nenit 440 dhe 447 të K.Pr.Penale, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, gjatë hetimi gjyqësor te kësaj çështje ka qenë e obliguar që të respektojë dhe t'i përmbahet Vendimit nr. 555 date 03.12.2008 të Gjykatës së Lartë, për çdo çështje të së drejtës që është vendosur në të, si dhe të zbatojë detyrat dhe konkluzionet e këtij vendimi të Gjykatës së Lartë.<sup>150</sup>

### **Çështje për diskutim:**

A përbën raporti/gjendja e faktit në mes të viktimës dhe trafikantit një gjendje bashkëjetese në kuptim të asaj që përcakton KF dhe përjashtim nga e drejta për të mosdëshmuar në kuptim të nenit 158/2 të KPrP ?

Gjykata Kushtetuese me Vendimin nr. 40 datë 22.11.2011 mbi pretendimin e kërkuarit A.K për shkelje të nenit 32/2 të Kushtetutës, shprehet se: “Kufizimet e të drejtës për të mos dëshmuar janë parashikuar nga nevoja që të dëgjohen në fazën e gjykimit personat që kanë bërë kallëzim për veprën penale të cilët e kanë tejkalluar konfliktin e brendshëm psikologjik, midis detyrimit ligjor për të dëshmuar të vërtetën dhe detyrimit moral për të mos dëmtuar të afërmit e tyre. Në këto kushte, Gjykata vëren se nuk gjen zbatim parashikimi i nenit 158/2 të KPrP, me pasojën që kjo shtetase kishte detyrimin të dëshmonte dhe se për gjykatën nuk lindte asnjë detyrim për ta njohur atë, për mundësinë/të drejtën për të hequr dorë nga dhënia e dëshmisë.”

<sup>150</sup> Vendimi nr. 47, datë 28.07.2009 e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

### Rast praktik 3. - Trafikim i brendshëm i një të miture.

Prokuroria për Krime të Rënda mbi bazën e materialit të dërguar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë ka regjistruar në datën 16.07.2010 procedimin penal nr. 71 në ngarkim të të pandehurve B. U., D. U. dhe T. T. për veprën penale “Trafikim i të miturve”, parashikuar nga neni 128/b/3 i Kodit Penal.

**Rrethanat e faktit:** E dëmtuara e mitur M.H, banon në Durrës me prindërit, dy vëllezërit dhe tre motrat. Çdo ditë e dëmtuara shkonte në Portin e Durrësit ky lypte dhe paratë që fitonte i çonte në familje. Në muajin korrik 2011 ndërsa lypte në Portin e Durrësit është njohur me të pandehurin B., i cili i ka thënë se do të shkonte me të në Tiranë për të punuar. E dëmtuara e ka pyetur se çfarë pune do të bënte dhe i pandehuri i ka thënë se “do të shkonte me njerëz me lekë dhe lekët do ti ndanin bashkë”. E dëmtuara ka pranuar dhe bashkë me të pandehurin Bledar kanë udhëtuar me tren nga Durrësi për në Tiranë. I pandehuri B. e ka çuar fillimisht të dëmtuarën në shtëpinë e tij në Lezhë, ku e ka prezantuar të dëmtuarën me familjen si “nusen” e tij. E dëmtuara ka qëndruar dy net shtëpinë e të pandehurit B. dhe më pas janë nisur bashkë për në Tiranë.

Në Tiranë i pandehuri B. e ka çuar të dëmtuarën tek lulishtja pas godinës së Pallatit të Kulturës, ku ka filluar të ushtrojë prostitucion me klientët që gjente i pandehuri. I pandehuri B. U. gjente klientët, kurse të pandehurit D. U. dhe T. T. ruanin të dëmtuarën që të mos largohej prej tyre. Për çdo marrëdhënie seksuale e dëmtuara fitonte 5 mijë deri në 10 mijë lekë dhe të gjitha fitimet ia dorëzonte të pandehurve B, D dhe T. I pandehuri B. e keqtrajtonte sistematikisht të dëmtuarën për ta detyruar të fitonte më shumë pará. Ai i thoshte vazhdimisht: “...shko dil puno me klientët”. Ai e rrihte dhe godiste me thikë në trup dhe këto dëmtime janë ekzaminuar nga mjeku ligjor.

Ndërkohë që e dëmtuara detyrohej të prostituonte familja e saj kishte kallëzuar në polici faktin e mos gjetjes së saj. Vëllai i saj E. vihet në dijeni se motra e tij po shfrytëzohej si prostitutë në Tiranë dhe niset nga Durrësi për ta gjetur. Tek lulishtja pas godinës së Pallatit të Kulturës, ai gjen motrën bashkë me të pandehurit dhe fillon të debatojë me të pandehurit, të cilët nuk donin ta linin të dëmtuarën të largohej prej tyre. Në këto rrethana, E. nuk ka mundur të shpëtojë motrën prej të pandehurve. Të nesërmen në datë 16.07.2011, E. dhe i ati G. kanë shkuar tek lulishtja pas godinës së Pallatit të Kulturës, ku forcërisht kanë marrë të dëmtuarën dhe janë paraqitur në polici.

E dëmtuara ka dëshmuar se është detyruar të prostitutojë për rreth një muaj në vende të ndryshme në Tiranë dhe fitimet ia dorëzonte të pandehurve.

Dëshmia e të dëmtuarës përputhet me dëshminë e shtetasës R. Z. ka shpjeguar se e ka parë të dëmtuarën afër lokalit “Tajvan” në Tiranë me të pandehurin B. Ajo ka dëgjuar B. që e urdhëronte të dëmtuarën: “hajde shpejt të bëjmë lekë”. Akt ekspertimi mjeko-ligjor ku përcaktohet se: “...në trupin e viktimës gjenden 4 cikatrice në krahun e djathtë. Këto dëmtime janë shkaktuar me mjete të mprehta siç mund të jetë thikë...”.

### Argumentimi ligjor:

Gjykata pasi ka shqyrtuar provat në tërësi ka arritur në përfundimin se rekrutimi i të dëmtuarës nga të pandehurit është bërë me qëllim shfrytëzimin e saj si prostitutë për të fituar të ardhura financiare. Pra, rekrutimi i të dëmtuarës nuk është bërë rastësisht nga të

pandehurit, por ai është bërë me një qëllim të caktuar për të përfituar nga shfrytëzimi i saj si prostitutë. Si rrjedhojë, e dëmtuara ka ushtruar prostitucion në vende të ndryshme në Tiranë, tek kodrat e liqenit artificial dhe pas godinës së Pallatit të Kulturës. Gjatë ushtrimit të prostitucionit e dëmtuara ka qenë gjithmonë në praninë e tre të pandehurve, të cilët e ruanin. Fakti i shfrytëzimit të të miturës si prostitutë provohet nga dëshmitë e dëshmitarëve dhe të dëmtuarës. Gjatë kësaj kohe e dëmtuara i është nënshtruar dhunës së kryer kryesisht nga i pandehuri B. U., i cili ka rekrutuar të miturën.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin nr. 46, datë 27.07.2011 ka vendosur: Deklarimin fajtor të të pandehurit B.U. për veprën penale të “Trafikimit të të miturve” parashikuar nga neni 128/b/3 i Kodit Penal dhe dënimin e tij përfundimisht me 15 vjet burgim dhe 6 milionë lekë gjobë. Deklarimin fajtor të të pandehurit D.U. për veprën penale të “Trafikimit të të miturve” parashikuar nga neni 128/b/3 i Kodit Penal dhe dënimin e tij përfundimisht me 15 vjet burgim dhe 6 milionë lekë gjobë.

Deklarimin fajtor të të pandehurit T. T. për veprën penale të “Trafikimit të të miturve” parashikuar nga neni 128/b/3 i Kodit Penal dhe në zbatim të nenit 51 të Kodit Penal dënimin e tij përfundimisht me 7 vjet e 6 muaj burgim dhe 6 milionë lekë gjobë.

#### Çështje për diskutim:

- ▶ Pyetja e viktimës së trafikimit të mitur para gjykatës dhe në prani të të pandehurve a përbën shkelje të standardit të trajtimit të viktimës së mitur ?
- ▶ Nga cilat kritere duhet vlerësuar aftësia dhe vullneti i viktimës për tu përballur me të akuzuarin në sallën e gjyqimit ?

## 7.5 ROLI I GJYQTARIT NË LIDHJE ME SISTEMIN E MBROJTJES SË VIKTIMËS

Roli i gjyqtarit në sistemin e mbrojtjes përkon pak a shumë me rolin e prokurorit por në përgjithësi është në pozita më pasive për shkak të nevojës për të ruajtur paanshmërinë në gjykimin e kërkesave të mundshme si dhe për shkak të natyrës së pushtetit.

**Roli i tij jashtëgjyqësor** shfaqet në pjesëmarrjen e tij apo të një përfaqësuesi tjetër gjyqësor në GTN (Grupi Teknik Ndërsektorial) që ngrihet pranë bashkive sikurse është shpjeguar më lart dhe që parashikohet në nenin 52 të Ligjit nr. 18/2017. Bazuar në parashikimet e tij si dhe në përgjithësi në kontributin që mund të japë një gjyqtar apo përfaqësues i gjykatës në takimet e GTN mund të evidentojmë se roli i tij përfshin:

- ▶ Vlerëson nivelin e rrezikut dhe sugjeron përfshirjen në PIM të nevojës për marrjen e masave të menjëhershme të mbrojtjes apo masave të tjera të mbrojtës.
- ▶ Vlerëson dhe jep sugjerime nëse janë kushtet për heqjen e përgjegjësisë prindërore apo kujdestarisë.
- ▶ Të ofrojë ekspertizën që lidhet me detyrat dhe funksionet e gjykatës dhe se si mund të realizohet sa më thjesht aksesin në sistemin gjyqësor.
- ▶ Të ndajë informacionin në lidhje me tarifat e shërbimit gjyqësor.
- ▶ Bazuar në praktikën gjyqësore mund të sugjerojë elementë të veçantë në hartimin e

kërkesave të ndryshme pranë gjykatës për të siguruar arritjen e vendimeve.

- Bazuar në praktikën gjyqësore mund të sugjerojë llojet dhe natyrën e provave apo të dhënave të rëndësishme që sigurojnë suksesin e kërkesave.

**Roli i gjyqtarit në sistemin e mbrojtjes**, përveç sa u tha më lart, mund të analizohet në procedurat, afatet dhe vendimmarrjen gjyqësore në lidhje me kërkesat e ndryshme që i drejtohen gjykatës në lidhje me:



- Masat mbrojtëse të fëmijëve ndaj dhunës në familje në kuadër të Ligjit 9669/2006, i ndryshuar. Në lidhje me masat mbrojtëse, gjyqtari mund të gjykojë tre lloj kërkesash:
- Kërkesa për vlefësimin e Urdhrit të policisë që njihet me emërtimin Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme [neni 13/1 LDHF] (UMPMM). UMPMM është marrë nga ana e policisë për shkak të natyrës tepër urgjente të rastit i cili dikton marrjen e masave të menjëhershme për ndalimin e dhunës, që merren nga organet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit. UMPMM ka efekt 48 orë. Brenda 48 orëve nga marrja e masave, organet përgjegjëse pranë Policisë së Shtetit, paraqesin përpara gjykatës kërkesë për vlerësimin e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe kërkesëpadi për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes. Kjo kërkesë gjykohet brenda 48 orëve nga paraqitja e kërkesës.
- Kërkesa për nxjerrjen e Urdhrit të menjëhershme të mbrojtjes (UMM). Kjo kërkesë shqyrtohet nga gjykata brenda 24 orëve kur viktimat është e mitur. Masat e caktuara në këtë urdhër kanë fuqi deri në caktimin e masave të mbrojtjes përmes Urdhrit të Mbrojtjes dhe zbatohen menjëherë. Gjykata do të caktojë gjithashtu një datë për vazhdimin ose ndërprerjen e urdhrit brenda 20 ditëve nga lëshimi i tij. Të dy urdhrat hyjnë në fuqi menjëherë pas lëshimit nga gjykata dhe janë të vlefshëm pavarësisht faktit nëse abuzuesi është njoftuar ose jo
- Kërkesa për nxjerrjen e Urdhrit të mbrojtjes (UM). Kjo kërkesë shqyrtohet nga gjykata brenda 15 ditëve. Masat e caktuara kanë fuqi deri në 12 muaj dhe zbatohen menjëherë pas nxjerrjes së urdhrit. Ato përbëjnë titull ekzekutiv dhe zbatohen nga zyra e përmbarimit. Shkelja e tyre përbën vepër penale të parashikuar nga neni 321 i Kodit Penal.

### Roli i gjykatës në lidhje me martesat nën moshë

Vajzat që martohen nën moshë janë viktimat kryesore të trafikimit. Ky lloj trafikimi raportohet të ndodhë për disa arsye: për të marrë lejen e qëndrimit ose lehtësuar shfrytëzimin seksual nën pretekstin e martesës. Martesat e hershme konsiderohet se kanë një ndikim të rëndësishëm në cënueshmërinë dhe rrezikun që një vajzë të trafikohet. Vajzat e detyruara në martesë në moshë të re (rreth 14 vjeçe) shpesh shpëtojnë pas disa vitesh dhe bëhen lehtësisht viktimat të llojeve të tjera të trafikimit. Vajzat që martohen në mënyrë të paligjshme nën moshën e pëlqimit janë zakonisht rreth moshës 15 vjeç. Martesat e hershme janë tipike për disa pjesë të komunitetit Rom. Martesat rregullohen midis familjeve të vajzës dhe dhëndrit dhe këto vajza janë shumë vulnerabël.<sup>151</sup>

<sup>151</sup> [https://ec.europa.eu/anti-trafficking/sites/antitrafficking/files/study\\_on\\_children\\_as\\_high\\_risk\\_groups\\_of\\_trafficking\\_in\\_human\\_beings\\_0.pdf](https://ec.europa.eu/anti-trafficking/sites/antitrafficking/files/study_on_children_as_high_risk_groups_of_trafficking_in_human_beings_0.pdf)





## KREU VIII



# KOMPENSIMI PËR VIKTIMAT E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

## 8.1 LEGJISLACIONI NDËRKOMBËTAR PËR KOMPENSIMIN E VIKTIMAVE

E drejta ndërkombëtare ka sanksionuar parime e standarde mbi bazën e të cilave mund të ndërtohen legjislacionet e brendshme të shteteve. Ajo e konsideron garantimin e të drejtës për kompensimin e viktimës së veprës penale si një institut të rëndësishëm për një drejtësi efektive, si dhe për mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave. Konkretisht, viktimat e trafikimit kanë të drejtën për kompensim të përshtatshëm dhe efektiv. Kjo përfshin të drejtën për kompensim për dëmet materiale dhe jomateriale që ato kanë pësuar, si dhe aksesin e tyre në drejtësi përmes mjeteve procedurale. Gjithashtu, shtetet duhet të garantojnë që, nëse një kompensim i tillë nuk mund të sigurohet nga trafikuesi ose autor i veprës penale, e drejta duhet të parashikojë mundësinë e kompensimit të viktimave nga shteti. Kështu, përmes krijimit një fondi të posaçëm që mund të financohet përmes përdorimit të aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara, shtetet mund të dëmshpërblejnë viktimat. Madje, përdorimi i aseteve të konfiskuara për të kompensuar viktimat duhet të jetë një mundësi prioritare në shtet.<sup>152</sup>

### 8.1.1 AKTET E SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE GLOBALE

**Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (UNTOC)**<sup>153</sup> dhe Protokollin e saj “Për parandalimin goditjen dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve” (Protokollin e Palermos 2003), parashikojnë detyrimin e shteteve palë për të siguruar kompensimin e personave të trafikuar, përmes:

- Sigurimit të së paku njëres prej procedurave ligjore, me qëllim që personat e trafikuar të kenë mundësi për kompensimin e tyre.
- Krijimit të mekanizmit për informimin e viktimës në lidhje me këtë të drejtë.
- Njohjen e mundësisë për kompensim të viktimave edhe jashtë kufijve të shtetit.

Neni 25 (2) i Konventës u kërkon shteteve që të vendosin dispozita për konfiskimin e aseteve të trafikimit. Neni 6 (6) i Protokollit të Palermos, kërkon nga Shtetet Palë të sigurojnë që sistemet e brendshme ligjore të përfshijnë masa që ofrojnë mundësinë e marrjes së dëmshpërblimit për dëmin e shkaktuar.

<sup>152</sup> Konventa e KE mbi masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore, neni 15(4); Udhëzimet e OHCHR mbi të drejtat e njeriut dhe trafikimin e qenieve njerëzore, 4.4; Neni 25 (2) i Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi krimin e organizuar ndërkombëtar.  
<sup>153</sup> Konventa UNTOC është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 15 Nëntor 2000 dhe është ratifikuar nga shteti shqiptar më 21.8.2002.

### Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO)

Në disa Konventa të ILO-s,<sup>154</sup> të ratifikuara nga Shteti Shqiptar, është sanksionuar e drejta për shpërblimin e dëmit në rastet:



- ▶▶ e punës së detyruar dhe,
- ▶▶ kur janë shkelur të drejtat e punëtorëve dhe të migrantëve.

Këto konventa vendosin detyrimin e shteteve që të parashikojnë standarde ligjore të punës për të siguruar kryerjen e pagave<sup>155</sup> dhe rregullimin e agjencive private<sup>156</sup>, në mënyrë që të mbrohen të drejtat e punëtorëve. Detyrimet përfshijnë edhe sigurimin e “shpërblimit të përshtatshëm” ndaj punëtorëve, të cilëve u janë shkelur këto të drejta<sup>157</sup>.

### “E drejta e butë”

Në vitin 1985, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi “**Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimi të Pushtetit**”<sup>158</sup>. Kjo deklaratë ka qenë akti i parë në nivel ndërkombëtar që ka krijuar një mbështetje të gjerë për të drejtën e viktimave të krimit për kompensim. Ajo erdhi menjëherë si rrjedhojë e lëvizjeve për të drejtat e viktimave që u zhvilluan në fund të viteve '70 në SHBA dhe në Evropë. Deklarata kërkon nga të gjitha shtetet që në baza të rregullta të shqyrtojnë legjislacionin e tyre ekzistues, përfshirë edhe kompensimin e viktimave. Kur kompensimi nuk është në dispozicion nga burime të tjera, siç mund të jetë zakonisht autori i veprës penale, shteti është përgjegjës që të ofrojë kompensimin. Në këtë rast, shteti duhet të ofrojë kompensim për viktimën që ka përjetuar dëmtime të konsiderueshme mendore ose fizike. Kjo deklaratë gjithashtu inkurajon të gjitha shtetet që të rrisin fondet nacionale për kompensimin e viktimave të krimit.

Manuali Praktik i ODIHR-it mbi “**Mekanizmat Kombëtarë të Referimit**” përfshin udhëzime mbi rëndësinë e dëmshpërblimit si një mënyrë për kthimin e shkeljes së të drejtave të personave të trafikuar dhe efektin e rëndësishëm restaurues dhe parandalues.<sup>159</sup> Në lidhje me këtë, Plani i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore i OSBE-së, rekomandon që shtetet të shqyrtojnë dispozita ligjore për konfiskimin e mjeteve dhe fitimeve të krijuara prej trafikimit dhe veprave penale të lidhura me të, si dhe mjetet e konfiskuara të përdoren në përfitim të viktimave të trafikimit.

<sup>154</sup> Konventa e ILO-s 29, e vitit 1930; nr. 105, e vitit 1957; nr. 97, Konventa e Migracionit për Punësim (1949) dhe nr.143, Punëtorët Migrantë (Dispozita Shtesë)1975.

<sup>155</sup> Konventa 95 e ILO-s mbi Mbrojtjen e Pagave.

<sup>156</sup> Konventa 181 e ILO-s mbi Agjencitë Private të Punësimin.

<sup>157</sup> Shih: Compensation for Trafficked and Exploited Persons in the OSCE Region, OSCE/ODHIR, 2008, fq.20

<sup>158</sup> Mund të gjendet në linkun: [www.un.org/documents/ga/res/40/a40r034.htm](http://www.un.org/documents/ga/res/40/a40r034.htm).

<sup>159</sup> Mekanizmat Kombëtarë të Referimit: Bashkimi i Përpjekjeve për Mbrojtje të Drejtave të Personave të Trafikuar, Manual Praktik (OSBE/ODIHR, 2004), faqe 83-87.

## 8.2 AKTET E SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE RAJONALE

### 8.2.1 AKTET E KËSHILLIT TË EVROPËS

Konventa e Këshillit të Evropës **“Për masat kundër trafikimit të qenieve Njerëzore” (2005)**<sup>160</sup>.

Kjo Konventë parashikon të drejtën e viktimave për dëmshpërblimin financiar nga trafikuesi, autor i veprës penale. Ajo siguron mbrojtje për të gjitha viktimat e trafikimit gra, burra dhe fëmijë, për të gjitha format e shfrytëzimit si, shfrytëzimi seksual, shfrytëzimi për punë ose për shërbime të detyruara, skllavërimi, heqja e organeve trupore. Sipas Konventës, dëmshpërblimi mund të jepet ose nga gjykata, pas konfiskimit të pasurive të trafikantëve, ose nga shteti ku ka ndodhur shfrytëzimi. Konventa kërkon që shtetet të sigurojnë së paku një prej mundësive ligjore dhe praktike për kompensimin {neni 15(3)}.

**“Konventa evropiane për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme” (ECCVVC)**<sup>161</sup>

Konventa parashikon kompensimin nga shteti, kompensim i cili kufizohet vetëm në dëmet materiale, në rastet kur vepra penale ka qenë një krim i qëllimshëm dhune me pasoja fizike ose mendore për shëndetin. Gjithashtu, parashikon nevojën që viktima të jetë një viktimë e tipave specifike të krimeve të dhunës. Sa u përket dëmeve të viktimës sipas kësaj Konvente, e drejta për kompensim nga shteti shtrihet vetëm për krimet që shkaktojnë dëme serioze dhe krimet e dhunshme.

#### E drejta “e butë”

Rekomandimi (85) 11 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, **për pozitën e viktimës në kuadrin e të drejtës dhe procedurës penale**, thekson “funksionin kyç” të drejtësisë penale për plotësimin e nevojave dhe mbrojtjen e interesave të viktimës. E drejta për kompensim konsiderohet e rëndësishme për të rritur vetëbesimin e viktimave në sistemin e drejtësisë penale dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen e tyre si dëshmitare.

### 8.2.2 E DREJTA E BASHKIMIT EVROPIAN

- Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, 25 Tetor 2012 vendos standardet minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit. Ajo zëvendëson vendimin kuadër të Këshillit 2001/220/JHA162. Direktiva kërkon nga shtetet anëtare të BE-së që në legjislacionin e brendshëm, të garantojnë të drejtën e viktimave për kompensim në tri aspekte kryesore:
  - ▶ E drejta për rimbursimin e shpenzimeve gjatë procedimit penal.
  - ▶ “Restitucioni” ose “e drejta për të kthyer pronën”.
  - ▶ E drejta për kompensimin nga shkelësi.
- Direktiva e Këshillit të BE-së 2004/80/EC **“Për kompensimin e viktimave të krimit”**<sup>163</sup>, rregullon aksesin ndërkufitar të viktimave të krimit ndaj kompensimit të dëmit, në shtetet

<sup>160</sup> Kjo konventë është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë më 22.12.2005 dhe ka hyrë në fuqi më 6.02.07.

<sup>161</sup> Kjo konventë është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 9265, dt. 29.07.2004.

<sup>162</sup> Kjo Direktivë mund të gjendet në linkun: [https://ec.europa.eu/anti-trafficking/sites/default/files/directive\\_2012\\_29\\_eu\\_1.pdf](https://ec.europa.eu/anti-trafficking/sites/default/files/directive_2012_29_eu_1.pdf)

<sup>163</sup> E gjindshme në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32004L0080>

anëtare të këtij bashkimi. Në bazë të saj, shtetet anëtare të BE-së sigurojnë që, kur një krim i dhunshëm me dashje është kryer në një shtet anëtar tjetër nga shteti anëtar ku kërkuesi për kompensim është banor i zakonshëm, viktimat ka të drejtë të paraqesë kërkesën tek një autoritet ose ndonjë organ tjetër në shtetin anëtar, ku është kryer krimi.

## 8.3 PËRVOJAT E SHTETEVE

Në legjislacionet e vendeve të ndryshme, mundësia e viktimave për të kërkuar kompensimin nga një trafikant ose shfrytëzues, ekziston kryesisht përmes ushtrimit të mjeteve të parashikuara në procesin civil dhe atë penal. Në procesin penal kërkimi i dëmit mundësohet përmes padisë civile në procesin penal, por ka edhe përvoja të tjera si ajo e SHBA-së, ku një padi kompensimi për viktimën, e njohur si *restitutio*, është automatikisht pjesë e procedimeve penale në çështjet e trafikimit. Gjithashtu, SHBA, ka edhe një numër të konsiderueshëm rastesh në të cilat kompensimi u është dhënë personave të trafikuar duke përdorur padinë civile brenda procesit penal. Në Mbretërinë e Bashkuar, ka mundësi për të ashtuquajturin “urdhri kompensues”, i cili jepet nga gjykata brenda procedurave penale, si pjesë e ndëshkimit të dhënë ndaj një të dënuari. Shuma e kompensimit nuk është fikse, por ndryshon në vende të ndryshme. Megjithatë, në të gjitha vendet, ekzistojnë probleme për ekzekutimin e kompensimeve të caktuara nga gjykatat, duke bërë që personi i trafikuar të kërkojë procedura të tjera që e detyrojnë trafikantin të paguajë dëmin<sup>164</sup>.

Kompensimi për dëmet mund të përfshijë kostot e trajtimeve mjekësore, fizike, ose psikologjike; kostot që i janë dashur viktimës për terapi fizike dhe të lidhura me punën; kostot e nevojshme për transport, kostot për kujdesin ndaj fëmijës, kostot për qira shtëpie; të ardhurat e humbura dhe/ose rrogën/paratë që viktimat i fitonte për trafikantin dhe detyrohej që t’ia dorëzonte atij; tarifa ligjore dhe kosto të tjera apo shpenzime të kryera; pagesën për dëme jomateriale, që janë shkaktuar nga stresi emocional, nga dhimbja dhe nga vuajtjet që ka pësuar viktimat si rezultat i krimit; çfarëdo lloj kostoje që i ka ndodhur viktimës si rezultat i drejtpërdrejtë i krimit.

### 8.3.1 LEGJISLACIONI SHQIPTAR NË LIDHJE ME TË DREJTAT E VIKTIMAVE PËR SHPËRBLIMIN E DËMIT

Në legjislacionin shqiptar gjejmë disa mekanizma që garantojnë të drejtën për dëmshpërblimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore. Në lidhje me to, veçojmë:



- të drejtën për të kërkuar dëmshpërblimin nga trafikanti/shfrytëzuesi, përmes procesit penal;
- të drejtën për të kërkuar dëmshpërblimin nga trafikanti/shfrytëzuesi, përmes procesit civil;
- të drejtën për dëmshpërblim nga fondet shtetërore.

Ndryshimet legjislative që ndodhin në kuadrin e Reformës në Drejtësi (2016) sollën disa përmirësime në statusin e viktimës, duke përfshirë edhe zgjerimin e aksesit të saj ndaj gjyqësorit, për të kërkuar shpërblimin e dëmit. Këtu do të veçonim sanksionimin e të drejtave të posaçme procedurale për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore<sup>165</sup>; zgjerimin e aksesit të viktimave të veprës penale për të kërkuar jo vetëm dëmin material por edhe atë moral, përmes padisë civile në procesin penal<sup>166</sup>; përjashtimin e viktimës nga shpenzimet e tarifave gjyqësore<sup>167</sup>.

<sup>164</sup> Mekanizmat Kombëtarë të Referimit: ... cituar, fq. 24-25.

<sup>165</sup> Shih: nenin 58/b i KPrP & neni i ligjit “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

<sup>166</sup> Shih: nenin 61 të KPrP

<sup>167</sup> Shih: nenin 58/gj të KPrP

## **E drejta e viktimës për të kërkuar shpërblimin e dëmit material e moral në procesin penal. Padia Civile në Procesin Penal**

Ligji i ri për ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale sanksionon të drejtën e viktimës të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal. Me ndryshimin që ka pësuar neni 61 i KPrP, është sanksionuar jo vetëm e drejta që viktimat të kërkojë në procesin penal shpërblimin e dëmit material, por edhe dëmin moral. Kjo mundësi e re është një hap i rëndësishëm për viktimat e veprës penale e në mënyrë të veçantë, për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Kjo është një e drejtë që ushtrohet mbi bazën e kërkesës së vetë viktimës, prandaj informimi i kësaj të fundit, është shumë i rëndësishëm për mbarëvajtjen e të drejtës. Deri më sot, procesi penal ka qenë krejt i pafuqishëm të sigurojë gjykimin e padisë civile në procesin penal. Në gjykimin e veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore, Gjykata e Krimeve të Rënda i ka veçuar nga procesi penal kërkesat për shpërblimin e dëmit dhe nuk gjejmë ndonjë rast ku ajo të ketë vendosur së bashku me vendimin e fajësisë për të pandehurin. Prandaj, çështja që shtrohet është se si mund të ndihmojë zbatimi i Kodit të Procedurës Penale që ky mjet të ketë efektivitet dhe të mos mbetet një mjet deklarativ dhe formal. Teorikisht, kërkitimi i dëmit moral do të ketë më tepër efektivitet në procesin penal, meqenëse procesi i të provuarit, lidhet drejtpërdrejt me procesin e të provuarit të fajësisë së të pandehurit. Në këtë situatë, prokurori mund të mbledhë prova edhe për shpërblimin e dëmit, kurse gjykata do ta ketë më të lehtë të vendosë një masë dëmshpërblimi moral për viktimën. Në këto raste, nuk është e nevojshme të veçohet padia civile nga procesi penal. Nga ana tjetër, është e nevojshme të ndiqet një praktikë e re për të garantuar efektivitetin e këtyre dispozitave. Meqenëse si shkak kryesor për të vonuar procesin ka qenë mungesa e provave, ligji jep të gjitha mundësitë që këto prova të administrohen qysh në fazën e hetimit. Oficeri i policisë gjyqësore mund të mbledhë provat përkatëse për faktet që vërtetojnë dëmin. Në nenin 58 të KPrP që sanksionon të drejtat e viktimave në kuptimin e përgjithshëm, ligjvënësi ka shtuar dispozitën me këtë përmbajtje: “Viktima e veprës penale ka të drejtë të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtojë kërkesa të tjera përpara organit procedues”. Sidomos dëmi moral mund të çmohet automatikisht nga gjykata mbi provat e administruara në dosje nga Prokurori. Kjo praktikë do të qaste më mirë të gjitha veprimet e prokurorit, me qëllim që në fashikullin përkatës të përfshiheshin edhe kërkesa për padinë civile në procesin penal, shoqëruar nga provat e paraqitura, sikurse parashikon edhe neni 332, pika 1/a e tij.

Një problem i dukshëm që pengon aksesin e viktimave të veprës penale për shpërblimin e dëmit të ardhur nga kjo vepër, ka qenë e mbetet mosekzekutimi i vendimeve të gjykatave. Nga një monitorim, konstatojmë se, në të gjitha rastet ku gjykatat civile kishin pranuar kërkesën për shpërblimin e dëmit për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, nuk kemi asnjë prej tyre të ekzekutuar. Këto mungesa kanë disa faktorë, që lidhen me mangësi në legjislacion dhe moskuptim të drejtë të tij<sup>168</sup>.

## **E drejta e viktimës për të kërkuar shpërblimin e dëmit material e moral në procesin Civil**

Kodi Civil parashikon mundësinë për kompensim në procesin civil, në rastin kur një person është dëmtuar në mënyrë të paligjshme. E drejta për t’iu drejtuar gjykatës civile me kërkesë, u njihet edhe të huajve.<sup>169</sup> Përmes procesit civil, viktimat e veprës penale mund të kërkojë si dëmin material, ashtu edhe dëmin moral.

<sup>168</sup> CLCI, Raport, “Promotion of the rights of trafficked persons in Albania”, Tirane 2015, f.81.

<sup>169</sup> Neni 3 i Kodit.

Në nenin 625 të Kodit Civil identifikojmë kuptimin e dëmit moral të ardhur nga vepra penale, i cili mund të kërkohej:



- Kur personi ka pësuar një dëmtim të shëndetit ose është cenuar në nderin e personalitetit të tij.
- Është fyer kujtimi i një të vdekuri dhe kërkohej nga bashkëshorti me të cilin ka bashkëjetuar deri në ditën e vdekjes (ose nga të afërmit e tij deri në shkallën e II-të).

Kuptimi i dëmit moral është trajtuar edhe nga doktrina, por vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara, nr. 12/viti 2007, na vjen në ndihmë duke përcaktuar hollësisht kuptimin e dëmit moral, përfshirë edhe atë të dëmit ekzistencial, si një formë e posaçme e tij.

Në lidhje me shpërblimin e dëmit moral dhe përlogaritjen e tij, nuk ka përcaktime të posaçme të parashikuara nga Kodi Civil. Edhe praktika gjyqësore nuk ka krijuar ndonjë skemë referuese, duke e lënë vlerësimin e dëmit në çmim të gjyqtarit, rast pas rasti<sup>170</sup>.

Edhe legjislacioni i punës mund të shihet si një mundësi e mirë për të kërkuar dëmshpërblimin ndaj shfrytëzuesit në rastet e trafikimit për shfrytëzimin për punë. Sidoqoftë, në këtë aspekt, legjislacioni ynë i punës ka nevojë për disa përmirësime. Një prej tyre mund të ishte parashikimi i veprimeve mbështetëse nga palë të treta kundrejt një punëdhënësi shfrytëzues, për të ndihmuar personat e trafikuar me padi përfaqësuese, duke shmangur nevojën që viktimat ta ndjekin rastin individualisht.

### **E drejta e viktimës për t'u përjashtuar nga shpenzimet. Kodi i Procedurës Penale.**

Ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale (KPrP) parashikuan rishtazi të drejtën e viktimës që në kushte të caktuara me ligj, të përjashtohet nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve, si dhe tarifave gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë, që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale (neni 58/gj). Kjo e drejtë është mjaft e rëndësishme për aksesin në drejtësi të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore. Sanksionimi i saj e përçkas Kodin e Procedurës Penale me legjislacionin e Bashkimit Evropian, konkretisht me Direktivën 2012/29/EU (sipërpërmendur). Realisht, sanksionimi me ligj krijon mundësi të reja për ushtrimin e të drejtës për kërkimin e dëmit, përmes padisë civile në procesin penal.

Ky parashikim duhet trajtuar si e drejtë që zbatohet drejtpërdrejt nga institucionet, dhe jo si një e drejtë që përfitohet vetëm me kërkesën e viktimës. Deri tani, në pak raste është zbatuar kjo e drejtë. Përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale, ka pasur pamundësi për të kërkuar dëmin material e moral për shkak të shpenzimeve paraprake që kërkoheshin<sup>171</sup>. Në disa raste, viktimat e trafikimit janë sprapsur nga ky kërkim, pasi nuk mund të paguanin këto shpenzime, sidomos për qindjen e objektit të padisë, i cili ka shkuar nga 1% deri në 3% të shumës së kërkuar, sipas legjislacioneve në kohë të ndryshme. Sidoqoftë, jurisprudenca ka disa përvoja. Kështu, p.sh., në vitin 2008, Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda, pas një interpretimi që i ka bërë dispozitave të KPrP<sup>172</sup>, ka përjashtuar nga të gjitha detyrimet financiare viktimën e trafikimit, në procesin për shpërblimin e dëmit të ardhur nga vepra penale, përmes padisë civile në procesin penal. Megjithatë, këto vendime gjyqësore mbeteshin të izoluara. Vetëm ligji si një normë e përgjithshme krijon mundësi për të përmbushur këtë të drejtë në çdo rast të kërkimit të dëmit. Me

<sup>170</sup> Për më gjerë, shih Rezarta Mataj, *Disa sugjerime mbi vlerësimin sa më të drejtë të padisë: "Shpërblimi i dëmit jopasuror. Neni 608 dhe 625 i Kodit Civil, botuar në "Jeta Juridike", nr. 2, dhjetor 2007*

<sup>171</sup> Shih: SHADOW REPORT Submitted to the 64th session of CEDAW, në: [http://www.qag-al.org/ang/publication/shadow\\_report.pdf](http://www.qag-al.org/ang/publication/shadow_report.pdf); i përkthyer në gjuhën shqipe, në: [http://www.qag-al.org/publikime/raporti\\_upr.pdf](http://www.qag-al.org/publikime/raporti_upr.pdf); parag. 5.

<sup>172</sup> Shih vendimi i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, nr. 19, dt. 20.03.2008.

ndryshimet e reja ligjore, situata e shpërblimit të dëmit përmes padisë civile në procesin penal pritet të ndryshojë. Parashikimi në Kodin e Procedurës Penale garanton zbatimin e saj, si një normë e detyrueshme për të gjitha llojet e veprave penale.

### Probleme të zbatimit të legjislacionit për kërkimin e dëmit

Aktualisht, rastet e kërkesave me këtë objekt mbeten ende mjaft të pakta. Kjo, për shkak të informimit dhe ndërgjegjësimit të ulët të subjekteve të legjitimuara, në lidhje me këto të drejta, si dhe të jurisprudencës gjyqësore të pazhvilluar. Gjithashtu, një problem tjetër është se, kjo dispozitë duhet të pranohet dhe të zbatohet jo vetëm nga gjykatat penale, por edhe nga ato civile që marrin në shqyrtim kërkesat e viktimave të veprave penale për shpërblimin e dëmit. Nga praktika rezulton se veçimi i padisë civile nga procesi penal, është një masë që gjykata penale e ndërmerr në mënyrë të vazhdueshme. Por, gjykata civile zbaton Kodin e Procedurës Civile dhe aktet ligjore për tarifat gjyqësore. Madje, ka pasur edhe raste kur nga Gjykata Civile kërkesëpapia është kërkuar të ringrihet mbi bazën e kërkesave të Kodit të Procedurës Civile, duke paguar detyrimet për të filluar gjithçka nga e para. Ky është një interpretim i gabuar i ligjit. Pas vendimit të ndërmjetëm për veçimin e padisë civile nga procesi penal, ajo duhet të transferohet sikurse në rastet e transferimit të dosjeve për kompetencë. Në këtë rast, nuk ka vend për zbatimin e ligjit për tarifat gjyqësore në RSH<sup>173</sup>. Ky ligj ka qëllim përcaktimin e tarifave gjyqësore në gjykimin e çështjeve civile, administrative dhe në gjykimin në Gjykatën Kushtetuese. Pavarësisht se në rastin tonë zhvendosemi përpara një gjykimi civil, shkaku ligjor është ai që buron nga gjykimi penal. Sidoqoftë, mbetet të shohim praktikën që do të ndjekin gjykatat për këtë çështje. Ajo që këshillojnë avokatët në lidhje me këtë diskutim është që, të procedohet me padinë civile qysh në procesin penal (neni 61 e në vijim të KPrP). Më tej mund të vijohet me gjykatën civile, nëse gjykata penale do të vendosë veçimin e padisë civile nga procesi penal.

Për të përmbushur këto të drejta që njeh Kodi i Procedurës Penale, ka nevojë për një mentalitet të ri të gjykatave, për të respektuar të drejtën për përjashtimin e viktimave të veprës penale nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore. Kjo është një e drejtë e rëndësishme jo vetëm për aksesin e viktimave në drejtësi, por edhe për zbatimin e parimit të “zellit të duhur” nga ana e shtetit, pavarësisht nga fakti nëse institucionet shtetërore kanë qenë përgjegjëse drejtpërdrejt apo tërthorazi, për ardhjen e veprës penale.

Problem mbetet edhe mungesa e efektivitetit të organeve të drejtësisë dhe institucioneve të tjera shtetërore për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, që kanë vendosur shpërblimin e dëmit për viktimat<sup>174</sup>. Megjithatë, faktorët kryesorë për këtë situatë mbeten jo vetëm mungesat në legjislacion, por edhe paragjykimet dhe stigmatizimi ndaj viktimave. Në fakt, përfitimet e kryera nga trafikantët nëpërmjet aktivitetit të tyre shfrytëzues, duhet të përdoren në dobi të viktimave të trafikimit, individualisht ose në mënyrë kolektive.

### Ndihma Ligjore Falas

Ndihma ligjore falas është parashikuar nga ligji “Për Ndhimën Juridike të garantuar nga Shteti”, i cili, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore i parashikon si subjekte të posaçme që përfitojnë nga kjo ndihmë. Ky ligj, krijon sistemin e ndihmës dhe përcakton subjektet që e përfitojnë këtë ndihmë. Përfituesit ndahen në kategori të përgjithshme (neni 10) dhe kategori të veçanta (neni 11). Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore si kategori e veçantë, përfitojnë këtë ndihmë në të gjitha fazat e procesit gjyqësor. Ky sanksionim është i lidhur edhe me KPrP, i cili ka parashikuar si kategori të veçanta viktimat e abuzuara seksualisht dhe viktimat

<sup>173</sup> Ligji Nr. 98/2017 “Për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>174</sup> Vendimi gjyqësor që njeh një dëmshpërblim ndaj viktimës së trafikimit D.S., nuk ekzekutohet që nga viti 2014, vit në të cilin ka marrë formë të prerë.

e trafikimit të qenieve njerëzore (nenin 58/b).

Pyetja që shtrohet është se, çfarë i dallon viktimat si kategori e veçantë, të parashikuara nga neni 11 i ligjit, nga përfituesit si kategori e përgjithshme. Për subjektet e parashikuara nga neni 10, ligji shprehet se, "...e përfitojnë ndihmën juridike nëse përmbushin kushtet e parashikuara nga ky ligj" (neni 10/2). Nga një interpretim i dy neneve të ligjit, 10 dhe 11, që përcaktojnë përkatësisht subjektet përfituese, arrijmë në konkluzionin se subjektet e posaçme, ku përfshihen edhe viktimat e trafikimit, e përfitojnë ndihmën, pa iu nënshtruar kriterëve ekonomike të parashikuara nga ligji. Ky interpretim është mbështetur edhe nga studiuës të tjerë. Kështu, në raportin e monitorimit të Reformës në Drejtësi, është shprehur e njëjta pikëpamje, kur theksohet. "Ligji nr. 111/2017 zgjeron rrethin e subjekteve të cilët përfitojnë ndihmë juridike të garantuar nga shteti, duke parashikuar si përfitues disa kategori të veçanta (pavarësisht kriterit ekonomik) si viktimat e dhunës në familje; viktimat e abuzuara seksualisht dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore;..."<sup>175</sup>. Për më tej, mbetet të zbatohet nga gjykatat. Në praktikë janë vënë re raste ku gjykatat nuk e kanë kuptuar në këtë mënyrë zbatimin e nenit 11 të ligjit. Ato bëjnë interpretime të ndryshme të cilat kanë nevojë për unifikim. Kështu p.sh., në një rast me objekt "zgjidhje martesë" të gjykuar nga Gjykata e Rrethit gjyqësor Tiranë, kjo e fundit ka arsyetuar se, "Gjykata pasi mori në shqyrtim këtë kërkesë, në mbështetje të ligjit nr. 111/2017...vlerëson se nuk jemi në kushtet kur pala paditëse duhet të përjashtohet tërësisht nga shpenzimet për ekspert, për shkak se ky ligj parashikon përjashtimin e palës paditëse së dhunuar nga shpenzimet gjyqësore/dhe atë me ekspert në rastin e gjykimeve me objekt lëshimin e urdhrat të mbrojtjes dhe jo në çështjen me objekt zgjidhje martesë"<sup>176</sup>. Në fakt, është e paqartë se ku është bazuar gjykata për të bërë këtë interpretim, ndërkohë që ligji parashikon ndihmën falas për viktimat e dhunës në familje dhe jo për personat me urdhër mbrojtjeje. Interpretime të tilla mund të krijojnë sfida për zbatimin e këtij ligji edhe për viktimat e veprës penale. Aktualisht, ka nevojë për një monitorim të rasteve të zbatimit të këtij ligji në procesin penal, pasi deri tani, në caktimin e ndihmës me avokat janë zbatuar dispozitat e përgjithshme të Kodit të Procedurës Penale.

## 8.4 DETYRIMET SHTETËRORE PËR NJË KOMPENSIM EFEKTIV TË VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE. SKEMA SHTETËRORE E DËMSPËRBLIMIT TË VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT

Në Shqipëri krijohet mundësia për të siguruar dëmshpërblimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore nga një skemë shtetërore e kompensimit, nëpërmjet zbatimit të ligjit, nr. Nr. 10 192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar<sup>177</sup>. Rëndësia e këtij ligji qëndron në parashikimin e masave të posaçme për të goditur pasurinë e krijuar si rezultat i veprimtarisë së krimit të organizuar. Ligji parashikon kalimin në favor të shtetit të të gjitha pasurive që konfiskohen me vendim gjykate. Për administrimin e tyre krijohen organe të posaçme. Sidoqoftë, ligji nuk destinohet vetëm për viktimat e trafikimit të qenieve

<sup>175</sup> Shih: Klesta Hysi, *Monitorimi i zbatimit të Reformës në Drejtësi II*, Fakulteti i Drejtësisë Universiteti i Tiranës FDUT, Tiranë, 2020, fq.6, i gjindshëm në: <https://fdut.edu.al/wp-content/uploads/2020/06/Monitorimi-i-Zbatimit-te-Reformes-ne-Drejtësi-2.pdf>

<sup>176</sup> Shih: Klesta Hysi, *Monitorimi i zbatimit të Reformës në Drejtësi II*, Fakulteti i Drejtësisë Universiteti i Tiranës FDUT, Tiranë, 2020, fq. 19.

<sup>177</sup> Ligj nr. 10 192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar me ligj nr. 70/2017, Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin ligj nr. 10 192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", të ndryshuar.



njerëzore, por për të gjitha kategoritë e viktimave të krimit të organizuar.

Në bazë të këtij ligji, mund të evidentojmë dy shtylla kryesore të lidhura ngushtësisht me çështjen tonë: parashikimet për veprimtarinë e organeve të drejtësisë për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe parashikimet për veprimtarinë e organeve publike për miradministrimin e fondeve të krijuara në buxhetin e shtetit nga konfiskimet e pasurive me vendimin e gjykatës.

### Krijimi i fondit të posaçëm

Ky ligj vendos disa forma të administrimit të pasurive të konfiskuara në favor të viktimave të krimit të organizuar, të cilat mund të përdoren si për dëmshpërblimin individual, ashtu edhe për dëmshpërblimin kolektiv të tyre. Ligji parashikon krijimin e një fondi me pasuritë e konfiskuara, i cili ka për qëllim parandalimin e kriminalitetit dhe edukimin ligjor, si dhe nxitjen e programeve sociale për këto kategori (neni 37/2/c e ligjit). Të ardhura të krijuara nga ky fond i posaçëm mund të përdoren për dëmshpërblim individual të viktimave mbi bazën e vendimit gjyqësor, si dhe për mbështetjen, rehabilitimin dhe riaftësimin e viktimave.

### Dëmshpërblimi individual

Në lidhje me dëmshpërblimin individual, ligji ka parashikuar se ky fond shërben për dëmshpërblimin e viktimave të krimit të organizuar dhe të trafikimit në masën e përcaktuar me vendim gjyqësor (neni 37/2/ç i ligjit). Kjo dispozitë nënkupton se ky fond mund të përdoret për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për dëmshpërblimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore. Por praktikisht, deri më sot ka mbetur e pazbatueshme. Procedurat që duhet të ndiqen janë të paqarta. Mungojnë akte nënligjore ose të brendshme për rregullimin e praktikave të punës për Agjencinë përkatëse e administrimit të pasurive të konfiskuara dhe të sekuestruara. “Edhe pse ligji nr. 10 192, datë 3.12.2009 ...parashikon mundësinë e dëmshpërblimit të viktimave të trafikimit sipas vendimit gjyqësor, në asnjë rast nuk kemi ndonjë dëmshpërblim individual të viktimave të trafikimit nga ky fond”<sup>178</sup>. Madje, në përgjigje të kërkesave dhe të përpjekjeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në këtë rast, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara thekson: “Ju sqarojmë se kërkesa juaj drejtuar AAPSK nuk i takon institucionit tonë”<sup>179</sup>. Gjithashtu, ligji nuk ka parashikuar mekanizma automatikë për të kryer *restitutio* ndaj viktimës që ka pësuar dëme. Pasuria e konfiskuar shndërrohet në pronë shtetërore (neni 29) dhe nuk ka parashikime ligjore, se si mund të procedohet për përdorimin e saj për dëmshpërblimin e viktimave. Kjo, ka bërë që parashikimet ligjore për dëmshpërblimin individual të viktimave të trafikimit të mbeten të pazbatuara.

### Përdorimi i pasurisë për qëllime sociale

Këtu parashikohet kalimi i drejtpërdrejtë i pasurive të paluajtshme në pronësi të njërive të qeverisjes vendore ku ndodhet kjo pasuri (neni 37/3/a). Ligji nuk shprehet se si duhet të përdoren nga organet vendore këto pasuri dhe në cilin rast do t’u jepen organizatave jofitimprurëse. Ai parashikon që subjekte të përfitimit nga ky fond janë organizatat jofitimprurëse, që kanë për objekt të veprimtarisë së tyre rehabilitimin social, kulturor e shëndetësor të shtresave në nevojë, veçanërisht atyre të prekura apo të rrezikuara nga krimi, përfshirë organizatat dhe qendrat terapeutike, qendrat e riaftësimin dhe të kurimit të përdoruesve të substancave narkotike, si dhe qendrat e asistencës e të rehabilitimit të viktimave të trafikut të qenieve njerëzore, që, në

<sup>178</sup> Shih: SHADOË REPORT Submitted to the 64th session of CEDAW, cituar, parag.6

<sup>179</sup> Shih shkresën e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dt. 20.07.2018 (Nr.722/1 prot.), drejtuar Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare.

tri vitet e fundit nga paraqitja e kërkesës zhvillojnë veprimtari të tilla për përmbushjen e funksioneve të tyre ose për qëllime sociale (neni 37/3/b). Megjithatë, dispozitat në vijim na bëjnë të kuptojmë se këto financime do të jepen mbi bazën e projekteve, që gjithashtu mbeten rregulla të paqarta. Ligji nuk autorizon ndonjërin prej organeve për të nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e nenit 37. E vetmja mundësi rregullatore mbeten aktet administrative të brendshme.

## 8.5 PENGESAT PËR KOMPENSIMIN E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Jo shumë kohë më parë, viktimat e trafikimit konsiderohej si bashkautorë në veprën penale dhe, madje, dënohej. Ky fakt, e përjashtonte mundësinë e saj për të kërkuar shpërblimin e dëmit në rrugë gjyqësore. Sot, situata ka ndryshuar dhe një viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore mund të shndërrohet palë në procesin penal dhe të kërkojë shpërblimin e dëmit përmes padisë civile në procesin penal. Megjithatë, duhet theksuar se ka mjaft probleme ligjore e praktike që e bëjnë të vështirë zbatimin e legjislacionit shqiptar në këtë pikë. Mund të themi se, disa pengesa kanë shtrirje globale dhe janë të pranishme edhe në shtete të tjera, ndërkohë që disa pengesa të tjera lidhen me mjedisin shqiptar. Këto probleme mund të vijnë nga pamjaftueshmëria e parashikimeve ligjore, por edhe nga faktet sociale. Një pengesë ka qenë mentaliteti popullor shqiptar sipas të cilit, “Nderi dhe jeta nuk blihen me para”. Gjithashtu, mungesa e praktikave dhe e një kulture të posaçme për shpërblimin e dëmit, ndikon mjaft në krijimin e barrierave për të kërkuar kompensimin pranë organeve të drejtësisë. Pengesa krijohen edhe nga mendësi të disa prej punonjësve të shtetit, të cilët aktivitetin e ushtruar nga viktimat e konsiderojnë ende si aktivitet të paligjshëm, i cili nuk meriton dëmshpërblim.

Barriera të tjera lidhen me faktorë proceduralë, si, mungesa e provave të disponueshme për të mbështetur padinë, mosinformimi i viktimave për të drejtat e tyre për kompensim, si dhe vështirësitë që lindin gjatë ekzekutimit të vendimeve të gjykatës. Sistemi i dëmshpërblimit ka nevojë të funksionojë po aq mirë sa mjedisi gjyqësor dhe administrativ në vend. Sot, Shqipëria është ende në kuadrin e masave për reformën në drejtësi. Në këtë kuadër, është e nevojshme që ai të kuptohet si pjesë e funksionimit të shtetit të së drejtës dhe si element përbërës i dhënies së drejtësisë. Ende nuk është konceptuar si i tillë. Në përfundim, mund të themi se të gjitha amendimet e Kodit të Procedurës Penale sjellin një përmirësim të statusit të viktimës në procesin penal, por zbatimi i tyre kërkon një mentalitet të ri, miqësor dhe një angazhim profesional nga të gjitha organet dhe profesionistët e drejtësisë.

Deri tani, ka pasur mjaft raste të pamundësisë për të kërkuar dëmin material e moral në organet kompetente për shkak të shpenzimeve që kërkohen; në të gjitha rastet e njohjes së dëmshpërblimit nga gjykatat nuk kemi asnjë prej tyre të ekzekutuar, për shkak të mungesave në ligj dhe/ose të një kuptimi jo të drejtë të legjislacionit përkatës në këtë fushë; deri tani është konstatuar një mosinteresim dhe mospërgatitje e avokatëve në lidhje me kërkimin e të drejtave të viktimave<sup>180</sup>. Ne mendojmë se faktorët kryesorë për këtë situatë mbeten jo vetëm mungesat në legjislacion, por edhe paragjykimet dhe stigmatizimi ndaj viktimave<sup>181</sup>, i cili vijon ende, si dhe mungesa e efektivitetit në organet e drejtësisë dhe e pafuqisë për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore<sup>182</sup>.

<sup>180</sup> Nga monitorimi i vendimeve gjyqësore gjatë kësaj periudhe në Tiranë, si dhe nga përvojat e organizatave të shoqërisë civile, konstatohet se ka pasur një numër të ulët të kërkesave për dëmshpërblimin e viktimave.

<sup>181</sup> CLCI, Raport, “Promotion of the rights of trafficked persons in Albania”, Tiranë 2015, f.81.

<sup>182</sup> Vendimi gjyqësor që njeht një dëmshpërblim ndaj viktimës së trafikimit D.S., nuk ekzekutohet që nga viti 2014, vit në të cilin ka marrë formë të prerë.

Edhe pse ka pësuar ndryshime, legjislacioni shqiptar nuk garanton dëmshpërblimin e viktimave. Neni 36 i Ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili parashikon konfiskimin e pasurive të ardhura nga krimi njësi si pronar ekskluziv të këtyre pronave, Shtetin. Asnjë prej agjencive shtetërore nuk lejon që përmes tyre të realizohet dëmshpërblimi në favor të viktimave të krimit. Edhe pse ligji “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, parashikon mundësinë e dëmshpërblimit të viktimave të trafikimit sipas vendimit gjyqësor, në asnjë rast nuk kemi ndonjë dëmshpërblim individual të viktimave të trafikimit nga ky fond<sup>183</sup>. Kjo e drejtë nuk është kuptuar mirë edhe nga gjykatat, për të cilat ne mendojmë se duhet të shprehen qartë në vendimet që nxjerrin, për mënyrën e dëmshpërblimit të viktimave, me qëllim që vendimi i tyre të jetë i realizueshëm.

Edhe pse, gjatë procesit të konsultimeve për reformën në drejtësi u paraqitën disa sugjerime nga organizatat e shoqërisë civile, me qëllim përshtatjen e legjislacionit në këtë kuadër, ato u morën në konsideratë pjesërisht, pa e zgjidhur thelbin e problemeve<sup>184</sup>.

## 8.6 MJETET ALTERNATIVE PËR KOMPENSIMIN. ROLI I SHOQËRISË CIVILE

Mbështetja dhe ndihma e shoqërisë civile përqendrohet veçanërisht në ofrimin e ndihmës ligjore falas. Ndiha ligjore falas është lëvruar në 20 vitet e fundit nga organizatat jofitimprurëse dhe ka krijuar një grup avokatësh të shoqërisë civile të specializuar në këtë fushë. Për sa analizuar më sipër, në këtë rubrikë mund të përmbledhim tri mundësi për veprimtarinë e organizatave të shoqërisë civile, me qëllim mbështetjen e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore për kompensimin e tyre.

- ▶▶ Zbatimin e ligjit nr. 10 093, datë 9.3.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë për mbështetjen e shoqërisë civile”, i ndryshuar. Koordinimi i ndihmës në këtë kuadër është i rëndësishëm, sidomos për zbatimin e procedurave ligjore për përzgjedhjen e organizatave që ofrojnë cilësinë më të mirë të shërbimit përmes mbështetjes së viktimave me ndihmë psikologjike, edukim e trajnim profesional dhe shërbime të tjera rehabilituese.
- ▶▶ Zbatimin e ligjit “Për Ndihmën Juridike të garantuar nga Shteti” dhe akteve të tija nënligjore që parashikojnë procesin e kontraktimit të organizatave për ofrimin e ndihmës juridike falas. (shih: paragrafi II/5)
- ▶▶ Zbatimin e ligjit “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, i cili parashikon si subjekte të përfitimit nga fondi i posaçëm i krijuar nga pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara, edhe organizatat jofitimprurëse (shih: pjesa e III-të)

<sup>183</sup> Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në një përgjigje që i kthen CLCI-së në dt. 20.07.2018 (Nr.722/1 prot.), thekson: “Ju sqarojmë se kërkesa juaj drejtuar AAPSK nuk i takon institucionit tonë”.

<sup>184</sup> Këto propozime u paraqitën nga organizata të Koalicionit “Drejtësi për të gjithë”, si dhe nga ekspertë të UNDP, Shqipëri, në lidhje me përmirësimet në ligjin nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar. Efektivisht, u përmirësuan rregullimet në lidhje me fondin që u jepet organeve vendore për zhvillimin e veprimtarive, por jo sa u përket dëmshpërblimit individual të viktimave të trafikimit në bazë të vendimeve gjyqësore.

## **LISTA E STREHËZAVE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË ASISTENCËS PËR VIKTIMAT E TRAFIKIMIT, ANËTARE TË MEKANIZMIT KOMBËTAR TË REFERIMIT**

### **Të ndryshëm dhe të Barabartë, Tiranë**

E-mail: [different&equal@icc-al.org](mailto:different&equal@icc-al.org)

Tel: +35542221892

Website: <http://differentandequal.org/sq/>

### **Tjetër Vizion, Elbasan**

E-mail: [tjetervizion@gmail.com](mailto:tjetervizion@gmail.com)

Tel. +355 54 252919

Website: <https://tjetervizion.org/>

### **Qendra Vatra, Vlorë**

E-mail: [qvatra@icc-al.org](mailto:qvatra@icc-al.org);

Tel: +3553224078

Website: <http://www.qendravatra.org.al/>

# REFERENCA

## Instrumente Ndërkombëtare

- Deklarata Universale e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Organizata e Kombeve të Bashkuara, 1948.
- Direktiva 2011/36BE e Parlamentit European dhe e Këshillit e 5 prillit 2011, mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të këtij trafikimi, dhe zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA.
- Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të e 25 tetorit 2012 “ Vendosja e Standardeve Minimum mbi të Drejtat, Mbështetjen dhe Mbrojtjen e Viktimave të Krimit dhe Zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA.
- Konventa për Ndalimin e Tregtisë së Skllavërvë të Bardhë, 1910.
- Konventa Ndërkombëtare për Ndalimin e Trafikimit të Grave dhe Fëmijëve, 1921.
- Konventa e Lidhjes së Kombeve për Skllavërinë, 1926.
- Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës nr. 29, për Punën e Detyruar, 1930.
- Konventa e Lidhjes së Kombeve për Ndalimin e Trafikimit të Grave në Moshë Madhore, 1933.
- Konventa për Ndalimin e Trafikimit të Personave dhe Shfrytëzimit të Prostitucionit të të tjerëve, 1949.
- Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, Këshilli i Evropës, 1950 (hyri në fuqi në 1953).
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, Organizata e Kombeve të Bashkuara 1979.
- Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, Organizata e Kombeve të Bashkuara 1989.
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, 2000.
- Konventa e Migracionit për Punësim, Organizata Ndërkombëtare e Punës, 1949.
- Konventa nr. 143 Për Punëtorët Migrantë (Dispozita Shtese), Organizata Ndërkombëtare e Punës, 1975.
- Marrëveshja e parë Ndërkombëtare për Sigurimin e Mbrojtjes së Efektshme ndaj Trafikimit kriminal, 1904.
- Konventa e Këshillit të Evropës për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 2005.
- Pakti për të Drejtat Civile e Politike, Organizata e Kombeve të Bashkuara, 1966.
- Pakti për të Drejtat Ekonomike Social e Kulturore, Organizata e Kombeve të Bashkuara, 1966.
- Protokollin kundër Trafikimit të Migrantëve me Rrugë Tokësore, Ajrore dhe Detare, Organizata e Kombeve të Bashkuara, 2000.
- Protokollin për Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkimin e Trafikut të Personave, Veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve
- Protokollin 2014 i Konventës mbi Punën e Detyruar, Organizata Ndërkombëtare e Punës, 1930.
- Rekomandimi nr. (85) 11 i Këshillit të Evropës mbi Pozicionin e Viktimës në kuadrin e Legjislacionit dhe Procedurës Penale.
- Vendimi Kuadër i BE mbi Statusin e Viktimave në Gjykimin Penal, 2001.
- Konventa 95 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës mbi Mbrojtjen e Pagave.
- Konventa 181 e Organizatës Ndërkombëtare e Punës mbi Agjencitë Private të Punësimin.
- Konventa Evropiane e Këshillit të Evropës për Kompensimin e Viktimave të krimeve të dhunshme, 1983.

- Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimi të Pushtetit, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 1985.
- Direktiva e Këshillit të Bashkimit Evropian 2004/80/EC “Për kompensimin e viktimave të krimit”.

#### **Raporte, studime, manuale, artikuj, etj.**

- Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions on the EU Strategy on Combatting Trafficking in Human Beings 2021- 2025, Brussels, 14.4.2021, në [https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/default/files/pdf/14042021\\_eu\\_strategy\\_on\\_combatting\\_trafficking\\_in\\_human\\_beings\\_2021-2025\\_com-2021-171-1\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/default/files/pdf/14042021_eu_strategy_on_combatting_trafficking_in_human_beings_2021-2025_com-2021-171-1_en.pdf)
- CEDAW, Shadow Report Submitted to the 64<sup>th</sup> session of CEDAW, në: [http://www.qag-al.org/ang/publication/shadow\\_report.pdf](http://www.qag-al.org/ang/publication/shadow_report.pdf); i përkthyer në gjuhën shqipe, në: [http://www.qag-al.org/publikime/raporti\\_upr.pdf](http://www.qag-al.org/publikime/raporti_upr.pdf).
- Center for Legal and Civic Initiatives, Report “Promotion of the rights of trafficked persons in Albania”, Tirane 2015.
- ILO, UNICEF dhe UN.GIFT, Manual Trajnimi për luftën kundër trafikimit të fëmijëve, 2009, <https://www.unicef.org/exploitation.html>
- Komiteti i Ekspertëve i ILO-s mbi zbatimin e Konventës së Punës së Detyruar, Anketa e Përgjithshme për punën e detyruar Nr. 29, viti 1930.
- Komiteti i Ekspertëve i ILO-s mbi zbatimin e Konventës së Punës së Detyruar, Anketa e përgjithshme për punën e detyruar, 2007.
- Klesta Hysi, “Monitorimi i zbatimit të Reformës në Drejtësi” II, Fakulteti i Drejtësisë Universiteti i Tiranës FDUT, Tiranë, 2020, në: <https://fdut.edu.al/wp-content/uploads/2020/06/Monitorimi-i-Zbatimit-te-Reformes-ne-Drejttesi-2....pdf>
- Organization for Security and Cooperation in Europe/ODHIR, Mekanizmat Kombëtarë të Referimit: Bashkimi i Përpjekjeve për Mbrojtje të Drejtave të Personave të Trafikuar, Manual Praktik, 2004.
- Organization for Security and Cooperation in Europe/ODHIR, Compensation for Trafficked and Exploited Persons in the OSCE Region, 2008. Organization for Security and Cooperation in Europe, Combating Human Trafficking, Permanent Council Decision No. 557: OSCE Action Plan to Combat Trafficking in Human Beings, <https://www.osce.org/actionplan>
- Organization for Security and Cooperation in Europe, “Trafficking in Human Beings: Identification of Potential and Presumed Victims”, 2011. <https://www.osce.org/files/f/documents/4/e/78849.pdf>
- Prezenca e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë në Shqipëri, “Tipologjia e Trafikimit të Fëmijëve në Shqipëri”, 2020.
- Raporti i 3të i Komisionit Evropian për Parlamentin Evropian dhe Këshillin mbi progresin e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore (2020) në zbatim të Direktivës 2011/36/BE për parandalimin dhe luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave. [https://ec.europa.eu/anti-trafficking/sites/default/files/third\\_progress\\_report.pdf](https://ec.europa.eu/anti-trafficking/sites/default/files/third_progress_report.pdf)
- Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit mbi Trafikimin e Personave, 2020: Shqipëria, [https://al.usembassy.gov/wp-content/uploads/sites/140/TIP\\_ENG.pdf](https://al.usembassy.gov/wp-content/uploads/sites/140/TIP_ENG.pdf).
- Rekomandime për politikën dhe legjislativën drejt zbatimit efektiv të parimit të mosdënimit të viktimave të trafikimit. OSBE, 2014. <https://www.osce.org/files/f/documents/d/c/110471.pdf>
- Raporti i Raportuesit të Posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për Trafikimin e Personave, sidomos të Grave dhe Fëmijëve, A/HRC/41/46, 23 prill 2019.
- Rregullat Minimale Standard të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të miturit (Rregullat e Pekinit 1985)
- Udhëzimi i UNICEF për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Trafikimi, <https://www.unicef.org/protection/>

Unicef\_Victims\_Guidelines\_en.pdf

- UNICEF “Reference Guide on Protecting the Rights of Child Victims of Trafficking in Europe”, 2004.
- Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Kriminalitetit të Rinjtë (Udhëzimet e Riadit)
- UNODC: Database e çështjeve gjyqësore, <https://sherloc.unodc.org/cld/v3/htms/cldb/index.html?lng=en>
- Trafficking and Exploitation: Guidance for health Workers, Scottish Government, October 2019,
- Treguesit e punës së detyruar, ILO, [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed\\_norm/---declaration/documents/publication/wcms\\_203832.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_norm/---declaration/documents/publication/wcms_203832.pdf)
- Zyra e Komisionerit të Lartë për Drogën dhe Krimin, “Abuse\_of\_a\_Position o Vulnerability” [https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/2012/UNODC\\_2012\\_Guidance\\_Note\\_-\\_pdf](https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/2012/UNODC_2012_Guidance_Note_-_pdf)
- Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, “Parimet dhe udhëzimet e rekomanduara për të drejtat e njeriut dhe trafikimin e qenieve njerëzore” <https://www.ohchr.org/documents/publications/traffickingen.pdf>
- Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin, Ligji Model kundër trafikimit të personave i, [https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/2014/UNODC\\_2014\\_Issue\\_Paper\\_Consent.pdf](https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/2014/UNODC_2014_Issue_Paper_Consent.pdf)
- Rezarta Mataj, “Disa sugjerime mbi vlerësimin sa më të drejtë të padisë: Shpërblimi i dëmit jopasuror. Neni 608 dhe 625 i Kodit Civil,” botuar në “Jeta Juridike”, nr. 2, dhjetor 2007.

### Kuadri ligjor vendas

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë 1998, e ndryshuar.
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, 1995, i ndryshuar.
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, 1995, i ndryshuar.
- Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, 2017.
- Ligji nr. 9110 datë 24.07.2003 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave për Krime të Rënda”.
- Ligji 18/2017, “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”.
- Ligjit nr. 10173, datë 22.10.2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”.
- Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.
- Ligji Nr. 98/2017 “Për tarifatat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligj nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 663 datë 17.07.2013 “Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës Kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve të Paligjshme dhe Terrorizmit, 2013-2020 dhe Planit të Veprimit për Vitet 2013-2016”.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 814, datë 26.11.2014 “Për një Shtesë në Vendimin nr. 663, datë 17.7.2013, të Këshillit të Ministrave ‘Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës Kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve të Paligjshme dhe Terrorizmit, 2013-2020, dhe Planit të Veprimit për vitet 2013-2016”.
- Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 499, datë 29.8.2018, “Për Miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit”.

**Jurisprudence e GJEDNJ-së**

- Rantsev v Cyprus and Russia, aplikimi nr. 25965/04, vendim i 7 Janar 2010.
- Siliadin v. France, aplikimi nr. 73316/01, vendim i 26 korrik 2005.
- CN and V. v. France, aplikim nr. 67724/09, vendim i 11 tetor 2012.
- Van der Mussele v. Belgium, aplikim nr. 8919/80, vendim i 23 nëntor 1983.
- Stummer v. Austria, aplikim nr. 37452/02, vendim i 7 korrik 2011.
- M. and others v. Italy and Bulgaria, aplikimi nr. 41416/08, vendim i 31 korrik 2012.
- C.N. v. kundër Mbretërisë së Bashkuar aplikim nr. 4239/08, vendim i datës 13 nëntor 2012.
- J. and Others v. Austria, aplikimi nr. 58216/12 vendim i 17 janar 2017, parag. 118.
- Chowdury and others v. Greece, aplikim nr. 21884/15, vendimi i 30 mars 2017.
- L.E. v. Greece, aplikim nr. 71545/12, vendim i 21 janar 2016.

**Jurisprudencë vendase**

- Vendimi nr. 19, dt. 20.03.2008 i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda.
- Vendimin nr. 31, datë 14.06.200 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.
- Vendimin nr.47, datë 23.10.2007 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.
- Vendimi nr. 72, datë 23.10.2008 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.
- Vendimi nr. 44, datë 02.07.2012 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.
- Vendimi nr. 5, datë 17.01.2008 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.
- Vendimi nr. 135, datë 27.07.2016 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.
- Vendim i datës 4.4.2016 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda.
- Vendim nr. 77, datë 19.07.2017 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.
- Vendimi nr. 47 datë 28.07.2009 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.







Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
**Prezenca në Shqipëri**